

SIGURIA NJERËZORE DHE PËRGJEGJËSIA E SHTETIT

BESIM KUSARI

Dorëzuar:
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca
Juridike, me profil e Drejta Publike, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: **PhD. MIRGEN PRENÇE**

Numri i fjalëve: 53.156

Korrik 2016, Tiranë

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim shkencor është shkruar nga unë, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Autori: Besim KUSARI

ABSTRAKT

Siguria njerëzore në vazhdimësi rrezikohet nga kërcënimet e tilla si: dhuna fizike, krimi, terrorizmi, dhuna në familje, punësimi i fëmijëve, papunësia dhe varfëria e vazhdueshme, sëmundjet vdekjeprurëse infektive, mungesa e qasjes në kujdesin themelor shëndetësor, ushqimi i pasigurt, skamja, uria dhe kequshqyerja, degradimi dhe ndotja e mjedisit dhe burimeve, fatkeqësitë natyrore, tensionet ndëretnike, fetare dhe tensionet tjera në bazë të identitetit, represioni politik dhe abuzimet e të drejtave të njeriut. Obligimet ndërkombëtare për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e shteteve, ka sjellë në fokus edhe obligimin e shteteve, për mbrojtjen e segmenteve të sigurisë njerëzore, duke përfshirë: sigurinë politike, personale, të bashkësisë, ekonomike, ushqimore, mjedisore dhe sigurinë shëndetësore.

Siguria njerëzore e qytetarëve të Kosovës është përgjegjësi e vet shtetit të Kosovës dhe si e tillë është e garantuar me Kushtetutë dhe e mbrojtur përmes normave penalo juridike e në veçanti me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, të cilat edhe janë objekt shqyrtimi i këtij studimi. Për qëllime krahasimore janë marrë edhe shtetet si: Slovenia, Kroacia, Serbia dhe Gjermania duke shikuar në mënyrën e mbrojtjes, përmes normave, të sigurisë njerëzore në këto shtete në raport me Kosovën. Rritja e sigurisë njerëzore konsiston drejtpërdrejtë me ngritjen e nivelit të mirëqenies ekonomike, sociale dhe politike e poashtu edhe të mirëjetesës dhe standardeve të jetesës më të mirë.

Nga punimi rezulton se në Kosovë pasiguria njerëzore rrjedh si pasojë e qeverisjes së dobët, zhvillimit të pamjaftueshëm shtetëror dhe vet shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e pushtetit shtetëror.

Studimi vën në fokus nevojën e pushtetit shtetëror për të parandaluar pasigurinë njerëzore përmes mjeteve dhe akterëve të përcaktuar në këtë punim. Për mbrojtjen e sigurisë njerëzore egziston një dualitet në mes sovranitetit të shtetit si bartës i përgjegjësisë dhe diplomacisë ndërkombëtare me rastin e bartjes së sovranitetit përmes ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe formave tjera të montorimit për t'u siguruar që siguria njerëzore është arritur.

Për një nivel të kënaqshëm të sigurisë njerëzore nuk mjafton vetëm angazhimi i shtetit apo edhe kapaciteteve rajonale. Ekuilibri në realizimin e qëllimit (*siguria njerëzore*) realizohet me pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, të cilët janë konsumues të sigurisë njerëzore. Ata më së miri mund të kontribuojnë në identifikimin e rreziqeve dhe luftimin e tyre në partneritet me vet shtetin.

Fjalët kyqe: Siguria njerëzore, qytetari, të drejtat dhe liritë e njeriut, mirëqenia, shteti.

ABSTRACT

Human security is continuously endangered by various threats such as: physical violence, crime, terrorism, domestic violence, child labor, unemployment and continuous poverty, deadly infectious diseases, lack of access to basic health services, lack of food, poverty and malnutrition, degrading and environmental pollution, natural disasters, inter-ethnic, religious and other identity based tensions, political repression and human rights abuse.

The international obligation for respecting human rights and freedoms by the state has brought to focus also the obligation of states to protect human security segments to include: political, personal, community, economic, food, environment and health security.

Human security of citizens of Kosova is the responsibility of the state itself and thus is guaranteed by the Constitution and protected thorough criminal legal norms in particular the Criminal Code of Republic of Kosova, norms which are the object of this study. Countries like Slovenia, Croatia, Serbia and Germany have been viewed for the purpose of comparison on how these countries provide protection of human security in relation with Kosova. The increase of human security correlates directly with the increase of the economic, politic and social welfare, as well as the increase if liveability standard. The study shows that human insecurity in Kosovo results from poor governance, insufficient state development and the violation of human rights by the government.

The study places the focus on the requirement that the government must prevent human insecurity through means and actors specified in this study. There is a dual role in protecting human security, with one role being on the state as bearer of the sivereignty and the international diplomacy through shifting of sovereignty by the ratification of

international agreements and other forms of monitoring in order to ensure that human security is achieved.

Only the engagement of state or even of the regional capacity is not sufficient for a satisfactory level of human security. The balance in achieving this goal (human security) is best accomplished through active citizen participation as consumers of human security. They can best identify threats and fight against these threats in partnership with the government.

Key words: Human security, citizen, human rights and freedoms, welfare, state.

Dedikimi:

Për ty BENINA, miku im i jetës.

FALENDERIME

Falenderim i veçantë i dedikoj Beninës, bashkëshortes sime, për mbështetjen dhe kontributin e saj të çmuar, gjatë realizimit të këtij punimi shkencor. Në anën tjetër, i'u kërkoj falje fëmijëve tanë: Noliana, Arba dhe Flori, për përkushtimin e mungur prindëror gjatë studimit për raealizimin e këtij punimi shkencor. Falenderimi ndaj prindërve të mi, do të jetë i përjetshëm, me shpresën se finalizimi i studimit, do të jetë dhuratë e bukur për pleqërinë e tyre.

Falenderim të veçantë ia dedikoj udhëheqësit doktoral z. Mirgen Prençe, i cili në kohën e duhur, përmes angazhimit dhe bashkëpunimit ka ndikuar që ky punim të arrijë standardet më të mira.

Falenderimi miqësor i'u takon miqve, për ndihmën e pakursyer në sigurimin e literaturës së nevojshme dhe qasjen në libraritë digjitale, të cilat më kanë ndihmuar në finalizimin e studimit.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I: HYRJE

1.1	Shtrimi i problemit.....	1
1.2	Qëllimi i studimit.....	2
1.3	Hipoteza e punimit.....	4
1.4	Pyetjet kërkimore të punimit.....	6
1.5	Metodat dhe metodologjitë e kërkimit.....	6
1.6	Mundësitë dhe kufizimet.....	8

KAPITULLI II: ORIGJINA DHE DEBATI TEORIK.

2.1	Vështirimi historik.....	10
2.2	Dimensioni socio juridik dhe filozofik.....	16
2.3	Ngjashmëritë dhe dallimet: siguria njerëzore, tradicionale dhe rendi publik...	20

KAPITULLI III:

SIGURIA NJERËZORE SIPAS AKTEVE NDËRKOMBËTARE

3.1	Trajtimi i sigurisë njerëzore përmes të Drejtave të Njeriut.....	25
3.2	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.....	29
3.3	Konventa dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.....	31
3.4	Aktet tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.....	33

KAPITULLI IV:

PËRGJEGJËSIA SHTETIT PËR T'I MBROJTUR QYTETARËT

4.1	Shteti: mes mbrojtësit dhe shkelësit të sigurisë njerëzore.....	36
4.2	Pasiguria njerëzore si pasojë e qeverisjes së dobët.....	38
4.3	Pasiguria njerëzore si pasojë e dhunës politike.....	40
4.4	Politikat e parandalimit dhe reagimit ndaj pasigurisë njerëzore.....	42

KAPITULLI V: PARANDALIMI DHE MBROJTJA E SIGURISË

NJERËZORE PËRMES LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS

5.1	Vështrim historik.....	45
5.2	Efekti i akteve ndërkombëtare në legjislacionin e Kosovës.....	48
5.3	Rreziqet aktuale të sigurisë njerëzore në Kosovë.....	57
5.4	Mbrojtja penale e segmenteve të sigurisë njerëzore.....	63
5.4.1	Mbrojtja nga pasiguria politike.....	64
5.4.2	Mbrojtja nga pasiguria personale.....	72
5.4.3	Mbrojtja nga pasiguria e bashkësisë.....	78
5.4.4	Mbrojtja nga pasiguria ekonomike.....	85
5.4.5	Mbrojtja nga pasiguria ushqimore.....	96
5.4.6	Mbrojtja nga pasiguria mjedisore.....	101
5.4.7	Mbrojtja nga pasiguria shëndetësore.....	112
5.5	Politika ndëshkimore si mjet për forcimin e sigurisë njerëzore.....	121

KAPITULLI VI:

SIGURIA NJERËZORE SIPAS LEGJILACIONIT TË DISA SHTETEVE:

VËSHTRIM JURIDIK KRAHASUES

6.1	Vështrim historik.....	126
6.2	Kundërpërgjigjet shtetërore.....	128
6.2.1	Slovenia.....	129
6.2.2	Kroacia.....	138
6.2.3	Serbia.....	149
6.2.4	Gjermani.....	157

KAPITULLI VII: EKUILIBRI I PJESEMMARRJES

7.1	Mekanizmat vendor të sigurisë.....	163
7.2	Qytetaria pjesëmarrëse.....	167
7.3	Kapacitetet rajonale të sigurisë.....	169

KAPITULLI VIII: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

8.1	Konkluzione.....	171
8.2	Rekomandime.....	178

LISTA E REFERENCAVE/BIBLIOGRAFIA.....	183
--	------------

LISTA E TABELAVE

Figura 4.2.1	Pasiguritë si pasojë qeverisjes së dobët.....	38
Figura 4.2.2	Mjetet e parandalimit/reagimit ndaj pasigurisë nga qeverisja e dobët..	39
Figura 4.2.3	Aktorët e parandalimit dhe reagimit ndaj pasigurisë nga qeverisja.....	39
Figura 4.3.1	Pasiguritë si pasojë dhunës politike.....	41
Figura 4.3.2	Mjetet e reagimit ndaj pasigurisë.....	41
Figura 4.3.3	Aktorët e reagimit ndaj pasigurisë.....	42
Figura 4.4.1	Orientimet shkakësore-kauzaliteti.....	43
Figura 4.4.2	Politikat e parandalimit dhe reagimit.....	44
Figura 5.2.1	Kërcënimet ndaj sigurisë politike dhe mbrojtja kushtetuese.....	49
Figura 5.2.2	Kërcënimet ndaj sigurisë personale dhe mbrojtja kushtetuese.....	50
Figura 5.2.3	Kërcënimet ndaj sigurisë ekonomike dhe mbrojtja kushtetuese.....	51
Figura 5.2.4	Kërcënimet ndaj sigurisë shëndetësore dhe mbrojtja kushtetuese.....	53
Figura 5.2.5	Kërcënimet ndaj sigurisë ushqimore dhe mbrojtja kushtetuese.....	53
Figura 5.2.6	Kërcënimet ndaj sigurisë mjedisore dhe mbrojtja kushtetuese.....	55
Figura 5.2.7	Kërcënimet ndaj sigurisë së bashkësisë dhe mbrojtja kushtetuese.....	57
Figura 5.4.6.1	Emisionet aktuale dhe limitet e ndotjes së ajrit.....	106
Figura 5.4.6.2	Emisionet e CO ₂ , nga TC “Kosova A” dhe TC “Kosova B”.....	107
Figura 5.4.6.3	Burimet e gazrave serë.....	107
Figura 6.2.1.1	Kërcënimet e sigurisë njerëzore në Sloveni dhe mbrojtja kushtetuese...	131
Figura 6.2.2.1	Kërcënimet e sigurisë njerëzore në Kroaci dhe mbrojtja kushtetuese...	139
Figura 6.2.3.1	Kërcënimet e sigurisë njerëzore në Serbi dhe mbrojtja kushtetuese.....	151
Figura 6.2.4.1	Kërcënimet e sigurisë njerëzore në Gjermani dhe mbrojtja kushtetuese	158
Figura 7.3.1	Fuqia e sigurisë në rajon.....	170

LISTA E SHKURTIMEVE

ACA	Autoriteti civil i aviacionit
AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
BE	Bashkimi Evropian
BH	Bosnja dhe Hercegovina
DoJ	Departamenti i Drejtësisë së Amerikës
DPPI	Nisma për Përgatitje dhe Parandalim ndaj Katastrofave
DSP	Departamenti për Siguri Publike në Kosovë
DUDNj	Deklarata Universale për të drejta e njeriut
EULEX	Misioni i Evropës për zbatimin e ligjit në Kosovës
EUROSTAT	Institucioni i statistikave të Evropës
EVSB	Ekipet e Veprimit për Siguri në Bashkësi
FAK	Forcat e Armatosura të Kosovës
FAO / OBSH	Organizata ushqimore dhe agrikulturës në kuadër të OKB-së
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
GIZ	Organizatë qeveritare Gjermane për zhvillim ndërkombëtar
GJED	Gjykata Evropiane e Drejtësisë
GJEND	Gjykata Evropiane për të Drejtave të Njeriut
GjSK	Gjykata Supreme e Kosovës
GjSRK	Gjykata Supreme e Republikës së Kroacisë
HCHRO	Zyra e komesarit të lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut
HIV	Virusi i mungesës së imunitetit njerëzor

ICITAP	Programi për ndihmë në trajnime për hetimin e krimit – SHBA
IT	Internacional Transparency
KE	Komisioni Evropës
KEDNJ	Konveta Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KEK	Koorporata Energjetike e Kosovës
KEMM	Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit përmes së Drejtës Penale
KFOR	Forca Ushtarake e misionit të NATO-s, në Kosovës
KGJ	Kushtetuta e Gjermanisë
KKo	Kushtetuta e Kosovës
KKr	Kushtetuta e Kroacisë
KKSB	Këshilli Komunal për Sigurinë në Bashkësi, Kosovë
KKVK	Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e përkohshme të Kosovës
KNDESK	Konveta Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
KNDF	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve
KP	Kodi Penal
KPGJ	Kodi penal i Gjermanisë
KPK	Kodi Penal i Kroacisë
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
KPSe	Kodi Penal i Serbisë
KPSl	Kodi Penal i Slovenisë
KS OKB	Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara

KSB	Komuniteti për Siguri
KSe	Kushtetuta e Serbisë
KSE	Karta Sociale Evropiane
KSK	Këshilli Sigurisë së Kosovës
KSI	Kushtetuta e Slovenisë
KUE	Këshilli i Uninit Evropian
LPK	Ligji Penal i Kosovës (i vjetër)
LPS	Ligji Penal i Serbisë
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizata Jo Qeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri e Bashkimit Evropian
PK	Policia Kososovës
Qarkore	Urdhëresë e lëshuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës
TBE	Traktati i Bashkimit Evropian
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni administrues i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

KAPITULLI I: HYRJE

1.1 Shtrimi i problemit

Mirëqenia, lumturia dhe standardi i jetesës së çdo qytetari dhe çdo familje, është në varësi të nivelit egzistues të sigurisë njerëzore në një shtet.

Në një shekull ku globalizimi ka zënë vend në agjendat prioritare ndërkombëtare dhe shtetërore, shpesh vërehet përzierja e koncepteve të sigurisë. Çdoherë kur përmendet fjala ‘Siguri’, vëmendja fillimisht tërhiqet tek rendi publik (*vendor dhe ndërkombëtar*); siguria e përgjithshme dhe siguria globale.

Me zhvillimet në dekadën e fundit, fokusi mbi sigurinë është kthyer në kërcënimet nga sulmet terroriste, të cilat kanë potencialin e destabilizimit të rajoneve të tëra. Megjithatë, secili nga ne, si individ, ka nevojat e përditshmërisë, të cilat lidhen me sigurinë dhe mirëqenien tonë individuale. Këto nevoja i referohen kërkesës për një mjedis të pastër, ushqim të sigurt, shërbime adekuate shëndetësore, mosrrezikim të ekzistencës ekonomike, nevojës për jetesë dinjitoze dhe të barabartë për të gjithë, duke anashkaluar diferencat që mund të kemi mes vete.

Të gjitha këto të drejta të njeriut për një mirëqenie të mirëfilltë, barazohen në atë që quhet “Siguri njerëzore”. Për të arritur mbrojtjen e sigurisë njerëzore, njëjtë sikur edhe te siguria tradicionale, ekziston nevoja që shteti të materializojë mbrojtjen përmes legjislacionit dhe mbrojtjes në praktikë të këtij segmenti.

Dukuritë asociale dhe kriminale të shoqërisë, kërkojnë ofrimin e mbrojtjes adekuate të sigurisë së individit, e cila më pas do të reflektojë në sigurinë e përgjithshme, për arsye se siguria njerëzore është parakusht për sigurinë e përgjithshme. Siguria njerëzore apo e

individit duket të mos jetë ende në agjendat prioritare të institucioneve shtetërore, për faktin se institucionet dështojnë të bëjnë partneritet me vet qytetarin, për të identifikuar më lehtë shqetësimin dhe për të kuptuar më mirë masat që duhen të ndërmerren në kontekstin e parandalimit dhe mbrojtjes së sigurisë njerëzore nga kërcënimet e vazhdueshme.

1.2 Qëllimi studimit

Qëllimi i studimit është analizimi i segmenteve të sigurisë njerëzore në disa aspekte të ndryshme, me qëllim të identifikimit, njohjes dhe kuptimit të dimensioneve të ndryshme të sigurisë njerëzore.

Pjesë e studimit është edhe analizimi i veçorive, përjashtimeve, kontraditave dhe paradigmes së sigurisë njerëzore në raport me sigurinë tradicionale dhe rendin publik.

Për të gjetur vendin e segmenteve të sigurisë njerëzore në rregullativën e një shteti, studimi ka për synim analizimin e sigurisë njerëzore në raport me normativën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut; Jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*në disa nga segmentet e sigurisë njerëzore*); Rregullimin përmes normave kushtetuese të sigurisë njerëzore në Republikën e Kosovës; dhe Kodifikimin penal të kërcënimeve që rrezikojnë sigurinë njerëzore.

Fokusi kryesor i studimit është analizimi dhe vlerësimi i përgjegjësisë së shtetit në garantimin dhe mbrojtjen e segmenteve të sigurisë njerëzore në Republikën e Kosovës.

Politika ndëshkimore si mjet për forcimin e sigurisë njerëzore, poashtu do të jetë pjesë e studimit, duke u fokusur më qështjen e zbatimit praktik të normave penale që mbrojnë segmentet e sigurisë (*Kodifikimi*), nga kërcënimet.

Studimi përmban edhe analizën krahasimore të normativës ligjore të disa shteteve, objekt të studimit, në kontekstin e mbrojtjes penale të segmenteve të sigurisë njerëzore.

Pjesë e studimit, do të jenë ato shtete të rajonit, me të cilat Republika e Kosovës, kishte një histori të përbashkët bashkëjetese në ish.jugosllavi. Pjesë e kësaj analize krahasimore do të jetë edhe normativa ligjore e Republikës së Gjermanisë, si një nga vendet më të zhvilluara evropiane, përveç tjerash, edhe për mënyrën e trajtimit të sigurisë njerëzore në një shtet të konsoliduar, dhe në shërbim të qytetarëve.

Një fokus të studimit do të jetë identifikimi dhe njohja e kërcënimeve dhe reflektimi apo angazhimi i institucioneve shtetërore në parandalimin dhe mbrojtjen e segmetneve të sigurisë njerëzore.

Pjesë e rëndësishme e studimit do të jetë edhe njohja dhe vlerësimi i kontributit të qytetarëve në identifikimin e shqetësimeve mbi sigurinë njerëzore dhe bashkëpunimi i tyre me institucionet lokale dhe shtetërore, në ngritjen e nivelit të sigurisë njerëzore.

Synimi i përgjithshëm i këtij studimi është ngritja e përgjithshme e vetëdijes së institucioneve shtetërore dhe qytetarëve, lidhur me përgjegjësinë që ata bartin, për ruajtjen e sigurisë njerëzore.

Qytetarët përveç nevojës për ndjenjën e sigurisë, duhet të jenë bashkëpjesëmarrës, krahas institucioneve, në parandalimin dhe mbrojtjen e sigurisë njerëzore nga kërcënimet. Sepse, gjendja e mirë e sigurisë njerëzore, mundëson promovimin e dinjitetit dhe mundëson plotësimin e nevojave themelore të qytetarit, kjo për faktin se liria e qytetarit përfshinë lirinë nga nevoja.

Të drejtat themelore të njeriut nuk mund të zhvillohen nëse qytetarët nuk kanë qasje në ushqim të mjaftueshëm, ujë të pijshëm apo medikamente, për të cilat dhe për të jetuar, ata kanë nevojë çdo ditë.

Promovimi i sigurisë njerëzore duhet të jetë interes moral dhe strategjik i Institucioneve të Republikës së Kosovës, me qëllim të realizimit të nevojave të qytetarëve për mirëqenie, lumturi dhe për ngritjen e standardit të jetesës. Të gjitha këto nevoja, nën ombrellën e kërkesës për siguri njerëzore, garantimi dhe mbrojtja e të cilës është përgjegjësi e shtetit, si bartëse e sorvanitetit të shtetit.

1.3 Hipoteza e punimit

Hipoteza si një lloj i veçantë I pyetjeve të hulumtimit, e që në fakt nuk është pyetje, por një pohim ose shprehje e marrëdhënieve midis dy ose më shumë koncepteve, e cila më shumë është e nënkuptueshme sesa e shprehur, dhe si e tillë mund të provoj ose të hedh poshtë lidhjen e koncepteve mes njëra tjetrës.

Hipoteza e punimit: “Pasiguria si pasojë e sundimit të dobët të ligjit dhe keqqeverisjes, kërcënon të gjitha segmentet e sigurisë njerëzore”?

Fokusi i analizës për vërtetimin e hipotezës, zhvillohet në mes:

(1) Pasigurisë njerëzore si dhunë politike (variabël e varur), dhe

(2) Shkaqet e pasigurisë njerëzore si dhunë politike që përfshijnë problematikën e qeverisjes së dobët dhe zhvillimin e pamjaftueshëm shtetëror (variabla e pavarur).

Shkaqet e pasigurisë njerëzore si pasojë e dhunës politike përfshijnë qeverisjen e dobët dhe zhvillimin e pamjaftueshëm shtetëror, dhe të cilat do të konsiderohen si ‘Variabla të pavarura’.

Kauzaliteti i lidhjeve mund të jetë shumë faktorial dhe me ndërlidhje të shumta, si: kërcënimet nga papunësia apo tensionet ndëretnike mund të kenë lidhje kauzaliteti me dhunën politike. Kauzaliteti mund të reflektojë me një raport të ndërlidhur reciprok të

papunësisë dhe të zhvillimit të pamjaftueshëm të shtetit, e cila, jo vetëm që mund të kategorizohen si shkak - pasojë e dhunës politike, por mund të rezultojë (të krijojë pasoja) në rritjen e papunësisë dhe ngecjen e zhvillimit ekonomike të shtetit.

Në kuadër të verifikimit të hipotezës, pretendojmë që variabli apo ndryshori do të rezultojë me konstatimin se: të dhënat të cilat do të mbledhen dhe analizohen gjatë studimit, kanë një numër të madh të dallimeve në dimensione të ndryshme.

Variablat do të shërbejnë edhe si rregulla, për klasifikimin e kërcënimeve të segmenteve të sigurisë në kategori të ndryshme (*psh: nga dhuna politike dhe nga qeverisja e dobët*). Variablat apo ndryshorët, mund të jenë diskret në kontekstin e çështjeve, si psh; qeverisja e pushtetit, mund të jetë e mirë apo e keqe, apo mund të jetë subjekt apo jo, i shkakut të dhunës politike.

Meqenëse variablat mund të rezultojnë të vazhdueshme, gjatë analizës së objektit të studimit do të analizojmë nivelin e demokracisë së shtetit në relacion me garantimin dhe mbrojtjen e segmenteve të sigurisë njerëzore dhe të drejtave dhe lirive të njeriut.

Konsiderojmë mundësinë që variabla e varur, “*Pasiguria njerëzore si dhunë politike*”, mund të influencojë nivelin e demokracisë dhe mbrojtjen e sigurisë njerëzore, ndërsa, përse i përket variablës së pavarur “*Shkaqet e pasigurisë njerëzore si dhunë politike që përfshijnë problematikën e qeverisjes së dobët dhe zhvillimin e pamjaftueshëm shtetëror*”, konsiderojmë që analiza të arrijmë të vertetojmë se shkaqet e pasigurisë njerëzore, janë pasojë e keqeverisjes dhe zhvillimit të pamjaftueshëm shtetëror që konvertohet si dhunë politike.

1.4 Pyetjet kërkimore të punimit

Pyetjet kërkimore si çështje me rëndësi thelbësore në punimin shkencor, kanë funksion të dyfishtë, në njërën anë shprehin qëllimin e punimit kërkimor, dhe në anën tjetër, sistemojnë procesin kërkimor.

Pyetjet kërkimore të punimit shkencor janë:

1. Cili është kuptimi i sigurisë njerëzore?
2. Cilët segmente përbëjnë sigurinë njerëzore?
3. Cilat kërcënime rrezikojnë sigurinë njerëzore në Kosovë?
4. Çfarë trajtimi i kushtohet sigurisë njerëzore përmes normave penalo juridike, normave kushtetuese dhe normave ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut?
5. Sa efektive është mbrojtja e sigurisë njerëzore vetëm përmes të drejtës materiale?

1.5 Metodat dhe metodologjitë e kërkimit

Metodologjitë e kërkimit, për studimin e temës së punimit shkencor mbështeten parimisht në: Pikëpamjet doktrinale; legjislacionin penal; të drejtat dhe liritë e njeriut; dhe praktikën gjyqësore.

Përzgjedhja e pyetjeve kërkimore të punimit, ka qenë përcaktuese për zgjedhjen e metodave kërkimore për grumbullimin e të dhënave. Mbi bazën e të dhënave të grumbulluara do të realizojmë njohjen e origjinës dhe konceptin teorik të sigurisë njerëzore në Republikën e Kosovës, përgjatë periudhave caktuara kohore. Periudhat kohore do të kategorizohen në: Periudhën para dhe periudhën e pas luftës së vitit 1999. Të dhënat e grumbulluara do të shërbejnë për analizmin dhe vlerësimin e ngjashmërive dhe dallimeve konceptuale të segmenteve të sigurisë njerëzore me kuadrin e normativës ligjore të

Kosovës, si dhe aspektin krahasimor me legjislacionine shteteve, objekte të përcaktuar të studimit.

Kuadri bashkëkohor aktual i metodologjive kërkimore përfaqësohet nga katër llojet e metodologjive kërkimore: (1) Metodologjinë eksperimentale, (2) Metodologjinë përfaqësimore, (3) Metodologjinë afatgjate, dhe (4) Metodologjinë e rastit të studimit (Matthews, 2010:57).

Përzgjedhja e pyetjeve kërkimore dhe hipotezën kanë qenë përcaktuese në zgjedhjen e Metodologjisë përfaqësimore të kërkimit, në realizimin e studimit të punimit shkencor. Kjo metodë ndryshe njihet edhe si “Prerja e tërthortë”, dhe pasqyron një tablo përfaqësimore të shoqërisë në një periudhë të caktuar kohore. Metodologjia përfaqësimore e kërkimit konsiston në studimin shkencor përmes zbatimit të vrojtimit dhe dokumenteve.

Në kuptimin e dokumenteve të studimit i referohemi: (1) Dokumenteve që përmbajnë të dhëna cilësore, duke përfshirë raportet dhe gjetjet e projekteve të hulumtimit; dhe (2) Dokumente zyrtare dhe institucionale, informacione dhe interpretime personale.

Zbatimi i metodogjisë përfaqësimore të kërkimit I adresohet dy strategjive të kërkimit, apo planeve të veprimit:

1. **Strategjia kërkimore krahasuese**, e cila konsiston në identifikimin e ngjashmërive dhe dallimeve të dy apo më shumë çështjeve apo dukurive.
2. **Strategjia kërkimore vlerësuese**, e cila konsiston në identifikimin e praktikave dhe proceseve të ndryshme, si dhe vlerësimin e ndikimit të tyre në situata të caktuara.

Metodat e kërkimit. Theksojmë se përzgjedhja e hipotezës dhe pyetjeve kërkimore ka përcaktuar llojet e metodave kërkimore për grumbullimin e të dhënave. Poashtu, në përzgjedhjen e metodave kërkimore dhe nga aspekti i temës së hulumtimit, që janë focusi

më kryesor, vëmendje të veçantë i kushtojmë debateve të përgjithshme mbi mbledhjen e të dhënave, e të cilat rrjedhin nga këndvështrime të ndryshme epistemologjike dhe ontologjike, që përshkruhet si debati sasior/cilësor (Matthews, 2010:57).

Për realizimin e studimit shkencor, respektivisht për grumbullimin e të dhënave, do të përdorim dy lloje të metodave kërkimore:

1. **Metoda cilësore**, për mbledhjen e të dhënave cilësore, përmes shqyrtimit të literaturës së kualifikuar shkencore, me qëllim të analizimit të koncepteve, teorive, mendimeve dhe bindjeve mbi çështjet që lidhen me sigurinë njerëzore.

2. Metoda sasiore, për mbledhjen e të dhënave sasiore me qëllim të analizimit dhe vlerësimit të çështjeve dhe mekanizmave, objekt të studimit në kuadër të punimit.

Meqenëse analizimi i të dhënave cilësore, në një shkallë të madhe varet nga interpretimi i të dhënave të papërpunuara, procesin e analizimit të të dhënave të grumbulluara do të realizojmë edhe gjatë kohës së grumbullimit të tyre.

Me qëllim që analiza e të dhënave të grumbulluara të ketë nivel të lartë të besueshmërisë, gjatë studimit do të realizojmë qasjen analitike sistematike dhe gjithëpërfshirëse, që nënkupton se gjatë analizës do të realizojmë procedura të njëjta, qasje të hapur dhe të kuptueshme.

1.6 Mundësitë dhe kufizimet

Mundësitë:

Konsiderojmë se për realizimin e punimit shkencor, përfitimet nga mundësitë konsistojnë në këto çështje:

- Koncepti mbi sigurinë njerëzore, nuk njihet mjaftueshëm në shoqërinë Kosovare, ngase nuk trajtohet mjaftueshëm në aspektin shkencor dhe akademik.

- Eksistenca e akteve të mjaftueshme ndërkombëtare që trajtojnë të gjitha segmentet e sigurisë njerëzore.
- Literatura e mjaftueshme shkencore në gjuhën angleze dhe në gjuhët tjera.
- Çasja në bibliotekat e ndryshme, për kërkimin e literatures që i kushtohet segmenteve të sigurisë njerëzore dhe punimeve të kualifikuara shkencore.

Kufizimet:

Shkrimet shkencore zakonisht kanë të parapërcaktuara rregullat dhe kufizimet e punimit dokoral. Sa më shumë jemi thelluar në studim, aq më tepër jemi tunduar nga dëshira që në punim të përfshijmë sa më shumë të gjetura, mirëpo në respektim të rregullave të përcaktuara, kemi bërë redaktime të mundshme duke qenë të kujdesshëm që të mos temat të mos humbin kuptimin e tyre. Theksojmë se për realizimin e punimit të kualifikuar shkencor, kemi tejkaluar kufizimet me të cilat jemi ballafaquar gjatë hartimit të punimit. Kufizimet kanë konsistuar në:

- Mungesën e literaturës së kualifikuar në gjuhën shqipe, që trajton sigurinë njerëzore;
- Kufizimin në përdorimin e zhargoneve apo termave të ndryshëm, përdorimi i të cilave do të mund të krijonte paqartësi në të kuptuarit e tematikave të parashtruara në kuadër të pjesëve të veçanta të punimit;
- Gjatë punimit kemi qenë të kufizuar nga përdorimi i shkurtesave, edhe pse teknikisht është e pranueshme që ato të përkufizohen herën e parë, mirëpo, shkurtesat nuk i kemi përdorur nëse për ato bëhej fjalë në një faqe tjetër pasuese apo në faqe tjera të punimit.

KAPITULLI II: ORIGJINA DHE DEBATI TEORIK

2.1 Vështrimi historik

Origjina e sigurisë njerëzore në Kosovë, pashmangshëm lidhet me historinë e shkurtër të saj, duke përfshirë fazën e bashkëjetesës së përbashkët në ish Jugosllavi si dhe fazën pas luftës së vitit 1999. Gjersa në fazën e parë, në kohën e ish Jugosllavisë siguria njerëzore nënkuptonte angazhimin e dhunës shtetërore në parandalimin e dukurive që kërcënojnë sigurinë njerëzore në njërin anë, ndërsa në anën tjetër dhuna politike përdorej ndaj gjithë atyre pjesëtarëve të kombeve tjera, të cilët në mënyrë të vazhdueshme kërkonin trajtim të barabartë në aspektin e të drejtave dhe lirive të njëriut. Për më tej, gjersa në kohën e ish Jugosllavisë siguria njerëzore kërcënohej nga abuzimi shtetëror me të drejtat e njëriut, në fazën e dytë siguria njerëzore në Kosovë kërcënohet nga qeverisja e dobët dhe zhvillimi i ngadalshëm ekonomik. Në fazën e parë, pushteti shtetëror angazhohej që me çmimin e ruajtjes së interesave shtetërore të sakrifikonte të drejtat dhe liritë themelore të njëriut, duke keqtrajtuar, burgosur dhe eliminuar (vlarë), të gjitha ata qytetarëve të cilët përmes demonstratave dhe protestave të vazhdueshme kërkonin respektimin e parimit të barazisë qytetare.

Pavarësia e Kosovës dhe lirimi nga regjimi serb nuk ishin të mjaftueshme për mirëjetesën e qytetarëve, për arsye se, nevojat në rritje për një standart më të lartë të jetesës shtrihen shumë gjërë. Standardet e jetesës përfshijnë lirinë nga frika, si kërcënim i vazhdueshëm i kriminalitetit, dhe bashkëjetesën në bashkësi, duke përfshirë aspektin etnik, fetar dhe të identitetit.

Paslufta në Kosovë dhe zhvillimi i ngadalshëm ekonomik kanë shpërfaqur varfërinë si një dukuri shumë të rëndë, me të cilën ballafaqohen shumë familje në Kosovë. Varfëria

si shkak prodhon pasoja të shumta në familje, duke përfshirë kequshqyrjen, shëndetin e dobët, punësimin e fëmijëve, dhunën në familje etj.

Në Kosovën e pasluftës, mosangazhimi i mjaftueshëm i institucioneve të ruajtjes së ambientit, ka ndikuar që keqbërësit e ndryshëm për interes të përfitimeve personale kanë degraduar mjedisin.

Gjersa në fazën e parë (*bashkëjetesa në ish Jugosllavi*), edhe ato norma penale egzistuese, që mbronin segmentet e sigurisë njerëzore, interpretoheshin në interes të sigurisë dhe me fuqinë e tyre zyrtarët e i inspektimit në mënyrë shumë rigoroze dhe të fuqishme sanksionimin të gjithë ata persona, që shkelnin ato norma dhe rrezikonin sigurinë njerëzore. Në fazën e dytë (*pas luftës së vitit 1999*), normat penale, përmes të drejtave dhe lirive të njëriut, mbulojnë dhe mbrojnë të gjithë spektrin e segmenteve të sigurisë njerëzore mirëpo, parandalimi i kërcënimeve të sigurisë njerëzore dhe mbikqyrja e vazhdueshme inspektuese nga ana e zyrtarëve lë për të dëshiruar. Siç mund të kuptohet ndryshimi thelbësor në mes të dy fazave të sigurisë njerëzore konsiston në angazhimin e pushtetit shtetëror në mbrojtjen e qytetarëve, e jo për mungesën e normave penale.

Kthehemi tek tema e teorive mbi konceptin e sigurisë njerëzore, teoritë kanë qenë pjesë e debateve bashkëkohore të argumenteve sipas të cilave individët duhet të jenë dhe të ndjehen të sigurt në jetën e tyre të përditshme (Collins, 2007:128), apo edhe mbi atë se siguria njerëzore është një gjendje në të cilën individët lehtësohen nga traumat që rrethojnë zhvillimin njerëzor, apo edhe kur këto trauma u mungojnë tërësisht (UNDP, 2009). Ideja se njerëzit duhet të jenë të sigurtë në jetën e tyre të përditshme, nuk është ndonjë risi apo zhvillim teorik i kohës në të cilën jetojmë. Kjo ide është një realitet i cili kërkon disa kushte të nevojshme për të garantuar sigurinë e njerëzve përmes lirisë dhe barazisë para ligjit, Në

të vërtetë, këto argumente nga studiuesit e sigurisë kritike për thellimin dhe zgjerimin e idesë së sigurisë, udhëhiqen në masë të madhe nga një vizion kushtesh që duhen përmbushur për të garantuar sigurinë e njerëzve (Collins, 2007: 129). Këto parakushte në esence kanë një lidhje të ngushtë me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njëriut, të njohura si lirimi nga frika dhe lirimi nga skamja (Oberleitner, 2002:29).

Sipas të drejtës ndërkombëtare, çdo njëri i zakonshëm ka të drejtën në mirëqenie (Paris, 2001:87), jetesë adekuate dhe të shëndetshme (Pogge, 2007:11) si për veten e tij, poashtu për familjarët e tij. Këto kushte bazike përfshirë mes tjerash edhe ushqimin, veshmbathjen, banimin dhe trajtimin mjekësor.

Debatet mbi sigurinë njerëzore konsistojnë në ndjenjën e qytetarëve gjatë përditshmërisë së tyre, në garantimin e barazisë para ligjit dhe të lirisë nga frika dhe kërcënimet. Konsiderojmë se të gjitha debatet mbi këto shqetësime janë reale, ngase qytetarët, pa marrë parasysh etninë, vendbanimin apo dallimet tjera, të gjithë ballafaqohen me të njëjtat shqetësime gjatë aktiviteteve të tyre të përditshme. Të gjithë shqetësimet e qytetarëve duhet të trajtohen me shumë seriozitet nga qeverisjet lokale dhe nacionale. Arsye qëndron në faktin se pushteti shtetëror ka obligim të parandalojë kërcënimet, të garantojë dhe mbrojë sigurinë e qytetarëve. Koncepti mbi sigurinë njerëzore ka ndryshuar, ndër vite, në drejtim të zhvillimit të tij gjithnjë në favor të individit dhe qytetarit, e jo në drejtim të sigurisë tradicionale (Mejdani, 2007).

Përgjatë pjesës më të madhe të shekullit të XX-të, siguria konceptohej ekskluzivisht si siguri kombëtare dhe fokusi i shtetit përqëndohej në shqetësimet që buronin nga kërcënimi; kontrolli dhe përdorimi i fuqisë ushtarake, në kontekstin e konkurrencës ndërkombëtare shtetocentrike (Henk, 2005:91). Mirëpo, pas luftës së ftohtë, koncepti i

“Interesit kombëtar” pësoi një transformim të dukshëm, duke u zhvendosur nga siguria shtetërore drejt sigurisë dhe mirëqenies së individit (Wolfers, 1952:482). Prioriteti i analizës së konceptit të sigurisë është zhvendosur drejt asaj që u emërtua si “*Siguri Njerëzore*” (King, 2002:585), e cila në analizat akademike është referuar si “*Siguri antropocentrike*” apo “*Liri nga pasiguria*” (Huey, 2012:174) ose edhe me emërtim artistic “*Siguri me fytyrë njerëzore*”. Në këto rrethana, analiza mbi sigurinë fokusohet në lirinë nga frika dhe në lirinë nga varfëria e qenieve njerëzore (Thakur, 2004:347). Me krijimin e rrehanave të reja, të kohës, siguria njerëzore i’u është larguar analizës së nivelit shtetëror, duke u përqendruar në nivelin individual dhe organizativ të analizës, në marrëdhëniet ndërkombëtare (Macpherson, 2013:5).

Siguria njerëzore merr në konsideratë një varg kushtesh të cilat paraqesin kërcënim për mbijetesën, standardin e jetesës dhe identifikon edhe kufirin minimal përtej të cilit jeta e njeriut është e kërcënuar deri në masë të patolerueshme (Balbo, 2009:6). Definicioni apo termi i ‘sigurisë njerëzore’ nga këndvështrime të ndryshme, ka rezultuar me përceptime të kombinuara, duke filluar nga definicioni më i shkurtër “*Liria nga frika*”, e mbështetur nga qeveria e Kanadasë dhe akademikët si: Krause, Mack and MacFarlane (Amouyel, 2006: 13). Ky definicion i adresohet frikës nga dhuna fizike, kriminaliteti dhe terrorizmi, të cilat si të tilla, janë rreziqe permanente që rrezikojnë jetën dhe trupin e qytetarëve.

Definicioni më i zgjeruar mbi sigurinë njerëzore përfshinë konfliktet e dhunshme, të drejtat njerëzore, qeverisjen e mirë, çasjen në edukim dhe shëndetësi (Amouyel, 2006: 13). Ky definicion i referohet mbrojtjes nga kërcënimet, duke u siguruar që çdo individ ka mundësinë për të zgjedhur përmbushjen e nevojave dhe potencialeve të tij, si: liria nga

skamja, liria nga frika, liria e gjeneratave të ardhshme për një ambient të shëndetshëm, si dhe siguria nacionale.

Mbrojtja e bazës vitale të jetës së njerëzimit është qëllimi i përgjithshëm i sigurisë njerëzore, në mënyrën që vazhdimisht përparon liritë e njeriut (Ogata, 2003: 4). Në kontekstin e lirive të njeriut në kuadër të sigurisë njerëzore, nënkupton mbrojtja e të drejtave fundamentale - të drejtave të cilat paraqesin bazën e jetës; mbrojtjen e njerëzve nga kërcënimet dhe situatat e kritike (të rënda) dhe depërtuese. Poashtu, të drejtat fundamentale shërbejnë për vënien në përdorim të proceseve që zhvillojnë fuqitë dhe aspiratat e njerëzve përmes krijimit të sistemeve politike, sociale, ambientale, ekonomike, ushtarake dhe kulturore. Të gjitha këto struktura kanë për obligim dhe detyrim ofrimin e mundësisë qytetarëve, që të kontribuojnë në ngritjen e mirëqënies, standardit të jetesës dhe dinjitetit të tyre.

Institucionet shtetërore në garantimin i sigurisë njerëzore duke të kenë një qasje të përshkallëzuar në adresimin ndaj sigurisë ekonomike, të ushqyerit, shëndetësisë, mjedisit, sigurisë individuale, komunitare dhe politike. Kjo qasje e përshkallëzuar ofron një kuptim të veçantë mbi sigurinë njerëzore, dhe si e tillë kategorizohet një prej përkufizimeve të gjëra, duke reflektuar bazën e ndarjes mbi kuptimin e sigurisë njerëzore (Collins, 2007: 129-131).

Siguria njerëzore reflekton ndërlidhjen e kërcënimeve dhe reagimit si përgjigje në rastet kur adresohen këto pasiguri. Kjo për shkakun se kërcënimet ndaj sigurisë njerëzore janë të ndërlidhura në efektin domino; në kuptimin që secili kërcënim stimulon tjetrin. Kjo ndërlidhje ka implikime të rëndësishme në politikë bërje, pasi lë të kuptohet se pasiguria njerëzore nuk mund të preket si e izoluar, duke iu adresuar vetëm përgjigjeve të

fragmentuara dhe të veçuara. Përkundrazi, siguria njerëzore kërkon një çasje gjithëpërfshirëse duke u siguruar dhe potencuar nevojën e një përgjigje multisektoriale dhe bashkëpunim të institucioneve relevante duke iu adresuar agjendave që ndërlidhen me sigurinë, zhvillimin dhe të drejtat e njeriut (Balbo, 2009:6).

Nga një perceptim më ndryshe, siguria njerëzore nënkuptohet si zëvendësimi i kulturës së pritjes me kulturën e parandalimit dhe të reagimit (UN, 2001), me focus të dyfishtë: mbrojtjen dhe fuqizimin (Balbo, M., & Guadagnoli, 2009:7).

Idhtarët e sigurisë njerëzore akuzohen se po mundohen të bëjnë lidhjen kauzale mes çështjeve socio ekonomike dhe atyre politike, apo mes sigurisë së individit dhe ruajtjes së paqes ndërkombëtare, mirëpo këto akuza nuk janë justifikuar (Tadjabakhsh, 2005:6). Në kuadër të këtij koncepti, konflikti i vitit 1999 në Kosovë është një ilustrim i sigurisë njerëzore, me të cilën është përballur njerëzimi në fundshekullin XX-të. Konflikti i Kosovës, në kontekstin e sigurisë njerëzore, njihet si pikë kthese në politikat botërore, meqenëse në këtë rast siguria e njerëzve ka qenë vendimtare në shtytjen për veprim. Ashtu siç fiton një peshë të re në çështjet ndërkombëtare, siguria njerëzore ngreh edhe kundërshtime me normat ekzistuese, me çrast konflikti dhe intervenimi në Kosovë e ilustron më së miri këtë kontraditë të veçantë (McRea, 2001: 122), duke e konceptuar sigurinë njerëzore si siguri e përgjithshme.

Siguria njerëzore e vështruar nga aspekti i analizës së “*Makro teorisë*”, përceptohet si siguri e përgjithshme e cila trajton të gjitha aspektet e botës shoqërore, apo thënë ndryshe siguria e përgjithshme konceptohet si teori madhore (Matthews, 2010:32). Në teorinë madhore siguria njerëzore zë një pjesë të veçantë, sepse merret direkt me mirëqenien e qytetarit. Në qoftë se në një kulturë të caktuar nocioni siguri njerëzore ndërtohet nga

shoqëria si i fuqishëm dhe mbizotërues, kjo do të shfaqet qartë edhe në mënyrën se si janë strukturuar familjet dhe organizatat (Matthews, 2010:34). Sipas kësaj “*Meso teorie*”, strukturimi i familjeve dhe organizatave është përcaktuese për mbizotërimin e sigurisë njerëzore. Anda, nga ky pikëvështrim mund të kuptojmë se siguria njerëzore dhe familja kanë ndërrvarësi mes vete, si nga aspekti teorik poashtu edhe praktik (në jetën e përditshme). Nga këndvështrimi i “*Mikro teorisë*”, (Matthews, 2010: 34) qytetarët që jetojnë në një lagje të caktuar apo në një bashkësi të caktuar, shpesh nuk kanë pushtet mbi aspektet e tjera të jetës së tyre. Andaj këta qytetar me arsye kërkojnë të fuqizohen përmes anëtarësimit në një organizim shoqëror. Qëllimi i tyre është që të kenë mundësi të kontribuojnë në ngritjen e sigurisë së bashkësisë, me qëllim të sigurimit të një jetese larg rrezikut nga kriminaliteti në lagje.

2.2 Dimensioni socio juridik dhe filozofik

Liria e njeriut zë një vend shumë të rëndësishëm edhe në kontratën sociale të Rusosë, (Wraight, 2008:19). Kjo më së miri kuptohet nga postulati: “*Të heqësh dorë nga liria do të thotë; të heqësh dorë nga të qenurit njeri, të braktisësh të drejtat e njerëzimit, madje edhe detyrat e tij*” (Jashari, 2015:445). Tjetërsimi i lirisë në çdo variant është i denoncueshëm në të gjitha shoqëritë politike, dhe se shtetet duhet të vlerësohen për mënyrën e rregullimi të jetesës së qytetarëve (Rousseau, 2000:5). Lidhur me këtë vlerë të theksohet se: ligjet janë vetëm kushtet e shoqërisë civile ndërsa, njerëzit duke qenë subjekt i ligjeve, duhet të jetë autor të tyre. Ky koncept i adresohet kuptimit se kushtet e shoqërisë duhet të rregullohen vetëm nga ata që vijnë së bashku për të formuar atë (Rousseau, 1977:68). Koncepti i Rusosë në ‘Kontratën sociale’, konsiston në atë se një gjendje e tillë shoqërore, siç është ajo e “Gjendjes natyrore”, mund të kalohet vetëm nëse individët

nënshkruajnë një kontratë (*sa imagjinare aq edhe reale*) me shtetin, duke ia kaluar shtetit përgjegjësinë për sigurinë dhe duke e referuar si garantin e vetëm të sigurisë së brendshme dhe të jashtme (Shehu, 2011: 153).

Teoria klasike e të drejtave natyrore, e zhvilluar nga filozofi anglez Xhon Loku (John Locke) që në shek XVII-të parashihte se çdo qenie njerëzore ka të drejta të caktuara që rrjedhin nga zoti ose natyra, e jo nga qeveria apo ligjet e saj, kurse legjitimiteti i qeverisë mbështetet në respektimin e këtyre të drejtave (Jashari, 2015:444).

Sipas “Etërve themelues”¹ të drejta e njeriut, i’u ndanë njerëzve në këmbim të lojalitetit të tyre ndaj qeverisë (Jashari, 2015:445). Lok (Locke). Kjo në përgjithësi është në harmoni me mendimet e Ruso-së, por ai (Rusoja) e zgjeron më tepër konceptin e sigurisë duke e parë shtetin si një burim rreziku për qytetarin. Në këtë kontekst, Rusoja për shtetin thekson se mund të kthehet shumë shpejt në diktaturë dhe në këtë mënyrë, është e mundur që vetë shteti të kthehet në një rrezik për nënshtetasit e tij (Shehu, 2011:153).

Filozofët si Ruso, Volter dhe Xhon Stjuart Milli, në vazhdimësi kanë diskutuan për çështjen e të drejtave të njeriut. Në vazhden e këtyre mendimeve Monteskjë (Montesquieu) flet për konceptin e tij të ndarjes së pushteteve, për të ashtuquajturën “*Liri politike*”. Sipas tij liria politike e qytetarëve qëndron në të qenurit të sigurtë, ose të paktën në ndjenjën e sigurisë (*pavarësisht se këta të fundit mund të mos jenë të sigurtë*) ndaj sulmeve nga ana e pushtetit. Duke jetuar në të dyjat konceptet: në rendin shoqëror dhe në gjendjen natyrore, ne jemi subjekt i shqetësimit nga të dy këto koncepte, duke mos gjetur sigurinë fare. Është e vërtetë se, përsosja e rendit shoqëror konsiston në bashkimin e forcës dhe të ligjit; por që

¹ Konsiderohen politikanët e hershëm amerikan, të cilët morën pjesë në harimin e deklaratës Amerikane për Pavarësi.

kjo të jetë kështu ligji duhet të udhëheq fuqinë; ndërsa sipas ideve të princave rreth pavarësisë së tyre absolute, të detyruar vetëm duke folur për qytetarët në maskën e arsyes së shtetit, privon vullnetin e tij që të rezistojë, dhe emri i drejtësisë e cila vjen nga perëndia, si burimi i saj i vetëm, (Rousseau, 1977:163) shërben vetëm si një mburojë për dhunë (Rousseau, 1997:163).

Duke pasur parasysh faktin se Rusoja nuk është marrë shumë me studimin e çështjeve nga lëmia e së drejtës penale, përkundër kësaj në veprën e tij (*le contrat social* - 1762), ai parashtrohet konceptet e veta filozofike, të cilat patën jehonë të madhe edhe në të drejtën penale. Sipas tij, individët kanë hequr dorë nga e drejta e mbrojtjes individuale – të ndëshkimit të fajtorit dhe këtë ia kanë besuar shoqërisë dhe shtetit (Salihu, 2005:80). Pra, me formimin e shtetit, e drejta e ndëshkimit i është besuar shtetit, i cili nëpërmjet gjykatës dhe në interes të individit dhe shoqërisë, e ndëshkon kryesin e veprës penale. Sipas këtij koncepti, me kryerjen e veprës penale fajtori shkakton reagimin e bashkësisë shoqërore – shtetit, kurse shteti e realizon këtë reagim në bazë të autorizimeve të besuara me kontratë (Salihu, 2005:80). Nëse e mbështesim një koncept të tillë, atëherë është e arsyeshme baza juridike që shteti të ndëshkojë kryesin e veprës penale. Pikërisht në këtë aspekt shprehet mendimi revolucionar i Rusosë sepse, luftën kundër arbitraritetit dhe tiranisë së shtetit feudal e proklamon si të drejtë natyrore të njeriut. Të gjithë qytetarët kanë të drejtë të trajtohen në mënyrë të barabartë pranë gjykatës dhe organeve të tjera të shtetit (Salihu, 2005:80).

Politika kriminale ishte veçanërisht e pasuruar me ide në shek. XVIII. Këto ide përqendroheshin në sulme kundër arbitraritetit të judikaturës penale dhe ndaj ligjeve drakonike të cilat ngushtonin çdo liri të mendimit dhe të ndërgjegjes (Latifi, 2012:65-75).

Mendimet e Monteskies mbi politikën kriminale janë parashtruar në veprën e tij të njohur “Fryma e Ligjeve” (*L’esprit des lois-1748*). Në këtë vepër, ligjet trajtoheshin si prodhim i mendjes të krijuara në kushte të caktuara të jetës. Në frymën e Monteskiesë paraqitet edhe Rusoja, si përfaqësues udhëheqës i iluminizmit francez (Elezi, 2006:40). Rusoja botëkuptimet e tij mbi ndëshkimin i ka parashtruar në punimet e tij “*Mbi traktatin shoqëror*” dhe “*Mbi origjinën e pabarazisë midis njerëzve*” (Latifi, 2008:27-78). Dënimet justifikoheshin me mbrojtjen e individëve dhe shoqërisë nga kriminaliteti, pra nga ata të cilët cenonin kontratën sociale. Nga pikëvështrimi mbi ndëshkueshmërinë të gjithë njerëzit janë të barabartë, dhe atyre iu takon e drejta natyrore që të respektohet liria dhe personaliteti i tyre. Me konceptcionet e këtilla Ruso synonte ta lironte njëriun nga gjithëfuqia e shtetit dhe t’i kufizonte të drejtat e shtetit me anë të ligjit. Kësisoj, konceptcionet e tij kanë kontribuar që në të drejtën penale të respektohet parimi i ligjshmërisë, lidhur me veprat penale dhe dënimet (Latifi, 2008:27-78).

Vlerësojmë se qëllimi i kontratës sociale nuk ishte përshkrimi i ndryshimeve të njeriut “primitiv”, derisa arriti tek pasardhësit e tij, të antarësuar në shoqërinë politike, por akoma më tej, të jap një përgjigje në pyetjen “*Pse një njeri duhet t’iu bindet ligjeve të qeverisë*”. Andaj, Ruso e filloi librin e tij me frazën e njohur “*Njeriu lind i lirë, por atë kudo e kanë lidhur me vargonj*”. Por në pyetjen e parashtruar: Pse ngjau kështu?. Ai kishte thënë se nuk e di përgjigjen. Por nëse ai dinte se si të bëhet i ligjshëm një ndryshim i tillë, ai besonte se do të mund të përgjigjej përmes konceptcioneve të parashtruara në veprën “Kontrata sociale”, në të cilën konstatohet se ajo kishte të bëjë me çështjet e ligjshmërisë, të drejtës dhe sigurisë, e jo me histori. Mbi këto konceptcione, mund të themi se Rusoja është teoriticien i përsosmërisë së pjesëmarrjes. Kuptimi i natyrës së sistemit politik e

përshkruar në kontratën sociale, është themeltare për teorinë e demokacisë pjesëmarrëse (Pateman, 1976:22).

Një person mund të jetë i kënaqur me qetësinë publike, qytetarët për lirinë e tyre individuale; një tjetër person mund të preferojë sigurinë e pasurisë; dëshira e dikujt tjetër mund të jetë qeverisja më e mirë, dikush tjetër pohon se ajo është e butë; një tjetër dëshiron që të dënohen krimet, ndërsa tjetri dëshiron dhe shpreson që krimi të parandalohet; dikush mendon se është gjë e bukur që të kesh frikë nga fqinjët, të tjerë preferojnë që të injorohen nga ana e tyre; një tjetër është i kënaqur kur qarkullon paraja, të tjerët kërkojnë që njerëzit të edukohen (Rousseau, 1997:237). Në këtë kontekst, populli sovran duhet të delegojë përgjegjësinë dhe fuqinë për të zbatuar ligjet nga një trup të magjistratëve ose nga qeveria në kuptimin e ngushtë (Rousseau, 1997:237). Të lindësh për të jetuar i lumtur, apo të vdesësh çdo ditë nga frika për jetën, është paradigma e siguri së njerëzore. Njerëzimi do të jetoj gjithnjë në frikë nëse qytetarët nuk kanë siguri në jetën e tyre të përditshme, dhe nuk fillojnë me forcën e ligjit të luftojnë shkaqet e kërcënimeve ndaj siguri së tyre ngase ligji është një urdhër i sjelljes njerëzore (Kelsen, 1945: 3-14). Andaj, për shumë njerëz nuk ka dyshim se (në vetvete) paradigma tradicionale e bazuar në siguri në shtet është duke çaluar në objektivin e saj kryesor - për të mbrojtur njerëzit (Owen, 2004:347).

2.3 Ngjashmëritë dhe dallimet: siguria njerëzore, tradicionale dhe rendi publik

Bashkërendimi i teorisë për botën shoqërore me qëndrimet e caktuara ontologjike dhe epistemologjike njihen me emrin Paradigma (Matthews, 2010:34). Për një kohë të gjatë, siguria është barazuar vetëm me kërcënimet ndaj kufirit shtetëror, ndërsa sot për shumë njerëz, një ndjenjë e pasiguri lind (DeMartino, 1963:113) më shumë nga shqetësimet rreth jetës së përditshme sesa nga frika e një ngjarje katastrofike botërore.

Siguria për punë, siguria për të ardhura, siguria shëndetësore, siguria ambientale dhe siguria nga krimi, janë shqetësimet e reja të sigurisë njerëzore në të gjithë botën. Të gjithë e dinë se siguria është njëra nga nevojat themelore të njeriut (Newman, 2001:239), një garancion i pakundërshtueshëm i sigurisë dhe mirëqenies, një vetbesim i mundësive ekonomike, socializim dhe rend, e jetës së jetuar lirshëm pa frikë apo vuajtje. Siguria njerëzore është një e mirë universale në dispozicion për të gjithë, dhe një premtim solem (Canetti, 2007:61) në mes qytetarëve dhe liderëve të tyre politikë, për të cilët siguria e popullit të tyre është qëllimi parësor (detyra e parë) e cila duhet realizuar përmes zbatimit të politikave vendore dhe ndërkombëtare. Siguria mbetet një nga ëndrrat më kokëfortë dhe të qëndrueshme të modernizmit (Burke, 2002:27), ngase siguria njerëzore është një fëmijë i cili nuk ka vdekur, një sëmundje që nuk është përhapur, një punë që nuk është ndërprerë, një tension etnik që nuk shpërthen në dhunë, një disident i cili nuk ishte i heshtur.

Siguria njerëzore nuk është një shqetësim me armë - por një shqetësim për jetën dhe dinjitetin njerëzor (UNDP, 1994). Siguria në kuptimin e gjërë, tradicionale apo siguria e shtetit përfshinë atë siguri në kuptimin e ombrellës shtetërore, që gërrsheton sigurinë e sovranitetit dhe territorit shtetëror. Dallimet mes sigurisë njerëzore dhe asaj tradicionale më së miri përshkruhen në Raportin e Komisionit për Sigurinë Njerëzore (Ogata, 2003:6).

Orientimi drejt individit: Siguria e shtetit fokusohet në shtetet tjera me qasje agresive apo kundërthënëse. Shtetet ndërtojnë struktura të fuqishme për të mbrojtur veten, kufinj të tyre, institucionet e tyre dhe vlerat e tyre. Siguria njerëzore nga ana tjetër, zhvendos fokusin nga agresioni i jashtëm tek mbrojtja e njerëzve nga një numër i madh kërcënimesh.

Kërcënimet: Siguria e shtetit ka nënkuptuar mbrojtjen e kufijve territorial me trupat e uniformuar. Siguria njerëzore gjithashtu përfshin mbrojtjen e qytetarëve nga ndotja e

mjedisit, terrorizmi transnacional, zhvendosjet masive të popullatës, sëmundjet infektive si HIV/AIDS dhe kushtet afatgjatë të shtypjes dhe shkeljeve.

Akterët: Numri i akterëve të cilët merren me sigurinë njerëzore është zgjeruar me përfshirjen e organizatave rajonale dhe ndërkombëtare, organizatat joqeveritare dhe shoqërinë civile. Të gjitha këtë organizata janë të përfshira në menaxhimin e çështjeve të sigurisë njëjtë, sikur në luftën kundër HIV/AIDS, ndalimin e minave tokësore dhe mobilizimeve masive në mbështetje të të drejtave të njeriut.

Fuqizimi: Siguria e njerëzve nënkupton pashmangshëm edhe fuqizimin e tyre individual dhe të bashkësive (*shoqërive*). Në shumë situata njerëzit mund të kontribuojnë drejtpërdrejtë në identifikimin dhe implementimin e zgjidhjeve në të mirë të problematikës së sigurisë. Në disa situata post konfliktuale, për shembull, krijimi i partneriteteve nga faktorët e llojllojshëm në rindërtimin e komuniteteve të tyre mund të zgjidhin disa nga problemet e sigurisë njerëzore.

Për të siguruar cilëndo nga konceptet e sigurisë në botën demokratike, kërkohen institucione të fuqishme dhe stabile, dhe kjo më së miri arrihet përmes qeverisjes demokratike të shtetit, një parlament të zgjedhur me votë të lirë në relacion me detyrimin e qeverisë përballë akteve të miratuara nga parlamenti. Kjo për arsyen se si një organ kolegjal, qeveria në rolin e saj substancial në sistemin politik, e ushtron pushtetin ekzekutiv në zbatimin e ligjeve (KK, 2008: neni 92) dhe akteve tjera të miratura nga parlamenti. Siguria në kuptimin e gjërë të saj, përfshinë edhe gjyqësinë kushtetuese e cila përbën një inovacion të demokracisë në kuptim të “*freskimit*” të ngjyrës së republikanizmit që prodhoi revolucionin amerikan në fund shekullin e XVIII-të (Griffin, 1998:32).

Siguria e përgjithshme nuk do të pasqyronte një garanci për qytetarët në mungesë të një pushteti gjyqësor, si degë e tretë e pushteti shtetëror, e ndarë sipas logjikës së parimit të ndarjes së pushtetit. Rrënjët filozofike të ndarjes së pushtetit gjyqësor nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ mbështetën ndër të tjera, në idenë e Monteskjesë, i cili argumentonte se “*Nuk ka liri, nëse pushteti gjyqësor nuk është i ndarë nga ai legjislativ dhe ekzekutiv*” (De Montesquieu, 1970:155). Me këtë argumentim përcaktohet gjerësia e autoriteti i institucioneve. Për më tepër edhe kushtetutat të udhëhequra mbi parimin e ekuilibrit në mes pushteteve, sendërtojnë kontrollin civil ndaj institucioneve të sigurisë. Të dy këto segmente ngërthejnë sanksionimin e standardeve më të avancuara për sa i përket përdorimit të forcës fizike nga ana një shteti, në kohë paqeje dhe në kohë lufte, duke mos rrezikuar që forca e tyre pa kontroll të shembet nga vet pesha e saj (org. *Vis consilii expres mole ruit sua*) (Basigalup, 2006:40).

Përderisa siguria njerëzore nënkupton siguri nga kërcënimet e tilla si uria, sëmundjet, mjedisi etj, rendi publik në shumicën e shteteve demokratike është kategori kushtetuese ku shteti ka pushtet mbi institucionet e zbatimit të ligjit, drejtësisë, inteligjencës, emergjencës dhe kontrollit të kufinjve. Në kuadër të nocionit të rendit publik, përmes së cilave dizejohen rregullat që sigurojnë zbatimin e qetësisë në komunitet (Nippel, 1995:9), prodhohen dy obligime për qytetarin dhe dy obligime për institucionet shtetërore, por objekt i përbashkët për katër obligimet është interesi i përgjithshëm.

1. Respektimin e ligjit nga ana e qytetarëve;
2. Respektimin e Institucioneve publike nga ana e qytetarëve;
3. Mbrojtjen e interesit ligjor nga ana e Institucioneve shtetërore; dhe
4. Mbrojtjen e lirive të personit nga ana e Institucioneve shtetërore.

Në përgjithësi rendi publik ka të bëjë me konceptin e mbrojtjes së interesit publik përmes sanksioneve të së drejtës penale, në kuptimin e tyre objektiv njëjtë, si të gjitha rregullat ligjore të themeluara nga shteti me qëllim të lidhjes me veprimin i cili përbën vepër penale, dënimin që përmban sanksioni, apo në kuptimin subjektiv të saj “*jus puniendi*”, (Aaron, 2009:01-198) të njohur si e drejta e shtetit për të dënuar (Liszt, 1908:1).

Shoqëritë ndryshojnë si në perceptimin e tyre për rendin publik poashtu edhe për metodat e zbatimit të saj të cilat ata i konsiderojnë të përshtatshme. Natyrisht, në çdo shoqëri të caktuar metodat mund të ndryshojnë me kalimin e kohës (Liszt, 1908:1). Mirëpo theksojmë se trazirat dhe protestat kanë qenë ato të cilat kanë sjellë çështjet e rendit publik në vëmendjen akademike (Vaddington, 1994:25). Në kontekst të saj, mund të theksojmë se rendi publik siguron respektimin e të drejtave të njëriut në një shoqëri, dhe kjo është arsyeja e promovimit të modelit të drejtësisë penale të rendit publik (Conte, 2005:233) në një shoqëri demokratike.

Nëse në disiplinat tjera juridike, vetëm disa nga komponentët e tyre konsiderohen pjesë e rendit publik, ligji penal në tërësi i përkushtohet mbrojtjes së rendit publik (Cimamonti, 1996:89), sepse nga vet qëllimi i tij, ligji (*Kodi*) penal është e drejtë e rendit publik (De Vabres, 1947:61).

Ligjvënësit, në çdo periudhë të historisë, do të mund të arrinin një situatë të qartë ligjore, duke kufizuar veten dhe garantuar rendit publik, parandalimin dhe atë çfarë është perceptuar si abuzimet e lirive, përmes hartimit të ligjeve të përgjithshme që do definonin saktësisht mundësitë e ndërhyrjeve të shtetit (Habermas, 1996:274-328). Siguria publike ka një rëndësi madhore për secilin shtet sepse, antiteza sigurisë publike është anarkia dhe zhbërja e institucioneve shtetërore. Ligji bashkëkohor penal është ligji i sigurisë së

brendshme të çdo shteti (Domat, 1723:190) që ndjek përkohshmërinë e jetës biologjike të qenieve njerëzore (Yves, 2009:15). Andaj pushteti, në çdo kohë duhet të sigurohet që të ruaj fuqishëm rendin publik duke respektuar ligjet në fuqi (Kelsen, 1952:73). Rendi publik si një e mirë juridike, ka një vlerë pozitive dhe njohje juridike nga ana e ligjit dhe në mënyrë specifike nga ligji penal (Puig, 2004:5). Ligji penal, në veçanti pjesa kundër terrorizmit, është fokusuar në mbrojtjen e rendit shoqëror duke synuar t'i qeverisë marrëdhëniet mes njerëzve në një organizatë paqësore (Bouloc, 1970:30).

KAPITULLI III:

SIGURIA NJERËZORE SIPAS AKTEVE NDËRKOMBËTARE

3.1 Trajtimi i sigurisë njerëzore përmes të drejtave të njeriut

Segmentet e sigurisë njerëzore të trajtuara përmes të drejtave të njeriut kanë kaluar nëpër një formë të klasifikimit historik, duke shikuar në gjenezën e tyre. Kategoritë e ndryshme të të drejtave, janë ndarë në tre gjenerata (Vasak, 1977). Në vazhdim të kësaj tematike, do të shtjellojmë këtë klasifikim por me fokus të veçantë në ato të drejta që në mënyrë specifike lidhen apo prekin segmentet e sigurisë njerëzore:

- **Gjenerata e parë**, ka të bëjë më shumë me autonominë personale të individit, ku bëjnë pjesë të drejtat civile dhe politike, të cilat përgjithësisht kategorizohen në kuadër të *segmentit të sigurisë politike dhe individuale*. *Këto segmente* përfshijnë në veçanti; të drejtën në jetë, të drejtën në liri dhe siguri, lirinë e shprehjes, të drejtën në zgjedhje të lira, lirinë e mendimit dhe të religjionit, si dhe të drejtën në pronë.

- **Gjenerata e dytë**, për dallim nga gjenerata e parë kërkon mbështetje institucionale nga shteti. Këtu, mes të drejtave tjera hyn edhe e drejta në punë dhe sigurim në rast të sëmundjes, apo sigurimi sociali. Këto të dyja kanë lidhmëni me dy segmente mjaft të rëndësishme të sigurisë njerëzore siç janë: **siguria ekonomike** dhe **shëndetësore**.
- **Gjenerata e tretë**, ndryshe quhet edhe si të drejta solidare, dhe si kategori e tillë nuk mund të ushtrohen individualisht, por vetëm në grupe apo bashkësi të njerëzve. Këto të drejta përfshijnë një varietet të segmenteve të sigurisë dhe më së miri mund të ndahen si në vijim:
 - E drejta në vetvendosje, e drejta në paqe dhe e drejta e minoriteteve seksuale, etnike, fetare, gjuhësore si segmente të sigurisë së bashkësisë;
 - E drejta në ndihmë humanitare si segment i sigurisë ushqimore;
 - E drejta mjedisore si segment i sigurisë mjedisore.

Një gjeneratë e re, (gjenerata e katërt) ka të bëjë me të drejtat e gjeneratës të së ardhmes dhe si të tilla kanë të bëjnë kryesisht me të drejtat e inxhinjerisë gjenetike. Megjithatë, egzistojnë kushte të tjera që mund të përdoren për të përshkruar teknologjinë, duke përfshirë manipulimin e gjeneve, klonimin e gjeneve, teknologjinë e rikombinimit të ADN-së, modifikimin gjenetik, dhe gjenetika të reja. Lidhur me këtë, egzistojnë edhe përkufizime ligjore të përdorura në administrimin e mekanizmave rregullatorë, në ato vende ku praktikohet inxhinieria gjenetike (Nicholl, 2003:2).

Duke patur në konsideratë nevojat e ndryshme dhe gjithnjë në evoluim gjatë dekadave të fundit, vërejmë se edhe fokusi i nevojës për mbrojtje ka ndryshuar. Kështu psh, gjersa në fillim fokusi ka qenë në mbrojtjen nga represioni shtetëror, tani gjithnjë e më tepër kërkohet angazhimi i institucioneve në ofrimin e mbrojtjes nga kërcënimet të cilat

mund të dëmtojnë sigurinë njerëzore nga aspekte më të gjëra sesa që është vetëm represioni.

Me ngritjen e vetëdijes shoqërore, njerëzit kanë filluar të kërkojnë më shumë nga shteti. Meqenëse njerëzit kanë filluar të kërkojnë më shumë siguri, për një jetë të dinjitetshme, në këtë prizëm edhe të drejtat dhe segmentet e sigurisë janë zgjeruar me sigurinë shëndetësore, ushqimore dhe mjedisore. Megjithatë, jo rrallë edhe kërkesat e ndryshme dallojnë dhe bien ndesh njëra me tjetrën, dhe andaj edhe bëhet më e vështirë të sigurohet një ekuilibër. Në këtë kontekst, për të siguruar një mirëqenie dhe zhvillim ekonomik shpesh rrezikohet siguria mjedisore apo me zhvillimin e fushës së gjenetikës dhe hulumtimeve shkencore rrezikohet siguria shëndetësore (sipas rasteve) dhe siguria e dinjitetit të individit.

Me zhvillimin e vazhdueshëm të normave të së drejtës ndërkombëtare, ka filluar të bëhet edhe fragmentimi i së drejtës ndërkombëtare, e cila njëkohësisht po sjellë edhe deri tek situatat kur e drejta ndërkombëtare jo vetëm bie ndesh me të drejtën regjionale por edhe me të drejtat e njeriut. Në raste të tilla, kërkohet një analizë më e madhe me qëllim të barazpeshimit të asaj se cila është më me peshë për një shoqëri. Një rast i tillë ku siguria njerëzore (*personale dhe ekonomike në veçanti*) bien ndesh me sigurinë e përgjithshme dhe tradicionale, është pikërisht vendimi i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GjED) në rastin “**Kadi**” (GjED, Kadi case T-315/01). Në këtë rast GjED-ja ka vendosur të anulojë Rregulloren e Këshillit të Unionit Evropian (KUE) 881/2002 (EC Reg.881/2002) të datës 27 maj 2002, mbi caktimin e masave të caktuara kufizuese të drejtuara kundër personave apo entiteteve të caktuara të lidhura me Osama Bin Laden, rrjetin Al Kaida dhe Talibanët. Rregullorja në fjalë ishte miratuar me qëllimin për të fuqizuar Rezolutën e Këshillit të

Sigurimit 1267 dhe 1333. Bazuar në Rezolutën e KS, rregulloja kishte vendosur masa restriktive për ngrirjen e aseteve ndaj personave dhe entiteteve të lidhura me Osama Bin Laden, rrjetin e Al-Kaidës dhe Talibanët. Sipas GjED-së, në këtë rast janë vërtetuar shkelje të të drejtave fundamentale të njeriut të cilat mbrohen me Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut. Vendimi ishte i jashtëzakonshëm për vet faktin se për herë të parë (*në mënyrë indirekte*) është gjetur se Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB mbi anti-terrorizmin shkel të drejtat fundamentale të njeriut. Deri në atë kohë asnjë gjykatë ndërkombëtare apo regjionale nuk kishte gjetur se sanksionet e vëna nga KS i OKB në kontekst të luftimit të terrorizmit shkelin të drejtat e njeriut (Weiler, 2008, 895).

Sfida të tilla si vendimi i GjED-së në rastin Kadi ngrisin çështje që kanë të bëjnë me autoritetin e të drejtës ndërkombëtare në përgjithësi, dhe mbi vendimet e Këshillit të Sigurimit në veçanti. Ky rast paraqet një distancim nga përqafimi tradicional i të drejtës ndërkombëtare nga ana e Unionit Evropian (De Burca, 2009: 51). Rasti në fjalë, ka inicuar ristudimin e çështjes së hierarkisë në mes të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës regjionale, si ajo e UE-së duke shikuar dinamikën e zhvillimeve në marrëdhëniet ndërmjet shteteve dhe situatat e reja që paraqiten si rrjedhojë e kësaj (Posch, 2009:256).

Njëkohësisht, rasti Kadi ngrit edhe pikëpyetje mbi peshën e sigurisë individuale ndaj asaj kolektive. Siguria njerëzore përbën motivin e Deklaratës Universale të të drejtave të njeriut, Kartës së Organizatës së Kombeve të bashkuara, Konventave të Gjenevës, Traktatit të Otavës si dhe Gjykatës ndërkombëtare të krimeve (Collins, 2010: 130). Parë nga këndvështrimi normativ, koncepti i sigurisë njerëzore shërben për të nxjerrë në horizont rendësinë e normave të mira globale.

Siguria njerëzore shpeshherë shërben si një normë ombrellë për traktate dhe konventa të ndryshme, të cilat synojnë të mbrojnë njerëzit e pambrojtur nga aktorët persekutues, sidomos prej shtetit (Collins, 2007: 130).

Nga vështrimet e mësipërme të segmenteve të sigurisë përmes korelacionit të tyre me të drejtat e njeriut, konstatohet kompleksiteti i segmenteve të sigurisë njerëzore, të cilat, edhe pse secila nga ato janë të domosdoshme për njeriun, prapë se prapë ndërlidhja e tyre është aq komplekse sa që ndodh që disa prej tyre të fuzionohen në një segment, ndërsa në rastin tjetër kërkesat e njërit segment shëndërrohen në kërcënim për segmentin tjetër.

Elaborimi në vijim përqendrohet më shumë në ndërlidhjen mes sigurisë njerëzore dhe të drejtave të njeriut, respektivisht në mbrojtjen e sigurisë njerëzore përmes kërkesës për respektim të drejtave të njeriut. Analiza fokusohet në rregullimin ndërkombëtar të kësaj fushe për të kaluar më pas me analizimin e mbrojtjes kushtetuese të sigurisë njerëzore. Analiza do të kalojë në aspektin e analizës së të drejtës materiale penale në Kosovë duke zbërthyer mënyrën e mbrojtjes penale të sigurisë njerëzore.

3.2 Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Duke pasur parasysh se të drejtat njerëzore janë universale, Deklarata universale për të drejtat e njeriut, ka qenë instrumenti i parë ndërkombëtar cili ka vendosur standardet për promovimin e të drejtave qytetare, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore (Sadikovic, 2006:13). Deklarata universale proklamon respektimin e dinjitetit të natyrshëm dhe të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme, dhe janë themel i lirisë, drejtësisë dhe paqes. Njëkohësisht secili individ ka të drejtë për jetë, liri dhe siguri personale, si dhe në kontekstin e drejtësisë, të gjithë janë të barabartë para ligjit, pa kurrfarë diskriminimi në mbrojtjen e ligjit (DUDNJ, neni 1, 2 dhe 7). Deklarata universale dhe dokumentet tjera

ndërkombëtare, tregojnë gjithë rëndësinë që i kushtohet mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut, në ndërtimin e bashkësisë ndërkombëtare. Të drejtat e njeriut si të drejta imanente ekzistojnë, pavarësisht vullnetit të individit apo grupit të njerëzve. Të drejtat e njeriut as nuk fitohen as nuk dhurohen nëpërmes të çfarëdo veprimi, ato mund të mos njihen apo të mos respektohen, por ato prapë se prapë të drejtat e njeriut i takojnë individit (Hanski, 1999:6). Të drejtat e njeriut, të cilat i përmbante deklarata mbi të drejtat e njeriut dhe qytetarit, e vitit 1789, i ka theksuar ato si të drejtat më të rëndësishme “*Natyrore dhe të patjetërsueshme*” të njeriut siç janë: liria, prona, siguria, rezistenca...ndaj shtypjes” (Sadikovic, 2006:11). Sipas nenit 3 të DUDNJ-së, “Secili ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë siguri vetjake”. Ky nen përban tri të drejta të ndryshme: e drejta në jetë në kuptimin biologjik (*inter alia* e drejta dhe aftësia në ekzistencë) (Eide, 1989:35) dhe në kuptimin më të gjerë human (*mbrojtja nga kushtet johumane të jetës*); e drejta në liri personale, si psh., e drejta e lëvizjes; dhe e drejta në siguri personale, si psh. e drejta në mbrojtje kundër ndërhyrjes intensive nga ana e akterëve shtetërorë dhe joshtetërorë, duke përfshirë individët privatë (të drejtat e integritetit) (Gudmundur, 1999).

Liria, nuk nënkupton vetëm mobilitetin personal, ajo ka të bëjë edhe me posedimin e disa të drejtave fundamentale si: e drejta e lirisë dhe sigurisë; trajtimi i barabartë para ligjit; liria e të menduarit, shprehurit dhe informimit; e drejta e qeverisjes së mirë dhe obligimi i institucioneve të UE të kompenzojnë dëmet që mund t’ia kenë shkaktuar ndonjë individ (KE, 2004:4). Këto të drejta u përkasin të gjithë atyre që jetojnë legalisht në BE, edhe nëse ata janë shtetas të BE-së apo jo (KE, 2004:4).

3.3 Konventa dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Me konceptin e të drejtave të njeriut, posaçërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), ndodhemi në qendrën historike të të Drejtës Evropiane, dhe veçanërisht të të Drejtës Penale Evropiane (Pradel, 2010:216-415). Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, u ideua si një vazhdimësi rajonale e Deklaratës Universale të Kombeve të Bashkuara e vitit 1948. Mirëpo, ndryshe nga deklarata, konventa jo vetëm shpalli të drejtat themelore të njeriut, por themeloj mekanizmin e posaçëm ligjor për mbrojtjen e njerëzore. Pra, konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut krijoi Gjykatën Evropiane për të drejtat e njeriut (GjEDNj) me seli në Strasburg e cila filloi të funksionojë nga viti 1959.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në dekadat e fundit ka zgjeruar jashtë mase interpretimin e të drejtave të parapara me KEDNj, dhe atë duke patur parasysh të dy standardet sipas Konventë: (1) Obligimin pozitiv dhe (2) Obligimit negativ. Ajo që dallon obligimin pozitiv nga obligimi negativ është se obligimi parë kërkon ndërhyrjen pozitive të shtetit, ndërsa obligimi dytë kërkon shmangie nga ndërhyrja. Për më tej, në rastin e parë, shkelja e Konventës do të rezultojë nga mosveprimi, respektivisht pasiviteti i autoriteteve shtetërore, dhe në rastin e dytë shkelja e konventës do të rezultojë nga parandalimi apo kufizimi i tyre në ushtrimin e të drejtës përmes veprimit pozitiv (Kombe, 2003: 7).

Në këtë kontekst theksojmë se të drejtat e njeriut, në bazë të kriterit të raportit të ndërsjellë në mes të individit (*Qytetarit*) dhe shtetit klasifikohen në: *të drejtat e statusit negativ, të drejtat e statusit pozitiv dhe të drejtat e statusit aktiv*.

Të drejtat e statusit negative, janë të drejtat e qytetarit të cilat shteti nuk mund t'i prekë, pra qytetarët gëzojnë liritë nga intervenimi i shtetit në sferën e tyre juridike.

Të drejtat e statusit pozitiv, përkundrazi, u japin qytetarëve të drejtën që nga shteti të kërkojnë veprime ose mosveprime të caktuara dhe shteti është i obliguar që të veprojë aktivisht në favor të qytetarëve.

Të drejtat e statusit aktiv, janë ato të drejta në të cilat qytetarët marrin pjesë aktivisht, në kryerjen e punëve publike (Čukalović, 2013: 77).

Të drejtat nga statusi negativ, ndryshe konceptohen edhe si të drejta të lirisë, të cilat garantojnë dhe mbrojnë qytetarin nga represioni politik, që mund të ushtrohet nga pushteti. Këto të drejta kushtetuese të qytetarit i dedikohen lirive, të drejtave dhe obligimeve të njeriut dhe qytetarit, mbrojtjes së dinjitetit të njeriut, barazisë para ligjit dhe zbatimit të drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare. Të gjitha këto korrespondojnë me konceptin e përgjithshëm të Kushtetutës si mjet për mbrojtjen e njeriut dhe kufizimit të pushtetit shtetëror. Për më tej, ajo është në përputhje edhe me dispozitën themelore (Kushtetuta, 2008: neni 21) që përcakton se Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si të drejta themelore të pandashme, patjetërsueshme dhe të pacenueshme dhe se janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës (Kushtetuta, 2008: neni 21, par.1).

KEDNj përfshinë kryesisht të drejtat politike apo ato klasike politike, pra vetëm ato të drejta dhe liri të njeriut të cilat janë të mundshme të mbrohen dhe realizohen (Macovei, 2002:17), përkundër deklaratës së 1948 që kanë karakter socioekonomik. Konventa Evropiane mbi mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut ka ngelur e përforcuar në pikëpamje të caktuar se individi është shfrytëzues i vetëm i të drejtave të njeriut, për vet faktin se konventa thekson se e drejta çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj.

Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj (KEDNJ, 2002: Neni 2). Përveç tjerash, Konventa është kujdesur që individi të mbrohet nga çfarëdo diskriminimi, i cili mund të jetë mbi baza etnike, religjioze dhe çfarëdo përkatësie tjetër kolektive përbrenda shtetit. Në mënyrë që të drejtat etnike dhe ato të ngjashme kolektive të radhiten në sistemin e të drejtave të njeriut të Konventës Evropiane, Konventa duhet të jetë e mbrojtur nga ana e shtetit në mënyrë adekuate, siç është me rastin e të gjitha të drejtave të njeriut të përfshira në Konventën Evropiane (Sadikovic, 2006:13).

3.4 Aktet tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Normativa ndërkombëtare është shumë e pasur sa i përket rregullimit, jo vetëm të fushave të përgjithshme rreth të drejtave të njeriut, por edhe me dokumente nga fusha specifike të cilat rregullojnë çështje specifike të të drejtave të njeriut. Për ilustrim do të numërojmë disa nga këto dokumente, të cilat në rastin konkret arsyetojnë studimin e aspektin e sigurisë njerëzore, objekt i këtij punimi:

1. ***Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj.*** Kjo është një instrument ndërkombëtar për të drejtat e njeriut me karakter legjislativ. Me dispozitat e tij janë parashikuar të drejtat individuale dhe kolektive, masat e caktuara për mbiqyrje të respektimit të tyre dhe Komisioni i themeluar për të drejtat e njeriut që përpiket që shtetet nënshkruese t'iu përmbahen obligimeve të marra. Konventa është miratuar dhe hapur për nënshkrim dhe ratifikim ose aderim, me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 2200 A(XXI) të

16 dhjetorit 1966, ndërsa ka hyrë në fuqi me 23 mars 1976, kur 35 shtete, sa kërkoheshin, i deponuan instrumentet e tyre për ratifikim ose aderim. Bashkë me Konventën Ndërkombëtare janë miratuar edhe dy protokolle: (1) Protokolli opcional i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike që ka hyrë në fuqi më 23 mars 1976 dhe (2) Protokolli opcional i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike që ka hyrë në fuqi më 11 korrik 1991 (Hasani, 2013:84);

2. ***Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.***

Është marrëveshja e parë regjionale ndërkombëtare gjithëpërfshirëse dhe instrumenti i parë ndërkombëtar juridikisht i obligueshëm që i është kushtuar në tërësi mbrojtjes së pakicave kombëtare. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës e ka miratuar Konventën Kornizë në vitin 1994, e cila ka hyrë në fuqi me 1 shkurt 1998 (Hasani, 2013:84);

3. ***Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor.*** Është

miratuar dhe hapur për nënshkrim dhe ratifikim nga ana e Asamblesë së Përgjithshme me rezolutën 2106 A(XX) të 21 dhjetorit 1965 dhe ka hyrë në fuqi më 4 janar 1969 (Hasani, 2013:84);

4. ***Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas.*** Kjo

konventë është e njohur si Konventa CEDAW e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 18 dhjetor 1979, si një prej dokumenteve kyçe për zvogëlimin e pabarazisë gjinore (Hasani, 2013:84);

5. ***Konventa për të Drejtat e Fëmijës.*** Është miratuar më 20 nëntor 1989 në

Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së dhe hyrë në fuqi në vitin 1990 pasi që u

nënshkrua nga 20 shtetet e para. Konventa përmban 54 nene, që përcaktojnë katër grupe të të drejtave: (1) E drejta për mbijetesë, (2) E drejta për zhvillim, (3) E drejta e mbrojtjes, (4) E drejta e pjesëmarrjes (Hasani, 2013:84);

6. ***Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.*** Kjo konventë është miratuar në vitin 1984, ndërsa ka hyrë në fuqi në vitin 1987. Përveç dispozitave për ndalimin e torturës, në instrumentet kryesore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ekzistojnë edhe marrëveshje të veçanta që kanë të bëjnë me torturën dhe veprimet ose dënimet miroze, jonjerëzore ose poshtëruese. Më e rëndësishmja prej tyre është Konventa në fjalë. Mbrojtja e integritetit fizik dhe psikik është e drejtë absolute që duhet të përcillet me ndalime precize (Hasani, 2013:84).

Meqenëse objekti i studimit, në këtë punim, janë segmetet e ndryshme të sigurisë njerëzore, të cilat kërkojnë një shtjellim më të gjërë, atëherë edhe dokumentet e mësipërme përmenden vetëm për qëllime referimi, duke mos u lëshuar tutje në analizën e secilit dokument veçmas. Të njëjtat dokumente trajtohen edhe përmes Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

KAPITULLI IV:

PËRGJEGJËSIA SHTETIT PËR TË MBROJTUR QYTETARËT

4.1 Shteti: mes mbrojtësit dhe shkelësit të sigurisë njerëzore

Sovraniteti i shtetit mbart përgjegjësinë për të mbrojtur sigurinë njerëzore të qytetarëve. Nocioni i sovranitetit përfshinë tre elemente (*Hasani, 2013: 16*):

- *Elementin e jashtëm* (që shpreh pavarësinë e pushtetit shtetëror në raport me shtetet tjera);
- *Elementin e brendshëm* (që shpreh supremacinë e pushtetit shtetëror në raport me të gjitha pushtetet dhe institucionet në territorin e tij), dhe
- *Elementi sintetik* (pasojë logjike e lidhjes së këtyre dy elementeve paraprake). Elementi sintetik i nocionit të sovranitetit nënkupton moskufizimin juridik të pushtetit shtetëror në përcaktimin e normave ligjore sipas zgjedhjes së vet, pa kurrfarë kufizimesh të jashtme apo të brendshme.

Përgjegjësia e pushtetit shtetëror për të realizuar mbrojtjen e sigurisë së njerëzve përfshinë; përgjegjësinë për të parandaluar kërcënimet dhe shkaqet të cilat krijojnë pasoja në sigurinë njerëzore si dhe përgjegjësinë për të reaguar ndaj nevojave njerëzore me mjetet e duhura, të cilat mund të përfshijnë masa shtrënguese përmes sanksionimit penal (*Collins, 2007:85*). Siguria njerëzore në fokus kryesor ka njerëzit, si individ apo si bashkësi, andaj mund të themi se siguria njerëzore është *Antropocentrike* (*Collins, 2007:133*).

Në debatin lidhur me kërcënimet, fokusi i teoricienëve është përqëndruar në dy shkolla (*Collins, 2010: 132*):

- (1) Shkolla e konceptimit të ngushtë, dhe

(2) Shkolla e konceptimit të gjerë.

Sipas shkollës së konceptimit të ngushtë, siguria njerëzore përkufizohet si “*Liri nga frika*”, dhe përfshinë kërcënimet nga dhuna politike e pushtetit shtetëror përmes aparatit të dhunës.

Ndërsa, sipas shkollës së konceptimit të gjerë, siguria njerëzore përkufizohet “*Liri nga nevoja*”, dhe përfshinë; varfërinë, papunësinë, urinë, skamjen, sëmundjet, ushqimin, mungesën qasjes në kujdesin themelor shëndetësor, degradimin e mjedisit dhe burimeve, fatkeqësitë natyrore, ndotjen, dhunën fizike, krimin, terrorizmin, dhunën në familje, punësimin e fëmijëve, tensionet ndër-etnike, fetare dhe tensionet tjera në bazë të identitetit.

Të gjitha këto kërcënime rrezikojnë jetën e individit, pavarësisht nëse ato janë të lidhura me aktivitet antropogjenetike ose shkaqe natyrore (Thakur, 2004:347), apo si pasojë direkte e dhunës shtetërore, apo nga zhvillimi i përgjithshëm demokratik i pamjaftueshëm. Në njërën anë është dhuna shtetërore mbi qytetarët që kërcënon pasigurinë njerëzore si pasojë e *represionit* dhe *abuzimeve me të drejtat e njeriut*, ndërsa qeverisja e dobët krijon si pasojë zhvillimin i pamjaftueshëm shtetëror (*ekonomike, demokratik, etj*), prodhon pasiguri njerëzore duke influencuar në rritjen e varfërisë, urisë, papunësisë, etj. Mbi këto baza orientimet shkakësore sipas dy shkollave argumentojnë se dhuna politike krijon pasiguri njerëzore përmes represionit dhe abuzimeve me të drejtat e njeriut (*Koncetimi i ngushtë*). Ndërsa, qeverisja e dobët dhe zhvillimi i pamjaftueshëm shtetëror, për pasojë ka rritjen e varfërisë, papunësisë, urinë, skamjen, mungesën e qasjes në kujdesin shëndetësor, degradimin e mjedisit, dhunën fizike, tensionet ndër etnike etj.

4.2 Pasiguria njerëzore si pasojë e qeverisjes së dobët

Shteti, si bartës i sovranitetit është i obliguar të garantojë dhe të mbrojë qytetarët nga kërcënimet të cilat shkaktohen si pasojë e qeverisjes së dobët dhe zhvillimit të pamjaftueshëm shtetëror.

PASIGURITË NJERËZORE	KËRCËNIMET
Qeverisja e dobët dhe zhvillimi i pamjaftueshëm shtetëror (Shkolla e konceptimit të gjere)	1.Varfëria,
	2. Papunësia,
	3. Uria,
	4.Skamja,
	5.Sëmundjet,
	6.Ushqimi,
	7.Mungesa e qasjet në kujdesin themelor shëndetësor,
	8.Degradimi i mjedisit dhe burimeve,
	9.Fatkeqësitë natyrore,
	10. Ndotja,
	11. Dhuna fizike,
	12. Kriminaliteti,
	13.Terrorizmi,
	14. Dhuna në familje,
	15.Punësimi i fëmijëve,
	16.Tensionet ndër etnike, fetare dhe identitetin,
	17. Tensionet fetare,
	18. Tensionet në bazë të identitetit.

Figura 4.2.1 Pasiguritë si pasojë qeverisjes së dobët

Ndryshimet të cilat mund të parandalojnë pasigurinë njerëzore përfshijnë: realizimin e agjendave zhvillimore; forcimin e sundimit të ligjit; zgjedhjet demokratike dhe mekanizmat monitorues ndërkombëtar, rajonal dhe vendor. Këta mekanizma duhet të jenë objekt i fokusimit nga donatorët dhe investitorët, organizatat ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare (*rajonale dhe vendore*), si dhe shoqëria civile.

MJETET	MËNYRAT
Realizimi i agjendave zhvillimore	Hartimi i agjendave zhvillimore në nivel shtetëror dhe lokal, që kanë të bëjë me lehtësimin e investimeve të huaja.
	Krijimi i parqeve industriale me infrastrukturë të rregulluar për investime, politikës tatimore dhe beneficinet për investitorët potencial në politikën e punësimit të kuadrit vendor.
	Kthimi i fondeve të qytetarëve të Kosovës, të cilat janë jashtë vendit dhe nuk shfrytëzohen për dhënien e kredive zhvillimore.

Forcimi i sundimit të ligjit	Realizimi i procesit të ri për rizgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve egzistues, i cili do të organizohet nga një strukturë përzgjedhëse ndërkombëtare.
	Llogariadhënia e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si proces i dekriminalizimit në drejtësi.
	Ndryshimi i politikave ndërkombëtare, përmes krijimit të metodologjisë së unifikuar të matjes së dënimeve.
Zgjedhjet demokratike	Në momentet e krizave politike, të gjithë aktorët politikë duhet të ngriten mbi interes personale dhe grupe duke ia kthyer vendimarrjen sovranit, për të përzgjedhur elitën politike, për të cilën pretendojnë se do të ngriti nivelin e qeverisjes së mire, sundimit të ligjit, zhvillimit ekonomike etj.
	Zgjedhjet të jenë të zhvilluara në mënyrë demokratike dhe të monitoruara nga institucionet ndërkombëtare të verifikimit të zgjedhjeve.
Mekanizmat monitorues ndërkombëtar, rajonal dhe vendor.	Hartimi dhe publikimi i raporteve hulumtuese lidhur me gjendjen egzistuese lidhur me shkeljet e të drejtave dhe lirive të njëriut. Poashtu, në kuadër të raportit të përfshihen edhe rekomandimet e nevojshme për zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme që kanë të bëjë me të drejtat dhe liritë e njëriut.

Figura 4.2.2 Mjetet e parandalimit/reagimit ndaj pasigurisë nga qeverisja e dobët

Për parandalimin e pasigurisë njerëzore përveç mjeteve nevojiten edhe akterët përgjegjës dhe kompetent për zbatimin e agjendave zhvillimore, përmes mjeteve të cilat i kemi pasqyruar në tabelën e mësimërme. Ndërsa në vazhdim (në tabelë) paqyrojmë akterët relevant të cilët përmes angazhimit të tyre në parandalim, mund të rezultojnë me sukses në zgjidhjen e problemit të pasigurisë njerëzore. Angazhimi i këtyre akterëve duhet të fokusohet veçmas në krijimin e fondit zhvillimor, investimet në raport me lehtësirat ekonomike, angazhimin në ndryshimet e nevojshme kadrovike në sistemin e drejtësisë dhe monitorimin e procesit të zgjedhjeve.

AKTORËT	AKTIVITETET
Donatorët dhe investorët	Me ndihmën e shteteve mike të Kosovës, të organizohet konferenca e donatorëve. Fondi i mbledhur do të shfrytëzohet për zhvillim ekonomik të Republikës së Kosovës bazuar në agjendën zhvillimore.
	Depërtimi tek investorët për t'i njoftuar me parqet e gatshme industriale, lehtësirat dhe benificionet e investimit në kontekstin e politikës tatimore në raport me punësimin e kuadrit vendor.
Organizatrat ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare	Të realizojnë mbikqyrjen e vazhdueshme dhe monitorimin e realizimit të agjendave zhvillimore, të raportojnë për mundësitë dhe lehtësirat që ofron Republika e Kosovës për investime të huaja. Të monitorojnë zgjedhjet parlamentare dhe lokale me qëllim të ngritjes së llogaridhënies, transparencës dhe demokratizimit të procesit zgjedhor. Të realizoj procesin e ri, të rizgjedhjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës.
Shoqëria civile	Të monitoroj dhe të bëj transparente punën e sistemit të drejtësisë, dhe procesit të zgjedhjeve parlamentare dhe vendore.

Figura 4.2.3 Akterët e parandalimit/reagimit ndaj pasigurisë nga qeverisja

4.3 Pasiguria njerëzore si pasojë e dhunës politike

Segmentet e sigurisë njerëzore rrezikohen edhe nga dhuna politike, si pasojë e represionit politik (*siç rezulton nga lista e kërcënimeve*). Meqenëse në këtë rast shteti, është krijues i këtyre pasojave, atëherë aspekti i parandalimit të pasigurisë njerëzore duhet të rezultoj nga ndryshime shumë të mëdha brenda shtetit. Është utopike të mendohet se dhuna politike e pushtetit shtetëror ndaj qytetarëve mund të menaxhohet nga aparati shtetëror, andaj, debati zhvendoset tek sovraniteti dhe bartja e tij tek mekanizmat ndërkombëtarë.

Pushteti shtetëror, i cili krijon rendin juridik, është sovran ngase rregullon vetë rendin e tij juridik (*Hasani, 2013: 16*)., ndërsa delegimi i elementeve të sovranitetit të shtetit tek institucionet ndërkombëtare (*përmes ratifikimit të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare*), nënkupton përgjegjësinë e mekanizmave ndërkombëtarë për mbrojtjen e qytetarëve të një shteti, në rastin kur shteti nuk zbaton normat ndërkombëtare, respektivisht nëse i shkel ato norma. Edhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës marrëveshjet ndërkombëtare të cilat ratifikohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (Kapitulli I, neni 17, paragrafet 1 dhe 2), bëhen pjesë e sistemit juridik të Republikës së Kosovës. Me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare Republika e Kosovës i bart kompetencat shtetërore për disa çështje të caktuara (*të cilat nuk janë përcaktuar në Kushtetutë*), tek organizatat ndërkombëtare. Në bazë të dispozitave ndërkombëtare nëse Republika e Kosovës vepron ndryshe nga normat e përcaktuara në marrëveshjet ndërkombëtare, atëherë dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare mbizotërojnë me fuqinë juridike dhe në këtë konstalacion të normave, mekanizmat ndërkombëtarë kanë supremacinë ndaj pushtetit shtetëror të Republikës së Kosovës, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut respektivisht qytetarëve të saj.

PASIGURITË NJERËZORE	KËRCËNIMET
Dhuna politike (Shkolla e konceptimit të ngushtë)	1. Represioni politik,
	2. Abuzimet e të drejtave të njeriut,

Figura 4.3.1 Pasiguritë si pasojë dhunës politike

Siç theksuam më lartë, segmentet e sigurisë njerëzore në vazhdimësi rrezikohen nga vet dhuna e aparatit shtetëror si dhe nga qeverisja e dobët dhe zhvillimi i pamjaftueshëm shtetëror andaj, është e domosdoshme që reagimi ndaj dhunës së pushtetit shtetëror të kalojë në fokus të mekanizmave ndërkombëtarë, gjithnjë duke u bazuar në dispozitat e marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare. Reagimi i instrumenteve ndërkombëtare ndaj pushtetit shtetëror fokusohet në zbatimin e marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut.

MJETET	MËNYRAT
Diplomacia	Zhvillimi i bisedimeve për zgjidhjen e problemeve,
	Identifikimi i shkëljes së marrëveshjeve ndërkombëtare
	Përdorimi i metodave për zgjidhjen e problemeve (psh, shkopi dhe karrota)
Mekanizmat monitorues ndërkombëtar dhe rajonal	Monitorimi i represioni politik dhe abuzimeve të të drejtave të njeriut nga dhuna e shtetërore.
	Raportimi i dhunës shtetërore përmes dokumentimit tek mekanizmat ndërkombëtarë.
Misionet verifikuese ndërkombëtare	Angazhimi i misioneve ndërkombëtare dhe rajonale (psh.misioni OSBE-së), në territorin e shtetit që krijon pasigurinë politike përmes dhunës shtetërore, për verifikimin dhe raportimin e dhunës shtetërore.
Sanksionet	Vënia e sanksioneve dhe pengesave diplomatike ndaj elitës politike.

Figura 4.3.2 Mjetet e parandalimit dhe reagimit ndaj pasigurisë si pasojë e dhunës politike

Të gjitha këto mënyra të reagimit, mund të zbatohen nga akterët ndërkombëtar, të thirrur për mbikqyrjen, verifikimin e zbatimit të marrëveshjeve, konventave dhe traktateve të ratifikuara ndërkombëtare.

AKTORËT E REAGIMIT	AKTIVITETET
Organizatat ndërkombëtare dhe rajonale	- Monitorimi dhe raportimi i rregullt i dhunës
	- Verifikimi përmes të dërguarve special apo misioneve verifikuese në terren.
	- Dialogu që rezulton në kompromis;

	- Sanksionimi përmes embargoeve ndaj shtetit dhe zyrtarëve shtetëror.
Organizatat joqeveritare	Identifikimi i cenimit të segmenteve të sigurisë njerëzore Raportimi i shkeljeve të drejtave të njeriut
Gjykata Kushtetuese	Konstatimi i shkeljes së të drejtave të njeriut dhe anulimi i vendimeve që shkelin këto të drejta
Gjykata Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.	- Vendimet e GJEDNj - Dëshmipërblimi i detyruar nga ana e shtetit

Figura 4.3.3 Aktorët e parandalimit dhe reagimit ndaj pasigurisë si pasojë e dhunës politike

4.4 Politikat e parandalimit dhe reagimit ndaj pasigurisë njerëzore

Kontesti analitik dhe politik i bazuar në të dy konceptcionet (i ngushtë dhe i gjerë), provon se ekzistojnë lidhje të konsiderueshme mes tyre, andaj theksojmë se i gjithë diskutimi mbështetet në dy qëllime:

- 1) *Fokusimin tek pasiguria njerëzore si dhunë politike sipas konceptimit të ngushtë (variabël e varur).*
- (2) *Fokusimin tek shkaqet e pasigurisë njerëzore si dhunë politike që përfshijnë problematikën e qeverisjes së dobët dhe zhvillimin e pamjaftueshëm shtetëror (variabla e pavarur).*

Kauzaliteti i lidhjeve mund të jetë shumëfaktorial dhe me ndërlidhje të shumta, psh: kërcënimet nga papunësia apo tensionet ndëretnike mund të jenë lidhje kauzaliteti apo shkakësore, të ndërlidhura me dhunën politike. Për më tej, kauzaliteti mund të reflektojë me një raport të ndërlidhur ‘bumerang’: papunësia dhe zhvillimi i pamjaftueshëm i shtetit, jo vetëm që mund të kategorizohen si shkak pasojë e dhunës politike, por mund të rezultojë me rritjen e papunësisë dhe ngecje të zhvillimit, edhe ashtu të pamjaftueshëm shtetëror.

Nga analiza rezulton se parandalimi dhe reagimi ndaj dhunës politike në rast të dështimit të diplomacisë ndërkombëtare apo edhe rajonale, mund të realizohet përmes

ndërveprimit diplomatik dhe dërgimit të misioneve verifikuese në terren, me qëllim të identifikimit të problemeve dhe raportimit të të njëjtave tek instancat dhe mekanizmat diplomatik. Në këtë kontekst, theksojmë se reagimi diplomatik kërkon adresim adekuat ndaj dhunës politike, bazuar në shkollën e konceptimit të ngushtë “*liri nga frika*”, dhe shkollës së konceptimit të gjerë “*Liri nga nevoja*” ndaj qeverisjes që dobët dhe zhvillimit të pamjaftueshëm shtetëror.




Figura 4.4.1 Orientimet shkakësore-kausaliteti




Figura 4.4.2 Politikat e parandalimit dhe reagimit

Nga kjo analizë mund të konstatojmë se ekziston një lidhje e ngushtë shkaksore mes pasigurisë njerëzore të shkaktuar nga dhuna politike dhe qeverisjes së dobët dhe zhvillimit të pamjaftueshëm shtetëror. Duke marrë në konsideratë vëmendjen e shkollës së konceptimit të ngushtë në dhunën politike si variabël e varur dhe fokusin e shkollës së konceptit të gjerë mbi zhvillimin njerëzor si variabël e pavarur, krijohet mundësia e kuptimit të këtij kauzaliteti dhe rrjedhimisht edhe identifikimit të politikave të parandalimit dhe të reagimit ndaj pasigurisë njerëzore.

KAPITULLI V:

PARANDALIMI DHE MBROJTJA E SIGURISË NJERËZORE PËRMES LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS

5.1 Vështrim historik

Standardi i jetesës së qytetarëve dhe për pasojë siguria njerëzore në vazhdimësi rrezikohet nga dukuritë kriminale dhe asociale të shoqërisë, andaj edhe niveli i sigurisë njerëzore varion mbi bazën e agjendave shtetërore. Ky lloj i sigurisë mvaret shpesh nga politikat e klasës udhëheqëse, orientimit të tyre, prioritizimit të agjendave dhe implikimeve tjera të rëndësishme.

Shoqëria Kosovare përgjatë tre (3) dekadave të fundit, për sa i përket nivelit të sigurisë njerëzore, ka kaluar nëpër një variacion të pakrahasueshëm, dhe pothuajse plotësisht të kundërt njëri me tjetrin. Qytetarët e Kosovës para luftës së vitit 1999, duke jetuar nën pushtetin jugosllav dhe serb, në vazhdimësi kanë qenë të atakuar nga represioni dhe dhuna e pushtetit. Pushtetin e paraluftës e kanë mbajtur pothuajse shumica e pjesëtarëve të etnitetit serb, të cilët përmes dhunës fizike ndaj qytetarëve shqiptarë, dhe kombeve tjera, kanë ndikuar në tensionimin ndëretnik. Regjimi i asaj kohe, pas abrogimit të Kushtetutës së Kosovës në vitin 1989, shumicën e shqiptarëve, i ka larguar nga puna, i ka mbyllur shkollat shqipe dhe banorëve autokton shqiptarë ua ka mohuar qasjen në shëndetësi. Poashtu, ai regjim ka ndikuar në rritjen e nivelit të papunësisë, varfërisë dhe të mirëqenies që qytetarëve shqiptarë. Këto pasoja kanë ndikuar në migrimin e vazhdueshëm të popullatës shqiptare. Në anën tjetër, po në kohën e paraluftës, kërcënimet e sotme të sigurisë së përgjithshme dhe sigurisë personale si terrorizmi, nuk kanë qenë çështje për brengosje. Është për t'u çuditur se si në atë kohë, nën frikën e kërcënimit nga shteti,

kërcënimet ndaj mjedisit si degradimi dhe ndotja e mjedisit, kanë qenë pothuaj minimale. Karakteristikë e asaj kohe ka qenë se aparati shtetëror ka qenë aq i organizuar, i fortë dhe i dhunshëm sa që nëse diçka ka qenë e paraparë me ligj, ato dispozita kanë gjetur zbatim rigoroz edhe në praktikë.

Pikërisht zbatimi i ligjeve dhe dispozitave ligjore në praktikë mungon në Kosovën e pasluftës së vitit 1999. Mbarimi i luftës së vitit 1999, në Kosovë ka sjellë misionin e UNMIK-ut, për të administruar pushtetin dhe për të zbatuar ligjin. Në vitet e administrimit të UNMIK-ut, përveç ndryshimeve të vazhdueshme të normave penalo juridike, në zhvillim kanë qenë edhe krijimi dhe funksionalizimi i institucioneve të administratës dhe të zbatimit të ligjit. Megjithatë, gjatë periudhës së tranzicionit, edhe përkundër angazhimit të akterëve të shumtë ndërkombëtarë, të cilët vinin nga sisteme ku siguria njerëzore ishte prioritet i politikave të shtetit, fatkeqësisht kjo përvojë nuk është bartur tek institucionet e Kosovës.

Në shoqërinë kosovare, pas luftës së vitit 1999, mungesa e zbatimit të ligjit është arsyetuar si fazë tranzicionale apo fazë e pasluftës, dhe për kryesit ka egzistuar arsyetimi, se në një mënyrë apo një tjetër, ata (kryesit) kanë qenë viktimë të luftës apo të angazhuar në luftë dhe gabimet e tyre nuk janë të qëllimshme andaj, edhe duhet të anashkalohen këto çështje. Pra, gjithnjë ka pasur një arsye për të mos proceduar penalisht kërcënuesit e sigurisë njerëzore. Në këto kushte dhe rrethana zyrtarët e administratës dhe zbatuesit e ligjit në të shumtën e rasteve kanë dështuar në zbatimin e normave penalo juridike dhe për pasojë është krijuar një atmosferë e mosdënueshmërisë së qytetarëve të cilët kanë shkelur ligjin.

Me 17 shkurt 2008, Kosova ka shpallur pavarësinë, mirëpo, Institucionet shtetërore, të ambientuar me klimën e pushtetit të UNMIK-ut, kanë vazhduar të dështojnë në krijimin

e politikave kriminale për të ngritur nivelin e sigurisë njerëzore. Fokusi primar i Institucioneve nuk ishin agjendat prioritare për mbrojtjen e segmenteve të sigurisë, por zbatimi i agjendës për përmbushjen e kriterëve për integritet Evropian. Institucionet e Kosovës duke u angazhuar në përmbushjen e kriterëve për integritet Evropian dhe kërcënimeve globale, me fokus të veçantë në luftimin e terrorizmit dhe korrupsionit, kanë lënë anash përmbushjen e nevojave më bazike të qytetarëve për më shumë siguri personale, të bashkësisë, ekonomike, ushqimore, shëndetësore, mjedisore dhe politike. Nevoja këto të cilat janë kushti bazik për mirëqenien e shoqërisë dhe standardit të jetesës.

Në ditët e sotshme, pas 16 viteve në liri, dhe 8 viteve në pavarësi, qytetarët e Kosovës ballafaqohen ende me mungesën e sigurisë njerëzore. Theksojmë se në kohën e paraluftës, siguria njerëzore e qytetarëve rrezikohej nga aparati shtetëror (regjimi), mirëpo po i njëjti aparat shtetëror në mënyrë rigoroze dhe shpesh arbitrare zbatonte legjislacionin dhe sanksiononte të gjithë ata që kryenin shkelje ligjore, me përjashtim të segmentit të sigurisë politike, të cilin e keqpërdorte vet aparati shtetëror. Mund të theksojmë, se nëse para luftës qytetarët e Kosovës kanë qenë subjekt i dhunës së aparatit shtetëror, në formë të represionit të vazhdueshëm dhe si formë e shkeljes së obligimit të mosndërhyrjes në jetën e qytetarëve, në kohën e pasluftës qytetarët janë viktimat të mungesës së angazhimit të Institucioneve shtetërore apo të një indiference të institucioneve në ofrimin e nivelit të duhur të sigurisë njerëzore.

Ndërsa, për sa i përket sigurisë kolektive, vlerësojmë se mbrojtja e paqes dhe interesave shtetërore janë qëllimi i vetë shtetit (KK, 2008: neni 2 paragrafi 3), dhe mbi këtë normë kushtetuese, Kosova mund të marrë pjesë në sistemin e sigurisë ndërkombëtare, e cila përbëhet nga masat e ndërmarrura nga shtetet dhe organizatat ndërkombëtare (psh,

OKB, NATO etj), për të siguruar mbijetesën dhe sigurinë në botë. Duke pasur parasysh rëndësinë e ruajtjes së paqes në botë si dhe interesave shtetërore, Republika e Kosovës mund të marrë pjesë edhe në sistemin e përgjithshëm të ruajtjes dhe mbrojtjes së sigurisë ndërkombëtare, e cila, për shkak të globalizimit, rritjes së terrorizmit ndërkombëtar, interesit të Fuqive të mëdha, krizës ekonomike botërore, mungesës së ushqimit dhe ujit, ndryshimeve krimaterike dhe katastrofës së mundshme ekologjike, në ditët e sotme rrezikohet më shumë se kurrë (Hasani, 2013:20). Të gjitha këto rreziqe përbëjnë tërësinë e segmenteve të sigurisë njerëzore dhe për interes të përgjithshëm vlen të investohet në parandalimin e kërcënimeve dhe mbrojtjen e tyre, jo vetëm në territorin e Kosovës por edhe angazhimin sado modest në ruajtjen e paqes dhe sigurisë njerëzore në botë.

5.2 Efekti i akteve ndërkombëtare në legjislacionin e Kosovës

Edhe pse Republika e Kosovës nuk është nënshkruese dhe ratifikuese e normave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (*të përmendura parapraakisht*), megjithatë të njëjtat norma gjejnë zbatim në Kosovë pikërisht përmes Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Këto norma marrin efektin e zbatueshmërisë në Kosovë, duke iu dhënë prioritet në rast konflikti ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike (KK, 2008: neni 22).

Theksojmë se Kushtetuta e Republikës së Kosovës shkon edhe përtej mbrojtjes së të drejtave në nenet e saj, duke u siguruar që të jetë në hap me zhvillimet dhe praktikën ndërkombëtare, duke kërkuar që të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutë, të interpretohen në pajtim me vendimet e GjENDNj-së (KK, 2008:53).

Marrë parasysh, nga sa u tha më sipër dhe nga fakti se të drejtat dhe liritë e njeriut janë të përcaktuara në kuadër të 35 neneve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, shihet si e domosdoshme që në vijim të japim një pasqyrim mbi mbrojtjen e këtyre të drejtave, të cilat njëkohësisht, një numër i madh i tyre kanë lidhshmëri edhe me segmentet e sigurisë njerëzore. Në analizën e dispozitave kushtetuese në Kosovë mund të themi se të gjitha segmentet e sigurisë njerëzore gjejnë mbrojtje kushtetuese përmes mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Siguria politike, respektivisht kërcënimet që cenojnë këtë segment të sigurisë njerëzore kanë mbulueshmërinë më të madhe në Kushtetutën e Kosovës, duke përfshirë pothuajse të gjithë Kapitullin e dytë të Kushtetutës, i cili i referohet të drejtave dhe lirive themelore. Kjo arsyetohet me faktin se në kuadër të këtij segmenti të sigurisë bën pjesë edhe kërcënimi individit nga represioni i shtetit dhe abuzimi me të drejtat e njeriut. Rrjedhimisht, segment dhe si të drejta të njeriut që hyjnë në këtë fushë kanë ndikim edhe në segmentet tjera të sigurisë njerëzore. Në vazhdim (në tabelë) pasqyrojmë mbrojtjen kushtetuese nga kërcënimet e sigurisë politike.

KËRCËNIMET	MBROJTJA KUSHTETUESE (NENI)
Represioni politik dhe abuzimet e të drejtave të njeriut	Barazia para ligjit (3), E drejta për integritetin personal (KK, neni 26), Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues (KK, neni 27), E drejtat e lirisë dhe sigurisë (KK, neni 29), Të drejtat e të akuzuarit (KK, neni 30), E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (KK, neni 31), E drejta për mjete juridike (KK, neni 32), E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër (KK, neni 34), Liria e lëvizjes (KK, neni 35), E drejta e privatësisë (KK, neni 36), Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë (KK, neni 38), Liria e shprehjes (KK, neni 40), E drejta e qasjes në dokumente publike (KK, neni 41), Liria e tubimit (KK, neni 43), liria e asociimit (KK, neni 44).

Figura 5.2.1 Kërcënimet ndaj sigurisë politike dhe mbrojtja kushtetuese

Siguria politike në aspektin kushtetues dhe të drejtave të njeriut ka implikime të obligimit negativ të shtetit, respektivisht kërkesën apo më saktë ndalesën, që i bëhet shtetit

për të mos interferuar në të drejtat e njeriut dhe rrjedhimisht edhe cenimin e segmenteve të ndryshme të sigurisë njerëzore. Raste të tilla, të shkeljeve potenciale të këtyre të drejtave nga ana e akterëve shtetëror ka në numër të madh, e në veçanti raste të trajtuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga palët që janë thirrur në nene të ndryshme të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Duke presupozuar se i gjithë kapitulli për të drejtat e njeriut bën pjesë edhe në segmentin e sigurisë politike, me këtë nuk përjashtojmë grupimin e neneve të veçanta sipas segmenteve tjera të sigurisë. Mirëpo, dallimi qëndron në atë se nenet tjera që i referohen segmenteve tjera të sigurisë njerëzore përgjithësisht kanë të bëjnë me ‘obligimin pozitiv’ të shtetit për të ndërhyrë për të ndërmarrë hapa në ofrim të mbrojtjes dhe sigurisë, e jo si kërkesë që shteti të mos ndërhyjë.

Siguria personale paraqet poashtu një segment mjaft të gjërë, me përfshirje të një numri të normave kushtetuese të drejtave të njeriut, përmes së cilave mbrohet siguria personale nga kërcënimet që e cenojnë. Në vazhdim pasqyrojmë (në tabelë) kërcënimet dhe mbrojtjen kushtetuese të qytetarëve në aspektin e sigurisë personale.

KËRCËNIMET	MBROJTJA KUSHTETUESE (NENI)
Dhuna fizike dhe krimi	Dinjiteti i njeriut (KK, neni 23), E drejta për jetën (KK, neni 25), E drejta për integritetin personal (KK, neni 26), Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues (KK, neni 27), Mbrojtja e pronës (KK, neni 46).
Terrorizmi	E drejta për jetën (KK, neni 25).
Dhuna në familje	Dinjiteti i njeriut (KK, neni 23), E drejta për jetën, (KK, neni 25), E drejta e integritetit personal (KK, neni 26), Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues (KK, neni 27), E drejta e lirisë dhe sigurisë (KK, neni 29), Liria lëvizjes (KK, neni 35), E drejta privatësisë (KK, neni 36), E drejta martesës dhe familjes (KK, neni 37), Liria e shprehjes (KK, neni 40), E drejta për arsimim (KK, neni 47).
Punësimi fëmijëve	Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar (KK, neni 28), E drejta e martesës dhe e familjes (KK, neni 37), Të drejtat fëmijës (KK, neni 50).

Figura 5.2.2 Kërcënimet ndaj sigurisë personale dhe mbrojtja kushtetuese

Ky segment i sigurisë njerëzore, rrezikohet nga kërcënime të ndryshme të cilat përbëjnë një kërcënim shumë të gjerë, andaj në reflektim të kësaj çështje edhe mbrojtja

kushtetuese është e llojllojshme. Nëse analizohen secilat nga këto nene (nga tabela e mësipërme), në veçanti do të shohim pikërisht atë elementin e obligimit pozitiv të shtetit, që të ofrojë mbrojtje për individin, edhe në rastet kur këto të drejta potencialisht shkelen nga një individ tjetër. Kjo pasi nënkuptohet se me lejimin e shkeljes së këtyre të drejtave, qoftë edhe nga vet individi, shteti nuk përmbush obligimin për të drejtën e normuar, për të cilën është zotuar se do të ofrojë.

Siguria ekonomike në Republikën e Kosovës mbrohet përmes normave kushtetuese të cilat adresojnë çështjen e papunësisë dhe varfërisë së vazhdueshme, të cilat drejtpërdrejtë ndikojnë në dinjitetin e njeriut dhe mund të prodhojnë si pasojë edhe rrezikimin e jetës. Në vazhdim (në tabelë) pasqyrojmë llojet e kërcënimeve dhe mbrojtjen kushtetuese të qytetarëve në aspektin e sigurisë ekonomike.

KËRCËNIMET	MBROJTJA KUSHTETUESE (NENI)
Papunësia dhe varfëria e vazhdueshme	Dinjiteti i njeriut (KK, neni 23), E drejta për jetën (KK, neni 25), Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar (KK, neni 28), E drejta e martesës dhe familjes (KK, neni 37), Mbrojtja e pronës (KK, neni 46) E drejta e arsimit (KK, neni 47), E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit (KK, neni 49), Të drejta e fëmijës (KK, neni 50).

Figura 5.2.3 Kërcënimet ndaj sigurisë ekonomike dhe mbrojtja kushtetuese

Siguria ekonomike e qytetarit poashtu garantohet përmes mbrojtjes së pronës (neni 46) si gërshetim i obligimit pozitiv dhe negativ të shtetit, për sigurimin e paprekshërisë së pronës së individit dhe të drejtës së punës dhe ushtrimit të profesionit (neni 49). Me theks të veçantë në ofrimin e mundësisë së angazhimit në punë, pa rrezikun e një kufizimi të tillë nga shteti apo kushdo tjetër dhe duke u siguruar që për këtë të merr shpërblimin e duhur. Neni 49 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës garanton të drejtën e punës *“E drejta e punës garantohet, secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës”*,

duke potencuar se e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit, garanton që secili person të ketë liri në përzgjedhjen e profesionit dhe vendit të punës. Të drejtën e punës dhe të ushtrimit të profesionit e proklamon më së mirë Pakti ndërkombëtar për të drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e viti 1996, në pjesën e tretë (*neni 6-7*). Poashtu, Karta Sociale Evropiane (KSE), në mënyrë mjaft precize dhe gjithëpërfshirëse e përcakton pozitën juridike të punëtorëve dhe të grupimeve të tjera sociale, duke u nisur nga fakti se përmirësimi i standardeve të jetesës së popullsisë dhe të begatisë shoqërore (Salihu, 2014: 590), janë parakusht themelor për kultivimin dhe realizimin e mëtejshëm të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, si dhe të ngritjes së nivelit të sigurisë individuale që qytetarëve. Meqenëse përmes së drejtës në punë, sigurohet edhe jetesë familjare, në veçanti e drejta e fëmijëve në mirëqenie, atëherë edhe mbrojtja kushtetuese zgjerohet edhe në mbrojtjen e asaj kategorije, të cilët mvaren nga anëtarët e familjes për të ju siguruar një jetë të dinjitetshme, jo në varfëri.

Siguria shëndetësore. Lufta ndaj rrezikut për shëndetin e njeriut kërkon një bashkëpunim dhe angazhim ndërkombëtar dhe për këtë arsye janë ratifikuar shumë konventa dhe marrëveshje nga shteti ynë, si psh: rregullorja ndërkombëtare e shëndetësisë nr.6/77. Theksojmë se e drejta për mbrojtje shëndetësore në Republikën e Kosovës është e drejtë kushtetuese. Në kuadër të autorizimeve kushtetuese, institucionet shtetërore dhe mekanizmat tjerë kanë nxjerrë ligje dhe masa të ndryshme, me qëllim të ruajtjes dhe përparimit të shëndetit të popullatës, parandalimit dhe luftimit të sëmundjeve ngjitëse. Kushtetuta e Kosovës ka përcaktuar normat me të cilat mbron shtetasit nga kërcënimet, të cilat i pasqyrojmë (në tabelë) në vazhdim, duke përfshirë llojet e kërcënimeve dhe mbrojtjen kushtetuese të qytetarëve në aspektin e sigurisë shëndetësore.

KËRCËNIMET	MBROJTJA KUSHTETUESE (NENI)
Sëmundjet vdekjeprurëse infektive	Dinjiteti i njeriut (KK, neni 23), E drejta për jetën (KK, neni 25), E drejta e integritetit personal (KK, neni 26), Mbrojtja shëndetësore dhe sociale (KK, neni 51)
Mungesa e qasjes në kujdesin themelor shëndetësor	Mbrojtja shëndetësore dhe sociale (KK, neni 51),
Ushqim të pasigurt	E drejta për jetën (KK, neni 25), E drejta e integritetit personal (KK, neni 26),

Figura 5.2.4 Kërcënimet ndaj sigurisë shëndetësore dhe mbrojtja kushtetuese

Me sa duket, siguria shëndetësore më së miri është normuar përmes nenit për të drejtën në integritetin personal (neni 26). Kjo normë në mënyrë më specifike i referohet të drejtës së njeriut të ketë kontrollin mbi trupin e vet dhe të mos i nënshtrohet trajtimeve dhe eksperimenteve mjekësore pa aprovimin e vet apo edhe të ndërhyjë në ato raste kur vihet në dijeni se një intervenim i tillë është bërë apo tentohet të bëhet. Konventa ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve, së cilës përmes Kushtetutës së Kosovës, i'u është pranuar primati ndaj legjislacionit vendor, vendos një obligim të veçantë, sidomos kur është fjala për mirëqenien e fëmijëve. Konventa udhëzon shtetet të kenë parasysh “*Rreziqet e ndotjes së ambientit*”, për të siguruar implementimin e plotë të të drejtës së fëmijëve në shëndet (KNDF, CRC: neni 24).

Siguria ushqimore. Disponueshmëria dhe aksesit në ushqim duhet të jenë të drejta të pamohueshme për çdo shtet demokratik, në shërbim të popullit. Në këtë kontekst, theksojmë se është e drejtë kushtetuese liria e qytetarëve nga pasiguria ushqimore. Në vazhdim (në tableë), pasqyrojmë të drejtat kushtetuese të qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilat i adresohen kërcënimeve nga skamja, uria dhe kequshqyerja.

KËRCËNIMET	MBROJTJA KUSHTETUESE (NENI)
Skamja, uria dhe kequshqyerja	Dinjiteti i njeriut (KK, neni 23), E drejta për jetën (KK, neni 25), E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit (KK, neni 49), Të drejtat e fëmijës (KK, neni 50), E drejta shëndetësore dhe sociale (KK, neni 51).

Figura 5.2.5 Kërcënimet ndaj sigurisë ushqimore dhe mbrojtja kushtetuese

Segmenti i sigurisë ushqimore, sikur edhe të gjitha segmentet e sigurisë njerëzore, rezulton në të drejtën e njeriut për jetë dhe dinjitet. Nenet kushtetuese që lidhen me mbrojtjen shëndetësore dhe sociale (neni 51), e drejta në punë dhe të drejtat e fëmijëve gërshetojnë tre format e sigurisë, (1) Sigurinë shëndetësore, (2) Sigurinë ekonomike dhe (3) Sigurinë ushqimore, duke bartur përgjegjësinë e kësaj të drejte në ligjet aplikueshme në Kosovë. Megjithatë, në aspekt të trajtimit të sigurisë ushqimore, mund të themi se neni 51 nënkupton se nga shteti kërkohet, që përmes normave ligjore, të ofrojë mbrojtje më të zgjeruar, p.sh mbrojtja nga sëmundje infektive, qasje në shërbime shëndetësore, ushqim të sigurtë etj.

Qasja në furnizime adekuate me ushqim, paraqet nevojën dhe të drejtën më bazike njerëzore, ndërsa uria paraqet shkelje të dinjitetit të njeriut dhe një pengesë e progresit social, politik dhe ekonomik. E drejta ndërkombëtare njeh se të gjithë gëzojnë të drejtën themelore për të qenë të lirë nga skamja dhe një numër i vogël i shteteve e kanë përfshirë të drejtën ushqimore në kushtetutat e tyre. Qeveritë duhet të bëjnë gjithçka është e mundur për t'u siguruar që njerëzit të kenë qasje fizike dhe ekonomike në ushqim të sigurtë, me vlera ushqyese, si dhe jetë aktive (FAO, 28). Në këtë kontekst theksojmë se Deklarata e Stokholmit e vitit 1972 ka njohur se ekziston e drejta fundamentale në liri, barazi dhe kushte adekuate për jetesë, në një mjedis me kualitet që mundëson një jetë me dinjitet dhe mirëqenie.

Siguria mjedisore garantohet përmes normës “ërgjegjësia për mjedisin” (neni 52). Objekti mbrojtës i kësaj norme është e drejta e njeriut të jetojë në një mjedis të pastër duke i siguruar atij një jetë të shëndetshme dhe në mirëqenie, duke përfshirë edhe ndërhyrjen e shtetit që të mbrojë nga abuzuesit e mjedisit në dëm të tjerëve. Në vazhdim (në tabelë)

pasqyrojmë llojet e kërcënimeve dhe mbrojtjen kushtetuese të qytetarëve në aspektin e sigurisë mjedisore.

KËRCËNIMET	MBROJTJA KUSHTETUESE (NENI)
Degradimi dhe ndotja e mjedisit dhe burimeve si dhe fatkeqësitë natyrore.	Përgjegjësia për mjedisin jetësor (KK, neni 52),

Figura 5.2.6 Kërcënimet ndaj sigurisë mjedisore dhe mbrojtja kushtetuese

Meqenëse siguria mjedisore bën pjesë në kuadër të të segmenteve dhe të drejtës së gjeneratës më të fundit, andaj theksojmë se shumica e dokumenteve që i referohen kësaj fushe janë të mëvonshme. Deklarata e Rios e vitit 1992 në nenin e parë të saj thekson se: *“Qeniet njerëzore... kanë të drejtë të jetojnë në jetë të shëndetshme dhe produktive në harmoni me natyrën”*. Kushtet joadekuate mjedisore mund të kenë ndikim në konsumimin e disa të drejtave tjera si psh.: e drejta në jetë, shëndet, ujë dhe ushqime. Disa nga traktatet e OKB për të drejtat e njeriut në mënyrë eksplicite e njohin këtë ndërlidhje (UNEP, 2015, 12). Konventa ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore e cila i udhëzon shtetet të miratojnë masa sipas nevojës për *“përmirsimin e të gjitha aspekteve të higjienës mjedisore dhe industriale”*, ka për qëllim realizimin e plotë të drejtës në shëndet (KNDESK, neni 12). Edhe Deklarata e Rios lidh zhvillimin e qëndrueshëm me mbrojtjen e mjedisit, duke theksuar se kjo e dyta paraqet pjesë integrale të procesit zhvillimor dhe se nuk duhet trajtuar si e izoluar (neni 4).

Deklarata e Rios adreson dhe promovon nevojën e pjesëmarrjes së qytetarëve në çështjet mjedisore. *“Në nivelet kombëtare, secili individ do të ketë qasje të duhur në informatën rreth mjedisit të cilën mund ta kenë autoritetet, përfshirë edhe informatën mbi materialet e rrezikshme dhe veprimtaritë në bashkësinë e tyre dhe mundësinë për të marrë*

pjesë në vendim-marrje”,(Deklarata e Rios, neni 10). Është pikërisht ky nen që I adresohet përgjegjësisë së shtetit për të bashkëpunuar me qytetarët dhe për të drejtën e qytetarëve në informim, si dhe të drejtën e tyre dhe për të qenë pjesë e vendim marrjes, për mirëqenien e tyre që është edhe një nga kërkesat që dalin edhe nga segmenti i sigurisë në bashkësi.

Siguria e bashkësisë, në aspektin kushtetues garantohej me një grup nenesh që kanë të bëjnë me të drejtën dhe mbrojtjen që i ofron shtetit njerëzve në grupacione të ndryshme fetare, etnike, dhe asociacione tjera duke siguruar kështu edhe mbrojtjen që i jepet në veçanti komuniteteve. Kur është fjala në planin ndërkombëtar, këto të drejta janë të garantuara me dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare, si psh: Paktin ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike, Deklaratën e për të drejtat e pakicave kombëtare apo etnike, fetare dhe gjuhësore të vitit 1992 (Hasani, 2013:219). Deklarata e garanton të drejtën për pjesëmarrje dhe vendosje, në nivel kombëtar dhe atje ku është e mundur në nivel rajonal, çdoherë kur ka të bëjë me çështjen e pakicave të cilave u takojnë apo, rajonin në të cilin jetojnë. Për më tej, këto të drejta garantohej edhe me Konventën Kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare të Këshillit të Evropës nga viti 1995, Konventën për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racor dhe Rekomandimet e Londrës për pjesëmarrje të pakicave kombëtare në procesin zgjedhor. Sipas konventës, vendet anëtare obligohen që të ndalojnë dhe eliminojnë çdo lloj të diskriminimit të pakicave kombëtare, që veçanërisht kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave politike, pjesëmarrjes në qeveri dhe në udhëheqjen e punëve publike në të gjitha nivelet (Hasani, 2013:219). Në vazhdim (në tabelë), pasqyrojmë kërcënimet ndaj sigurisë në bashkësi dhe normat kushtetuese të cilat garantojnë mbrojtjen e bashkësive.

KËRCËNIMET	MBROJTJA KUSHTETUESE (NENI)
Tensionet ndër etnike, fetare dhe tensionet tjera në bazë të identitetit	Barazia para ligjit (KK, neni 3), Gjuhët (KK, neni 5), Trashëgimia kulturore dhe fetare (KK, neni 9), Liria e lëvizjes (KK, neni 35), Liria besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë (KK, neni 38), Konfesionet fetare (KK, neni 39), Liria e shprehjes (KK, neni 40), Liria asociimit (KK, neni 44), Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre (KK, neni 59), Përfaqësimi në punësim në institucionet publike, përfaqësimi në organet e pushtetit lokal (KK, neni 61), E drejta për arsimim (KK, neni 47), Mbrojtja gjyqësore e të drejtave (KK, neni 54), Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore (KK, neni 55), Përgjegjësitë e shtetit (KK, neni 58); Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre (KK, neni 59), Këshilli Konsultativ për komunitete (KK, neni 60), përfaqësimi në punësim në institucionet publike (KK, neni 61) përfaqësimi në organet e pushtetit lokal (KK, neni 62).

Figura 5.2.7 Kërcënimet ndaj sigurisë së bashkësisë dhe mbrojtja kushtetuese

Në aspektin e sigurisë bashkiake, të cilën jemi të orientuar ta trajtojmë në këtë punim, siguria në bashkësi kryesisht i referohet tensioneve ndëretnike dhe atyre tensioneve mes grupacioneve të ndryshme si pasojë e diverisiteve. Ky konflikt shpeshherë lidhet me të drejtën Kushtetuese për mosdiskriminim dhe trajtim të barabartë, si një kërkesë e përgjithshme e njohur edhe ndërkombëtarisht si e drejtë e mbrojtur. Parimi i mosdiskriminimit është parashikuar në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian dhe në Direktivat që rregullojnë zbatimin dhe respektimin e parimit të trajtimit të barabartë. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian është bërë e detyrueshme për zbatim nga shtetet anëtare, duke e bërë atë burim parësor të legjislacionit të BE-së. Parimi i mosdiskriminimit parashikohet edhe në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (neni 14 dhe Protokoli 12) dhe në shumë instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

5.3 Rreziqet aktuale të sigurisë njerëzore në Kosovë

Në ditët e sotshme qytetarët e Kosovës ballafaqohen me shumë sfida për jetën, shëndetin dhe pronën. Vjedhjet në objekte individuale janë shumë të shpeshta, duke përfshirë vjedhjet në objektet e banimit familjar, duke shkaktuar dëm të madh në financat

familjare si dhe traumat psikike tek antarët të familjes, sidomos tek fëmijët. Huliganizmi dhe dhuna janë bërë përditshmëri, të cilat në aspektin e sigurisë publike janë pasojë e mosreagimit të forcës së dhunës shtetërore (*Policisë*) dhe në anët tjetër shkaktojnë panik tek qytetarët, sidomos tek gjinia femërore dhe tek fëmijët të cilët gjatë aktiviteteve të tyre të përditshme në qytet, ndjejnë pasiguri nga bandat e rrugëve. Kërcënim i llojit të veçantë është edhe dhuna në familje, e cila tanimë për fat të keq është dukuri normale, në përditshmërinë e jetesës në Kosovë. Dhuna në familje është bërë dukuri normale jo për faktin se është dukuri e re, por për faktin se vetëdijësimi përmes njohjes së dhunës, ka ndikuar në denoncimin e kësaj dukurie të dëmshme shoqërore tek organet e rendit.

Meqenëse papunësia në Kosovë është shumë e lartë, mungesa e punësimit të prindërve ndoshta shtyen këta të fundit, të lejojnë apo të inkurajojnë fëmijët e tyre në punësim, duke shkelur kështu gjitha normat ligjore dhe obligimet prindërore për t'iu ofruar fëmijëve një jetë të sigurtë. Jetesa e sigurtë për fëmijë nënkupton sigurimin e ushqimit të mjaftueshëm dhe kualitativ, vijueshmërinë e shkollimit dhe plotësimin e nevojëve tjera që kanë fëmijët gjatë periudhës së tyre të rritjes.

Që nga paslufta (1999), bashkëjetesa ndëretnike në Kosovë është dëmtuar nga vrasjet, sulmet fizike dhe tensionet tjera në bazë të identitetit dhe përkatësisë. Menjëherë pas luftës, kanë ndodhur vrasje të shumta me motive të ndryshme, duke përfshirë motivet politike, ekonomike dhe të përkatësive të ndryshme etnike. Lidhur me motivin e fundit, theksojmë se imazhi i Republikë së Kosovës është dëmtuar nga ngjarjet e vitit 2004. Këto ngjarje prodhuan dëmtime dhe djegie të objekteve fetare serbe (në territorin e Kosovës). Përveç dëmtimit të imazhit është dëmtuar edhe bashkëjetesa në mes etnive, e cila edhe deri në atë kohë ishte shumë fragile për shkak të pasojave të krijuara nga regjimi serb ndaj

qytetarëve shqiptarë të Kosovës. Viti 2004 ishte një vit i humbur në aspektin e krijimit të urave të bashkëpunimit me banorët serb të Kosovës, edhe pse të njëjtëve i'u mungonte vullneti apo ekzistonte një lloj kërcënimi i heshtur ndaj gjithë atyre që tentonin të bashkëjetonin dhe punonin me shqiptarët. Sfida tjera të sigurisë janë edhe degradimi i mjedisit, mospërgjegjësia në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, rreziqet nga produktet e dyshimta ushqimore si dhe mungesa e skemave sociale. Për më tej, degradimi i mjedisit është një sfidë dhe problematikë e patrajtuar siç duhet nga institucionet shtetërore, që nga paslufta. Degradimi i mjedisit fillimisht (nga 1999), ishte si pasojë e mungesës së krijimit të institucioneve vendore, të cilat përmes inspektorëve të mjedisit duhej të angazhohej në parandalimin e degradimit të mjedisit. Degradimi i mjedisit nënkupton, në këtë rast, shkatërrimin e rrjedhës së lumenjëve gjatë nxjerrjes së paligjshme të rërës nga individë të papërgjegjshëm, të cilët rërën e shitnin në treg, duke mos qarë kokën për pasojat e degradimit të rrjedhës së lumjenëve.

Mirëpo, përkundër sfidave të cilat u përmendën deri më tani, theksojmë se sfida më e madhe mjedisore në Kosovë është ndotja e ajrit, e cila dëmton shëndetin e qytetarëve. Ndotja e ajrit ndodh si pasojë e transmetimit të tymit nga industritë e përpunimit të thëngjilit për të krijuar rrymën e elektrike. Për më tej, ndotja ndodh nga kompanitë e prodhimit të cementos, kompania e përpunimit të nikelit (Feronikeli) oxhaqet e së cilës në vazhdimësi nxjerrin tym helmues.

Sfidë e llojit të veçantë është edhe mungesa e përgjegjësisë së personelit mjekësor në ofrimin e shërbimeve adekuate mjekësore. Nga pas lufta (1999), arsyetimi i personelit mjekësor ishte pagesa e ulët për punën e kryer në shërbim të pacientëve, perderisa ky arsyetim u eliminua pas ngritjes së pagave për shërbyesit mjekësore. Shërbyesit mjekësor

edhe në ditët e sotshme nuk ndejnë përgjegjësinë adekuate për të ofruar shërbimet e nevojshme për qytetarët dhe në raste të ndryshme, opion i vetëm për të realizuar një trajtim të duhur nga shërbyesit mjekësor është dhënie e dhuratave në forma të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe dhënien e parasë së gatshme. Dukuria e mungesës së gatishmërisë së shërbyesve mjekësor në ofrimin e shërbimeve adekuate mjekësore është edhe pasojë e legjislacionit, ngase vet legjislacioni iu mundëson atyre të punojnë në shërbimin mjekësor shtetëror dhe njëkohësisht të posedojnë dhe punojnë në klinikat e tyre private. Mungesa e ofrimit të shërbimit mjekësor shtetëror adekuat nga ana e shërbyesve mjekësor, drejtpërdrejtë nënkupton se të njëjtit shërbyes ofrojnë alternativë të shërbimit adekuat dhe cilësor në klinikat e tyre private, kuptohet në kundërvlerë të pagesave të larta monetare.

Sfidë e rëndë dhe kërcënim i vazhdueshëm për shëndetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës është qarkullimi në treg i produkteve të dyshimta ushqimore. Para luftës së vitit 1999, qytetarët ishin të shqetësuar nga pasiguria e kualitetit të ushqimit dhe nga origjina e tij. Për një kohë të gjatë qytetarët ishin të sfiduar nga exporti i ushqimit nga Ukraina, që në vetvehte krijonte frikë tek qytetarëve, pasi që në atë shtet kishte ndodhur tragjedia e “Çernobilit”, shpërthimi i centralit bërthamor, dhe ushqimet e tyre përbënin rrezikshmëri për sëmundjen e kancerit. Paslufta (pas 1999) për qytetarët e Kosovës solli dukurinë e radhës: ndryshimin e origjinës në paketimet e produkteve si dhe ndryshimin e datës së skadencës së tyre (produkteve). Të dyja këto problematika, nuk do të shqetësonin qytetarët, konsumues të këtyre ushqimeve, në rast se do të funksiononte inspektoriati ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorëve.

Meqenëse kërcënimet ndaj sigurisë njerëzore në Kosovë janë të shumta, disa prej të cilave i trajtuam, rrjedhimisht lind pyetja *“nga çfarë rrezikohet më së shumti siguria në*

Kosovë? Në Kosovë eziston një dualizëm shumë i madh lidhur me çështjen: Cila është hallka më e dobët, që rëndon mbi Kosovën si shtet dhe mbi qytetarët e saj? Gjersa në përgjithësi kemi një perceptim mbi shkallën e lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar në Kosovë, nga ana tjetër me fillimin e paraqitjes së rreziqeve shumë aktuale të terrorizmit, edhe fokusi dhe frika e njerëzve për sigurinë e tyre ka ndërruar drejtim. Perceptimi për korrupsionin, krimin ekonomik etj, tek popullata e Kosovës është shumë i lartë, pasi që ata besojnë se korrupsioni ka përfshirë të gjitha sferat e jetës institucionale në Kosovë.

Perceptimi i bazuar me “*mbylljen e syve*” nga ana e Institucioneve të sundimit të ligjit, ka krijuar bindjen në paprekshmërinë e kryesve të këtyre vepra kriminale, sidomos të atyre të profilit të lartë. Gjithashtu, është egziston perceptimi në varësinë dhe ndikueshmërinë politike të sundimit të ligjit, e cila ka rezultuar në mosndëshkueshmërinë e politikanëve apo zyrtarëve të lartë për keqpërdorimet të cilat i kanë kryer.

Ngjarjet e vitit 2015, kanë sjellë në fokus të analizës shkaktarët e përhapjes së ideologjive ekstremiste fetare në Kosovë. Ky lloj ekstremizmi ka filluar të rrezikojë sigurinë personale të qytetarëve si dhe sigurinë e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Theksojmë se në këtë kohëra, terrorizmi dhe aktet e terrorizmit janë frika më e madhe e gjithë njerëzimit. Në vitet e fundit, rrezik të madh në aspektin e terrorizmit kanë shfaqur grupet terroriste si Al-qaida, Al-nusra dhe Isis. Gjatë viteve të fundit, këtyre grupeve terroriste, i’u janë bashkëngjitur edhe një numër i shqiptarëve, të cilët aktivitetin e tyre luftarak e kryejnë në territion e Sirisë dhe Irakut. Nga të dhënat statistikore të Këshillit Prokurorial të Kosovës rezulton se në vitin 2013 për veprën penale të përfshirjes së shqiptarëve të Kosovës pjesë e procesit hetimor kanë qenë 10 persona, në vitin 2014 janë ndaluar dhe hetuar 105 persona, ndërsa në vitin 2015 janë ndaluar dhe hetuar 65 persona

(sipas raporteve vjetore të KPK-së). Në përmbledhje, numri i përgjithshëm i shqiptarëve të Kosovës të cilët kanë qenë objekt i ndjekjes dhe ndalimit për veprën penale të pjesëmarrjes në luftërat e huaja, për tre vite është 175 persona.

Në anën tjetër, Republika e Kosovës i'u është bashkuar koalicionit të shteteve në luftën ndaj grupeve terroriste si dhe formave konvencionale dhe jo-konvencionale të terrorizmit. Të gjithë këta qytetarë i'u janë nënshtruar hetimit, ndjekjes dhe ndalimit, vetëm pasi që parlamenti i Kosovës, me procedurë urgjente dhe me këshillë të shteteve aleate, ka miratuar aktet e nevojshme ligjore për të inkriminuar dhe dënuar qytetarët e saj të cilët marrin pjesë në luftërat e huaja.

Por, si arritën qytetarët e Kosovës në këtë shkallë, që t'iu bashkohen këtyre grupeve terroriste? Cilat janë arsyet dhe shkaqet e angazhimit të shqiptarëve të Kosovës në këtë organizatë terroriste? Mendojmë se janë dy (2) arsye kryesore që shqiptarët e Kosovës shkojnë në luftërat e huaja, që tërthorazi nënkuptohet inkudrimi në grupe terroriste:

Arsyeja e parë është papunësia e madhe, sidomos e të rinjve të cilët edhe me një analizë shumë të thjeshtë mund të kuptojnë dhe të konstatojmë se shanset e tyre për punësim në Kosovë, janë shumë të vogla. Arsye tjetër është mungesa e shpresës për ndryshime në Kosovë, për shkak të mungesës së stabilitetit politik.

Arsyeja e dytë e shkuarjes së shqiptarëve të Kosovës në luftërat e huaja, është e lidhur ngushtë me arsyen e parë. Papunësia e madhe e rinisë dhe mungesa e shpresës për ndryshime në qeverisje, i shtyen të rinjtë që të përkushtohen arsyes shpirtërore fetare. Shumë të rinj kanë filluar të jenë të përkushtuar në kryerjen e riteve fetare nëpër xhamia.

Pas luftës së vitit 1999 me kontributin e OJQ-ve nga shtetet arabe, në Kosovë janë ndërtuar shumë xhami të reja në të cilat janë punësuar shumë predikues të fesë muslimane

dhe po të njëjtit kanë shpërndarë ndihma humanitare, duke u bërë kështu edhe faktor të mirëqenies së grupeve të caktuara të qytetarëve.

Kërcënimet e lartëshënuara, janë vetëm një pjesë e kërcënimeve që cenojnë tërësinë e sigurisë njerëzore në Kosovë. Të gjitha këto kërcënime, rëndojnë jetesën e qytetarëve dhe rrezikojnë mirëqenien e tyre dhe të familjeve. Për të siguruar një mirëqenije të mirë kërkohet kriminalizimi i kërcënimeve ndaj mirëqenies, si dhe angazhim të Institucioneve shtetërore në aspektin e parandalimit, reagimit dhe rimëkëmbjes.

Pasqyrimet e mësipërme paraqesin vetëm një segment të dështimit të shtetit në përmbushjen e obligimit për sigurimin e mbrojtjes së sigurisë njerëzore dhe mirëqenies së qytetarëve. Bashkë me privilegjet e udhëheqjes së shtetit vjen edhe vet përgjegjësia për mbrojtjen e atyre që u kanë dhënë besimin.

5.4 Mbrojtja penale e segmenteve të sigurisë njerëzore

Siguria e qytetarëve të Republikës së Kosovës, kërcënohet nga pasiguritë për jetën dhe mirëqenien, të cilat përveç që cenojnë vazhdimisht standardin e jetësës së qytetarëve, të njëjtat po shtohen në vazhdimësi. Duket qartë se siguria njerëzore, sikur ka kaluar jo vetëm në dorë të dytë, por shpesh duket të jenë jashtë agjendave dhe temave të shqetësimit dhe diskutimit nga institucionet shtetërore. Në bazë të analizës së zbatimit praktik të normave penale që adresojnë sigurinë njerëzore në Kosovë, konstatojmë se siguria njerëzore kategorizohet në shtatë segmente, sa të veçanta aq edhe të ndërlidhura me njëra tjetrën.

Segmentet përbërëse të sigurisë njerëzore përfshijnë: sigurinë politike, personale, të bashkësisë, ekonomike, ushqimore, mjedisore dhe shëndetësore. Pasiguria personale është pasojë e kërcënimeve si: dhuna fizike dhe krimi; terrorizmi; dhuna në familje dhe punësimi i fëmijëve; Pasiguria në bashkësi është pasojë e kërcënimeve nga tensionet ndër etnike,

fetare si dhe tensionet tjera mbi bazën e identitetit; pasiguria mjedisore rrjedh si pasojë e degradimit dhe ndotjes së mjedisit dhe burimeve, si dhe nga fatkeqësitë natyrore; pasiguria ekonomike është si pasojë e papunësisë dhe varfërisë së vazhdueshme; pasiguria shëndetësore është pasojë e sëmundjeve vdekjeprurëse infektive, mungesës së qasjes në kujdesin themelor shëndetësor; siguria ushqimore kërcënohet si pasojë e ushqimit të pasigurtë, skamjes, urisë dhe kequshqyrjes; dhe në fund, pasiguria politike kërcënohet si pasojë e represionit politik dhe abuzimeve të të drejtave të njeriut.

5.4.1 Mbrojtja nga pasiguria politike

Segmenti i sigurisë politike cenohet apo rrezikohet nga represioni i pushtetit dhe abuzimi me të drejtat e njeriut, dhe që të dy këto çështje sjellin në përballje të vazhdueshme qytetarin dhe pushtetin shtetëror. Pra, ky koncept përfshin shqetësimet e qytetarëve karshi Institucioneve shtetërore. Segmenti i sigurisë politike përbën kryesisht paradigmen e sigurisë së ofruar dhe të shkelur nga aparati shtetëror.

Siguria politike e qytetarëve nga njëra anë kërcënohet nga dhuna e aparatit shtetëror, ndërsa në anën tjetër pushteti (*pushteti legjislativ*) ka për obligim të mbroj qytetarët nga shkeljet e ndryshme, të cilat mund të jenë edhe si pasojë e dhunës së aparatit shtetëror. Vlen të theksohmë se normat kushtetuese që garantojnë segmentin e sigurisë njerëzore mbrohen me normat penalo juridike nga Kodi Penal i Kosovës (KP, 2013), dhe në këtë mënyrë mbrojnë qytetarët nga represioni dhe abuzimet e të drejtave të njeriut. Këto kërcënime mbrohen me një numër normash juridiko penale e në veçanti me kapitullit 17 “*Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut*” nga Kodi Penal i Kosovës. Norma penalo juridike “*Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës*”, nga neni 193 i Kodit Penal i Republikës së Kosovës (tutje KP), ka për objekt të

mbrojtur penalo-juridik barazinë lidhur me përkatësinë nacionale, racore, ngjyrën, gjuhën, besimin fetar, ateizmin, mendimin politik, apo mendimin tjetër, prejardhjen sociale ose kombëtare, në pronë, në lindje, në arsim, në statutin shoqëror (Salihu, 2014:519).

Afirmimit të idesë për të drejtën e barazisë e kanë realizuar Volteri dhe Rosu me kritikën që i kanë bërë shoqërisë feudale, nga e cila kanë buruar pabarazitë shoqërore (Gruda, 2001:204), deri në legalizimin e parimit të barazisë ndërmjet njerëzve si produkt i revolucioneve borgjeze (McKean, 1983:01). Parimi i barazisë është parim bazë i rendit shtetëror juridik, pra, themeli në të cilin bazohet dhe ndërtohet rendi juridik, si dhe e drejtë themelore e qytetarëve e garantuar me kushtetutë (Hasani, 2013:2). E drejta e lirisë dhe sigurisë është në pajtim të plotë me parimin e njohur se të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit me frymë vëllazërimi (KK, 2008: neni 29). E drejta e lirisë dhe sigurisë përlligjet në normën penalo juridike “*Shtrëngimi*” nga neni 195 i KP-së, nënkupton përdorimin e forcës apo kanosjes ndaj tjetrit, për ta detyruar atë që të veprojë apo të mos veprojë, ose të pajtohet, respektivisht t’a detyrojë në sjellje të caktuar. Kjo është vepër penale e veçantë, e cila me përdorimin e forcës dhe kanosjes përjashtohet apo kufizohet tjetri që të vendos lirshëm. Në këtë kontekst, me këtë vepër penale shkelet e drejta e lirisë së veprimit andaj, si e tillë është objekt i segmentit të sigurisë.

Norma penalo juridike “Privimi i kundërligjshëm i lirisë”, nga neni 196 i KP-së, inkriminon pengimin e lëvizjes së lirë të personit fizik në mënyrë të paligjshme, e drejtë që i përket personit edhe në bazë të së drejtës për liri dhe siguri personale (neni 5 KEDNJ) e mbrojtur edhe me të drejtën ndërkombëtare. Meqenëse me anë të privimit të lirisë mund të cenohen rëndë liritë dhe të drejtat e njeriut, përkatësisht me qëllim të mbrojtjes nga privimi

arbitrar i lirisë, kjo çështje është rregulluar në mënyrë të detajuar me konventa dhe akte ndërkombëtare (Salihu, 2011:91) si psh: “Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike (Neni 9)” dhe “Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njëriut (KEDCP)”, e cila në mënyrë taksative i cek bazat juridike dhe situatat e mundshme të cilat e arsyetojnë privimin e personave nga liria. Kushti thelbësor është që të përqëndrohem në atë që arrihet nga proceset dhe jo në mënyrën sesi quhen ato (Macovei, 2002:17) sepse arrestimi, ndalimi dhe paraburgimi duhet të jenë mjetet e fundit të institucioneve të zbatimit të ligjit. Pushteti shtetëror duhet sa më pak të kufizojë lirinë natyrore të individëve dhe ajo mund të intervenojë vetëm atëherë kur është e nevojshme që të mbrohet liria tjetër e dikujt (Hasani, 2013:85).

Gjyqtarët në mënyrë të vazhdueshme duhet të kenë parasysh se me qëllim që liri të tilla të jenë kuptimiplotë, çdo privim nga ato duhet të jetë gjithmonë vetëm në rrethana përjashtuese, të jetë i justifikuar në mënyrë objektive dhe të mos zgjasë më shumë sesa të jetë absolutisht e nevojshme. Ngase e drejta për lirinë dhe sigurinë është një e drejtë unike ndërsa nocioni duhet të interpretohet si një tërësi. Siguria e personi,” duhet kuptuar në kontekstin e lirisë fizike dhe nuk mund të interpretohet sikur i referohet çështjeve të ndryshme (*si për shembull detyrimi i një shteti për t’i suguruar dikujt mbrojtje personale kundrejt një sulmi nga të tjerë, ose të drejtën për sigurime shoqërore*). Garantimi i sigurisë së personit, shërben për të theksuar një kusht që kanë zhvilluar autoritetet në Strasburg në interpretimin dhe shpjegimin e së drejtës për lirinë (KEDNJ, 2002: neni 5).

Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar është e garantuar me nenin 27 të Kushtetutës së Kosovës (*Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruar*), dhe mbrohet me normën penalo juridike “Marrja

e deklaratave me anë të shtrëngimit”, nga neni 197 i KP-së. Kjo normë penale inkriminon vetëm personin zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, duke marrë deklaratë nga qytetari përmes nënshtrimit të torturës, sjelljeve çnjerëzore apo procedurave ose ndëshkimit poshtërues, të drejta këto që garandohet me norma ndërkombëtare (Neni 3, KEDNJ).

Norma penalo juridike “*Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike*”, nga neni 198 i KP-së, poashtu ka për objekt mbrojtjen e dinjitetit e njëriut dhe kontrollin e sjelljeve të personave me autorizime të cilat burojnë nga ligji (Salihu, 2014:539). Në rastin kur dy policë të policisë së Kosovës e tërheqin të dëmtuarin me forcë nga kamioni dhe e godasin me grushta në kokë, shqelma në pjesë të trupit, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore, për shkak se sipas tyre, i dëmtuari e ka cenuar një ndër dispozitat e Ligjit mbi sigurinë e komunikacionit rrugorë, respektivisht neni 164 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPR Kosovës (*Aktgjykim penal, nr. 322/08 të Gjykatës Komunale në Prishtinë*).

Norma penalo juridike “*Cënimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve*”, nga neni 200 i KP-së paraqet një nga të drejtat më themelore të njëriut, kuptimi i së cilës është mbrojtja më e rëndësishme e sferës private (Salihu, 2014:539). Poashtu e drejta e privatësisë mbrohet edhe me normën penalo juridike “*Kontrollimi i kundërligjshëm*”, nga neni 201 i KP-së, dhe *nënkupton* kontrollimin e paligjshëm të banesës, lokalit apo personit juridik, me çrast prek sferën e të drejtave themelore të njëriut të garantuar me parimet kushtetuese. Andaj intenca e ligdhënësit me këtë normë penalo-juridike është që t’i vejë nën kontroll veprimet procedurale të personit zyrtar me rastin e kontrollit të banesës, lokaleve dhe personit.

Janë edhe një mori nenesh të Kodit Penal që i referohen pikërisht të drejtave të njeriut dhe sanksionojnë shkeljen e tyre potenciale, në veçanti nga ana e zyrtarëve. Nenet në vijim janë pasqyrim i këtyre të drejtave të mbrojtura: *Cenimi i fshehtësisë së korrespondencës dhe i bazave të të dhënave kompjuterike* (KP, 2013: neni 202); *Zbulimi i paautorizuar i informacionit konfidencial* (KP, 2013: neni 203); *Përgjimi i paautorizuar* (KP, 2013: neni 204); *Fotografimi dhe incizimet tjera të paautorizuara* (KP, 2013: neni 205); *Shkelja e urdhrave për masat e fshehura ose teknike të vëzhgimit ose hetimit* (KP, 2013: neni 206); *Parandalimi ose pengimi i tubimit publik* (KP, 2013: neni 207); *Cënimi i së drejtës për ushtrimin e mjetit juridik* (KP, 2013: neni 208); *Parandalimi i shtypjes ose i shpërndarjes së materialeve të shtypura dhe emetimit të programeve* (KP, 2013: neni 209).

Normat penalo juridike të cilat i kemi klasifikuar në kuadër të sigurisë politike, i adresohen mbrojtjes së qytetarëve në aspektin procedural, gjatë procesimit të rasteve nga policia, prokuroria dhe gjykatat. Këto institucione mund të cenojnë të drejtat dhe liritë e njeriut përmes shkeljeve procedurale gjatë zbatimit të ligjit, andaj edhe të drejtat e statusit negativ janë të drejtat të cilat shteti nuk mund t'i prekë, e që për rrjedhojë qytetari qëzon lirinë nga intervenimi i shtetit në sferën e tyre juridike. Për më tej, legjislacioni përveç që ka parashikuar normat penalo procedurale për zbatimin e ligjit, njëkohësisht ka përcaktuar edhe ndalesat e institucioneve të zbatimit të ligjit, në kontestin e paprekshmërisë së lirive dhe të drejtave të njeriut. Në rastin e Irlandezëve, GJEDNj ka konstatuar se përdorimi i kombinuar i pesë teknikave të marrjes në pyetje për të arrestuarit në Irlandën e Veriut në vitin 1971 përbën trajtimin jo njerëzor, brenda kuptimit të nenit 3 të KEDNJ. Gjykata ka konstatuar se teknikat të cilat përfshijnë: qëndrimin mbështetur për muri, mbylljen në

vetmi, nënshtrimin ndaj zhurmës, moslejimin e gjumit dhe mos lejimin e marrjes së ujit dhe ushqimit, ishin aplikuar të kombinuara, me qëllim të nxjerrjes së informacionit dhe se këto i'u teknika kanë shkaktuan, nëse jo menjëherë lëndime trupore, së paku vuajtje të mëdha fizike dhe mendore, personave të cilët iu ishin nënshtruar këtyre metodave dhe gjithashtu kjo ka krijuar pasoja në çrregullimin akut psikik gjatë marrjes në pyetje. Sipas Gjykatës këto teknika të marrjes në pyetje kanë qenë degraduese, pasi që, si të tilla, nxisnin tek viktimat ndjenjën e frikës, ankthit dhe inferioritetit, duke shkaktuar përluljen dhe poshtërimin e tyre dhe po ashtu thyerjen e rezistencës fizike dhe morale të tyre. Mirëpo, kjo gjykatë ka përfunduar me konstatimin se përdorimi i teknikave të marrjes në pyetje, paraqesin veprime johumane, jonjerëzore dhe degraduese por jo edhe torturë, sepse konstaton Gjykata, nuk ishte arritur një shkallë e atij intensiteti të vuajtjeve dhe ashpërsije sa që të konsiderohet si torturë (*Aktgjykimi i GJEDNJ të datës 18.01 1978, rasti Irlanda kundër Britanisë së Madhe*).

Në kuadër të procedurës penale, respektivisht të veprimeve hetimore (Kodi Procedurës Penale: neni 19), përkufizimet për dyshimin e bazuar dhe shkakun e bazuar kërkojnë nga prokurorët që të posedojnë “*Prova të artikulueshme*”, që nënkupton se prokurorët duhet të jetë në gjendje t'i përshkruajnë provat që e mbështesin dyshimin e bazuar apo shkakun e bazuar.

1. Dyshimi i arsyeshëm,
2. Dyshimi i bazuar dhe
3. Shkaku i bazuar.

Këto tre (3) standarde nuk kërkojnë që prokurori të posedojë dëshmi që janë të pranueshme, por vetëm që ta ketë informacionin mbështetës apo provat.

Nga ana tjetër standardi i “*Gjasave reale*” është standardi më i lartë, {neni 19 (1) (11)}, për të arsyetuar ndërhyrjen në privatësinë e personit, dhe në këto rrethanat, nuk kërkohet që prokurori të ketë dëshmi të pranueshme. Gjithashtu, neni 19 (1) (12) e përkufizon “*Dyshimin e bazuar mirë*”, si standard për ngritjen e aktakuzës nga prokurori. Në këtë rast nga prokurori kërkohet që të posedojë “*Prova të pranueshme që do ta bindnin një vëzhgues objektiv se një vepër penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri*”. Për shembull, prokurori lëshon një “*Urdhër të përkohshëm për përgjim të mesazheve telefonike*”. Njëri mesazh thotë vetëm që droga do të shitet në një bar në Gjilan pas një jave. Pas tre ditëve, gjykata refuzon ta konfirmojë urdhrin e përkohshëm të lëshuar nga prokurori dhe nuk e konfirmon sipas detyrës zyrtare që urdhri ka qenë i ligjshëm. Nëse prokurori ka kërkuar nga gjykata lëshimin e urdhrit për blerje të simuluar të drogës në atë bar në Gjilan, kërkesa do të jetë e bazuar në provat që nuk kanë qenë të pranueshme (atë mesazhin telefonik). Sipas nenit 19 (1) (11), kjo nuk do të ishte bazë e mjaftueshme për “*gjasat reale*” por do të ishte bazë e mjaftueshme për dyshimin e bazuar. Mirëpo, sipas nenit 92 (1) (13), një urdhër për masa të fshehta dhe teknike duhet të mbështetet në gjasat reale, që nënkupton se prokurori duhet të ketë prova të pranueshme. Andaj, gjykata nuk duhet ta pranojë kërkesën për blerje të simuluar përveç nëse prokurori posedon prova tjera të pranueshme që e mbështesin atë kërkesë (Smibert, 2013: 52). Të gjitha këto standarde të të provuarit janë të domosdoshme gjatë procedimit penal, pasi në mungesë të tyre do të

kishte një anarki të plotë procedural, ku secili rast do të trajtohej sipas vlerësimit individual të përgjegjësit të çështjes, e jo sipas normativës së shkruar.

Në këtë kontekst, mund të themi se represioni nga pushteti mund të jetë jo vetëm represion ndaj individit por edhe repression ndaj kundërshtarëve politik. Nëse hedhim një vështrim analitik të Kodit Penal të Kosovës, konstatojmë se përgjithësisht egziston një sanksionim mjaft efektiv sa i përket çështjes së inkriminimit të veprave, në veçanti përmes normës penale “*Parandalimi ose pengimi i tubimit publik*” (KP, 2013: neni 207) si dhe tërë kapitullit të veprave kundër të drejtave të votimit (KP, 2013: Kapitulli XVIII).

Megjithatë që nga zhvillimet e gjysmës së vitit 2015 kemi qenë dëshmitarë të luhatjes së këtij parimi të sigurisë politike, pikërisht për shkak të kundërthënieve tepër të mëdha politike, pakënaqësisë së popullatës me zhvillimet e përgjithshme politike dhe një armiqtësi të skajshme mes subjekteve opozitare dhe të pozitës. Kjo paknaqësi ka rezultuar me akuza të rënda të pjestarëve të opozitës për përndjekje politike për shkak të arrestimeve dhe ndjekjeve penale të deputetëve të partive opozitare, si pasojë e veprimeve të tyre në Kuvendin e Kosovës. Akuzat i referohen kryesisht mosveprimit të institucioneve të sundimit të ligjit në mungesën e ndjekjes dhe mos dënimit të kryesve të veprave të ndryshme të cilat për vite qëndrojnë në prokurori dhe gjykata pa u adresuar fare. Ndërsa në rastin e deputetëve egzistonte reagim i menjëhershëm i procesimit të rasteve (*ndalimi dhe paraburgimi si masa të sigurisë*). Një reagim për shkelje të sigurisë politike nga qeveria ndaj oponentëve të tyre politik, është bërë në veçanti në rastin e bastisjes së zyreve të Lëvizjes Vetvendosje më 28 nëntor 2015, e zbatuar nga njësi elite e policies. Në këtë rast

rreth 50 aktivistë të kësaj lëvizje, janë raportuar të jenë lënduar nga përdorimi i forcës së tepruar të policisë (Amnesty International: 2016).

Përveç mbrojtjes përmes kodit penal të Kosovës, siguria politike e qytetarëve nga represioni politik dhe abuzimet e të drejtave të njeriut mbrohet edhe përmes ligjeve të veçanta. Mbrojtja e të dhënave personale nga abuzimi i pushtetit shtetëror realizohet përmes Ligjit Nr.03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale të miratuar me 13.05.2010. Ligji përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale si dhe përmes këtij ligji themelohet institucioni përgjegjës për mbikqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave.

Për më tej, liria e asociimit, si një e drejtë kushtetuese (neni 44 i kushtetutës së Kosovës), garantohet edhe përmes ligjit Nr.04/L-57 për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare, të miratuar me 29.08.2011.

E drejta e tubimit është e drejtë kushtetuese (neni 43), dhe si e tillë mbrohet edhe përmes ligjit Nr.03/L-118 për tubimet publike, të miratuar me 26.03.2009. Me këtë ligj rregullohet e drejta për tubime publike, e drejta e fjalës së lirë në tubime publike, protestave, parakalimeve, kremtimeve publike, përkujtimeve dhe manifestimeve tjera publike. Ky ligj i'u mundëson qytetarëve që të shfaqin apo të shprehin pakënaqësisë e tyre lidhur me çështje të ndryshme.

5.4.2 Mbrojtja nga pasiguria personale

Siguria personale kuptohet më lehtë nëse themi se është një gjendje pa kërcënime dhe pa rreziqe, në të cilën mund të jetë njëri, (Tatalovic, 2006:10) në një shtet që ka obligim t'i sigurojë individit jetë të qetë, siguri cilësore dhe liri (Abazovic, 2006:35). Kushtetuta e Kosovës në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, i'u jep autorizime

organeve dhe shërbimeve të sigurisë, por duke precizuar saktë përcaktimin e detyrave me qëllim të mbrojtjes së të drejtave themelore të qytetarëve, përkatësisht sigurisë.

Segmenti i sigurisë personale kërcënohet nga: Dhuna fizike, krimi, terrorizmit, dhuna në familje dhe punësimi i fëmijëve, ndërsa qytetarët mbrohet përmes normave penalo juridike nga Kodi Penal i Kosovës. Kërcënimet që sjell dhuna fizike dhe krimi, mbrohen përmes normave penale nga katër kapituj të Kodit Penal të Kosovës, të cilat inkriminojnë cenimin e jetës dhe trupit të njeriut.

Normat penalo juridike nga kapitulli 16 “*Veprat penale kundër jetës dhe trupit*” (KP, 2011) mbrojnë qytetarëte nga *Dhuna fizike dhe krimi*, siç janë: *Vrasja* (KP, 2011: neni 178); *vrasha e rëndë* (KP, 2011: neni 179); *Vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore* (KP, 2011: neni 180); *vrasha nga pakujdesia* (KP, 2011: neni 181); *Vrasja e foshnjës gjatë lindjes* (KP, 2011: neni 182); *Kanosja* (KP, 2011: neni 186); *Ngacmimi* (KP, 2011: neni 186); *Sulmi* (KP, 2011: neni 187); *Lëndimi i lehtë trupor* (KP, 2011: neni 188); *Lëndimi i rëndë trupor* (KP, 2011: neni 189). Për më tej, dhuna fizike dhe krimi janë të inkriminuara edhe në kapitulli 17 “*Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut*” të Kodit Penal të Kosovës, respektivisht: *Rrëmbimi* (KP, 2011: neni 194) dhe *Shtrëngimi* (KP, 2011: neni 195). E drejta e lirisë dhe sigurisë përligjet në normën penalo juridike “*Rrëmbimi*” nga neni 194 i KP-së.

Në kushtet bashkëkohore dhe e shprehur në formë të terrorizmit kjo vepër paraqet rrezikshmëri jo vetëm të përgjithshme por edhe individuale. Rrëmbimi ishte frika më e madhe e në historinë e zezakëve para luftës civile në Amerikë (Wilson, 2005:1780-1865), andaj edhe në ditët e sotshme interesi ndërkombëtar për ta luftuar këtë lloj të kriminalitetit është shumë i madh (Salihu, 2014:523). Dhuna fizike dhe krimi janë të inkriminuara edhe

me disa norma penalo juridike nga kapitulli 20 “Veprat penale kundër integritetit seksual”, si në vazhdim: *Dhunimi* (KP, 2011: neni 230); *Sulmi seksual* (KP, 2011: neni 232); *Degradimi i integritetit seksual* (KP, 2011: neni 233); *Keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime ose paaftësi mendore apo emocionale* (KP, 2011: neni 234); *Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet* (KP, 2011: neni 235); *Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi* (KP, 2011: neni 238) dhe *Keqpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin* (KP, 2011: neni 239). Siguria personale e qytetarëve, nga frika dhe kërcënimi mbi pasurinë e tyre mbrohet me normat penale nga kapitulli 20 “Veprat penale kundër pasurisë” të Kodit Penal të Kosovës, respektivisht; *Vjedhja* (KP, 2011: neni 325); *Vjedhja e shërbimeve* (KP, 2011: neni 326); *Vjedhja e rëndë* (KP, 2011: neni 327); *Vjedhja grabitqare* (KP, 2011: neni 328); *Grabitja* (KP, 2011: neni 329); *Shpërdorimi i pasurisë së huaj* (KP, 2011: neni 330) *Marrja në posedim e pasurisë së luajtshme* (KP, 2011: neni 331); *Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme* (KP, 2011: neni 332); *Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë* (KP, 2011: neni 333); *Zjarrvënia* (KP, 2011: neni 334); *Mashtrimi* (KP, 2011: neni 335); *Detyrimi* (KP, 2011: neni 340); *Shantazhi* (KP, 2011: neni 341); *Keqpërdorimi i besimit* (KP, 2011: neni 342) dhe *Fajdeja* (KP, 2011: neni 343).

Segmenti i sigurisë personale, përveç kërcënimit nga dhuna fizike dhe krimi, ajo kërcënohet edhe nga *Terrorizmi*, veprimet e së cilit rrezikojnë jetën e qytetarëve. Norma penalo juridike nga Kapitulli 14 “Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”. Vepra penale e terrorizmit është inkriminuar me normën penalo juridike “*Terrorizmi*” nga neni 136 “*Kryerja e veprës terroriste*” dhe në rastin konkret po e

trajtojmë si vepër që kërcënon integritetin personal të individit më shumë se sa si kërcënim i përgjithshëm apo global.

Siguria personale kërcënohet edhe nga format e ndryshme të dhunës në familje, që është një nga dukuritë më të shpeshtë edhe në hapësirat shqiptare e cila shkatërron jo vetëm integritetin e individit por edhe celulën bazike të shoqërisë, familjen. Kërcënimi nga dhuna në familje është e rregulluar në normat penalo juridike nga kapitulli 21 “*Veprat penale kundër martesës dhe familjes*”, që janë: Marrja apo mbajtja e kundërligjshme e fëmijës (KP, 2011: neni 249); Keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës (KP, 2011: neni 250); Shkelja e detyrimeve familjare ((KP, 2011: neni 251) dhe Shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës ((KP, 2011: neni 252).

Në kuadër të kërcënimeve ndaj sigurisë personale bëjnë pjesë edhe *Punësimi i fëmijëve*. Punësimi i fëmijëve është ndaluar me të gjitha normat ndërkombëtare dhe vendore, andaj edhe shtrëngimi i fëmijëve për të punuar është rregulluar me norma penale juridike me qëllim të parandalimit të kryerjes së kësaj vepre penale. Punësimi i fëmijëve është i ndaluar me norma penalo juridike nga kapitulli 15 i Kodit penal të Kosovës, të emërtuar “*Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare*” respektivisht neni 169 “*Skllavëria, kushtet e ngjashme me shkllavërinë dhe puna e detyruar*”, si dhe me nenin 171 “*Trafikimi me qenie njerëzore*”.

Mbrojtja e sigurisë personale përveç që garantohet me kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe mbrohet me kodin penal të Kosovës, ajo njëherit realizohet edhe përmes ligjeve të veçanta, të cilat mbrojnë çështje specifike të sigurisë personale. Një kërcënim i vazhdueshëm ndaj sigurisë personale është edhe çështja e mbrojtjes së fëmijëve, respektivisht sigurimi i respektimit të drejtës së kujdestarisë dhe kontaktit me fëmijët.

Lidhur me këtë, Ligji nr.03/L-238 “*Aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës*”, në Republikën e Kosovës, interpretohet dhe zbatohet në pajtim me Konventën e Hagës “Konventa për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve” (*e nënshkruar në Hagë me 25 tetor 1980*).

Çështje me rëndësi për mbrojtjen nga kërcënimet që sjellë kriminaliteti është edhe Ligji Nr.05/L-036, “*Për kompenzimin e viktimave të krimit*”, i cili parasheh si vepra të dhunshme të kompenzueshme: vrasjet, trafikimin me njerëz, dhunimin; keqpërdorimin seksual të fëmijëve, dhe veprat penale që përkufizojnë dhunën në familje. Ky ligj është në pajtueshmëri me Direktivën e Këshillit 2004/80/EC të 29 prillit 2004, lidhur me kompenzimin e viktimave të krimit. Ligji rregullon të drejtën e kompensimit financiar të viktimave të veprave të dhunshme penale dhe të vartësve të tyre, autoritetet vendimmarrëse si dhe procedurat për realizimin e të drejtës për kompensim në situatat vendore dhe ndërkufitare, që në këtë rast është përcaktuar të jetë komisioni për kompensimin e viktimës së krimit.

Mbrojtja e qytetarëve nga kërcënimet që shkaktohen nga zjarri realizohet me *Ligjin Nr.04/L-012 për mbrojtje nga zjarri*. Me këtë ligj mbrohet nga zjarri, jeta e njerëzve, pasuria dhe mjedisi dhe përcaktohen detyrat e komunave që në territorin e tyre të organizojnë kujdes për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri. Ndërsa, sigurimi i mekanizmave reargues efektiv për zjarrfikje, me qëllim të shpëtimit të njerëzove, pasurisë dhe mjedisit në situata emergjente rregullohet me Ligjin Nr.04/L-049 “*Për zjarrfikje dhe shpëtim*”, të miratuar me 07.10.2011 nga Kuvendi i Kosovës. Kërcënim i vazhdueshëm për sigurinë personale është edhe dhuna në familje, andaj edhe parandalimi i dhunës në familje është rregulluar me *Ligjin Nr.03/L-182 “për mbrojtje nga dhuna në familje”*. Ligji ka për

qëllim parandalimin e të gjitha formave të dhunës në familje, përmes masave të përshtatshme ligjore, për pjesëtarët e familjes që janë viktimë të dhunës në familje, duke kushtuar një vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve, dhe personave me aftësi të kufizuara. Poashtu, ligji rregullon trajtimin e kryesve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave të viktimave të dhunë në familje.

Në kuadër të kërcënimeve modern që cilat cenojnë të drejtat e njeriut dhe të dhënat personale, bën pjesë edhe krimi kibernetik. Mbrojtja e qytetarave nga sulmet kibernetike realizohet përmes *Ligjit Nr.03/L-166 për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik*. Kriminaliteti kibernetik çënon së pari dinjitetin e njeriut si e drejtë kushtetuese (neni 23 i Kushtetutës së Kosovës), dhe të drejtën e integritetit personal, poashtu si të drejtë kushtetuese (neni 26 i Kushtetutës së Kosovës). Krimi kibernetik është vepër penale e kohës moderne dhe paraqet një aktivitet kriminal të zhvilluar në rrjet, që ka si objekt apo si mënyrë të kryerjes së krimit keqpërdorimin e sistemeve kompjuterike dhe të të dhënave kompjuterike. Veprat penale që ndërlidhen me konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmësinë e të dhënave të sistemeve kompjuterike, janë të dënueshme nga 6 muaj deri 5 vite burgim.

Theksojmë se autoritetet kompetente në Republikën e Kosovës kanë të drejta, obligime dhe përgjegjësi për parandalimin dhe luftimin të gjitha formave të trafikimit me njerëz, duke përfshirë edhe mbrojtjen e viktimave të trafikuar. Këto të drejta dhe obligime të autoriteteve respective parashikohen me Ligjin Nr.04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të krimit.

Një kërcënim i veçantë ndaj sigurisë personale është edhe terrorizmi, në të gjitha format e saj, andaj me ligjin Nr.04/L-178 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-

196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit, të miratuar me 26.02.2013, përcakton Njësinë e Inteligjencës Financiare si organ shtetërorë për ndjekjen e transaksioneve të dyshimta që kanë të bëjnë me financimin e terrorizmit.

Financimi është bazamenti kryesor i organizimit të terrorizmit, si kërcënim i vazhdueshëm për qytetarët, andaj edhe parandalimi dhe luftimi i financimit të terrorizmit është mbrojtja më e mire, në luftën e tillë. Kërkesë e cila qëndron mbi të gjitha nevojat e qytetarit është rendi dhe qetësia publike në vendbanim dhe vendpunim. Rregullimi i sjelljes personale me qëllim të ruajtjes së rendit dhe qetësisë publike rregullohet me ligjin Nr.03/L-142 për rendin dhe qetësinë publike, dhe në veçanti duke përcaktuar kundërvajtjet kundër rendit dhe qetësisë publike, si dhe duke paraparë ndëshkimet për kryerjen e kundërvajtjeve.

Rendi dhe qetësia publike për çdo qytetar nënkupton që të njëjtit duhet të respektojnë sistemin ligjor, institucionet publike, mbrojtjen e interes ligjor dhe mbi të gjitha mbrojtjen e lirive të personit. Në këtë kontekst vlen të përmendin postulatit e vjetër *“Të drejtat tuaja vlejné deri në momentin kur fillojnë të drejtat e tjetrit”*. Pra me këtë ligj rregullohen obligimet e përbashkëta me qëllim të konsumimit të rendit dhe qetësisë së përbashkët në vendbanim dhe vendpunim.

5.4.3 Mbrojtja nga pasiguria e bashkësisë

Njerëzimi do të jetojnë gjithnjë nën frikë nëse njerëzit nuk kanë siguri në jetën e tyre të përditshme dhe gjersa nuk fillojnë me forcën e ligjit të luftojnë shkaqet e kërcënimeve ndaj sigurisë njerëzore, ligji është një urdhër i sjelljes njerëzore (Kelsen, 1945:3-14). Sipas të drejtës ndërkombëtare çdo njëri i zakonshëm ka të drejtë për një mirëqenije, për një jetesë adekuate të shëndetshme (Paris, 2001: 87-102) për veten dhe familjen e tij, duke përfshirë: ushqimin, veshmbathjen, banimin dhe trajtimin mjekësor.

Siguria në bashkësi si koncept i gjerë: Pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe luftimeve në rajonin e Ballkanit, duket sikur i gjithë Ballkani është prekur nga sindromi i mosdurueshmërisë etnike. Kjo dukuri në veçanti ka qenë dhe ka mbetur e shprehur në Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Kosovë dhe Maqedoni. Të gjitha këto shtete të dala nga ish-Jugosllavia, pa përjashtuar edhe tjerat, si vende me përzierje më të madhe të popullsisë dhe urrejtjes tradicionale mes etniciteteve edhe në ditët e sotshme vazhdojnë të kenë problem të të njëjtës natyrë. Këto problem në vazhdimësi vënë në rrezik sigurinë e përgjithshme, si në vendet respective, poashtu edhe sigurinë rajonal. Këto vende kanë potencial të mjaftueshëm për konflikte të vazhdueshme. Por një gjë tjetër që ka prodhuar kjo urrejtje patologjike ndër etnike është se ka vënë në pikëpyetje edhe sigurinë njerëzore, respektivisht sigurinë e individit dhe të bashkësisë.

Nëse i referohemi çështjes së multi etnicitetit dhe sigurisë në bashkësi në Kosovë, ajo duket të jetë shumë komplekse. Nëse shikojmë legjislacionin vendor, e në veçanti aktin më të lartë të Republikës së Kosovës; Kushtetutën me plotë besim themi se është një nga kushtetutat më të avansuara, sa i përket të drejtave të njeriut në përgjithësi, por edhe të drejtave të zgjeruara të komuniteteve në veçanti. Këto të drejta shpesh janë parë si përparim i Kosovës në këtë fushë, megjithatë në praktikë, sidomos në aspekt të qarjes përpara të proceseve dhe perceptimit të përgjithshëm të popullatës, ka qenë produkt i pakënaqësive dhe pengesave. Kosova realisht është më e avasuar në këtë fushë sidomos në raport me vendet fqinje si Maqedonia dhe Serbia ku popullata pakicë shqiptare gëzon shumë pak të drejta apo të themi më mirë në vazhdimësi ka shkelje të drejtave të popullatës pakicë shqiptare dhe shpesh edhe në formë represioni.

Në Kosovë, në njërën anë kemi popullatën shumicë që nuk resht së potencuari faktin e kompetencave të zgjeruara të minoriteteve dhe se si këto kompetenca ndikojnë në integritetin shtetëror dhe territorial në veçanti. Ndërsa nga ana tjetër kemi popullatën pakicë serbe e cila në vazhdimësi ankohet në trajtim të pabarabartë dhe kufizim të lirisë së lëvizjes. Këto pretendime janë raportuar edhe në raportin e Amnesty International për vitin 2015/16. Për fatin e keq, sidomos të popullatës pakicë serbe në Kosovë, çështja e konflikteve ndëretnike e sidomos në qytetin e ndarë të Mitrovicës, gjithmonë shihet vetëm në prizmin e sigurisë së përgjithshme të shtetit, edhe pse qëllimi ynë nuk është të themi se një gjë e tillë nuk është me rëndësi. Gjersa popullata serbe që jeton në pjesët tjera të Kosovës kanë qenë shumë më bashkëpunuese dhe ngadalë kanë filluar të integrohen brenda realitetit Kosovar, pjesa e Kosovës veriore vazhdon të karakterizohet nga tensionet dhe shpërthimeve periodike të dhunës. Pjesa veriore e Mitrovicës është bërë sinonim i konflikteve të pazgjidhura të Kosovës. (Brand, 2012: 4).

Problemi i çështjeve ndër etnike në Kosovë qëndron pikërisht në distancimin e aparatit shtetëror të Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë, nga vet qytetari, nga nevojat e tij njerëzore, duke u munduar të zgjidh problemin nga perspektiva e tyre e jo nga perspektiva e qytetarit. Situata aktuale më së shumti dëmton qytetarin dhe sigurinë e tij në shoqërinë, komunitetin dhe rrethin ku jeton, si një nga dimensionet shumë të rëndësishme të sigurisë njerëzore. Janë në fakt vet popullata serbe dhe ajo shqiptare në Mitrovicë, të cilat po privohen nga të drejtat e tyre bazike për hir të interesave më madhore të njërit apo tjetrit shtet dhe kështu duke i mohuar qytetarëve partneritetin në bërjen dhe sigurimin e mirëqenies dhe sigurisë njerëzore.

Për shkak të aktualitetit gjithnjë më të madh në jetën bashkëkohore, veprat penale me të cilat vihet në rrezik jeta dhe integriteti trupor i njerëzve kanë qenë objekt trajtimi i shumë kongreseve ndërkombëtare. Në këto konferenca debate është zhvilluar mbi faktin se kryerja e kësaj vepre penale rrezikon sigurinë në bashkësi dhe si e tillë është e nevojshme të ketë gjithë vëmendjen e sistemit të sigurisë dhe të drejtësisë në mbrojtje të qytetarëve që banojnë në vendbanime të përbashkëta. Këto vepra penale rrezikojnë drejtpërdrejtë jetën e qytetarëve, duke cenuar të drejtën për jetë, si një e drejtë kushtetuese (KK, 2008: neni25), sipas së cilës secili individ gëzon të drejtën për jetën.

Meqenëse objekt primar i këtij studimi është kryesisht siguria e bashkësisë, (tensionet mes komuniteteve dhe grupeve tjera bazuar në identitetin e tyre etnik, fetar apo tjetër), theksi sa i përket inkriminimit si vepër penale është vënë më së shumti në veprat që sigurojnë liritë dhe të drejtat e bashkësive (komuniteteve). Kështu në kuadër të veprave që inkriminojnë mosbarazinë dhe trajtim të pabarabartë mes qytetarëve të Republikës së Kosovës janë veprat si: 147 *Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik* dhe 193 *Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës*. Baza për një inkriminim të tillë qëndron fuqishëm në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me gjitha të drejtat që ofron ajo.

Vlen të potencohet se përveç problematikës shumë të ndjeshme të tensioneve ndër-etnike, Kosova në këto vitet e fundit ka filluar të ballafaqohet edhe me dy dukuri tjera: tensionet e ngritura nga pjestarët e një nga sektet e islamit radikal që kohëve të fundit ka gjetur mbështetës edhe në Kosovë me ata që praktikojnë islamin tradicional; një tjetër grup që kohëve të fundit po has në vështirësi në raport me popullatën apo grupe njerëzish janë

edhe pjestarët e komunitetit LGBT, ndaj të cilëve tentohet të ketë një çasje diskriminuese. Veprat e sipër përmendura nga Kodi penal mbulojnë edhe këto dy kategori.

Siguria në bashkësi përmes pjesmarrjes së qytetarëve: Në pjesën e mësipërme të shtjellimit të çështjes së sigurisë në bashkësi, ne u fokusuam më tepër në aspektin e sigurisë në bashkësi në kontekst të konflikteve ndër-etnike apo edhe tensioneve potenciale mes grupeve tjera fetare apo të orientimit të caktuar seksual. Për të qenë një analizë më e plotë e çështjes së sigurisë së bashkësisë, shtjellimi në vijim më shumë i kushtohet pikërisht asaj që u potencua edhe më lartë: në kuptimin e vërtetë të asaj se çfarë nënkuptojmë me sigurinë në bashkësi në aspekt të obligimit se kush ofron një siguri të tillë dhe si mund të arrihet ajo.

Siguria në bashkësi është një qasje e fuqishme që ndërton sigurinë njerëzore dhe i kontribuon paqes më të gjerë dhe qëllimit të zhvillimit. Nëse zhvillimi i paqes dhe komunitetit ka për qëllim veprimet pozitive për angazhim në forcimin e raporteve mes shteteve dhe shoqërive dhe për përmirsimin e ofrimit të sigurisë njerëzore, siguria në bashkësi duhet të bëhet një mjet kryesor në strukturimin e politikave dhe programeve të akterëve ndërkombëtarë. Siguria në bashkësi identifikon dhe i përgjigjet përceptimeve lokale për sigurinë, duke punuar si përmes sistemeve formale ashtu edhe ato joformale dhe shpesh duke vepruar si urë lidhëse mes tyre. Provat sygjerojnë se kalimi direkt në një model ku shteti është autoriteti i vetëm i përcaktuar për të sunduar dhe anashkalohen autoritetet tjera joformale, atëherë kjo është jopraktike. Nëse i kthehemi shtjellimit të mëhershëm që i referohet nevojës për një çasje multi-sektorale në garantimin e sigurisë njerëzore, mund të konstatojmë se është domosdoshmëri krijimi i partneritetit mes qytetarit dhe shtetit.

Rritja e nivelit të krimit dhe frikës nga krimi nëpër lagje dhe qytete ka nxitur banorët të angazhohen në përpjekjet për rritjen e sigurisë dhe rendit publik. Ndonjëherë qytetarët ndërmarrin iniciativa individuale, për të mbrojtur shtëpitë dhe familjet e tyre, dhe ndonjëherë ata bashkëpunojnë me grupe të qytetarëve për të luftuar krimin. Në të dyja rastet, aktivitetet e tilla t'i quajmë bashkëprodhuese; në mënyrë substanciale mund të rrisin burimet e përkushtuara në luftimin e krimit dhe zvogëlimin e frikës së qytetarëve (Percy, 1987:83-93). Në vitet e fundit në shtetet demokratike, idea e bashkëprodhimit të sigurisë, është rritur në masë të madhe për të vetmin fakt, është kuptuar se për të gëzuar sigurinë duhet kontribuar për të. Andaj, qytetarët nga niveli pasiv, të konsumuesit të sigurisë kanë kaluar në nivelin aktiv, të kontribuesit në prodhimin dhe krijimin e sigurisë.

Fjalët, kanë kuptimin e tyre: disa fjalë, gjithashtu kanë ndjenjën e tyre, dhe fjala bashkësi është njëra prej tyre. Në një bashkësi të fuqishme, mund të ndihemi të sigurtë, sepse të gjithë e kuptojnë njëri tjetrin, mund t'i besojnë njëri tjetrit, dhe asnjëherë nuk jemi të huaj për njëri tjetrin. Pra, bashkësia është një strukturë e rëndësishme sa për mirëqenien e qytetarëve po aq edhe për të ngritur nivelin e sigurisë nëpër lagje. Shtete të zhvilluara si p.sh. SHBA, Britania e Madhe dhe shtete tjera të zhvilluar, kanë zhvilluar programe të sigurisë bashkiake apo në lagje të quajtur "*Neighborhood watch*". Edhe Republika e Kosovës, në frymën e kësaj praktike, dhe me mbështetjen e faktorit ndërkombëtar, ka instaluar disa struktura të ngjajshme në nivele komunale për të siguruar partneritet mes qytetarit si linja e parë e informacionit dhe institucioneve shtetërore. Bartës i këtij procesi ka qenë , Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, përmes programit për ndihmë në trajnime në hetimit e krimit "ICITAP". Ky program në vitin 2003 ka inicuar themelimin e Ekipeve të Veprimit për Sigurinë në Bashkësi "EVSB", me qëllim të

ndërtimit të bashkëpunimit të qytetarëve të të njëjtës bashkësi, në ngritjen e sigurisë dhe mirëqenies së tyre (US DoJ, 2010:10). Jemi të mendimit se vetëm me një partneritet të tillë do të mund të kuptojmë nevojat e qytetarëve për sigurinë e tyre dhe mirëqenien e tyre andaj, dhe për t'iu shmangur problemeve, qoftë edhe atyre që mund të ngriten e nivelet e konflikteve ndër etnike apo mes grupeve tjera respektive.

Mbrojtja e sigurisë në bashkësi përveç që garantohet me kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe mbrohet me kodin penal të Kosovës, ajo njëherit mbrohet edhe përmes ligjeve të veçanta, të cilat mbrojnë çështje specifike të sigurisë në bashkësi. Një prej elementeve të sigurisë në bashkësi është edhe liria fetare. Liria fetare përfshinë lirinë për të pasur ose për të mos pasur fe; për të mbajtur apo për të ndërruar fenë ose besimin; dhe lirinë për të manifestuar fenë ose besimin, si individ ose në bashkësi me të tjerët, publikisht ose privatisht, përmes adhurimit, predikimit, praktikimit dhe ceremonive. Këto të drejta dhe liri fetare mbrohen me *Ligjin nr.02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë*, e veçanërisht përmes elementit thelbësor i këtij ligji i cili konsiston në atë se çdo njëri ka të drejtë të gëzojë lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar, që përligj të drejtën kushtetuese të përcaktuar me nenin 38 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës “Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë”.

Element thelbësor i bashkësive të lira është elementi gjuhësor, përmes të cilit respektohet identiteti gjuhësor i të gjithë personave, si një investim në krijimin e mjedisit të përbashkët për të gjitha komunitetet. Përdorimi i gjuhëve në Republikën e Kosovës mbrohet me Ligjin Nr. 02/L-37 “*Për përdorimin e gjuhëve*”, si e drejtë e bazuar në shumë akte ndërkombëtare:

- Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike,

- Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore dhe në Protokollat e saj,
- Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare,
- Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare,
- Rekomandimet e Hagës lidhur me të drejtat e shkollimit të pakicave kombëtare dhe
- Rekomandimet e Oslos lidhur me të drejtat gjuhësore të pakicave kombëtare, -

Poashtu, e drejta e përdorimit të gjuhës përfshihet edhe në udhëzimet mbi përdorimin e gjuhëve minoritare në mediat transmetuese, me qëllim që të rregullojë përdorimin e gjuhëve. Nga sa u tha, konstatohet se përdorimi i gjuhëve në Republikën e Kosovës është e drejtë e mbrojtur me ligj të veçantë, që garanton barazi në mes etnive që jetojnë në Kosovë.

Përveç lirive fetare dhe të drejtës së gjuhës, mbrojtja e barazisë së bashkësive realizohet edhe me mbrojtjen e zonave të veçanta, duke përfshirë manastiret, kishat, vendet tjera fetare, vendet historike dhe kulturore.

Këto të drejta të garantuara, mbrohet përmes Ligjit Nr.03/L-039 “*Për zonat e veçanta të mbrojtura*”, duke përcaktuar zonën që rrethon një monument, ndërtesë, grup ndërtesash, tërësi, fshat, ose qendër historike të qytetit që mbrohet nga çdo zhvillim apo aktivitet i cili mund të dëmtojë kontekstin e tij historik, kulturor, arkitektural apo arkeologjik, mjedisin natyror apo kuadrin vizual estetik.

Përmes këtij ligji mbrohet mozaiku i të drejtave dhe lirive të etniteteve në Republikën e Kosovës.

5.4.4 Mbrojtja nga pasiguria ekonomike

Siguria ekonomike i referohet nevojës së njerëzve për të pasur mundësinë të fitojnë dhe të kenë qasje në të ardhura bazike për jetë. Çdo anëtar i shoqërisë ka të drejta të

domosdoshme ekonomike, sociale dhe kulturore për dinjitetin e tij dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit të tij, duke u ndihmuar nga shteti në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe në përputhje me organizimin dhe burimet e çdo shteti (OKB, 1948: neni 22). Siguria ekonomike mund të kuptohet si siguria e përhershme ekzistenciale e cila i siguron ekzistencën biologjike individit, duke nënkupton garantimin e disa të ardhurave bazë për jetë duke u mbështetur në punën e tij. Në mungesë të punës duhet të ndihmohet nga një sistem i asistencës sociale, e cila nuk është e garantuar për popullatën në regjionin e Ballkanit, për shkak të gjendjes ekonomiko financiare të shteteve. Definicioni i thjeshtë mbi sigurisë ekonomike do të nënkuptohej si vazhdimësi e shpagimit, qëndrueshmërisë së të ardhurave dhe sigurim i punësimit si komponent primarë të sigurisë ekonomike. Pra, siguri ekonomike do të thotë disponim me të mira ekonomike dhe financiare për zhvillimin e jetës dhe për realizimin e qëllimeve sipas planit dhe kohës së parashikuar.

Siguria ekonomike mund të jenë individuale dhe kolektive (ndërmarrjes, rajonale, shtetërore etj). Siguria ekonomike është një shprehje gjithnjë e më e përdorshme, por edhe një koncept i teorizuar relativisht pak në literaturën e ekonomisë politike (Collins, 2007:262). Në përgjithësi ekzistojnë dy ligjërata tepër të ndara për sigurinë ekonomike: (1) Analizat mikronivelo, të cilat përqendrohen në agjentët “e lokalizuar”, si individët, vatrën familjare dhe komunitetet lokale, të cilët interesohen kryesisht për garantimin e sigurisë së jetesës së tyre (*në studimet mbi vendet në zhvillim kjo përqendrohet shpeshherë në çështjet e sigurisë së ushqimit, banimit, ujit, veshmbathjes etj*) (Hughes, 2004:22-29). (2) Siguria ekonomike makronivelo, e cila tenton të fokusohet në kombet-shtete (*ose në entitete të tjera të afta të drejtojnë një politikë të jashtme ekonomike*) dhe në angazhimet e tyre në sistemin ekonomik ndërkombëtar (Kahler, 2004:485-502). Parë nën këtë qasje dynivelo

është e mundur të artikulohen dy përkufizime të sigurisë ekonomike, të cilat, ndonëse të veçanta për nga natyra e sigurisë që përsiatin, ndërlidhen pazgjidhshmërisht në epokën aktuale globale që po jetojmë (Kahler, 2004:485-502). Në aspektin makroekonomik, sipas një përkufizimi mjaft të plotë shkencor, siguria ekonomike nënkupton *“Ruajtjen e integritetit strukturor, e kapaciteteve prosperitet-prodhuese dhe e interesave të një entiteti politiko-ekonomik në kontekstin e rreziqeve dhe kanosjeve të ndryshme të jashtme e të brendshme, me të cilat ai përballlet në sistemin ekonomik kombëtar e ndërkombëtar”* (Christopher, 2007:256). Siguria ekonomike, sipas Rexhep Mejdanit (ish President i Shqipërisë), ka të bëjë me sigurimin e të ardhurave bazike për individët e ndryshëm dhe familjet e tyre. Në këtë kuptim, duke pasur parasysh se disa qindra mijëra shqiptarë jetojnë me më pak se 1-2 euro në ditë, mund të pohohet pa dyshimin më të vogël që ky grup është fare i pasigurt nga ana ekonomike. Madje, e sigurt nga ana ekonomike, në Shqipëri, në një kuptim të mirëfillt, mund të jetë vetëm një e katërta e popullsisë së saj. Aq më tepër, që siç deklarohet ditët e fundit dhe nga organizata ndërkombëtare për mbikëqyrjen ekonomike, vitin e fundit është thelluar më tej hendeku midis qytetit e fshatit. Pa lënë këtu mënjane nivelin e lartë të papunësisë, që mund të shoqërohej me situata e konflikte të rënda sociale, nëse në ndihmë, familjeve nuk do të vinin prurjet monetare të shqiptarëve në emigracion (Mejdani, 2007).

Zhvendosja politike drejt një qasjeje më të fortë të sigurisë ekonomike ishte veçanërisht e spikatur në SHBA (Collins, 2007:264). Në fillim të viteve '90-të, siguria ekonomike u shndërrua në një çështje kyçe në diskutimet brenda Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe Këshillit të Marrëdhënieve me Jashtë. Në janar 1993, Presidenti i SHBA-ve, Bill Clinton e zgjeroi anëtarësinë në Këshillin e Sigurisë, duke përfshirë, midis të

tjerëve, sekretarin e Shtetit për Thesarin dhe zyrën e sapokrijuar të asistentit të Presidentit për Politikën Ekonomike. Kjo tregon se Klinton prante rolin në rritje të çështjeve ekonomike në formularin e politikës së sigurisë kombëtare SHBA (Collins, 2007:264). Kur këtë lidhje, siguri-ekonomi e bën shteti më i fortë në botë, duket mëse normale, por nëse themi se edhe shqiptarët e kishin këtë koncept, të ndërlidhjes së sigurisë me ekonominë dhe financat, atëherë besohet se të gjithë do mbesin të heshtur. Dokumentet historike na faktojnë se me 10 qershor 1878, shqiptarët e mbledhur në Kuvendin Kombëtar të Prizrenit shpallën krijimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, dhe zgjodhën organet e larta: Këshillin e Përgjithshëm me funksione legjislative dhe Komitetin Qendror me funksione ekzekutive. Sylejman Vokshi ishte caktuar të administronte buxhetin dhe të siguronte mjete për blerjen e armëve dhe municioneve për ushtrinë dhe policinë e lidhjes (Demaj, 2001:71). Poashtu Sylejman Vokshi ishte caktuar shëf i seksionit ushtarak (atribut komandantit të ushtrisë). Pra, lidhja e ngushtë në mes sigurisë dhe ekonomisë, është e njohur që nga Lidhja e Prizrenit në vitin 1878.

Krimi i organizuar, në kohët moderne, nuk konsiderohet si kërcënim direkt i sigurisë shtetërore, megjithatë ky lloj i kriminalitetit ka dëshmuar të jetë direkt sponsorizues i shumë prej dukurive që kërcënojnë sigurinë shtetërore. Migrimet e fundit të njerëzve nga Kosova dhe migrantëve tjerë nga Siria më së miri pasqyrojnë influencën e madhe të krimit të organizuar në sigurinë dhe jetën e qytetarëve dhe në destabilizimin e përgjithshëm rajonal. Sipas shifrave të publikuar nga EUROSTAT për numrin e azilkërkuesve për vitin 2015 rezulton se 1 255 600 persona kanë kërkuar azil në shtete e ndryshme të BE, e që paraqet dyfishin e vitit paraprak (EUROSTAT, 2016:44). Nga kjo shifër 5% e azilkërkuesve, respektivisht 66,885 persona kanë qenë nga Kosova. Bazuar në raportimet e

bëra nga mediat e ndryshme në Kosovë, nëse qytetarët e Kosovës për secilin anëtarë që ka migruar ilegalisht ka paguar minimum 700€ për kokë, atëherë rezulton se vetëm nga migrimi i këtyre shtetasve për vitin 2015, rrjeti i krimit të organizuar që merren me kontrabandimin e migrantëve ka përfituar rreth 47 milionë euro. Një shumë kaq e madhe e parave, e përfituar vetëm nga emigrantët Kosovarë, paraqet një burim të fuqishëm financiar për rrjetet e krimit të organizuar, të cilat gjithnjë e më tepër forcojnë pozitën e tyre. Duke pasur parasysh edhe zhvillimet e kohëve të fundit lidhur me destabilizimin e situatës në Europë nga sulmet e ndryshme terroriste, vijmë në përfundim se këta kontrabandues mund të kenë lidhshmëri jo vetëm me kontrabandimin e migrantëve por edhe shumë dukuri tjera negative që rrjedhin nga kjo veprimtari siç janë: trafikimi i qenieve njerëzore, trafikimi me organe, abuzimi i fëmijëve e deri te aktet e ndryshme terroriste. Të gjitha këto dukuri janë kërcënim permanent për sigurinë njerëzore (*individuale, shtetërore dhe globale*) duke bërë që njerëzit të ndjehen të pasigurt kudo që udhëtojnë dhe veprojnë.

Krimi i organizuar në Kosovën e pasluftës ishte produkt i një mungese të stabilitetit të institucioneve të Kosovës, duke u udhëhequr nga institucione paralele ndërkombëtare, vendore e në pjesën veriore të Kosovës edhe nga struktura kriminale. Këto struktura kriminale kanë lehtësuar kontrabandimin me mallra, duke forcuar në masë krimin e organizuar dhe rrjedhimisht edhe pasurimin enorm të udhëheqësve të strukturave të krimit të organizuar. Mungesa e kontrollit institucional krijoi kushtet e favorshme për lulëzimin e vrullshëm të strukturave të krimit të organizuar. Ky fenomen u fuqizua aq shumë përmes zhvillimit të aktiviteteve të tyre të paligjshme si: shitblerja e armeve, trafikimi me qenie njerëzore, prostitucioni dhe trafikimi me narkotik, kontrabandimi i migrantëve, korrupsioni, fajdeja dhe reketi. Të gjitha këto veprimtari kriminale janë shumë fitimprurëse. Këto

fenomene ngritën edhe figura të ‘*Paprekshme nga ligji*’, të cilët futën rrënjë edhe në bartësit e institucioneve më të larta shtetërore, duke krijuar një ndërvvarshmëri financiare mes tyre. Si pasojë e përfshirjes së zyrtarëve të ndryshëm shtetëror në këto veprimtari, Kosova u bë një vatër shumë e qëndrueshme e grupeve kriminale duke u ngritur në piramidë shumë të lartë dhe duke u shndërruar në kërcënimin më të madh të mirëqenies së qytetarëve në veçanti dhe të Kosovës si shtet në përgjithësi. Krimi i organizuar në vazhdimësi është më i sofistikuar, me shtrirje territoriale dhe vertikale në kuadër të strukturave të tyre formale dhe në kuadër të institucioneve. Grupet kriminale që veprojnë në Kosovë janë të organizuara në lidhje shoqërore dhe familjare, për të mundësuar një siguri më shumë për vete me qëllim të respektimit të hierarkisë. Kështu, pjesëtarë të këtyre veprimtarive të dyshimta. Përderisa pasuria e tyre (*personave të lidhur me krimin e organizuar*) rritet para syve të qytetarëve, që nga paslufta e vitit 1999, sistemi i drejtësisë vazhdon të jetë e verbër. Drejtësia me mosveprim, lejon këta kriminelë të gëzojnë frytet e pasurimit të tyre të paligjshëm, në kurriz të qytetarëve të Kosovës. Grupet kriminale e realizojnë shpërlarjen e parasë përmes klubeve, kazinove, kompanive të ndryshme private, tregëtimit të makinave apo ndërtimeve të larta apo siç shpesh edhe quhet ‘*mafia e ndërtimeve*’. Këto grupe kriminale përdorin metoda të ndryshme për të siguruar dominimin e tyre duke u nisur nga detyrimi, shantazhimi, korruptimi i zyrtarëve publik. Poashtu të gjitha këto metoda i zbatojnë edhe ndaj institucioneve të drejtësisë, me qëllim të zgjerimit të influencës së tyre dhe zhvillimit të veprimtarinë, e njëkohësisht për të përhapur sa më shumë frikë dhe perceptim mbi “*Paprekshmërinë e tyre*”. Kjo gjendje tek qytetarët ka për pasojë krijimin dhe forcimin e ndjejnës së pasigurisë për veten e tyre. Guximi qytetarëve në denoncimin e kësaj dukuri nuk mungon, mirëpo çdo tentim i tyre i kthen ata në viktima,

si pasojë e mosveprimit të drejtësisë dhe pastaj ata duhet të ballafaqohen me atë që kanë denoncuar. Gjersa organet e drejtësisë vazhdojnë të jenë indiferente ndaj këtij fenomeni, që është bërë kancer i shoqërisë sonë, krimi i organizuar vazhdon të thellohet në çdo segment të jetës së qytetarëve. Kjo situatë është shumë absurde, dhe absurditetit qëndron tek përgjegjësia e shtetit që duhet të ofroj siguri për qytetarët, ndërsa në realitet ndodh e kundërta, shteti, respektivisht zyrtarët dhe politikanët e involvuar në kriminalitet bëhen kërcënim direkt i sigurisë dhe mirëqenies së qytetarëve.

Mungesa e sigurisë ekonomike, krijon parakushte specifike tek familjet e ndryshme, sidomos tek ato familje të cilat e kanë të vështirë sigurimin e të ardhurave minimale për mirëqenien e familjes. Këto rrethana specifike dhe të vështira për familjet, shumë lehtë mund të transformohen në trazira dhe të krijojnë pasoja në destabilizimin e përgjithshëm të shoqërisë.

Në këtë kontekst, rikujtojmë shpërnguljen apo imigrimin e familjeve nga Kosova në vitet 2013-2015, në Hungari dhe pastaj në shtetet tjera të Evropës. Qëllimi i migrimit konsistonte në kërkimin e kushteve më të mira të jetesës. Rreth 107 mijë qytetarë (individë dhe familje), të detyruar të migrojnë, për shkaqe ekonomike, kanë paguar shuma të mëdha të hollave, për të realizuar ikjen e tyre përmes rrugëve ilegale. Vetëm gjatë vitit 2015, në shtetet e BE-së kanë kërkuar azil 66.885 qytetarë të Kosovës. Ky numër i azil kërkuesve, në vitin 2015 e ka pozicionuar Republikën e Kosovës në vendin e katërt (4) në renditjen shteteve me numrin më të madh të azil kërkuesve në shtetet e BE-së. Ky numër përbën 5% të azilkërkuesve në shtetet e BE-së, të cilët kanë shkuar nga Kosova. Në shtetet e BE-së në vitin 2015 kanë kërkuar azil qytetarët e këtyre shteteve: 362.775 shtetas të Sirisë (ose 29%), 178.230 shtetas të Afganistanit (ose 14%), 121.535 shtetas të Irakut (ose 10%), 66.885

shtetas të Kosovës (ose 5%), 65.935 shtetas të Shqipërisë (ose 5%), dhe gjithashtu shtetas të vendeve tjetra si, Pakistani, Eritrea, Nigeria, Irani etj (Eurostat, 2015).

Ikja nga vendlindja është plagë e kahmotshme e shqiptarëve. Arsyet e largimit janë kryesisht si pasojë e varfërisë, gjendjes së dobët ekonomike, papunësisë, dhe mungesës së sigurimit social dhe shëndetësor. Në këtë relacion theksojmë se është e drejtë e çdo anëtari të shoqërisë të ketë sigurim social dhe të drejta të domosdoshme ekonomike, sociale e kulturore për dinjitetin e tij dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit të tij, me ndihmën e shtetit në përputhje me organizimin dhe burimet e çdo shteti. Këto të drejta duhet të garantohen përmes legjislacionit pozitiv, duke inkriminuar çdo formë të rrezikimit apo cenimit të këtyre të drejtave. Këto të drejta zënë vend edhe në të drejtën ndërkombëtare të rregulluar me aktet ndërkombëtare, p.sh. me Deklaratën e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, e vitit 1948 dhe me Konventën Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe protokollet e saj.

Siç kemi diskutuar më sipër, kërcënimet si: papunësia dhe varfëria e vazhdueshme, të cilat cenojnë mirëqenien e qytetarëve të Kosovës, janë të mbrojtura edhe me Kushtetutë, respektivisht me disa nga nenet e kapitull të të drejtave dhe lirive të njëriut. Të gjitha këto kërcënime kanë potencial të transformimit në kriminalitet, ngase hulumtimet e ndryshme e lidhin papunësinë me krimin dhe dhunën.

Kodi penal i Kosovës i ka kushtuar një kapitull të tërë veprave që ndërlidhen me sigurinë ekonomike, të emërtuar “*Veprat penale kundër të drejtave nga marrëdhëniet e punës*”. Veprat penale të këtij kapitulli paraqesin cenimin e të drejtave individuale, të cilat rrjedhin nga marrëdhëniet në mes punëdhënësit dhe punës së punëtorit (Salihu, 2014:590). Të drejtat nga marrëdhënia e punës janë të rregulluara edhe me ligj dhe akte nënligjore, me

kontratën kolektive dhe me kontrata individuale të punës. Duhet theksuar se të gjitha këto norma penalo juridike kanë për objekt mbrojtës të drejtat e punëtorit, e për rrjedhojë sigurinë e tij ekonomike. Ajo që është e padiskutueshme sidomos për shtetet me ekonomi të dobët, siç është rasti Kosovës, papunësia paraqet një ndër faktorët kryesor të rritjes së kriminalitetit. Nga kjo dukuri më së shumti pëson individi, pasi që ai është objekt i atakuar, apo prona e tij atakohet. Si dukuri, veprat e tilla janë shumë të shprehura dhe janë bërë përditshmëri e zakonshme në Kosovë, duke cenuar edhe sigurinë individuale të njeriut. Për fund, vlen të potencojmë se konflikti që mund të vjen si pasojë e kërkesës së vazhdueshme për zhvillim ekonomik, përfshinë edhe rrezikimin e shëndetit të individit nga industrializmi. Andaj, krahas me kërkesën për zhvillim ekonomik, vëmendje duhet kushtuar edhe përgjegjësisë së shtetit për kujdesin ndaj shëndetit të qytetarëve përmes sanksionimit të industrive, ekonomive dhe faktorëve që mund të rrezikojnë mirëqenien e popullatës. Një shembull i mirë i kësaj kërkesë për ballancim është pikërisht edhe rasti Bacila vs Rumania, të trajtuar nga GJEDNJ. Parashtruesi i kërkesës në GJEDNJ, ka jetuar në Copsa Mica, Romani, në një lokacion ku ishte vendosur industria e metaleve, që për pasojë kishte ndotje të rëndë të mjedisit. Fabrika “Sometra” kishte liruar metale të rënda dhe dioksid sulfuri, e cila ndonjëherë arrinte deri nivelin 20-30 herë më të lartë sesa nivelet e autorizuara, duke shkaktuar kështu kontaminimin e ajrit, dheut, bimësisë dhe rrjedhave të ujit në qytet dhe rrethinën e tij, si dhe shi acidik. Si rezultat, edhe paraqitja e sëmundjeve respiratore në Copsa Mica ishte shtatë herë më e lartë se në pjesën tjetër të Rumanisë. GJEDNJ-ja ka gjetur se qeveria e Rumanisë kishte dështuar të bëjë baraspeshimin e duhur mes interesave të mirëqenies ekonomike të qytetit të Copsa Mica [...] dhe ushtrimin efektiv të drejtave të parashtruesit të kërkesës, për të drejtën në shtëpi dhe jetën private dhe

familjare” (par. 72). Andaj, GJEDNj ka konkluduar se Rumania ka shkelur nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Bacila v. Romania jep një kontribut domethënës në jurisprudencën e Gjykatës për të drejtat e njeriut, dhe njohje të të drejtës në një mjedis stabil dhe të shëndetshëm. Gjykata i ka dhënë rëndësi implementimit të së drejtës në respektimin e jetës private dhe familjare, kur e njëjta pengohet nga ndotja e ambientit; një e drejtë e cila duhet të mbrohet në mënyrë adekuate dhe të arsyeshme përkundër pasojave ekonomike (UNEP, 2014: 82).

Mbrojtja e sigurisë ekonomike, përveç që garantohet me kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe mbrohet me kodin penal të Kosovës, ajo njëherit mbrohet edhe përmes ligjeve të veçanta, të cilat garantojnë çështje specifike të sigurisë ekonomike. Kërcënimet e vazhdueshme të sigurisë ekonomike për qytetarët e Republikës së Kosovës, janë papunësia dhe varfëria e vazhdueshme. Këto kërcënime atakojnë të drejtat kushtetuese si: dinjitetin e njeriut, e drejta për jetën; ndalimi i sklavërisë dhe i punës së detyruar, e drejta e martesës dhe familjes, mbrojtja e punës, e drejtat e arsimit, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit dhe të drejtat e fëmijës. Mbështetja dhe ofrimi i ndihmës së përkohshme financiare për familjet në varfëri realizohet përmes Ligjit Nr.04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për skemën e ndimës sociale në Kosovë, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 18.08.2003. Ndërsa përcaktimi i të drejtave dhe lirive të të punësuarve rregullohet me Ligjin Nr.04/L-011 për organizimin sindikal në Kosovë. Me këtë ligj rregullohet themelimi dhe organizimi i lirë dhe vullnetar në organizatat sindikale në sektorin publik dhe privat, me qëllim të përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave ekonomike, sociale dhe profesionale të punëtorëve nga puna dhe marrëdhënia e punës. Mbrojtja pensionale garantohet përmes ligjit Ligji Nr.04/L-131 për skemat pensionale të

financuara nga shteti, të miratuar nga Kuvendi Kosovës me 21.05.2014. Me këtë ligj rregullohen dhe përcaktohen pensionet bazike të moshës, pensionet kontribut paguese të moshës, pensionet e aftësisë së kufizuar, pensionet e parakohshme, pensionet familjare dhe pensionet invalidore të punës, të cilat janë pensione (të *Shtyllës së I-rë*) të financuara nga shteti.

Duke u nisur nga fakti se Kosova garanton të drejtat e përcaktuara me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. Konstatohet se në Kosovë ndalohet diskriminimi i fëmijëve në çfarëdo baze. Andaj, duke pasur parasysh rëndësinë, rolin dhe vështirësitë e familjes në mbrojtjen dhe kujdesin për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme, theksojmë se Ligji Nr.03/L-022 *“për përkrahje material familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përheshëm”*, rregullon të drejtën për përkrahje materiale familjeve të cilët ruajnë dhe përkujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme dhe mënyra e realizimit të kësaj përkrahje materiale. Poashtu, mbrojtje ekonomike të personave me aftësi të kufizuar në Kosovës, ofron Ligji Nr.2003/23 *“Për pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë”*. Me këtë ligj, shtetit i ofron mbrojtje personit i cili konsiderohet me aftësi përherë dhe plotësisht të kufizuara, nëse është mbi 18 vjet apo më pak se 65 vjet. Gjithashtu kriter I përfitimit të këtij lloji të pensionit është edhe diagnoza mjekësore e gjendjes fizike, ndijore, ose mendore, të sëmundjes ose aftësisë së kufizuar, të cilat e bëjnë individin të paaftë për çfarëdo pune shpërblyese. Ligji Nr.04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare të dates 02.07.2012, nënkupton ofrimin e ndihmës për personat në nevojë sociale, në lidhje me punët e shtëpisë, kujdesin personal, lëvizshmërinë, komunikimin dhe mbikëqyrjen. Përkujdesja mund të ofrohet në shtëpinë e vetë personit, në një familje tjetër, në një qendër të specializuar të qëndrimit ditor ose në

një institucion rezidencial. Në këtë kontekst ndihma materiale nga shteti përfshinë sigurimin e parave, strehimin e përkohshëm, ushqimin, pagesën e shpenzimeve mjekësore, veshëmbathjen ose çfarëdo nevojë tjetër të domosdoshme materiale urgjente për individin ose familjen, të cilët nuk kanë burim tjetër në dispozicion. Ligji Nr.02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare, të dates 14.10.2005, mbron personat në nevojë dhe familjet që janë në nevojë në Kosovë, të cilat në rrethanat kur nuk ka përkrahje nga familja ose kur ajo nuk është e mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e një individi, shteti ka për detyrë të ofrojë shërbime sociale dhe familjare për ata njerëz që ndryshe nuk do të ndihmoheshin në mënyrën, e cila do të respektonte dinjitetin e tyre si qenie njerëzore dhe të drejtat e tyre themelore të bazuara në legjislacionin e Kosovës dhe në konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Përveç në rrethana të jashtëzakonshme të nevojës dhe të mbrojtjes, këto shërbime i'u ofrohen personave në nevojë dhe familjeve, në suaza të komunitetit e jo nëpër institucione rezidenciale. Ndërsa siguria personale për personat e verbër mbrohet me Ligjin Nr.04/L-092 "*Për personat e verbër*". Ky ligj i ofron mbrojtje personave të verbër nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes talljes dhe gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët bazuar në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

5.4.5 Mbrojtja nga pasiguria ushqimore

Siguria ushqimore nënkupton ushqim të mjaftueshëm në dispozicion për një familje (Pinstrup, 2009:5-7). Rritje e konkurrencës për tokë, ujë dhe energji, do të ndikojë në aftësinë e njerëzimit për të prodhuar ushqim dhe do të rrisë kërkesat urgjente për të reduktuar ndikimin e sistemit të ushqimit në mjedis (Godfray, 2010:812-818). Çdo person ka të drejtë për një nivel jetese, që nënkupton apo që siguron shëndetin dhe mirëqenien e tij

dhe të familjes së tij. Mirëqenia e individit përfshinë ushqimin, veshmbathjen, strehimin, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale, si dhe të drejtën për të qenë i siguruar në rast papunësie, sëmundjeje, invaliditeti, vejërie, pleqërie ose në raste të tjera të mungesës së mjeteve të jetesës për shkak të rrethanave që nuk varen nga vullneti i tij (DUDNJ, OKB, 1948: neni 25.1). Përkufizimi i konceptit të sigurisë ushqimore lidhet me një situatë në të cilën njerëzit në çdo periudhë duhet të kenë mundësi dhe hapësirën e nevojshme fizike, sociale e ekonomike, që të marrin ushqim të mjaftueshëm dhe të sigurt. Këto kërkesa konsistojnë në plotësimin e nevojave të tyre dietike dhe parapëlqimeve ushqimore, për një jetë aktive dhe të shëndetshme, të përcaktuara me deklaratën e samitit botëror të ushqimit. Ky përkufizim nxjerr në pah dy dimensione thelbësore të sigurisë ushqimore:

(1) *Disponueshmërinë e ushqimit*, e cila nënkupton disponueshmërinë e sasive të mjaftueshme të një ushqimi me cilësinë e duhur, i garantuar dhe furnizuar përmes prodhimit të brendshëm ose importeve (*përfshirë ndihmat e ndryshme ushqimore*); si dhe

(2) *Aksesin në ushqim*, që nënkupton aksesin nga individët në resurse të përshtatshme për të përftuar ushqimet e duhura për një dietë të shëndetshme.

Megjithatë, duke lënë anash sigurinë ushqimore nga aspekti i të drejtave të njeriut në shtjellimin e mëposhtëm do të përqendrohemi në inkriminimin e veprave penale që rrezikojnë sigurinë ushqimore në Kosovë, e rrjedhimisht edhe shëndetin e qytetarëve. Mbrojtja e sigurisë ushqimore arrihet përmes inkriminimit të veprave penale të cilat cenojnë ushqimin për konsum. Hulumtimet e shumta e ndërlidhin sigurinë ushqimore me përfshirjen e njerëzve në kriminalitet, kjo kryesisht si pasojë e mosmundësisë së realizimit të të hyrave. Përveç Kodit Penal të Kosovës, edhe shumë ligje përmbajnë norma penalo

juridike të cilat inkriminojnë dhe sanksionojnë cenimin e ushqimit të qytetarëve. Kodi Penal i Kosovës përmban norma penalo juridike që mbrojnë qytetarët nga ndotja qëllimshme apo e paqëllimshme e ushqimit për konsum siç janë: Prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimor (neni 267); Ndotja e ujit të pijshëm (neni 270); Ndotja e artikujve ushqimorë që përdoren nga njerëzit dhe kafshët (neni 271). Këto norma penalo juridike kanë për qëllim mbrojtjen e ushqimit dhe ujit të cilat konsumohen nga qytetarët. Objekt mbrojtës i këtyre normave penalo juridike është mbrojtja e shëndetit të njeriut nga ushqimi dhe uji i pijes (Salihu, 2014:745). Shkelja e detyrimeve familjare (neni 251) dhe shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës (neni 252) i referohen inkriminimit të atyre veprimeve ku personave të cilëve iu është besuar kujdesi ndaj një personi dështojnë në ofrimin e kujdesit të tillë. Në këto nene gërshetohen obligime dhe të drejta edhe ekonomike, megjithatë ajo që në rastin konkret është relevante për ne, është mohimi i dimensionit të aksesit në ushqim si pjesë e pasigurisë ushqimore, që për fat të keq ndodh në raste jo të rralla dhe me pasoja për shëndetin dhe jetën e njerëzve. Në kuadër të po të njëjtit kapitull të Kodit penal është paraparë edhe Kontrolli i papërgjegjshëm i produkteve shtazore të destinuara për konsumim (neni 268). Ky nen për dallim nga nenet paraprake ndërlihet me kryerjen e pandërgjegjshme të detyrës nga veterinarit apo personit tjetër të autorizuar për kontrollim të ushqimit i cili me apo pa vetëdije mund të bëjë lëshime në kryerjen e detyrës me ç'rast mundëson që artikuj të kontaminuar të depërtojnë në tregun e Kosovës. Përgjithësisht si shtet dhe për shkak të nivelit të ulët të zhvillimit ekonomik, Kosova ka predispozita të rrezikimit të sigurisë ushqimore nga dy aspekte:

- (1) *Nga prodhues dhe tregtarë vendor*, referuar cilësisë së produkteve dhe mundësisë së manipulimit, sidomos me afatet e skadencës, e poashtu edhe me mënyrën e

prodhimit të produkteve duke pasur parasysh kushtet higjienike dhe tjera në të cilat këto produkte prodhohen.

(2) *Rreziku i produkteve të importuara nga jashtë.* Duke pasur parasysh shkallën e lartë të importit të produkteve në krahasim me eksportin (*Eksporti i mallrave në muajin Dhjetor 2015 kishte vlerën 23,5 milion €, ndërsa importi 253,6 milion €*), Kosova si shtet ekspozohet ndaj kërcënimeve të vazhdueshme të pasigurisë ushqimore për shkak të cilësisë së atyre produkteve. Sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për muajin dhjetor 2015, 15.1% e importit ka qenë në ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani. Importi i këtyre produkteve vie në përqindje të madhe nga: Serbia (me 12.7 %), Turqia (me 12.0%), Gjermania (11.9%), Kina (9.4%), Italia (9.2%), Maqedonia (5.0%) etj (ESRK: 2015).

Agjencitë përgjegjëse për kontrollimin e mallrave dhe ushqimeve si; Dogana e Republikës së Kosovës dhe Agjencia për Veterinari dhe Ushqim, në vazhdimësi realizojnë kontrollimin e mallrave, sidomos atyre mallrave që vijnë nga jashtë shtetit. Theksojmë se nuk kanë qenë të rralla rastet kur janë konstatuar probleme rreth kualitetit të mallrave nga exporti. Problemi më shumë rëndohet, në ato raste kur produktet ushqimore janë prodhim vendor apo edhe kanë depërtuar në tregun Kosovar, pasi do të jetë më i vështirë kontrollimi i tyre. Për më tej, siguria ushqimore është njëra nga segmentet më të cënueshme të sigurisë njerëzore për vet faktin se çdo cenim i saj rrezikon direkt jetën dhe shëndetin e qytetarit. Andaj institucionet shtetërore duhet t'i kushtojnë kujdes të shtuar sigurisë së ushqimit dhe në veçanti ujit të pijes. Mendojmë se rreziku më i madh për qytetarët dhe njerëzimin konsiston tek siguria e ujit të pijshëm, për vet faktin se uji përdoret për konsum gjatë tërë ditës.

Mbrojtja e sigurisë ushqimore, përveç që garantohet me kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe mbrohet me kodin penal të Kosovës, mbrohet edhe përmes ligjeve të veçanta, të cilat garantojnë çështje specifike të sigurisë ushqimore. Ligji Nr.2004/17 “*për mbrojtjen e konsumatorëve*”, rregullon mbrojtjen e të drejtës themelore të konsumatorëve në blerjen e prodhimeve dhe gjatë shërbimeve, siç janë: e drejta për mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve; e drejta për mbrojtjen nga rreziku për jetë, shëndet dhe pasuri; e drejta e mbrojtjes juridike të konsumatorit; e drejta për informim dhe riedukim të konsumatorëve. Ligji Nr.04/L-078 për sigurinë e përgjithshme të produkteve rregullon sigurinë e përgjithshme të produkteve, të cilat vendosen në treg dhe në harmoni me standardet e Bashkësisë Evropiane. Pra, ky ligj mbron dhe rregullon vënien në treg të produkteve për konsum. Për më tej, me këtë ligj përcaktohen kërkesat për sigurinë e përgjithshme të produkteve, detyrimet e prodhuesve dhe shpërndarësve, informimin e publikut, nxitjen e masave vullnetare si dhe mbikëqyrjen ndaj përmbushjes së kërkesave të përcaktuara me këtë ligj. Ndërsa mbrojtja e shëndetit publik përmes përcaktimit të cilësisë dhe sigurisë së ushqimit rregullohet me Ligjin Nr.03/L-016 për ushqimin, të datës 06.03.2009. Me këtë ligj rregullohen parimet e përgjithshme dhe kërkesat që kanë të bëjnë me higjienën e ushqimit dhe ushqimit të sigurtë; obligimet e subjekteve afariste; kushtet e plasimit të ushqimit në treg; sistemin e kontrollit zyrtar të ushqimit; sistemin e laboratorëve të autorizuar testues; menaxhimin me krizat dhe me rastet emergjente si dhe rregullon themelimin dhe funksionalizimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Me rendësi të veçantë për konsumatorët është Ligji Nr. 04/L-114 “Për pasurimin e miellit”, të datës: 07.09.2012. Me këtë ligj përcaktohen rregullat që zbatohen në pasurimin e miellit për konsum, si njëra nga mënyrat që ka për qëllim parandalimin dhe reduktimin e

sëmundjeve të cilat shkaktohen nga mungesa e hekurit dhe acidit folik. Me fjalën “Miell i pasuruar” nënkuptohet mielli të cilit i është shtuar një apo më shumë përbërës si: vitamina, minerale, proteina, aminoacide, acide alifatike. Mbikqyrja shtetërore sanitare e kualitetit të ushqimit realizohet përmes zbatimit të ligjit Nr.2003/22 për inspektoriatin sanitar të Kosovës. Kjo mbikqyrje konsistion në kontrollin e kualitetit të ushqimit, kushteve higjieno dhe sanitare të objekteve industrial-ushqimore, tregtare ushqimore, shëndetësore, hoteliere, objektet parashkollore, shkollore, objektet publike dhe vendbanimeve publike. Ndërsa Ligji Nr.03/L-181 për Inspektoriatin dhe mbikqyrjen e tregut, rregullon inspektimin e standardeve të tregtimit të mallrave dhe të cilësisë së shërbimeve që ofrojnë subjektet ekonomike, duke mbikqyrë sigurinë e produkteve në treg; mbrojtjen e konsumatorëve; kontrollin e përdorimit të njësive matëse dhe peshoreve në qarkullim; veprimtarinë turistike dhe hoteliere; mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industrial në treg; mbrojtjen e të drejtës së autorit në treg.

5.4.6 Mbrojtja nga pasiguria mjedisore

Ambienti natyror në vetvete është objekt referimi më i rëndësishëm i sigurisë, për shkak të sulmeve sistematike në njerëzimit, si kërcënim përfundimtar për mbijetesën e njeriut (Hughes, 2004:29-117). Siguria mjedisore i referohet kërcënimeve nga ndryshimet klimatike si thatësitrat, stuhitë e ashpra, vërshimet, ngritja e niveleve të detit dhe të gjitha format e ndotjes së ajrit dhe ujit, që dëmtojnë shëndetin e njerëzve dhe gjallesave. Siguria mjedisore prek në mënyrë të drejtpërdrejtë njerëzimin ngase degradimi mjedisor dhe dëshpërimi janë shkatërrimtar për shoqëritë. Shkatërrimi i pyjeve, fragmentimi i habitateve, shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore, janë vetëm disa prej aktiviteteve të njeriut pasojat e të cilave tani më janë evidente. Si asnjëherë më parë, numri i habitateve që

zhduken dhe atyre që kërcënohen për zhdukje është duke marrë përmasa alarmante. “Zhvillimi i qëndrueshëm, është një çështje detyruese morale dhe humanitare, por në të njëjtën kohë një sfidë për sigurinë”, konstatonte Colin Power (ish sekretari Amerikan i Mbrojtjes), në një edicion special të revistës së publikuar nga Kombet e Bashkuara mbi këtë çështje në vitin 2000. Zyra e Komesarit të lartë të OKB për të drejtat e njeriut (OHCHR) dhe “Mapping report” i vitit 2013 i hartuar nga eksperti i pavarur i OKB-së, për të drejtat e njeriut dhe mjedisin, kanë nxjerrë konkludimin se “Të drejtat e njeriut përfshijnë obligimet lidhur me mjedisin” e që nënkupton si obligimet procedurale ashtu edhe materiale.

Sa i përket obligimeve procedurale të shtetit, e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut përcakton një varg obligime për qeveritë, lidhur me ndikimin mjedisor të aktiviteteve të tyre. Këto përfshijnë obligimin për të mbledhur dhe shpërndarë të dhënat mbi ndikimin e mjedisit, të lehtësojë pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje mbi mjedisin dhe të sgurojnë qasje për mjete të duhura në rast të dëmtimit mjedisor. Këto obligime janë të drejta civile dhe politike, por ato janë qartësuar dhe zgjeruar në kontekstin mjedisor në bazë të gjithë gamës së të drejtave të njeriut, që rrezikohen nga dëmi mjedisor (HRC, 2013). Njeriu duke kënaqur nevojat e veta socio ekonomike gjithnjë e më shumë po shkakton ndikime të ndjeshme negative në mjedisin e tij. Gjatë dy dekadave të fundit, kriminologët dhe politikë bërësit kanë filluar t’i kushtojnë më shumë vëmendje çështjeve të krimit të burimeve mjedisore dhe natyrore. Kriminaliteti i gjelbërt përshkruhet si studim i dëmit mjedisor, krim, viktimizim, ligj, rregullore dhe drejtësi (McGarrell, 2011:267). Përmasat e këtyre ndikimeve negative, mekanizmi i veprimeve dhe pasojat në mjedis janë të varura nga shumë faktorë. Mosndërmarrja e masave adekuate në parandalimin dhe eliminimin e

tyre në shumicën e rasteve shkaktajnë efekte të pariparueshme për mjedisin, duke përfshirë ndotjen e ujit, ajrit, tokës, menaxhimin e mbetjeve, ndotjen akustike dhe radioaktivitetin (AMMK, 2010). Ndërsa, prodhimi i mbeturinave nga shumica e industrive është edhe një segment tjetër i ndikimit të këtij sektori në mjedis (AMMK, 2010). Prerja e pakontrolluar e pyjeve po ndikon në shfaqjen e shumë ndryshimeve mjedisore si: erozioni, ndryshimet klimatike, vërshimet etj, të cilat kanë filluar të shfaqen në dekadat e fundit (AMMK, 2010).

Kushtetuta e Kosovës në kuadër të mbrojtjes së mjedisit jetësor përmban norma kushtetuese, përmes të cilave garantohet mbrojtja nga degradimi dhe ndotja e mjedisit dhe burimeve të saj e poashtu edhe nga fatkeqësitë natyrore.

Në mbrojtje të mjedisit, ligjvënësit në Kodin Penal të Kosovës kanë përcaktuar një pjesë të madhe të kapitullit 28 “*Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore*”, ngase një mjedis i ruajtur dhe i shëndoshë është parakusht për jetën, shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve. Baza e mbrojtjes penalo juridike e mjedisit të njeriut përveç kushtetutës janë edhe aktet e Organizatës së Kombeve të Bashkuar, Këshillit të Evropës dhe Unionit Evropian (Salihu, 2014:969). Dëmtimi i mjedisit megjithatë është i sanksionuar edhe si vepër kundërvajtëse dhe i referohet kryesisht veprave më të lehta.

Në kapitull 28 të Kodit Penal, të emërtuar “*Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore*”, gjenden një numër i veprave penale që i referohen aktiviteteve më të zakonshme në të cilat mund të përfshihen individët apo edhe bizneset e ndryshme. Këto aktivitete mund të kenë ndikim shumë të lartë në mjedis, dhe domosdoshmërisht në segmentet tjera të sigurisë njerëzore. Si shembull, neni 347 i Kodit Penal të Kosovës, i emërtuar “*Degradimi ose shkatërrimi i mjedisit*”. Objekt i mbrojtur i kësaj norme penale janë ajri, toka, ujërat rrjedhëse, ujërat statike, ujërat nëntokësore,

përrenjtë, deti, fundi i detit, toka nëndetare ose rrezikimi i pastërtisë së ajrit, tokës, ujit, lumenjeve apo detit, fundit të detit dhe tokës nëndetare, apo harmonisë gjenetike natyrore të divestitetit biologjik (Salihu, 2014:968). Degradimi i mjedisit paraqet një çështje mjaft aktuale në Kosovë sidomos, me degradimin e shtratit të lumenjëve përmes eksploatimit të zhavorit. Për shkak të nivelit të lartë të shfrytëzimit të rërës, për pasojë çdo vjet rritet rreziku i vërshimeve të shumta të lumenjve. Fatkeqësisht, “bizneset e zhavorit”, vazhdojnë të operojnë pandërprerë, në kundërshtim me të gjitha normat. Këto biznese, përkundër shkeljeve ligjore dhe rrezikimit të mjedisit, mbesin të pasanksionuara nga sistemi i drejtësisë, apo më e shumta që mund të ndodh, është dhënia e një gjobë administrative, e cila lëshohet nga inspektorati i Ministrisë së Mjedisit.

Situata e njëjtë vazhdon të jetë edhe me prerjen e drunjëve dhe shkretimin e pyjeve. Këto vepra janë të sanksionuara me Kodin Penal, respektivisht nenin 357 “Shkretërimi i pyjeve”, dhe neni 358 “Vjedhja e pyllit”. Megjithatë, për këto vepra penale kunder mjedisit, dënimet janë shumë të lehta dhe nuk mund të ndikojnë në vetëdijësimin e kryesve përmes parandalimit me sanksionim.

Veprat penale që lidhen me materialet nukleare dhe terrorizmin, janë ndër veprat më të rënda në Kodin Penal. Këto vepra i referohen veprave kundër të drejtës ndërkombëtare dhe rendit kushtetues. Mirëpo, qëllimi i përfshirjes së këtyre veprave në temë, konsiston në shpërfaqjen e ndërlidhjes së tyre me sigurinë mjedisore. Këto forma të rënda penale mund të realizohen pikërisht përmes cenimit të sigurisë së mjedisit dhe rrjedhimisht edhe sigurisë shëndetësore dhe ushqimore. Për shembull: nëse me një akt terrorist, sipas përkufizimit të nenit 135 vepra terroriste kryhet përmes ndotjes së mjedisit apo ujit të pijshëm. Në kohët e sotme nuk konsiderohet e pamundur, kryerja e këtyre

vepave peenale, pasi që dyshime janë ngritur pikërisht në Kosovë me rastin e kapjes së tre të dyshuarve për terrorizëm në afërsi të Liqenit të ‘Badovcit’ (*Liçeni furnizon Prishtinën me ujë të pijes*) në korrik të vitit 2015. Edhe pse hetimet e deritanishme ende nuk kanë arritur të vërtetojnë nëse ndotja e ujit ka qenë pikërisht qëllimi i këtyre të dyshimtëve, megjithatë raste të tilla, të bëjnë të mendosh për mundësitë reale, me të cilat shtetet mund të ballafaqohen në çdo kohë.

Gjatë kohës së luftës në Kosovë, respektivisht përgjatë 78 ditëve të bombardimeve nga NATO-ja ndaj forcave të armatosura të Serbisë, në territorin e Kosovës janë hedhur 31.000 predha që peshonin nga 271 gr. Sasia e përgjithshme e të cilave arrin 8,401 kilogram Uranium të varfëruar. Gjatë periudhës 5-17 nëntor 2008, një ekip i hulumtuesve nga Universiteti i Bristolit (Angli) ka mbledhur 340 mostra në total, respektivisht ka mbledhur: 247 mostra dheu, 45 mostra uji, 30 mostra të vegjetacionit, 10 teste të ndotjes, 5 mbështjellës, 7 penetratorë dhe 1 fragment pjesë penetratori, (UNDP, 2001:27-52). Në raportin final të universitetit të Bristolit, është konstatuar se pjesa më e madhe e mostrave të dheut përmbanin uranium të koncentruar brenda koncentrimit normal të ambientit. (1-300 mg/kg). Vetëm një sasi e vogël e mostrave kishin nivelin e ulët të koncentrimit me uranium dhe kjo ndodh vetëm në kontakt të drejtpërdrejtë me penetratorin. Izotopet e analizuar të uraniumit tregojnë se uraniumi i varfëruar përmban: 0.2 % të Uraniumit 235. Uraniumi i varfëruar gjithashtu ka gjurmë të koncentrimit U236 dhe të plutoniumit 239PU dhe 240PU. Sipas raportit, ka indikacione se ky metal është prodhuar nga karburantet nukleare (UNDP, 2001:27-52).

Për sa i përket ajrit në Republikën e Kosovës, theksojmë se cilësia e ajrit është veçanërisht e ulët në zonat e Prishtinës, Obiliqit dhe Drenasit dhe Mitrovicës. Burimet

kryesore të kontaminimit të ajrit janë: dyoksidi i sulfurit (SO₂), oksidet e azotit (NO) dhe NO₂ (NO_x), ozoni (O₃), plumbi (Pb), dyoksidi i karbonit (CO₂), grimcat (*PM apo pluhuri*) dhe dyoksina. Si burime kryesore të ndotjes së ajrit në Kosovë konsiderohen sektori i energjetikës, komunikacioni dhe industria e rëndë. Aktualisht ndotësit më të mëdhenj të ndotjes së ajrit në Kosovë janë prodhimi i energjisë dhe minierat, përfshirë dy termocentralet me thëngjil të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) dhe sipërfaqja e saj për nxjerrjen e thëngjilit (AMMK, 2010); mihjet sipërfaqësore të linjtit në Obiliq; Druri dhe linjiti për ngrohje të shtëpive; parku industrial i Mitrovicës (Trepçë); Miniera dhe prodhimi nikelit në Drenas (Ferronikeli); fabrika e çimentos në Hanin e Elezit (Sharrcem); Kompanitë e ngrohjes qendrore (Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë), transporti dhe Deponitë e mbetjeve urbane dhe atyre industriale, me ndikim të ndryshëm lokal.

Emisionet e pluhurit maten vetëm në termocentralin “Kosova B”, p.sh. mesatarja vjetore për emisionet e matura të pluhurit gjatë vitit 2008 kanë qenë: për Bllokun - B1: 272.22 ton/muaj, kurse për Bllokun - B2: 254.49 t/muaj, ndërsa parametrat tjerë (SO₂, NO_x dhe CO₂) kalkulohen nga ekipi për mjedis në Divizionin e Gjenerimit të Energjisë. Në tabelën vijuese janë paraqitur emisionet e termocentraleve të KEK-ut, dhe limitet sipas Direktivës 2001/80/EC.

Ndotësi	TC Kosova A	TC Kosova B	Limiti
Pluhur	902.32	156.35	50
SO ₂	251.42	208.55	400
NO _x	705.75	835.08	500

Figura 5.4.6.1 Emisionet aktuale dhe limitet e ndotjes së ajrit

Nga analiza në bazë të rezultateve zyrtare (në tabelë), emisionet e pluhurit në krahasim me limitet, sipas kriterëve ndërkombëtare (Memorandumi i Athinës II), janë shumë të larta, sidomos nga Termocentrali Kosova A. Po ashtu edhe emisioni i NOx sipas kalkulimeve është mbi nivelet e kërkuara. Emisionet e Dyoksid sulfurit (SO₂), edhe pse sipas kalkulimeve rezultojnë të jenë më të ulëta se limiti i Direktivës së BE-së (Direktiva 2003/54/BE), ato kërkohet të verifikohen përmes matjeve të vazhdueshme. Ndërsa emisionet e Dyoksid karbonit (CO₂) të llogaritura nga totali i linjitit të përdorur, llogariten të jenë mbi 5 milion ton për vit.

Termocentrali	Blloqet	Emetimet e CO ₂ (t/vit)
Kosova A	A1, A3, A5	1.532.930
Kosova B	B1, B2	3.608.876

Figura 5.4.6.2 Emisionet e CO₂, nga TC Kosova A dhe TC Kosova B

Ndotja e Prishtinës nga Ngrohtorja “Termokos”, sipas të dhënave për vitin 2010, rezulton të jetë: dyoksidi i sulfurit SO₂ (3% O₂) është 491.0 mg/Nm³. Pra emisioni i SO₂ është mbi vlerat e lejuara ndërsa, sasia e CO është 118.0 mg/m³ dhe është po ashtu në kufij të lejuar (Termokos:2010).

Burimet e gazrave serë	Njësia Gg (Giga Gram)					
	2008			2009		
	CO ₂	CH ₄	N ₂ O	CO ₂	CH ₄	N ₂ O
Energjia	6,221.976.11	5,388.79	252.56	7,040,831.31	5,578.54	269.94
Industria	11,054.45	1.32	0.18	11,474.52	1.37	0.18
Transporti	1,073.30	0.15	0.07	1,110.44	0.15	0.07

Figura 5.4.6.3 Burimet e gazrave serë

Përderisa në Kosovë në vazhdimësi ndotet ambienti dhe nuk i kushtohet rëndësi mbrojtjes së tij, Evropa ka krijuar një rrjet të gjerë të zonave të mbrojtura dhe programe të veçanta për të mos lejuar zhdukjen e llojeve gjallesave të rrezikuara. Sidoqoftë, ndryshimet

e gjëra të peisazheve, degradimi i ekosistemit dhe humbja e resurseve natyrore, nënkupton se BE nuk do t'i përmbushë objektivat e veta për vitin 2010 për ndalimin e humbjes së biodiversitetit. Për ta përmirësuar gjendjen, Europa ka vendosur t'i jap prioritet biodiversitetit dhe ekosistemeve në të gjitha shkallet e politikë bërjes, veçanërisht duke adresuar bujqësinë, peshkimin, zhvillimin rajonal, planifikimin dhe kohezionin hapësinor. Transformimi drejt një ekonomie të gjelbër evropiane do të siguroj një qëndrueshmëri afatgjate të mjedisit të Evropës dhe fqinjëve të saj, andaj theksojmë se ndërrimi i qëndrimeve do të jetë i rëndësishëm. Rregullatorët, bizneset dhe qytetarët së bashku, mund të marrin pjesë më gjerësisht në menaxhimin e kapitalit natyror dhe të shërbimeve të ekosistemit, duke krijuar mënyra të reja dhe inovative të përdorimit eficient të resurseve natyrore, si dhe duke i ruajtur. Bazuar të direktivës së habitatit, një rrjet koherent evropian ekologjik i zonave të veçanta të ruajtjes është ngritur nën titullin “Natura 2000” (Habitats Directive 92/43 EEC, 2000:18). Këshilli i Evropës në Strasburg ka miratuar Konventën për mbrojtjen e mjedisit përmes të drejtës penale (KEMM, 1998, no.172). Kjo konventë ka ofruar bazën normative për normim edhe Kodit Penal të Kosovës. Neni 4 i kësaj konvente, udhëzon shtetet që të ndërmarrin masat që veprat si në vijim të inkriminohen si vepra penale apo administrative sipas legjislacionit vendor pa marrë parasysh a janë shkaktuar qëllimshëm apo nga pakujdesia:

- *Emetimi i paligjshëm apo përzierja e një sasive të substancave apo radiacionit jonizues me ajrin, dheun apo ujën;*
- *Shkaktimi i paligjshëm i zhurmës;*
- *Asgjësimi, trajtimi, deponimi, transporti, eksporti apo importi i mbetjeve;*
- *Operimi i paligjshëm i plantacionit (centralit)*

- *Prodhimi, trajtimi, përdorimi, transportimi, eksporti apo importi i materialeve nukleare, substancave tjera nukleare apo kemikateve të rrezikshme.*
- *Shkaktimi i paligjshëm i ndryshimeve determinuese për komponentet natyrore të parkut nacional, rezervave natyrore, vendeve për konservim të ujit apo vendeve tjera të mbrojtura;*
- *Posedim i paligjshëm, marrja, dëmtimi, vrasja apo tregëtimi i florës së egër dhe specieve të faunës.*

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në dekadat e fundit ka filluar të trajtojë shumë nga rastet që kanë të bëjnë me sigurinë mjedisore, të cilat rrjedhimisht kanë ndikim në sigurinë shëndetësore. Përkundër asaj që gjykata shpesh ka vënë në dukje se nuk ka një të drejtë eksplicite në Konventë për një mjedis të pastër dhe të qetë apo për ruajtjen e mjedisit natyror si të tillë, është shpjeguar se shkelja e të drejtës në respektimin e shtëpisë nuk kufizohet në vetëm shkelje fizike dhe konkrete, si p.sh.: hyrja e pautorizuar në shtëpinë e një personi, por gjithashtu përfshijnë edhe zhurmën, emetimin, kundërmimet apo format tjera të interferencës. Kjo ka qar në një zgjerim të qartë të fushëveprimit të Nenit 8 për të përfshirë të drejtat njerëzore mjedisore (Harris, 2014: 582).

Në rastin *Guerra and Others v. Italy* (1998: par. 65), parashtuesit e kërkesës kanë pretenduar se fabrika e kemikateve ka shkaktuar dëm substancial popullatës vendore, por parashtuesit kanë dështuar të demostrojnë shkaktimin e dëmit të pësuar substancial dhe shkencërisht të verifikueshëm, nga fabrika. Megjithatë, Gjykata ka bërë lidhjen kauzale në praktikë duke theksuar se veprimtaria në fjalë, ka rritur rrezikun e parashtuesve të kërkesës dhe se shteti i paditur kishte dështuar në zbutjen e rrezikut (West, 2015: 20).

Ajo që është karakteristikë e praktikës gjyqësore në Kosovë, është se përkundër faktit se rrezikshmëria nga ndotjet e ndryshme janë të shumfishta, qoftë përmes ndotjes nga gazi i makinave, termocentraleve, industrisë së metaleve, degradimit të lumenjëve etj, Një problematikë e tillë (*e cila dalngadalë po ndikon në shkatërrimin e mirëqenies së popullatës*) po kalon pa u ndëshkuar në shkallën sa e meriton nga sistemi gjyqësor. Është karakteristike se veprat nga kapitulli i mjedisit shumë pak apo për të thënë fare nuk trajtohen si akuzë, në rast kur vepra tjetër që është kryer në lidhje me dëmtimin e ambientit, ka një sanksionim më të rëndë. Ndotja e mjedisit sikur kalon në rend të dytë, pikërisht me arsyetimin se vepra më e rëndë konsumon veprën më të lehtë, andaj edhe nuk ka nevojë si e tillë të përfshihet në aktakuzë.

Mbrojtja e sigurisë mjedisore, përveç që garantohet me kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe mbrohet me kodin penal të Kosovës, mbrohet edhe përmes ligjeve të veçanta, të cilat garantojnë çështje specifike të sigurisë mjedisore. Mbrojtja e ajrit nga ndotja rregullohet me *Ligjin Nr.03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja*, dhe ka për qëllim të rregulloj dhe garantoj të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit. Mbrojtja e mjedisit rregullohet me *Ligjin Nr.03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit*, të datës 19.03.2009, dhe ka për qëllim promovimin e krijimit të mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës, me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian. Mbrojtja e natyrës rregullohet me *Ligjin Nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës*, të datës 18.10.010, dhe ka për qëllim të rregullojë mbrojtjen e natyrës nga shfrytëzimi i qëndrueshëm i saj. Theksojmë se dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në rastet e evitimit të rrezikut të drejtpërdrejt për jetën, shëndetin e njeriut apo pasurinë, shpëtimin të njerëzve ose

pasurisë si dhe kryerjes së aktiviteteve për mbrojtjen e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-120 për mbrojtjen e bimëve, të datës 28.12.2012, përfshinë identifikimin dhe përcjelljen, pengimin dhe përhapjen e organizmave dëmtues në bimë, produkte bimore, përcaktimin dhe zbatimin e masave fitosanitare, realizimin e obligimeve që rezultojnë nga konventat, marrëveshjet dhe kontratat ndërkombëtare nga lëmia e mbrojtjes së shëndetit të bimëve.

Meqenëse resurset ujore të Republikës së Kosovës janë pasuri me interes të përgjithshëm dhe pronë e Republikës së Kosovës, ato mbrohen me Ligjin nr.04/L-147, të datës 05.04.2013. Qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social dhe ekonomik të Republikës së Kosovës. Qëllimi tjetër i ligjit është krijimi i procedurave dhe parimeve udhëzuese për shpërndarjen optimale të resurseve ujore, mbështetur në kriteret e shfrytëzimit dhe qëllimit. Poashtu, sigurimi i mbrojtjes së resurseve ujore nga ndotja, shfrytëzimi i tepërt dhe keqpërdorimi është qëllim mbrojtës, njëjtë sikurse përcaktimi i strukturave institucionale për administrimin e resurseve ujore në Republikën e Kosovës. Poashtu, në interes dhe qëllim të parandalimit ose zvogëlimit të ndikimeve negative të projekteve të publike dhe private, ligji Nr.03/L-214 për vlerësimin e ndikimit në mjedis, kontribuon në ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njeriut si dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës. Për më tej, qëllimi i ligjit Nr.03/L-230 për vlerësimin strategjik mjedisor është sigurimi i shkallës më të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut, përmes vlerësimeve strategjike mjedisore dhe të planeve dhe programeve për mjedisin. Mbikqyrja dhe kontrollimi i vazhdueshëm institucional ndaj mjedisit mundësohet nga Ligji Nr.04/L-175 për Inspektimin e mjedisit,

ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit. Përmes këtij ligji janë krijuar instrumentet e mbrojtjes së mjedisit, natyrës, ujërave, planifikimit hapësinor, urbanistik dhe ndërtimor, të cilat realizojnë mbikqyrjen e vazhdueshme përmes inspektorëve, të cilët ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në mbrojtje të mjedisit, duke harmonizuar aktivitetet e tyre me rekomandimet e parlamentit Evropian dhe Këshillit për “Kriteret minimale për Inspektimet mjedisore” (RMCEI 2001/331/EC).

5.4.7 Mbrojtja nga pasiguria shëndetësore

Siguria shëndetësore i referohet qasjes minimale në shërbime shëndetësore, ujë të pastër dhe nevoja tjera bazike, për të parandaluar sëmundje infektive dhe sëmundje kronike për shkak të mënyrës së jetesës. Hulumtimet lidhin nivelin e qasjes në shërbime shëndetësore me nivelet e dhunës. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë “OBSh”, rreth 25% e sëmundjeve të parandalueshme shkaktohen nga cilësia e keqe e ambientit në të cilin jetojmë. Por edhe njerëzit që vuajnë nga uria dhe të kequshqyerit, nëse nuk trajtohen kanë tendencë më të lartë për t’u prekur nga sëmundjet, që mund të jenë lehtësisht të transmetueshme, duke u kthyer kështu në kërcënim real edhe për sigurinë kombëtare. Përmirësimi i shëndetit njerëzor është në thelb të çështjes së zhvillimit të një vendi (Petersen, 2003:3-24) andaj për këtë arsye shëndeti është subjekti specifik i tre prej tetë qëllimeve kryesore të parashikuara në Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (Travis, 2004:900-906). Për rrjedhojë, siguria shëndetësore synon të garantojë një minimum të domosdoshëm mbrojtjeje nga sëmundjet, veçanërisht ato infektive dhe epidemike, apo dhe nga sëmundjet që shkaktohen nga kushtet e këqija të jetesës. Shkaqet mund të jenë natyrore, mjedisore, aksidentale ose të qëllimshme, por më së shumti ato janë të lidhura me sjelljen e njeriut. Qeveritë dhe institucionet shtetërore kanë përgjegjësi për të garantuar

trajtim mjekësor të çdokujt që ka nevojë. Injorimi ose refuzimi i këtij shërbimi qoftë edhe ndaj një qytetari të vetëm, mund të jetë me pasoja fatale nëse ai/ajo rezulton infektues, duke i kushtuar vendit miliona euro shpenzime, për të kontrolluar një epidemi të mundshme. Siguria shëndetësore synon të garantojë një minimum të domosdoshëm mbrojtje nga sëmundje, veçanërisht nga ato infektive e epidemike, apo dhe nga kushte të pashëndetshme jetese. Në këtë pikë, i referohemi rasteve kur nga një problematikë shëndetësore e një individi, siguria shëndetësore zgjerohet edhe në persona tjerë, deri në rastet kur një gjë e tillë mund të shkaktojë edhe çrregullim në nivel të vendit dhe më gjerë. Raste të tilla janë shumë aktuale në shumë vende të botës. Një nga epidemitë më të rrezikshme të shfaqura gjatë fundit të vitit 2015 dhe fillimin e vitit 2016 është përhapja e virusit “Zika” e cila po merr përmasa përtej kontinentit të Amerikës Jugore (ku është shfaqur për herë të parë). E njëjtë ka qenë edhe eksperiencia edhe me virusin “Ebola” dhe shumë e shumë sëmundje dhe epidemi tjera, që rrezikojnë sigurinë njerëzore dhe sigurinë e një vendi apo edhe atë globale. Siguria shëndetësore i referohet edhe nevojës për një sanksionim më rigoroz të trajtimeve të pandërgjegjshme të pacientëve. Kodi Penal i Republikës së Kosovës në mbrojtje të shëndetit të qytetarëve ka inkriminuar një numër veprash të cilat mund të rrezikojnë sigurinë shëndetësore.

Grupi i parë, e përbëjnë veprat që i adresohen reagimit dhe kërkimit të përgjegjesisë si nga autoritetet ashtu edhe nga individët, për dëshimin në ndërmarrjen e masave të mjaftueshme për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive. Në këtë grup bëjnë pjesë nenet: “*Përhapja e sëmundjeve ngjitëse*” nga neni 255; normën penalo juridike “*Mosveprimi sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë*” (neni 256), me të cilën inkriminohet mos veprimi sipas urdhrave apo vendimeve të nxjerra në bazë të dispozitave

ligjore nga organi kompetent, në bazë të cilave caktohen masat që kanë për luftimin apo parandalimin e epidemisë nga sëmundjet ngjitëse (Salihu, 2014:708). Siguria shëndetësore nga *“Përhapja e sëmundjeve venerike”* nga neni 257 mbron qytetarët nga kjo sëmundje e turpshme dhe vepra penale me vështirësi ose fare nuk zbulohen dhe nuk paraqiten, ngase ruhen si fshehtësi të jetës private. Popullata këto sëmundje i njeh me emërtimet *“Sifiliz”*, *“Gonorea”*, *“Limfogranulat venirike”*. Më të përhapurat janë sëmundjet e *“Sifiliz-it”* dhe të *“Gonorea-s”*. Këto sëmundje zakonisht përhapen me marrëdhënie seksuale (Salihu, 2014: 710). Me normën penalo juridike *“Përhapja e virusit HIV”*, nga neni 258, i cili sanksionon këdo që duke ditur së është i infektuar me HIV, nuk e zbulon këtë fakt dhe infekton personin tjetër. Siguria shëndetësore rrezikohet edhe nga personat e infektuar me sëmundje ngjitëse, andaj lidhur me këtë rrezik norma penale juridike *“Punësimi i personave të infektuar me sëmundje ngjitëse”* nga neni 259, inkriminon çdo person i cili në kundërshtim me ligjet e shëndetësisë, në spital, në maternitet të spitalit, në shkollë, në restaurant apo në punëtori ose në organizatë biznesi apo në ndonjë vend të ngjashëm pune, ku përpunohen artikujt ushqimorë apo ku kryhen shërbime higjienike, e punëson apo e mban në punë personin për të cilin e di se lëngon nga sëmundja ngjitëse dhe me këtë shkakton përhapjen e sëmundjes ngjitëse.

Grupi i dytë i veprave kanë të bëjnë më shumë me privimin e individit nga qasja në shërbime adekuate shëndetësore dhe mos nënshtrimi ndaj eksperimenteve të ndryshme mjeksore. Normat penale më domethënëse, që mbrojnë këtë fushë janë: *“Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor”*, nga neni 260 të KPRK-së, inkriminon mjekun i cili me rastin e dhënies së ndihmës mjekësore përdor haptas një mjet apo metodë të papërshtatshme të mjekimit ose nuk përdor masat përkatëse higjienike dhe me këtë shkakton keqësimin e

gjendjes shëndetësore të personit, dënohet me burgim deri në 3 vjet. Shëndeti publik mbrohet me ligj edhe nga trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor. Andaj, ligjdhënësi nën kushtet e caktuara, ka paraparë përgjegjësinë penale për mjekimin e pandërgjegjshëm, respektivisht për përdorimin e mjetit apo metodës së papërshatshme të mjekimit, për mos përdorimin e masave përkatëse higjienike. Kjo normë penale përcakton se mjeku mund të jetë kryes i veprës penale (Salihu, 2014:717). Nëse ekspertët kanë konstatuar se dokumentet mjekësore ofrojnë mundësinë e shikimit, se çka ka ndodhë me rastin e hyrjes nën anestezi, e që ka rezultuar me ndalimin akut të zemrës, nuk ekziston vepra penale, trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 126 LP të Serbisë (neni 219 Kodit Penal të Kosovës). *Nga arsyetimi*: Të akuzuarve u vihet në barë se me përdorimin haptas të mjetit të papërshtatshëm dhe me metodë të pa përshtatshme kanë ofruar ndihmën mjekësore, në at mënyrë që kanë kryer anestezinë jo adekuate e cila për pasoj ka pas ndaljen akute të punës së zemrës dhe është shkaktuar koma cerebrale e cila ka zgjatë dy orë. Duke e aprovuar mendimin e ekspertit se dokumentacioni ekzistues ofron mundësin e shikimit në atë se çka ka ndodhë me rastin e hyrjes nën anestezi, se për cilën keqësim të gjendjes shëndetësore është fjala dhe për ç'arsye është përdorë terapia e përmendur, drejt ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë kur ka gjet se nuk ka as një provë që do të arsyetonte dyshimin e bazuar se të pandehurit kanë kryer veprën penale të cekur në aktakuzë dhe për këtë arsye drejtë është vepruar kur është hedhë propozim akuza (*Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Beograd Kz. Nr. 3046/91 dt. 17. 12.1991*) (Salihu, 2014:721). Poshtu siguria shëndetësore mbrohet edhe nga mosdhënia e ndihmës mjekësore nga neni 261, e cili inkriminon mjekun mjekun ose punonjësin tjetër shëndetësor, i cili në kundërshtim me detyrën e tij refuzon t'i ofrojë ndihmën mjekësore personit të cilit i nevojitet ndihma e tillë, ndonëse ai është i

vetëdijshëm ose do duhej të ishte i vetëdijshëm se mosveprimi i tillë mund të rezultojë me lëndim të rëndë trupor apo dëmtim të rëndë të shëndetit ose vdekjen e personit. Siguria shëndetit të njëriut, respektivisht siguria shëndetësore të qytetarit mbrohet edhe me normën penalo juridike “*Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike*” nga neni 262, që inkriminon këdo që pa pasur kualifikimet profesionale apo autorizimet ligjore, kryen trajtime mjekësore, shërbime farmaceutike ose angazhohet në aktivitete tjera mjekësore për të cilat me ligj kërkohen kualifikime të posaçme. Objekti mbrojtës i kësaj norme penale është shëndeti i njëriut. Me dispozita të veçanta është paraparë se shërbimet shëndetësore mund t’i ofrojnë punëtorët shëndetësorë me përgatitje të larta profesionale dhe punëtorët me përgatitje të mesme shkollore (Salihu, 2014:725). Trajtimin mjekësor ose angazhimin në aktivitete tjera mjekësore, nuk mund ta ofrojnë personat të cilët nuk posedojnë kualifikimet profesionale apo autorizime ligjore ngase mund të jetë një formë e mashtrimit dhe atëherë ekziston rreziku real për shëndetin e njerëzve (Salihu, 2014:725). Kjo dukuri është e njohur dhe në popull këta persona njihen si mjekët popullorë.

Siguria njerëzore në shumë mënyra rrezikohet nga mjekët, dhe norma penalo juridike “*Eksperimentet e kundërligjshme mjekësore dhe testimi i barërave*”, nga neni 263 inkriminon këdo që pa autorizim ose në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm kryen eksperimente mjekësore, eksperimente të klonimit të njeriut apo eksperimente të ngjashme në njerëz, dënohet me burgim nga 3 muaj deri në 5 vite. Kjo normë penale, paraqet një vepër të re penale, andaj ligjdhënësi me një inkriminim të këtillë, ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit të njerëzve si objekt grupor i këtij kapitulli (Salihu, 2014:727). Ndërsa, mënyra të kryerjes së kësaj vepre penale janë: eksperimentet mjekësore, eksperimentet mjekësore, eksperimente të klonimit të njeriut apo eksperimente të ngjashme në njerëz dhe testimet

klinike të barnave (Salihu, 2014:727). Kjo normë penale nuk është inkriminuar në Kodet Penale të vendeve në rajon. Norma penalo juridike “*Përgatitja dhe dhënia e pandërgjegjshme e barërave*” nga neni 264, mbrohet qytetarin nga farmacisti personi tjetër që është i autorizuar të përgatisë apo të shpërndajë barëra, i cili i përgatit barërat në kundërshtim me standardet profesionale. Norma penalo juridike “*Transplantimi i kundërligjshëm dhe trafikimi i organeve dhe qelizave njerëzore*”, nga neni 265 inkriminon këdo që pa arsye mjekësore, pa autorizim ose në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm, për qëllim transplatimi merr pjesë të trupit të njëriut me pëlqimin e dhënësit. Norma penalo juridike “*Prodhimi dhe shpërndarja e produkteve të dëmshme mjekësore*”, nga neni 266 inkriminon këdo që prodhon barna të dëmshme ose produkte të tjera mjekësore që janë të dëmshme për shëndetin me qëllim që t’i shesë ato apo në ndonjë mënyrë tjetër t’i vë në qarkullim.

Grupi i tretë ka një ndërlidhje të ngushtë me sigurinë ushqimore të shtjelluar në mënyrë më të zgjeruar në pjesën që i referohet asaj kategorie të sigurisë sidomos në aspekt të kontrollit të cilësisë së ushqimeve. Siguria shëndetësore është ngushtë e lidhur me format e ndryshme të sigurisë e në veqanti me sigurinë ushqimore, mjedisore dhe ekonomike dhe si e tillë edhe problematika e tyre është e gërshetuar.

Përgjithësisht, në raport me inkriminimit të veprave penale që i referohen sigurisë shëndetësore, konstatojmë se siguria shëndetësore e qytetarëve të Kosovës mbrohet mjaftueshëm me norma penalo juridike, të cilat inkriminojnë cenimin e shëndetit të tyre. Ajo që përgjithësisht mungon në Kosovë është një llogaridhënie më e madhe e stafit mjeksor për veprimet e tyre të pandërgjegjshme. Nëse i referohemi p.sh. një rasti të trajtimit të një pacienti, jo në pajtim me mënyrën e paraparë higjenike apo shkencore dhe

nëse për pasojë kemi rrezikimin e shëndetit apo edhe vdekjen e pacientit, atëherë ajo që në përgjithësi paraqet normë të rregullt mjeksore, kalon në dimensionin penal të trajtimit të papërgjegjshëm të pacientit për të cilin ofruesi i atij shërbimi dënohet tashmë jo nga aspekti disiplinor por penalisht. Kjo ka të bëjë me të ashtuquajturën kriminalizim të veprimeve mjeksore, për të cilën dikush duhet të mbahet përgjegjës; dhe është pikërisht edhe kjo një nga fushat në të cilat Kosova nuk ka rezultate, si pasojë e mosndëshkueshmërinë adekuate të përgjegjësve. Krahësuar me vendet më të zhvilluara, në shumë raste në Kosovë, të cilat kanë përfunduar edhe me fatalitet të pacientëve, për fat të keq, nuk kanë rezultuar në një dënim të ashpër të mjekëve, të cilët vazhdojnë ushtrimin e profesionit të tyre përkundër faktit se në kuadër të dënimeve plotësuese të parapara me Kodin penal parashihet edhe dënimi plotësues, Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (KPRK, neni: 66), normë penalo juridike që do të duhej shqiptuar në çdo rast dhe do duhej heq edhe licenca për ushtrimin e atij profesioni.

Në Kosovë janë ende në procedurë e sipër disa raste shokuese të përfshirjes së një numri të madh të mjekëve në trajtim të pandërgjegjshëm të pacientëve me sëmundje kardiovaskulare apo siq njihet në publik si “*Rasti i stendave*” për të cilat mbetet të shihet nëse drejtësia do të thotë fjalën e saj përfundimtare në dhënien e një mësimi të mirë për të gjithë ata që luajnë me fatet dhe mirëqenien e njerëzve.

Për fund, siç theksuam në hyrje të kësaj teme, pashmangshëm, çështjet shëndetësore kanë lidhmëni natyrore me segmentet tjera në kuadër të sigurisë njerëzore. Shëndeti i njeriut është në varshmëri natyrore nga kushtet ekonomike, ushqimi, ambienti në të cilin jetojmë. Instituti Ndërkombëtar për hulumtime të politikave të Ushqimit ka zhvilluar një vizion të një botë 2020 (Pinstруп, 1998:1-10), ku çdo person ka qasje ekonomike dhe fizike

në ushqim të mjaftueshëm për të mbajtur një jetë të shëndetshme dhe produktive, ku kequshqyerja mungon, dhe ku ushqimi efikas vjen nga një kosto e ulët dhe sistemet bujqësore të cilat janë në përputhje me përdorimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore të qëndrueshëm. Mungesa e kushteve elementare, krijon pasoja në shëndetin e njeriut. Si pasojë e ndotjes së ambientit, bombardimeve, mungesës së ujit të pijes dhe të pastrimit, gazrave të ndryshëm të dëmshëm, tek popullata e Kosovës janë në rritje numri i sëmundjeve si leukemia, abortet spontane etj. Me këtë rritet edhe përgjegjësia e shtetit në ofrimin e mbrojtjes adekuate për qytetarët e saj. Çështja e sigurisë shëndetësore që lidhet edhe me sigurinë ambientale, është adresuar edhe nga ana e GJEDNj në rastin *López Ostra v. Spain* dhe raste të ngjajshme në të cilat Gjykata si rregull gjithmonë mundohet të bëjë fillimisht lidhjen kauzale me efektet e ndotjes dhe dëmtimit të shëndetit për të përcaktuar përgjegjësinë e shtetit. Gregoria López Ostra, duke inicuar rastin *López Ostra v. Spain* (1994), ka pretenduar se kundërmimi, zhurma dhe kontaminimi i shkaktuar nga plantacioni i përpunimit të mbetjeve ka shkelur të drejtat e saj sipas nenit 8 dhe nenit 3, si e drejta në integritetin fizik sipas KEDNj. Në konkludim Gjykata ka pranuar se ekspertiza, raportet mjeksore dhe mendimi i ekspertit teknik të dorëzuara të gjitha nga Znj. López Ostra kanë treguar dëm të mjaftueshëm në mbështetje të kërkesës sipas nenit 8 (West, 2015:20).

Mbrojtja e sigurisë shëndetësore, përveç që garantohet me kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe mbrohet me kodin penal të Kosovës, mbrohet edhe përmes ligjeve të veçanta, të cilat garantojnë çështje specifike të sigurisë shëndetësore. Çdo qytetar i Republikës së Kosovës ka të drejtë në kujdes shëndetësor që është i kushtëzuar me gjendjen e tij të shëndetit. Kujdesi shëndetësor adekuat, me qasje në vazhdimësi për të gjithë dhe pa

diskriminim 24 orë në ditë, garantohet me Ligjin Nr.2004/38 për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor. Ndërsa kujdesi shëndetësor emergjent për qytetarët e Republikës së Kosovës garantohet me Ligji Nr.02/L-50 për kujdesin shëndetësor emergjent, si një shërbim emergjent mjekësor me veprimtari me interes të veçantë shoqëror dhe strategjik i cili zbatohet në nivel parësor, dytësor, në qendrat referente për Kosovë në qendrën klinike universitare të Kosovës si dhe në shërbimin emergjent të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Siguria shëndetësore e qytetarëve realizohet edhe përmes mundësimit të sigurimit shëndetësor. Një mbrojtje e tillë në Kosovë, realizohet përmes Ligjit Nr.04/L-249 për sigurimin shëndetësor, të datës: 25.04.2014. Qëllim i këtij ligji është siguri i qasjes universale të qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës ndaj shërbimeve kualitative të kujdesit themelore shëndetësore, me qëllim të përmirësimit të indikatorëve shëndetësor dhe sigurimit të mbrojtjes financiare nga varfërimi për shkak të shpenzimeve të mëdha për kujdesin shëndetësor, nëpërmjet themelimit dhe rregullimit të sistemit publik të sigurimit shëndetësor. Përkundër miratimit të një ligji të tillë, qeveria e Kosovës ka dështuar në jetësimin e dispozitave të këtij ligji, kjo për faktin se siguri shëndetësor në Kosovë ende nuk është bërë i mundur. Kjo ka bërë që qytetarët e Republikës së Kosovës të jenë të vetmit në Evropë që nuk gëzojnë këtë të drejtë.

Ndërsa, përcaktimi i masave për përmirësimin e shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve në punë, rregullohet dhe mbrohet me Ligjin Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, të datës 31.05.2013. Ky ligj përmban parimet e përgjithshme për parandalimin e rreziqeve profesionale, eliminimin e faktorëve të rrezikut dhe aksidenteve, informimit, konsultimit, pjesëmarrjes së balancuar në përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe

shëndetit në punë, trajnimit të të punësuarve dhe përfaqësuesve të tyre, si dhe udhëzimet e përgjithshme për zbatimin e këtyre parimeve.

Baza ligjore për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës, egziston në Ligjin Nr.04/L-125 për shëndetësi, të datës 26.04.2013. Ky ligj ka për qëllim sigurimin e bazës ligjore për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës, përmes promovimit të shëndetit, aktiviteteve parandaluese, dhe ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe kualitative të kujdesit shëndetësor. Garantimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore realizohet përmes inspektimit të vazhdueshëm, të cilën e mundëson zbatimi i Ligjit Nr.02/L-38 për Inspektoriatin shëndetësor. Me këtë ligj mundësohet Inspektimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore, trajtimii pacientëve nga institucionet shëndetësore, raportet e personelit mjekësor ndaj pacientëve; mënyrën e përdorimit të barnave; aplikimin e metodave të parandalimit, diagnostifikimit, terapisë dhe rehabilitimit, mënyrën e reagimit të personelit mjekësor në situata emergjente. Parandalimi i kërcënimit nga sëmundjet ngjitëse, rregullohet me Ligjin Nr. 02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, të datës: 15.05.2008, përmes të cilit përcaktohen sëmundjet ngjitëse si dhe rregullohen aktivitetet për zbulimin në kohë, evidentimin e shfaqjes, parandalimin, ndalimin e përhapjes dhe mjekimin e tyre.

5.5 Politika ndëshkimore si mjet për forcimin e sigurisë njerëzore

Sanksionimi i veprimeve të kundërligjshme është elementi bazë i funksionimit të sundimit të ligjit, në cilindo shtet në botë. Mënyra e përcaktimit të sanksioneve penale, natyrisht ndryshon nga shteti në shtet për nga: mënyra e përcaktimit të sanksionit dhe mënyra e ekzekutimit të tij praktik. Mirëpo një gjë është e sigurt, pa një politikë të mirëfilltë të përgjithshme ndëshkimore në nivel shtetëror, pothuajse bëhet e pamundur

luftimi i dukurive të kundërligjshme. Për më tej, kjo vlen edhe përkundër faktit se Republika e Kosovës, në veçanti me Kodin Penal të vitit 2013, ka ashpërsuar në masë të madhe sanksionet për veprat penale, duke rritur sanksionin deri në burgim të përjetshëm si sanksion maksimal.

Dënimet janë në epiqendër të vëmendjes të së drejtës penale dhe të politikës kriminale, ndërsa çështjet tjera të cilat rregullojnë legjislacionin penal sado të rëndësishme që të jenë, i referohen parakushteve për zbatimin e dënimeve dhe sanksioneve tjera apo çështjeve tjera lidhur me zbatimin e tyre (Salihu, 2014:183). Parashikimi i veprave penale, llojet dhe lartësia e sanksioneve penale për kryesit e veprave penale bazohen në domosdoshmërinë e sanksionit penalo juridik dhe proporcionalitetit të shkallës së rrezikshmërisë për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të vlerave shoqërore (Salihu, 2014:1).

Po pse është e rëndësishme të shtjellohet politika ndëshkimore? Dihet se sanksionimi ka dy qëllime, atë të ndëshkimit individual dhe ndëshkimit me efekt të përgjithshëm.

Qëllimi i parë “Ndëshkimi individual i kryesit”, i referohet asaj se vet kryesi bart pasojat për veprimet e kundërligjshme të kryera nga vet ai. Në këtë mënyrë kryesit i bëhet e ditur se një vepër e kundërligjshme nuk kalon pa u ndëshkuar dhe në këtë formë ndikohet në të që të mos përsërisë veprime të tilla apo të ngjajshme të kundërligjshme.

Qëllimi i dytë “Ndëshkimit me efekt të përgjithshëm”, ka për qëllim që sanksioni të ketë ndikim jo vetëm në kryesit por edhe ndikim të përgjithshëm në shoqërinë, për të parandaluar të tjerët të kryejnë vepra të tilla të kundërligjshme.

Në rast se sanksionet e parapara me legjislacion mbasin të ashpra vetëm në ligjet e shkruara dhe nuk gjejnë aplikim praktik, apo edhe kur zbatimi i tyre varion aq shumë sa që

ka një mospërputhje të plotë në mes; shqiptimit të dënimit ndaj kryesve të veprave të ngjashme në të njëjtin vend, atëherë në një formë, vet sundimi i ligjit në vend të vënies së drejtësisë, mohon vet ekzistimin e sundimit të ligjit dhe njëkohësisht shkel edhe parimin e trajtimit të barabartë të individit para ligjit.

Politika e dobët ndëshkimore shkas për shkelje të drejtave të njeriut. Një nga parimet themelore dhe logjike të drejtësisë është se, rastet e ngjashme duhet të trajtohen njësoj (Ashworth, 1992:183). Konsistenca në qasje kërkon që të ketë një uniformitet, qasje konsistente ndaj vendimeve të dënimit nëpër të gjitha rastet. Prandaj, diskrecioni për dënim duhet të ushtrohet në mënyrë parimore. Duhet të jetë një qasje koherente gjyqësore në ushtrimin e diskrecionit të dënimit, i cili kërkon që të gjitha vendimet të bazohen në standardet e përbashkëta - parimet e përgjithshme themelore - të cilat janë aplikuar në mënyrë uniforme në faktet e çdo rasti (Ashworth, 1994:9). Për sa i përket matjes së dënimit Statuti (neni 78) i Gjykatës së përhershme penale ndërkombëtare, në mënyrë parimore është përcaktuar edhe mënyra e matjes së dënimit (Sandifer, 1939:211), ndërsa më për së afërmi kjo çështje është përcaktuar me rregullat e procedurës dhe të administrimit të provave (Salihu, 2014:328) respektivisht në nenin 101 “Dënimet”, në të cilën thuhet se: Dhoma Gjyqësore në përcaktimin e dënimit, merr parasysh: çfarëdo rrethane rënduese; çfarëdo rrethane lehtësuese duke përfshirë bashkëpunimin thelbësor të personit të shpallur fajtor me Prokurorin, para ose pas shpalljes së fajësisë; praktikën e përgjithshme të dënimeve me burgim në gjykatat e ish-Jugosllavisë; pjesën tashmë të kryer të dënimit që i është dhënë personit të shpallur fajtor nga një gjykatë e cilitdo shtet për të njëjtën vepër, (OKB, IT/32/Rev. 48 19 nëntor 2012) siç potencohet në paragrafin 3 të Nenit 10 të Statutit (Cassese, 2002:1535-1557). Sipas Hartit: “Cilësia kryesore që duhet të çojë në zbutjen e

dënimit, vjen nga krijimi i arsyeshëm i bindjes se për personin e akuzuar ishte shumë e vështirë të ndiqte kërkesat e ligjit, krahasuar me persona që gjenden në rrethana të tjera më normale për zbatimin e ligjit (Arendt, 2006:243-304).

Duhet patur në konsideratë se, një nga parimet fundamentale të drejtësisë është konsistenca andaj, edhe sistemi duhet ndërtuar në atë mënyrë që të ofrojë më shumë njëtrajtshmëri në politikën ndëshkimore në tërë Kosovën, për të mos hasur në mospërputhshmëri që mund të konsistojnë edhe në shkelje të të drejtave të njeriut. Një rekomandim i tillë është përfshirë edhe në Rekomandimin e Këshillit të Europës në preambulën e të cilit thuhet se: *“Rekomandohen që qeveritë e shteteve anëtare, gjatë marrjes parasysh të parimeve kushtetuese dhe traditës ligjore, dhe në veçanti pavarësisë së gjyqësorit, të ndërmarrin masat e duhura për promovimin e parimeve dhe rekomandimeve të dhëna në shtojcën e këtij Rekomandimi, për të iu shmangur mospërputhjet e pajustificueshme gjatë caktimit të dënimit”*.

Politika e dobët ndëshkimore rrit kërcënimet e sigurisë njerëzore. Gjykatat në Republikën e Kosovës kanë dështuar në formimin e një politike konsistente dhe të fuqishme ndëshkimore. Ato dështojnë të vlerësojnë rrethanat që janë relevante për zbutjen e apo ashpërsimin e dënimit për veprën penale kur caktojnë dënimin për të pandehurit dhe për pasojë përkundër faktit se nga viti 2013 dënimet janë ashpërsuar, dënimet e shqiptuara nga gjykatat vazhdojnë të mbesin shumë të ulëta. Gjykatësit me rastin e matjes së dënimit në shumë raste dënojnë nën minimumin e paraparë me ligj dhe këtë e bëjnë kryesisht duke shfrytëzuar mundësinë e aplikimit të rrethanave lehtësuese. Sipas raportit të OSBE-së ka një mospërputhshmëri mes gjykatave të ndryshme në Kosovë në shqiptimin e dënimeve të kryesve. Dënimet penale duhet të përforcohen dhe të zgjerohen dhe jo të kufizohen, përveç

arsyeve tjera edhe për të ofruar nxitje që i inkurajojnë të pandehuri për të bashkëpunuar me prokurorin, konkretisht që i akuzuari duke pranuar fajin, të lidh marrëveshje për pranimin e fajësisë, (OSBE, 2010:16) dhe në këmbim të përfitoj lehtësira të caktuara të cilat lidhen me dënimet, përkatësisht me sanksionet penale (Krasniqi, 2012:83).

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës ka hartuar një “Qarkore” për gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë të Kosovës, përmes së ciës ka kërkuar nga gjyqtarët racionalizim më të madh gjatë matjes së dënimeve, sidomos në aspekt të vlerësimit të rrethanave rënduese dhe lehtësuese, të cilat në masë të madhe kanë ndikuar në uljen e dënimeve në Kosovë. Nëse një politikë e ulët ndëshkimore do të vazhdojë edhe për një kohë atëherë, ne mund ta dërgojmë vendin drejt një anarkije, pasi në një anë kryesisht shohin se veprimet e tyre nuk po ndëshkohen apo po ndëshkohen fare pak dhe këtë pasivitet apo heshtje të drejtësisë mund ta konsiderojnë si shtysë për vazhdimin e veprimeve të kundërligjshme pa frikë për pasojën. Efekti tjetër konsiston në atë se palët e dëmtuara në këtë rast duke humbur çdo shpresë në sistemin e drejtësisë mund të vendosin për vetëdrejtësi, duke rrezikuar në këtë formë sigurinë e vendit dhe qytetarëve dhe mirëqenien e tyre.

KAPITULLI VI: SIGURIA NJERËZORE SIPAS LEGJILACIONIT TË DISA SHTETEVE: VËSHTRIM JURIDIK KRAHASUES

6.1 Vështrim historik

Parim kryesor i çdo shoqërie demokratike do të duhej të jetë siguria dhe mirëqenia e qytetarëve, për vet faktin se, edhe pse popujt e ndryshëm kanë shumë dallime për nga gjuha, kultura, tradita etj, ata nuk kanë dallime për nevojat që lidhen me sigurinë njerëzore, e të cilat duhet të mbrohen nga shteti. Me qëllimin e vlerësimit të asaj se ku gjendet Republika e Kosovës si shte, në aspektin e normave ligjore që mbrojnë sigurinë njerëzore, në vijim do të mundohemi të japim një pasqyrim të legjislacionit të disa shteteve të rajonit dhe më gjerë. Shtetet të cilat do të studiohen në këtë punim, si: Sllovenia, Kroacia, Serbia dhe Kosova, janë mvetësuar pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Meqenëse, këto shtete kanë qenë pjesë e një strukture të përbashkët shtetërore, domosdoshmërisht edhe kultura ligjore ka qenë deri diku e përafërt. Edhe profesionistët ligjor në Kosovë janë mësuar që analizën dhe interpretimin e normave penale, si të së drejtës materiale ashtu edhe të së drejtës procedural, ta interpretojnë bazuar në Komentaret e ndryshëm të cilët kryesisht janë punuar nga profesionistët dhe akademikët në Kroaci dhe Serbi.

Zhvillimet e viteve të 90-ta dhe ndarja më vete e secilës njësi konstituive të ish-Jugosllavisë, kanë bërë që në shumë aspekte legjislacioni i shteteve të krijuara, të reja, të ndryshojë drejtim. Disa nga këto shtete kanë qenë edhe ashtu më të zhvilluara edhe nga aspekti legjislativ, duke qenë se edhe në kohën e Jugosllavisë kanë pasur tërë infrastrukturën e tyre të rregulluar, gjë që nuk mund të thuhet për Kosovën. Kosova gjatë dekadave është mbajtur peng i shumë politikave në ish-Jugosllavi, duke mos i lejuar pavarësinë e saj të plotë. Vendet më të zhvilluara, të cilat edhe të parat u shkëputën nga shteti artificial i ish-

Jugosllavisë, si Sllovenia dhe Kroacia kanë filluar menjëherë procesin e integritetit të tyre në BE. Sllovenia e cila edhe ashtu ka qenë mjaft e avansuar me vite arriti statusin e shtetit anëtar të BE në maj të vitit 2004 ndërkaj Kroacia fitoi anëtarësinë në korrik të vitit 2013. Serbia në anën tjetër është pretendente për anëtarësim në BE, edhe pse duket sikur mosnjohja e realitetit të ri të Republikës së Kosovës nga ana e Serbisë është pikërisht arsyeja që e ngadalëson dhe pengon Serbinë në procesin e anëtarësimit në BE-. Këto shtete janë marrë si krahasim, pikërisht për shkak të këtyre karakteristikave të sipërpërmendura. Më shumë për të treguar se edhe Kosova është në një rrugë të drejtë sa i përket rregullimit ligjor penal, por paralelisht për të treguar se sa shumë larg dhe sa shumë punë kërkohet që ky rregullim penal ligjor të zbatohet në praktikë. Të gjitha këto ndryshimet nëpër të cilat ka kaluar Kosova në këto 17 vitet e pasluftës kanë krijuar edhe një lëmsh të rregullimit ligjor dhe praktikave, të cilat jo rrallëherë duken të pazgjidhshme. Gjersa vendet si Sllovenia, Kroacia e definitivisht edhe Gjermania ofrojnë një nivel të lartë të sigurisë njerëzore, në Kosovë siguria njerëzore shpesh është një koncept që hudhet plotësisht në harresë. Diktuar nga politikat integruese dhe politikat e agjendat e qeverive që shkojnë e vijnë, çështja e sigurisë individuale e qytetarit, mirëqenia dhe ruajtja e dinjitetit të qytetarit ka mbetur në fund të hallkës së rregullimit praktik. Çështje shumë absurde është fakti se banorët e Kosovës janë të vetmit qytetarë në shtetet e rajonit, të cilët nuk gëzojnë sigurimin shëndetësor. Gjendja e rënduar ekonomike ka shtyer një numër të madh të qytetarëve të zgjedhin rrugë ilegale për të emigruar, e kur kësaj i shtohen edhe përplasjet e mëdha politike ndërpartiake, atëherë duket se për brengat e qytetarëve nuk ka vend në politikat shtetërore. Me gjithë ndihmën dhe prezencën ndërkombëtare, Kosova do duhej të ishte zhvilluar shumë më tepër se disa shtete të rajonit, por për fat të keq nuk ka ndodhur. Ajo

që gjithmonë potencohet është mangësitë që ka Kosova në raport me vendet tjera sa i përket zbatimit praktik të këtij legjislacioni. Gjersa në vendet si Kroacia kemi rezultate të prekshme sa i përket psh.: Luftimit të korrupsionit në nivel të lartë me arrestimin e ish-kryeministrit të Kroacisë, z. Ivo Sanader, një gjë e tillë në Kosovë, duket e paarritshme dhe pothuajse e parealizueshme. Është një numër i madh i qeveritarëve dhe ish-qeveritarëve, pasuria e të cilëve ka arritur shuma marramendëse, e megjithatë segmenti i sundimit të ligjit dështon t'i mbajë përgjegjës të njëjtit dhe të realizoj konsfiskimin e pasurisë së tyre të fituar në mënyrë të paligjshme.

Në një vend ku sundimi i ligjit qalon, është vështirë të flitet për një koncentrim të shtetit në sigurinë njerëzore apo në sigurinë e individit, por gjithçka drejtohet kryesisht në atë çfarë është e rëndësishme për politikën në përgjithësi, e më pak për atë se për çfarë ka nevojë popullata për plotësimin e nevojave të sigurisë njerëzore. Megjithatë, me frymën e një pesimizmi optimishtë, themi se ka shpresë për këtë vend të vogël, i cili si një fëmijë që mbështetet në ndihmën e prindërve për të ecur drejtë, edhe Kosova po mundohet të forcohet në këmbë të veta, duke u munduar të bëjë reforma për përmirsimet që i duhen këtij vendi. Vitet në vijim do të jenë një test për shtetin e Kosovës, për të parë se sa realisht shteti do të mendojë për qytetarët e vet dhe kur përfundimisht do të mendojë të ju ofrojë sigurinë që ata meritojnë pas gjithë atyre peripetive shekullore.

6.2 Kundërpërgjigjet shtetërore

Nevoja për siguri njerëzore, është e njëjtë për të gjithë qytetarët, dhe jo vetëm në shtetet demokratike, por edhe në diktatura edhe pse në këtë të dytën janë të varur nga çka ofron shteti. Analiza në vijim, lidhur me legjislacionin e disa shteteve të rajonit dhe më gjerë, do të fokusohet më tepër në përgjigjet që parashohin këto shtete ndaj kërcënimeve që

rezikojnë sigurinë njerëzore në ato shtete përmes inkriminimit penal. Analiza nuk lëshohet në vlerësim të zbatimit praktik të këtyre dispozitave, kjo për faktin se një analizë e tillë e gjithmbarshme e legjislacionit dhe aspektit praktik do të kërkonte një studim më të thellë të secilit segment veç e veç. Këto dispozita do të shikohen edhe në raport me mbrojtjen ligjore që ofrohet në Kosovë, për të bërë një vlerësim edhe të zbrazëtirave potenciale ligjore në Kosovë të cilat do të mund të inkorporohen në të ardhmen për të siguruar një infrastrukturë sa më të kompletuar ligjore, duke marrë për bazë mbrojtjen që ofrojnë këto shtete për qytetarët e vet.

Normat ndërkombëtare që i referohen të drejtës së qytetarëve për siguri njerëzore janë çdo herë në evoluim e sipër, megjithatë secili nga shtetet që do të merren si shembuj më poshtë duke qenë se janë pjesë e strukturës së BE-së ose në proces të integritimit, andaj edhe kundërpërgjigja që këto shtete i japin kërcënimit të sigurisë njerëzore do të duhej të ishte në hap me këto zhvillime. Megjithatë, se sa kjo ndodh, mbetet të shihet në analizën e mëposhtme të legjislacioneve të disa shteteve.

6.2.1 Slovenia

Republika e Slovenisë është pjesë e shteteve të Bashkimit Evropian që nga viti 2004 andaj edhe parimet kushtetuese në këtë shtet janë në frymën e respektimit të parimeve të drejtave të njeriut, të cilat i promovon edhe BE-ja, andaj edhe siguria e qytetarëve të saj është e drejtë e rregulluar me kushtetutë. Vlen të theksohet se Kushtetuta e Republikës së Slovenisë, është një ndër ato kushtetuta të cilata garantojnë shumë të drejtat dhe liri të njeriut, dhe në këtë kontekst mbron edhe segmentet e sigurisë njerëzore. Është shumë interesant mbrojtja përmes kushtetutës së drejtave të veçanta të komuniteteve kombëtare

autoktone Italiane dhe Hungareze dhe të drejtat dhe statusi i veçantë kushtetues i komunitetit Rom në Republikën e Slovenisë. Në vazhdim (në tabelë) pasqyrojmë normat kushtetuese përmes të cilave mbrohen segmentet e sigurisë njerëzore.

SIGURIA	KËRCËNI MET	MBROJTJA KUSHTETUESE (NENI)
Personale	Dhuna fizike dhe krimi	Moscënimi jetës njerëzore (K.SL. neni 17); Ndalimi i torturës (K.SL. neni 18); Mbrotja e lirisë personale (K.SL. neni 19); Liria e lëvizjes (K.SL. neni 32); E drejta për dinjitet personal dhe siguri (K.SL. neni 34); Paprekshmëria e banimit (K.SL. neni 36); Mbrotjtja e të dhënave personale (K.SL. neni 38).
	Terrorizmi	Moscënimi jetës njerëzore (K.SL. neni 17); E drejta për dinjitet personal dhe siguri (K.SL. neni 34).
	Dhuna në familje	Barazia para ligjit (K.SL. neni 14); Moscënimi jetës njerëzore (K.SL. neni 17); Ndalimi i torturës (K.SL. neni 18); Mbrotja e lirisë personale (K.SL. neni 19); E drejta për dinjitet personal dhe siguri (K.SL. neni 34); Martesa dhe familja (K.SL. neni 53); Të drejtat e fëmijëve (K.SL. neni 56).
	Punësimi i fëmijëve	Mbrotja e lirisë personale (K.SL. neni 19); Martesa dhe familja (K.SL. neni 53); Të drejtat dhe detyrimet e prindërve (K.SL. neni 54); Të drejtat e fëmijëve (K.SL. neni 56).
Bashkësisë	Tensionet ndër-etnike, fetare të identitetit	Barazia para ligjit (K.SL. neni 14); Moscënimi jetës njerëzore (K.SL. neni 17); Ndalimi i torturës (K.SL. neni 18); Mbrotja e lirisë personale (K.SL. neni 19); E drejta për dinjitet personal dhe siguri (K.SL. neni 34); Liria e shprehjes (K.SL. neni 39); Liria ndërgjegjjes (K.SL. neni 40); E drejta e asocimit (K.SL. neni 42); Shprehja e përkatësisë kombëtare (K.SL. neni 61); E drejta për përdorimin e një gjuhe dhe shkrimi (K.SL. neni 62); Të drejtat e veçanta të komuniteteve kombëtare autoktone Italiane dhe Hungareze (K.SL. neni 64); Të drejtat dhe statusi i veçantë i komunitetit Rom në Sloveni (K.SL. neni 65).
Mjedisore	Degradimi dhe ndotja	Moscënimi jetës njerëzore (K.SL. neni 17); Mjedisi i shëndetshëm për jetesë (K.SL. neni 72).
Ekonomik e	Papunësia dhe varfëria e vazhdueshm	Barazia para ligjit (K.SL. neni 14); Mbrotjtja e personalitetit dhe dinjitetit njerëzor (K.SL. neni 20); E drejta për dinjitet personal dhe siguri (K.SL. neni 34); Liria e punës (K.SL. neni 49); Siguria e punësimit (K.SL. neni 66).
Ushqimore	Skamja, uria dhe kequshqyerja	Barazia para ligjit (K.SL. neni 14); Moscënimi jetës njerëzore (K.SL. neni 17); E drejta për dinjitet personal dhe siguri (K.SL. neni 34); Liria e punës (K.SL. neni 49); E drejta për sigurim social (K.SL. neni 50); Të drejtat e fëmijëve (K.SL. neni 56).

Shëndetësore	Sëmundjet vdekjeprurëse	Moscënimi jetës njerëzore (K.SL. neni 17); E drejta për dinjitet personal dhe siguri (K.SL. neni 34); Të drejtat e fëmijëve (K.SL. neni 56);
	Mungesa e qasjes në kujdesin shëndetësor	Barazia para ligjit (K.SL. neni 14); Moscënimi jetës njerëzore (K.SL. neni 17); E drejta për dinjitet personal dhe siguri (K.SL. neni 34); E drejta për kujdesin shëndetësor (K.SL. neni 51); Të drejtat e fëmijëve (K.SL. neni 56);
	Ushqim të pasigurt	Barazia para ligjit (K.SL. neni 14); Moscënimi jetës njerëzore (K.SL. neni 17); E drejta për dinjitet personal dhe siguri (K.SL. neni 34).
Politike	Represioni politik; dhe Abuzimet e të drejtave të njeriut	Barazia para ligjit (K.SL. neni 14); Moscënimi jetës njerëzore (K.SL. neni 17); Ndalimi i torturës (K.SL. neni 18); Mbrojtja e lirisë personale (K.SL. neni 19); Urdhrat dhe kohëzgjatja e paraburgimit (K.SL. neni 20); Barazia e mbrojtjes e të drejtave (K.SL. neni 22); E drejta për mbrojtje gjyqësore (K.SL. neni 23); E drejta për mjete juridike (K.SL. neni 25); E drejta e kompenzimit (K.SL. neni 26); Prezumimi i pafajësisë (K.SL. neni 27); Garancitë ligjore në procedurën penale (K.SL. neni 28); Paprekshmëria e banimit (K.SL. neni 36); Mbrojtja e fshehtësisë së korrespondencës dhe mjeteve të komunikimit (K.SL. neni 37); Mbrojtja e të dhënave personale (K.SL. neni 38); Liria e shprehjes (K.SL. neni 39); Liria ndërgjegjës (K.SL. neni 40); E drejta e asociimit (K.SL. neni 42); E drejtë peticionit (K.SL. neni 45); E drejta e personave me aftësi të kufizuar (K.SL. neni 52); Të drejtat e fëmijëve (K.SL. neni 56); Shprehja e përkatësisë kombëtare (K.SL. neni 61); E drejta për përdorimin e një gjuhe dhe shkrimi (K.SL. neni 62); Të drejtat e veçanta të komuniteteve kombëtare autoktone Italiane dhe Hungareze (K.SL. neni 64); Të drejtat dhe statusi i veçantë i komunitetit Rom në Sloveni (K.SL. neni 65); E drejta e grevës (K.SL. neni 77).

Figura 6.2.1.1 Kërcënimet e sigurisë njerëzore në Sloveni dhe mbrojtja kushtetuese

Segmenti i sigurisë personale në parim kërcënohet nga *dhuna fizike dhe krimi, terrorizmi me ndikim në sigurinë personale, dhuna në familje dhe punësimi i fëmijëve*. Kodi Penal i Sllovenisë ka inkriminuar cenimin e sigurisë personale nga këto kërcënime. Në vazhdim do të përcaktojmë se cilat norma penalo juridike nga Kodit Penal i Sllovenisë mbrojnë qytetarët nga kërcënimet që cenojnë sigurinë personale.

Dhuna fizike dhe krimi, në vazhdimësi cenon sigurinë personale andaj edhe ligjvënësit kanë inkriminuar në Kodin Penal format me të cilat cenohet siguria personale. Normat penalo juridike nga Kapitulli 15 të emërtuar “*Veprat penale kundër jetës dhe trupit*”, inkriminojnë cenimin e jetës dhe trupit të qytetarëve, duke përfshirë: *Vrasja* (neni

127); *Vrasja vullnetare* (neni 128); *Vrasja nga pakujdesia* (neni 129); *Vrasja e fëmijëve* (neni 130); *Lëndimi i lehtë trupor* (neni 133); *Lëndimi i rëndë trupor* (neni 134) dhe *Dëmtimi veçanërisht i rëndë trupor* (neni 135).

Normat penalo juridike nga Kapitulli 19 të emërtuar “*Veprat penale kundër integritetit seksual*” inkriminojnë cenimin e integritetit seksual, duke përfshirë: *Përdhunimi* (neni 180); *Dhuna seksuale* (neni 181); *Abuzimi seksual ndaj personit të pambrojtur* (neni 182); *Abuzimi seksual me personin më të ri se 15 vjet* (neni 183) dhe *Shkelja e integritetit seksual nga shpërdorim i pozitës* (neni 184).

Normat penalo juridike nga kapitulli 23 të emërtuar “*Veprat penale kundër pasurisë*” inkriminojnë cenimin e pasurisë së qytetarëve, duke përfshirë: *Vjedhja* (neni 211); *Vjedhja e madhe* (neni 212); *Plaçkitja* (neni 213); *Mashtrimi* (neni 217); *Zhvatja dhe shantazhi* (neni 218); *Dëmtimi i objektit të tjetrit* (neni 224); *Zjarrvënia* (neni 226); dhe *Dëmtimi i banesave dhe ndërtesave afariste dhe lokaleve* (neni 227). Normat penalo juridike nga Kapitulli 30 të emërtuar “*Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të qytetarëve dhe pronës*” inkriminojnë cenimin e sigurisë dhe pronës, duke përfshirë: *Shkaktimi i rrezikut publik* (neni 317) dhe *Shkaktimi i rrezikut përmes materialit neuklear* (neni 319).

Terrorizmi, si kërcënimi i dytë (*pas dhunës fizike dhe krimi*) i sigurisë personale mbrohet me normën penalo juridike *Terrorizmi ndërkombëtar* (neni 388), nga kapitulli 35 i emërtuar “*Veprat penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare*”. Njëjtë sikur edhe në legjislacionin penal të Kosovës dhe të vendeve tjera të rajonit dhe më gjerë kjo vepër inkriminohet edhe në aspektin e kërcënimit të sigurisë së përgjithshme dhe në atë të sigurisë së individit.

Dhuna në familje, si kërcënim në dukje i lehtë por në shtrirje kohore shumë i rrezikshëm meqenëse rrezikon mirëqenien e familjes dhe në vehte përmban kërcënimin e shkatërrimit të familjeve. Dhuna në familje mbrohet me normat penalo juridike nga kapitulli 21 të emërtuar “*Veprat penale kundër martesës, familjes dhe fëmijëve*”, të cilat inkriminojnë këto forma të kërcënimit: *Neglizhimi dhe keqtrajtimi i të miturve* (neni 201); *Shkelja e detyrimeve familjare* (neni 202) dhe *Mospagesa e vazhdueshme e alimentacionit* (neni 203).

Punësimi i fëmijëve, është një kërcënim permanent që rrezikon rritën normale dhe arsimimin e fëmijëve. Kodi penal i Slovenisë ka inkriminuar dy forma punësimit të fëmijëve, respektivisht norma: *Vendosja në kushtet e skllavërisë* (neni 387) nga kapitulli 35 “*Veprat penale kundër njerëzimit dhe dhe të drejtës ndërkombëtare*”, si dhe norma: *Neglizhimi dhe keqtrajtimi i të miturve* (neni 201) nga kapitulli 21 të emërtuar “*Veprat penale kundër martesës, familjes dhe fëmijëve*”.

Segmenti i sigurisë së bashkësisë kërcënohet nga tensionet ndër-etnike, fetare dhe tenseve tjera në bazë të identitetit. Siguria në bashësi është i mbrojtur me norma penalo juridike në dy kapituj të Kodit Penal i Slovenisë, respektivisht me normën penalo juridike; *Shkelja e statusit të barazisë* (neni 141) nga kapitulli 16 “*Veprat penale kundër të drejtave të njeriut dhe lirive*”, si dhe normën penalo juridike; *Pengimi i ceremonive fetare* (neni 314) nga kapitulli 29 “*Veprat penale kundër rendit dhe qetësisë publike*”. Gjersa norma e parë mbron statusin e barazisë në aspektin e përkatësisë etnike, fetare dhe racore etj, norma e dytë mbron lirinë e qytetarëve nga çfarëdo lloj tensioni fetar.

Norma penalo juridike “*Shkaktimi i rrezikut publik*” (KPSI, neni 314), mbron sigurinë në bashkësi duke inkriminuar shkaktarin e një rreziku të përgjithshëm dhe në këtë

mënyrë përmes kësaj norme penalo juridike mbronë sigurinë e një komuniteti apo bashkësie. Kjo vepër penale konsumohet kur shkaktohet rreziku i përgjithshëm për jetën apo për pasurinë në vëllim të madh me veprim të rrezikshëm ose me mjete të rrezikshme apo me veprim të palejueshëm, në raport me pajisjet që shërbejnë për mbrojtje nga rreziqet e tilla. Kjo vepër penale mund të shkaktohet me zjarr, vërshim, armë, helm, eksploziv, gaz helmues, rrezatim jonizues, forcë mekanike, energji elektrike ose ndonjë energji tjetër. Në këtë kontekst konstatohet se për të egzistuar vepra penale e shkakimit të rrezikut të përgjithshëm, nuk është e domosdoshme që, si pasojë e veprimit të ndërmarrë, të jetë shkaktuar dëmi pasuror; është e mjaftueshme që, për shkak të sjelljes së kryesit, është shkaktuar rreziku konkret për pasurinë në vëllim të madh. Aktgjykimi i Gjykatës së lartë Lubllanë, kp-1266/93. Për dallim nga shtetet si Bosnia dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia dhe Serbia, në Slloveni çështjet ndër-etnike janë shumë më pak të shprehura.

Segmenti i sigurisë mjedisore, rrezikohet nga degradimi dhe ndotja e mjedisit dhe burimeve, si dh fatkeqësitë natyrore. Normat penalo juridike nga kapitulli 32 “Veprat penale kundër mjedisit, hapësirë dhe burimeve natyrore”, mbrojnë mjedisin përmes inkriminimit të kërcënimeve, duke përfshirë: Dëmtimin dhe shkatërrimin e mjedisit dhe hapësirës (neni 333); Zhvlerësimi i mjedisit nga një automjet (neni 334); Sjellja e substancave të rrezikshme në vend (neni 335); Hedhja e paligjshme e substancave të rrezikshme (neni 336); Përvetësim i paligjshëm i pronës reale (neni 339); Shkatërrimi i plantacioneve me agjentë të dëmshëm (neni 340); Shkatërrimi i pyjeve (neni 341) dhe Transmetimi i sëmundjeve ngjitëse në kafshë dhe bimë (neni 345).

Segmenti i sigurisë ekonomike, kërcënohet nga papunësia dhe varfëria e vazhdueshme. Këto kërcënime mbrohen me dy norma penalo juridike nga dy kapituj të

kodit penal të Slovenisë. Normat penalo juridike; *Shkelja e të drejtave të punësimit ose papunësisë* (neni 206) nga kapitulli 22 i emërtuar “*Veprat penale kundër punësimit dhe sigurimit social*” si dhe norma penalo juridike; *Parandalimi i kthimit në punë* (neni 292) nga kapitulli 28 të emërtuar “*Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë*”. Të dy këto norma kanë për objekt mbrojtës barazisë në punësim me qëllim të sigurimi të egzistencës ekonomike personale dhe familjare.

Segmenti i sigurisë ushqimore, kërcënohet nga skamja, uria dhe keq ushqyerja. Kodi penal i Slovenisë ka inkriminuar shkeljen e të drejtave lidhur me sigurimin social (neni 209) nga kapitulli 22 “*Veprat penale kundër punësimit dhe sigurimit social*”. Kjo normë penale mbron qytetarin nga kërcënimi që mund të prodhon cenimi i sigurimit social përmes të cilit qytetari i gëzon të mirat financiale sociale për të siguruar egzistencën ekonomike personale dhe familjare në rastet e papunësisë dhe varfërisë.

Segmenti i sigurisë shëndetësore, sikur edhe segmentet tjera të sigurisë njerëzore garantohen edhe përmes Kushtetutës së vendit e cila garanton çdo person në të drejtën për kujdesin shëndetësor sipas kushteve të parapara me ligj dhe se askush nuk mund të detyrohet t’i nënshrohet trajtimit mjekësor përveç rasteve të parashikuara me ligj. Në aspektin penal kjo siguri mbrohet me norma penalo juridike nga Kodi penal i Slovenisë.

- *Sëmundjet vdekjeprurëse infektive*, si kërcënim i shëndetit të qytetarëve mbrohet me normën penalo juridike: “*Përhapja e sëmundjeve ngjitëse*” (neni 188) nga kapitulli 20 i emërtuar “*Veprat penale kundër shëndetit publik*”.

- *Mungesa e qasje në kujdesin themelore shëndetësor*, për qytetarët e Slovenisë inkriminohet me dy norma penalo juridike; “*Dështimi për të ofruar ndihmën mjekësore*”

(neni 189) dhe “Neglizhenca në trajtimin mjekësor” nga kapitulli 20 i emërtuar “Veprat penale kundër shëndetit publik”.

- Ushqimi i pasigurt, është kërcënim i cili në vazhdimësi rrezikon jetën dhe shëndetin e qytetarëve. Cenimi i ushqimit të sigurtë inkriminohet me norma penalo juridike në dy (2) kapituj të kodit penal të Slovenisë. Kapitulli 20 i emërtuar “Veprat penale kundër shëndetit publik”, përmban normat penale që cenojnë ushqimin e sigurtë, respektivisht; “Prodhimi dhe tregtimi i ilaçeve të dëmshme mjekësore” (neni 193); “Prodhimi dhe tregtimi i ushqimit të dëmshëm mjekësor dhe produkteve tjera” (neni 194); dhe “Inspektimi i pakujdesëm i mishit të destinuar për konsum” (neni 195). Poashtu, kapitulli 32 i emërtuar “Veprat penale kundër mjedisit, hapësirës dhe burimeve natyrore” përmban normat penalo juridike që cenojnë sigurinë e kualitetit të ujit të pijshëm dhe ushqimit, respektivisht normat penalo juridike; “Ndotja e ujit të pijshëm” (neni 337) dhe “Ushqimi i ushqimit dhe tagjise” (neni 338).

Segmenti i sigurisë politike kërcënohet nga represioni politik dhe abuzimet e të drejtave të njeriut. Këto kërcënime që cenojnë të liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit mbrohen përmes normave penalo juridike, në kuadër të tre (3) kapitujve të Kodit penal të Slovenisë, Norma penalo juridike “Pengimi ose ndërprerja e tubimit publik” nga kapitulli 16 i emëruar “Veprat penale kundër të drejtave të njeriut dhe lirive”, mbrohen qytetarët nga represioni politik. Abuzimet me të drejtat e njeriut inkriminohen në kuadër të dy (2) kapitujve. Kapitulli 26 “Veprat penale kundër detyrave zyrtare dhe autorizimeve publike” përfshinë këto norma penalo juridike: “Shpërdorimi i Zyrës së detyrave zyrtare” (neni 261); “Shpërdorimit të detyrës në zyrë” (neni 262); “Zbulimi i sekretit” (neni 266); “Ndërmjetësimi i paligjshëm” (neni 269); “Shkelja e dinjitetit njerëzor nga shpërdorimi i

pozitës zyrtare” (neni 270); “Marrja e deklaratës nën shtrëngim” (neni 271) dhe “Keqpërdorimi i pronës gjatë hetimeve” (neni 272). Ndërsa, kapitulli 16 i emërtuar “Veprat penale kundër të drejtave të njeriut dhe lirive” përmban norma penalo juridike që inkriminojnë abuzimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, respektivisht normat penalo juridike si në vazhdim: “Shkelja e statusit të barabartë” (neni 141); “Shtrëngimi penal” (neni 142); “Heqja e paligjshme e lirisë” (neni 143); “Kidnapimi” (neni 144); “Kërcënimi i sigurisë së personit tjetër” (neni 145); “Keqtrajtimi” (neni 146); “Bastisja e paligjshme e personit” (147); “Përgjimi dhe regjistrimi i paligjshëm i zërit” (neni 148); “Regjistrimi u paligjshëm visual” (neni 149); “Shkelja e fshehtësisë së mjeteve të komunikimit” (neni 150); “Publikimi i paligjshëm i shkrimeve private” (neni 151); “Hyrja e paligjshme në pronë” (neni 152); “Zbulimi i paligjshëm i sekretit” (neni 153); “Abuzimi i të dhënave personale” (neni 154); “Shkelja e të drejtës për ankesë” (neni 155); “Pengimi i publikimit apo transmetimit” (neni 157); “Shkelja e të drejtës së autorit” (neni 158); “Përdorimi i paautorizuar i punës autorit” (neni 159); dhe “Shkelja e të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit” (neni 160).

Sipas raportit të Amnesty International 2015/2016 (AI, 2016:324) i cili në vete përmban vlerësim për secilin shtet mbi shkeljen e të drejtave të njeriut, sa i përket vlerësimit të shkeljeve për Sloveninë, ven në fokus kryesisht qështjen e ndijshme sikur edhe shumë vende të rajonit dhe Evropës sa i përket krizës së refugjatëve nga Siria, ndërkaq në nivel vendi theksi vihet në trajtimin e popullsisë Rome të cilat edhepse gëzojnë një mbrojtje të veçantë kushtetuese, sipas raportit vazhdojnë të ballafaqohen me diskriminimin dhe përjashtimin shoqëror. Në veqanti potencohet mungesa e qasjes në shërbimet bazike si ujë, rrymë, sanitari dhe transport publik. Duke ju referuar gjithnjë diskriminimit raporti

potencon edhe të drejtat e komunitetit LGBTI për të ju lejuar martesat e cila gjë përmes referendumi është hedhur poshtë. Të dyja këto problematikat e fundit hyjnë në kuadër të fushës së sigurisë së bashkësisë për të cilën Slovenisë i duhet të punojë më shumë.

6.2.2 Kroacia

Nisur nga preambula e Kushtetutës, Republika e Kroacisë është konstituuar si shtet qytetar dhe demokratik. Në vet preambulën e kushtetutës thuhet se fuqia e Republikës së Kroacisë derivon nga populli dhe i përket popullit si një bashkësi e njerëzve të lirë dhe të barabartë. Kroacia me 28 korrik 2013 është bërë shteti i 28 i Bashkimit Evropian, ku legjislacioni i BE-së për sigurinë ushqimore bazohet në parimet e përgjithshme që rrjedhin nga Traktati i Bashkimit Evropian dhe Traktati për funksionimin e Bashkimit Evropian si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Në kontekstin e garantimit dhe mbrojtjes kushtetuese të sigurisë njerëzore, konstatojmë se të segmentit të sigurisë njerëzore në Kushtetutën e Kroacisë mbrohen përmes të drejtave dhe lirive të njeriut. Në tabelën në vazhdim prezantojmë të drejtat kushtetuese përmes të cilave garantohen dhe mbrohen segmentet e sigurisë njerëzore në Kroaci.

Segmenti sigurisë	Kërcënimet	Mbrojtja Kushtetuese (neni)
Personale	Dhuna fizike dhe krimi	Liria, moscenimi i pronësisë (K.KR. neni 3); E drejta për jetën (K.KR. neni 21); Paprekshmëria e lirisë dhe dinjitetit (K.KR. neni 22); Paprekshmëria e banimit (K.KR. neni 34); Garantimi dhe mbrojtja ligjore e jetës personale dhe familjare (K.KR. neni 35);
	Terrorizmi	E drejta për jetën (21);
	Dhuna në familje	Paqja (K.KR. neni 3); Barazia (K.KR. neni 14); E drejta për jetën (K.KR. neni 21); Paprekshmëria e lirisë dhe dinjitetit (K.KR. neni 22); Paprekshmëria e banimit (K.KR. neni 34); Garantimi dhe mbrojtja ligjore e jetës personale dhe familjare (K.KR. neni 35); Familja (K.KR. neni 61)
	Punësimi i fëmijëve	Familja (K.KR. neni 61); Mbrojtja e fëmijëve (K.KR. neni 62); Obligimet e prindërve (K.KR. neni 63); Obligimi përgjithshëm

		për mbrojtjen e fëmijëve (K.KR. neni 64);
Bashkësisë	Tensionet ndër-etnike, fetare të identitetit	Barazia kombëtare, paqja (K.KR. neni 3); Barazia (K.KR. neni 14); Të drejtat kombëtare dhe komuniteteve (K.KR. neni 15); Paprekshmëria e lirisë dhe dinjitetit (K.KR. neni 22); Liria e lëvizjes (K.KR. neni 33); Liria e ndërgjegjes dhe fesë (K.KR. neni 40); Barazia fetare (K.KR. neni 41); E drejta e organizimit social (K.KR. neni 59);
Mjedisore	Degradimi dhe ndotja e mjedisit	Mbrojtja e natyrës dhe mjedisit njerëzor (K.KR. neni 3);
Ekonomike	Papunësia dhe varfëria e vazhdueshme	Drejtësia sociale (K.KR. neni 3); E drejta e punës (K.KR. neni 54);
Ushqimore	Skamja, uria dhe kequshqyerja	E drejta për jetën (K.KR. neni 21); Sigurimi i ndihmës për nevojat primare për të papunët (K.KR. neni 57);
Shëndetësore	Sëmundjet vdekjeprurëse infektive	E drejta për jetën (K.KR. neni 21); Mbrojtja shëndetësore (K.KR. neni 23);
	Mungesa e qasjes në kujdesin themelor shëndetësor	E drejta për jetën (K.KR. neni 21); Mbrojtja shëndetësore (K.KR. neni 23); Ndihmë mjekësore (K.KR. neni 27); E drejta në sigurimin social (K.KR. neni 56); sigurimi shëndetësor (K.KR. neni 58); E drejta në jetë të shëndetshme (K.KR. neni 69);
	Ushqim të pasigurt	E drejta për jetën (K.KR. neni 21);
Politike	Represioni politik dhe Abuzimet e të drejtave të njeriut.	Respektimi i të drejtave të njeriut (K.KR. neni 3); Barazia (K.KR. neni 14); Të drejtat kombëtare dhe komuniteteve (K.KR. neni 15); E drejta në mjete juridike (K.KR. neni 18); E drejta për jetën (K.KR. neni 21); Paprekshmëria e lirisë dhe dinjitetit (K.KR. neni 22); Barazia para ligjit (K.KR. neni 25); Parimi i pafajësisë (K.KR. neni 28); paprekshmëria e korrespondencës (K.KR. neni 36); paprekshmëria e të dhënave personale (K.KR. neni 37); Liria e shprehjes (K.KR. neni 38); e drejta e tubimit (K.KR. neni 42); E drejta e asociimit (K.KR. neni 43); E drejta në grevë (K.KR. neni 60);

Figura 6.2.2.1 Kërcënimet e sigurisë njerëzore në Kroaci dhe mbrojtja kushtetuese

Segmentet e sigurisë njerëzore në Republikën e Kroacisë janë të kodifikuara në legjislacionin penal. Kodi Penal i Kroacisë ka inkriminuar cenimin e sigurisë personale nga kërcënimi që sjell dhuna fizike dhe krimi, terrorizmi, dhuna në familje dhe punësimi i fëmijëve. Poashtu, normat penalo juridike penale inkriminojnë cenimin e tensioneve ndër-etnike, fetare dhe tensioneve tjera në bazë të identitetit, të cilat përbëjnë segmentin e sigurisë së bashkësisë. Normat penalo juridike inkriminojnë kërcënimin e sigurisë mjedisore nga degradimi dhe ndotja e mjedisit dhe burimeve si dhe fatkeqësitë natyrore. Normat penalo

juridike inkriminojnë kërcënimin që sjellë papunësia dhe varfëria e vazhdueshme, duke mbrojtur kështu segmentin e sigurisë ekonomike. Kërcënimet nga skamja, uria dhe kequshqyerja janë të inkriminuara në kodin penal dhe si të tilla kriminalizojnë cenimin e sigurisë ushqimore. Cenimi i segmentit të sigurisë shëndetësore nga sëmundjet vdekjeprurëse infective, mungesa e çasjes në kujdesin themelor shëndetësor dhe ushqimin e pasigurtë, është inkriminuar dhe mbrohet nga normat penalo juridike të kodit penal të Kroacisë. Poashtu, edhe segmenti i fundit i sigurisë njerëzore, siguria politike mbrohet me norma penalo juridike nga kodi penal i Kroacisë, në të cilin janë inkriminuar kërcënimet që sjellin represioni politik dhe abuzimet e të drejtave të njeriut, të cilat mund të cenohen nga zyrtarët shtetëror. Në vazhdim, do të elaborojnë të gjitha kërcënimet që rrezikojnë segmentet e sigurisë njerëzore në Republikën e Kroacisë, duke pasqyruar normat penalo juridike të cilat mbrojnë qytetarin nga këto kërcënime, dhe inkriminojnë cenimin e të njëjtave nga kryesit e mundshëm.

Segmenti i sigurisë personale në parim kërcënohet nga dhuna fizike dhe krimi, terrorizmi, dhuna në familje dhe punësimi i fëmijëve. Në vazhdim do të pasqyrojmë normat penalo juridike të cilat mbrojnë qytetarin nga këto kërcënime.

- *Dhuna fizike dhe kriminaliteti mbrohet përmes normave juridiko penale në katër (4) kapituj të Kodit Penal të Kroacisë. Normat penale nga kapitulli 10 të emërtuar “Veprat penale kundër jetës dhe trupit”, inkriminojnë cenimin e sigurisë personale për sa i përket jetës dhe trupit, të cilat janë: Vrasja (neni 90); Vrasja e rëndë (neni 91); Vrasja e thjeshtë (neni 93); Vrasja e fëmijëve (neni 93); Vrasja me kërkesë (neni 94); Vrasje nga pokujdesia (neni 95); Lëndim trupor (neni 98); Lëndimi i rëndë trupor (neni 99); Lëndim impulsive trupor (neni 100) dhe Lëndim i pakujdesshëm trupor (neni 101).* Poashtu, segmenti i

sigurisë persona mbrohet edhe me normat penale nga kapitulli 14 të emërtuar “*Veprat penale kundër lirisë seksuale dhe moralit seksual*”, që përfshijnë: dhunimin (neni 188); Marrëdhënie seksuale me një person të pafuqishëm (neni 189); marrëdhënia seksuale me detyrim (neni 190); Marrëdhënia seksuale përmes abuzimit të pozitës (neni 191) dhe marrëdhënia seksuale me fëmijë (neni 192). Siguria personale e qytetarëve rrezikohet edhe nga kërcënimet ndaj pronës së tyre, të cilat mund të jenë qëllim i kriminalëve që përmes vjedhjes apo plaqkitjes së qytetarëve dhe shtëpive të tyre të sigurojnë përfitime materiale. Prona e qytetarëve të Republikës së Kroacisë mbrohet me normat penalo juridike nga kapitulli 17 të emërtuar “*Veprat penale kundër pronës*”, që përfshijnë: *Vjedhja* (neni 216); *Vjedhja e rëndë* (neni 217); *Vjedhja me detyrim* (neni 218); *Përvetësimi* (neni 219); *Mashtrimi* (neni 224); *Mashtrimi kompjuterik* (neni 224a); *Keqpërdorimi i sigurimit* (neni 225); *Keqpërdorimi i çekut dhe kredit kartelës* (neni 226); *Shkelja e të drejtave të autorit ose të të drejtave në punës artistike* (neni 229); *Përdorimi i paligjshëm i punës së autorit apo një përformancë artistike* (neni 230); *Zhvatja* (neni 234) dhe *Shantazhi* (neni neni 235). Poashtu, norma penalo juridike “*Rrezikimi i jetës dhe pronës përmes veprimit me mjete të rrezikshme*” (neni 263), nga kapitulli 20 të emërtuar “*Veprat penale kundër sigurisë publike të personave dhe pronës dhe siguria në trafik*”, mbron qytetarët nga rreziku i përgjithshëm persona dhe pronës së tyre nga kërcënimet në trafik. Kërcënimet fizike dhe kriminalitetit ndaj qytetarit mbrohet me norma penalo juridike *Kidnapimi* (neni 125), nga kapitulli 11 “*Veprat penale kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit*”.

- *Terrorizmi*, është formë e veçantë e kërcënimit të sigurisë personale është kodifikuar në kodin penal të Kroacisë në dy (2) kapituj. Kapitulli 12 i emërtuar “*Veprat penale kundër Republikës së Kroacisë*” ka inkriminuar terrorizmin si formë e kërcënimit të

sigurisë së shtetit të emërtuar “*Terrorizmi kundër shtetit*” (neni 141). Ajo që është karakteristike është pikërisht mënyra si është e definuar kjo normë pasi e njëjta bën reference specifike në sigurinë personale kur flet për kryerjen e aktit terrorist “... duke shkaktuar ndjenjën e pasigurisë personale tek qytetarët”. Në kuadër të Kodit penal janë paraparë edhe norma tjera që kanë të bëjnë me kryerjen e akteve terroriste në kapitullin 13 i emërtuar “*Veprat penale kundër vlerave të mbrojtura ndërkombëtare me ligj*”, ka inkriminuar formën e terrorizmit ndërkombëtar “*Terrorizmi ndërkombëtar*” (neni 169). Megjithatë kjo normë dhe normat tjera të ngjajshme më shumë i referohen shkallës së përgjegjësisë së të dyshuarve, njëjtë siq është e rregulluar edhe në Republikën e Kosovës.

- *Dhuna në familje*, është njëri ndër këcënimet që cenojnë në vazhdimisë sigurinë e individit dhe integritetit të tij në një ambient ku ai apo ajo do të duhej ndjerë më i sigurtë-vet familja. Kodi penal i Kroacisë ka inkriminuar *sjelljen e dhunshme në familje* (neni 215a) nga kapitulli 16 të emërtuar “*Veprat penale kundër martesës, familjes dhe fëmijëve*”.
- *Punësimi i fëmijëve*, është një ndër format më prezente si formë e eksploatimit të fëmijëve. Kodi penal i Kroacisë ka inkriminuar *trafikimin me qenie njerëzore dhe skllavërimin* (neni 175), në kapitullin 13 të emërtuar “*Veprat penale kundër vlerave të mbrojtura ndërkombëtarisht me ligj*”. Kjo normë penale juridike mbron fëmijët nga çdo formë e trafikimit dhe skllavërimit me qëllim të punësimit të detyrueshëm të fëmijëve, dhe si e tillë është e mbrojtur edhe me normë penalo juridike ndërkombëtare të mbrojtur me ligj.

Segmenti i sigurisë së bashkësisë rrezikohet nga tensionet ndër-etnike, fetare dhe tenseve tjera në bazë të identitetit. Kodi penal i Kroacisë në kapitullin 11 të emërtuar “*Veprat penale kundër të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit*” inkriminuar

shkeljen e barazisë së shtetasve (neni 106) dhe Shkeljen e lirisë së religjionit (neni 110). Këto dy norma penalo juridike inkriminojnë cenimin e barazisë etnike, racore, fetare etj si dhe cenimin e lirisë së religjionit. Theksojmë se mbrojtja e bashkësive respektivisht diversiteteve, është njëra ndër detyrat parësore të shtetit, në kontestin e zbatimit të parimit kushtetues të barazisë së shtetasve. Ndërsa, norma penalo juridike “*Shkatërrimit ose dëmtimi i instalimeve publike*” (KPKr, 264), mbron sigurinë individuale dhe të bashkësisë duke inkriminuar çdo person i cili shkatërron, dëmton, heq, ndryshon apo i bën instalimet e papërdorshme të shërbimeve publike për ujë, ngrohje, gaz apo energji, ose instalimeve të sistemeve të komunikimit, dhe me këtë shkakton një shqetësim të rëndësishëm në jetën e rregullt të qytetarëve apo të aktiviteteve ekonomike. Shkaktimi i pasojës (*Çrregullimi në jetën e qytetarëve*) është çështje faktike (*qustio facti*) që duhet vërtetuar në çdo rast konkret. Shkaktimi ndërprerja e lidhjes telefonike për 203 abonentë brenda një dite, për shkak të veprimeve të të akuzuarit (prerja e kabllave telefonike), me rastin e mihjes së kanalit, ka mundur të shkaktojë vështirësi në jetën e rregullt të qytetarëve, mirëpo asesi nuk ka shkaktuar çrregullime të konsiderueshme në jetën e rëndomtë të tyre”. Vendim i Gjykatës së Zhupanisë së Bjelovarit, Republika e Kroacisë, Ap,nr.180/98 të datës 28.05.1998.

Segmenti i sigurisë mjedisore, rrezikohet nga degradimi dhe ndotja e mjedisit dhe burimeve, si dh fatkeqësitë natyrore. Normat penalo juridike nga kapitulli 19 “*Veprat penale kundër mjedisit*”, mbrojnë mjedisin përmes inkriminimit në veprat penale, si në vazhdim: *Ndotja e mjedisit* (neni 250); *Ndotja e mjedisit nga zhurma* (neni 251); *Ndotja e mjedisit nga mbeturinat* (neni 252); *Importimi i mbeturinave radioaktive dhe të rrezikshme* (neni 253); *Transmetimi i sëmundjeve ngjitëse në mesin e kafshëve dhe të bimëve* (neni 255); dhe *Shkatërrimi i pyjeve* (neni 161).

Segmenti i sigurisë ekonomike, kërcënohet nga papunësia dhe varfëria e vazhdueshme, të cilat mbrohen me normën penalo juridike: Shkelja e të drejtës për të punuar dhe punëve tjera – lidhur me të drejtat (neni 114), nga kapitulli 11 të emërtuar “Veprat penale të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit”. Këto norma penalo juridike inkriminojnë cenimin e mundësisë së punësimit të qytetarit apo të drejtave të tjera të punës dhe të drejtat gjatë papunësisë së përkohshme. Norma penalo juridike ka për objekt të mbrojtur jetën e komunitetit apo bashkësisë së punëtorë të cilët punojnë në miniera, fabrika, punëtori ose vende tjer ku zhvillohet procesi i punës. Kryes mund të jetë çdo person, ndërsa vepra penale mund të kryhet me dashje dhe nga pakujdesia. Kur personi përgjegjës në punëtori apo në një punishte tjetër neglizhon detyrimin e tij që nga vendi i punës të mënjanojë punëtorin që kishte ardhur i dehur në punë ose në rast nevojë të ndërpresë punën derisa një punëtor i tillë të mos largohet nga punishtja, i cili vend i punës, për nga karakteri i punës që kryhet aty, kërkon një shkallë të lartë të vëmendjes dhe duke u bërë një lëshim i tillë shkaktohet rrezik për jetën e njerëzve. Vendim i Gjykatës Supreme e Kroacisë, Ap.nr.440/2006.

Segmenti i sigurisë ushqimore, kërcënohet nga skamja, uria dhe kequshqyerja. Këto kërcënime mbrohen me normën penalo juridike (normën e njëjtë tek siguria ekonomike), Shkelja e të drejtës për të punuar dhe punëve tjera – lidhur me të drejtat (neni 114), nga kapitulli 11 të emërtuar “Veprat penale të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit”. Kjo normë penalo juridike mbron qytetarin nga cenimi i sigurisë së tij sociale të cilën obligohet shteti që t’ia garantoj duke i’a siguruar ndihmën sociale për t’u ushqyer vetën, familjen si dhe për të siguruar shpenzimet që kanë të bëjnë me medikamentet e nevojshme në rast të sëmundjeve. Është e drejtë kushtetuese siguria ushqimore për qytetarët e

Republikës së Kroacisë të cilët për shkak të dobësisë, pafuqishmërisë, të papunësisë apo paaftësisë për punë, shteti i siguron të drejtën e ndihmës për të përmbushur nevojat e tyre themelore (KK, neni 58). Mbrojtja e sigurisë ushqimore, respektivisht cenimi i shëndetit të qytetarëve përmes produkteve me kualitet të dyshimtë mbrohet përmes normës penalo juridike “Prodhimi dhe shitja e ushqimeve të rrezikshme” (KPK, neni 247), i cili inkriminon këdo që prodhon, shet ose përndryshe vë në ushqime qarkullim, ushqim, pije apo produkte të tjera të dëmshme për shëndetin e njeriut. Për më tej norma penalo juridike “Inspektimi i pakujdesëm i mishit” (KPK, neni 248), inkriminon veterinerin apo personin tjetër të autorizuar për inspektimin e kafshëve për therje apo të mishit të destinuar për konsum njerëzor në kundërshtim me standardet profesionale ose rregullat, inspektimin e blegtorisë dhe mishit, ose gjithsesi nuk kryejnë një provim që është e nevojshme për të bërë, dhe kështu mundësoi shpërndarjen e mishit që është të dëmshme për shëndetin e njeriut. Për më tej norma penalo juridike “*Ndotja e mjedisit*” nga neni 250 i Kodit Penal të Kroacisë, inkriminon çdo person që në kundërshtim me rregullat bën kontaminimin dhe rrezikimin e cilësisë së ajrit dhe ujit, dhe në një masë që mund të përkeqësojë kushtet e jetës së njerëzve. Konstatojmë se normat penalo juridike të parashikuara në Kodin Penal i Kroacisë korrespondojnë me normat penalo juridike në Kodin Penal të Kosovës për sa i përket mbrojtjes së sigurisë ushqimore të qytetarëve.

Segmenti i sigurisë shëndetësore, kërcënohet nga tre lloj të rreziqeve; sëmundjet vdekjeprurëse infektive; mungesa e qasjes në kujdesin themelor mjekësor dhe ushqimi i pasigurtë.

- *Sëmundjet vdekjeprurëse infektive*, si kërcënim me propabilitet të ulët (*mundësia e ndodhjes*) mbrohet me dy (2) norma penalo juridike, respektivisht: *Transmetimi i*

sëmundjeve ngjitëse (neni 238); dhe *Transmetimi i sëmundjeve veneriane* (neni 239), nga kapitulli 18 “Veprat penale kundër shëndetit të popullatës. Në rastin kur një e akuzuar ka kryer veprën penale, ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore, nga neni 262 KPRK, kur pa autorizim ka përdor “tretmanin bioenergjik” ndaj fëmijës tre vjeçar i cili ka qenë i sëmur nga sindromi nefretik dhe ka shtytë prindërit t’ia ndërprejnë terapinë hormonale të përcaktuar nga trajtimi mjekësor, dhe për këtë është shkaktuar dëmtimi i rënd shëndetësor (*Aktgjykim, Kz, nr: 150/92, të datës: 9.04.2010, Gjykata e Qarkut në Bjelovar – Kroaci*) (Salihu, 2014:726). Në rastin kur nga gjendja e vërtetuar faktike rrjedhë se i akuzuari në një periudë të gjatë kohore ka pranuar dhe kontrolluar të sëmurit dhe ka përshkruar terapinë për disa lloje të sëmundjeve edhe pse për at nuk ka poseduar kualifikimin adekuate profesional, me këtë janë përmbush elementet e veprës penale, ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore nga neni 262 të KPRK-së (Salihu, 2014:726). Në këtë rast i akuzuari e ka reklamuar veprimtarin e vet kriminale nëpërmes shtypit me titull” shëroj të gjitha sëmundjet”, ka shtypë vizitë kartelat me adresën dhe telefonin e vet, me konstatim se është psikolog dhe shërues me barna popullore, edhe pse nuk ishte e saktë, ka shtyp udhëzime për përdorimin e pastave, çajave, lëngjeve të lloj llojshme të cilët nuk janë përcaktuar si barna. Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se i akuzuari ka pranuar dhe kontrolluar të sëmurit në dhoma të veçanta dhe ka përshkruar terapinë për shërimin e të sëmurëve edhe pse për at nuk ka poseduar kualifikimin profesional (*Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Slavonska Pozhega –Kroaci, Kz.nr 135/89 dt. 25. 09. 1989*), (Salihu, 2014:726).

- *Mungesa e qasje në kujdesin themelore shëndetësor*, është inkriminuar në kapitullin 11 “Veprat penale kundër të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit” të Kodit penal,

respektivisht vetëm me normën penalo juridike “*Shkelja e të drejtës për mbrojtje shëndetësore për personat me aftësi të kufizuar*”. Ndërsa, për sa i përket kërcënimit të shëndetit të qytetarëve nga neglizhenca e mjekëve, kodi penal i Kroacisë ka inkriminuar cenimin e shëndetit të qytetarit nga neglizhenca mjekësor përmes dy normave penalo juridike, respektivisht: *Neglizhenca mjekësore* (neni 24) dhe *Dështimi për të ofruar ndihmën mjekësore* (neni 243) të cilat bëjnë pjesë në kapitullin 18 të emërtuar “Veprat penale kundër shëndetit të popullatës”.

- *Ushqimi i pasigurt*, është një kërcënim real dhe i mundshëm sepse është çështje që prek fitimin e humbur të bizneseve në rastet kur ushqimeve i’u skadon afati përdorimit dhe të njëjtat në vend se të hudhen atyre i’u ndërrohet etiketa në të cilën shkruan afati përdorimit. Ky kërcënim ndaj qytetarëve mbrohet me tre (3) norma penalo juridike; *Prodhimi ose qarkullimi i produkteve ushqimore të dëmshme* (neni 247); *Inspektimi i pakujdesshëm i mishit* (neni 248) dhe *Veprat e rënda kundër shëndetit të popullatës* (neni 249), nga kapitulli 18 Veprat penale kundër shëndetit të popullatës”.

Segmenti i sigurisë politike kërcënohet nga *represioni politik* dhe *abuzimet e të drejtave të njeriut*. Në vazhdim do të pasqyrojmë normat penalo juridike të cilat mbrojnë qytetarin nga këto kërcënime, që për nga natyra kryhen nga zyrtarët shtetëror respektivisht nga aparati i dhunës shtetërore.

- *Represioni politik*, është një kërcënim periodik për shtetet demokratike, dhe mund të ndodhë vetëm në ato faza kur pushteti shtetëror humb legjitimitetin tek populli (jo edhe legalitetin), dhe për pasojë ndodhin trazira dhe prishet rendi juridik. Ligjvënësit e Republikës së Kroacisë represionin politik e kanë inkriminuar në kuadër të tre (3) kapitujve të kodit penal. Në kapitullin 11 të emërtuar “*Veprat penale kundër të lirive dhe të drejtave të njeriut*

dhe qytetarit” kanë inkriminuar, si vijon: *Shkelja e të drejtës së tubimit paqësor dhe protestës publike* (neni 108); *Shkelja e të drejtës së grevës* (neni 111); *Shkelja e të drejtës për parashtrimin e ankesës dhe petitionit* (neni 112); *Mohimi i të drejtës për të votuar* (neni 117); *Bastisja e paligjshme* (neni 123); *Privimi i paligjshëm i lirisë* (neni 124); *Marrja e dhunshme e deklaratës* (neni 126) dhe *Keqtrajtimi gjatë ekzekutimit të detyrës ose autoritetit publik* (neni 127). Kapitulli 25 të emërtuar “*Veprat penale kundër detyrës zyrtare*” mbron qytetarët nga dhuna shtetërore duke inkriminuar veprimet e zyrtarëve shtetërorë përmes normave penalo juridike: *Shpërdorimi i detyrave zyrtare* (neni 337); *Shkelja e ligjit në procesin gjyqësor* (neni 337a); *Neglizhenca në kryerjen e detyrës* (neni 339); *Dështimi në zbatimin e urdhërit* (neni 340); *Mashtrimi gjatë kryerjes së detyrës* (neni 344); *Mbledhje e paligjshme e pagesave* (neni 350); *Zbulimi i një sekretit zyrtar* (neni 351).

- Abuzimi me të drejtat e njëriut, si kërcënim i sigurisë politike mbrohet me normat penalo juridike nga kapitulli 11 “*Veprat penale kundër të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit*”, duke inkriminuar cenimin e të drejtave të njeriut dhe qytetarit, nga: *Shkelja e barazisë së shtetasve* (neni 106); *Shkelja e lirisë së shprehjes* (neni 107); *Shkelja e lirisë së asocimit* (neni 109); *Shkelja e lirisë së religjionit* (neni 110); *Kufizimi i shtypjes dhe shpërndarjes së materialeve të shtypura dhe e transmetimit* (neni 113); *Shkelja e të drejtës së votimit* (neni 116); *Cenimi i paprekshmërisë së banimit të personit* (neni 122); *Shtrëngimi* (neni 128); *Kërcënimi* (neni 129); *Shkelja e privatësisë së korrespondencës dhe pjesëve tjera të postës* (neni 130); *Regjistrimi dhe përgjimi i paautorizuar* (neni 131); *Zbulimi i të fshehtave profesionale pa autorizim* (neni 132); dhe *Përdorimi i paautorizuar i të dhënave personale* (neni 133). Normat e sipërme japin një pasqyrim të inkriminimit të sigurisë nga represioni i përgjithshëm apo edhe politik duke lejuar mundësinë e një

konkurence dhe shprehje demokratike të komuniteteve dhe partive të ndryshme. Kodi penal u njeh qytetarëve të drejtën në votë të lirë dhe pa presion dhe njëkohësisht edhe mundësinë e tubimit përderisa të njëjtat janë paqësore dhe publike.

Raporti i Amnesty International edhe në rastin e Kroacisë ven në pah diskriminimin si problematikë e vendit e cila për dallim nga Slovenia duket të jetë edhe më e shprehur. Diskriminimi duket të jetë më i shprehur ndaj Serbëve të Kroacisë dhe komunitetit LGBTI, përfshirë edhe diskriminimin ndaj popullsisë Rome sa i përket qasjes në punësim, banim dhe përshtim social. Raporti identifikon të paktën në dy instanca të sulmeve homofobike në të cilat autoritetet kanë dështuar në ofrimin e mbrojtjes së të drejtave të këtij komuniteti. Edhe për Kroacinë potencohet problematika e krizës së refugjatëve (AI, 2016: 131).

6.2.3 Serbia

Republika e Serbisë si shtet fqinj me Republikën e Kosovës, është në rrugën e saj drejt integritimit në BE. Megjithatë, nëse krahasojmë me legjislacionin e Kosovës, në veçanti legjislacionin penal shohim se Kosova është shumë më e përparuar në këtë drejtim. Megjithatë, duke qenë se gjasat që Serbia të hyjë në BE janë shumë më reale dhe me pranë sesa gjasat e Kosovës për realizimin e synimit të tillë, të cilën mund të themi se nuk është si rezultat i politikave më të mira në Serbi, por më tepër paraqet një realitet politik dhe interesa rajonale e strategjike që Serbisë po ia trasojnë rrugën drejt BE. Për qëllime krahasimi, ne do të bëjmë vetëm një krahasim sa i përket inkriminimit të veprave ndaj sigurisë njerëzore në Serbi dhe në këtë kontekst në vazhdim do të shohim aspektin normativ të normave penalo juridike të cilat mbrojnë sigurinë njerëzore të qytetarit në Republikën e Serbisë. Në kuadër të analizës së Kushtetutës së Serbisë kemi konstatuar se në kushtetutë, veçanërisht ka shumë të drejta të garantuara kushtetuese për sa i përket

pakicave kombëtare. Mirëpo, përkundër këtij fakti, është e njohur botërisht se pakicat kombëtare (shqiptarët, boshnjakët, hungarezët etj), nuk i gëzojnë këto të drejta kushtetuese si pasojë e dhunës politike të aparatit shtetëror të serbisë. Për shembull, nëse analizojmë interpretimin normative dhe frymën kushtetuese të nenit 78 të emërtuar “*Ndalimi i asimilimit të dhunshëm*”, kuptojmë se kushtetuta ndalon asimilimin e dhunshëm të pakicave kombëtare. Pra, objekt i mbrojtur në këtë normë është asimilimi i qytetarëve përmes dhunës, ndërsa me këtë normë kushtetuese nuk është e ndaluar asimilimi i padhunshëm i qytetarëve. Pra, kjo normë lejon asimilimin e qytetarëve, por duke u përmbajtur nga përdorimi i dhunës gjatë asimilimit. Përmes tabelës në vazhdim, pasqyrojmë normat kushtetuese që mbrojnë segmentet e sigurisë.

Segmenti sigurisë	Kërcënimet	Mbrojtja kushtetuese (neni)
Personale	Dhuna fizike dhe krimi	Sundimi ligjit (K.SR. neni 3); E drejta në jetë (K.SR. neni 24); Pacenueshmëria e integritetit fizik dhe psikik (K.SR. neni 25); E drejta në liri dhe siguri (K.SR. neni 27); Pacenueshmëria e banimit (K.SR. neni 40); E drejta e pronës (K.SR. neni 58);
	Terrorizmi	Sundimi ligjit (K.SR. neni 3); E drejta në jetë (K.SR. neni 24); Pacenueshmëria e integritetit fizik dhe psikik (K.SR. neni 25); E drejta në liri dhe siguri (K.SR. neni 27);
	Dhuna në familje	Barazia gjinor (K.SR. neni 15); Pacenueshmëria e integritetit fizik dhe psikik (K.SR. neni 25);
	Punësimi i fëmijëve	Sundimi ligjit (K.SR. neni 3); Ndalimi i punës së detyruar (K.SR. neni 26); Të drejtat e fëmijës (K.SR. neni 64); të drejtat dhe detyrat e prindërve (K.SR. neni 65);
Bashkësisë	Tensionet ndër-etnike, fetare të identitetit	Sundimi ligjit (K.SR. neni 3); Mbrojtja e pakicave kombëtare (K.SR. neni 12); kufizimi i të drejtave njerëzore dhe të pakicave (K.SR. neni 20); Ndalimi diskriminimit (K.SR. neni 21); Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njezore dhe të pakicave (K.SR. neni 22); E drejta në liri dhe siguri (K.SR. neni 27); Liria lëvizjes (K.SR. neni 39); E drejta e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë (K.SR. neni 43); Kishat dhe bashkësitë fetare (K.SR. neni 44); Ndalimi i nxitjes së urrejtjes racore, etnike dhe fetare (K.SR. neni 49); Ndalimi i diskriminimit të pakicave kombëtare (K.SR. neni 76);
Mjedisore	Degradimi dhe ndotja e mjedisit	Sundimi ligjit (K.SR. neni 3); E drejta në jetë (K.SR. neni 24); Mjedisi i shëndetshëm (K.SR. neni 74);
Ekonomike	Papunësia dhe varfëria	Pacenueshmëria e integritetit fizik dhe psikik (K.SR. neni 25); e drejta në punë (K.SR. neni 60);
Ushqimore	Skamja, uria	E drejta në jetë (K.SR. neni 24); Ndihma sociale (K.SR. neni 69); Pensioni social (K.SR. neni 70);

Shëndetësore	Sëmundjet vdekjeprurëse infektive	E drejta në jetë (K.SR. neni 24);
	Mungesa e qasjes në kujdesin shëndetësor	Sundimi ligjit (K.SR. neni 3); E drejta në jetë (K.SR. neni 24); E drejta në ndihmën e pare mjekësore (K.SR. neni 67); sigurimi shëndetësor (K.SR. neni 68);
	Ushqim të pasigurt	E drejta në jetë (K.SR. neni 24);
Politike	Represioni politik; Abuzimet e të drejtave të njeriut	Sundimi ligjit (K.SR. neni 3); Gjuha dhe shkimi (K.SR. neni 10); Mbrotja e pakicave kombëtare (K.SR. neni 12); Mbrotja e të drejtave dhe lirive të njezore dhe të pakicave (K.SR. neni 22); E drejta në jetë (K.SR. neni 24); Pacenueshmëria e integritetit fizik dhe psikik (K.SR. neni 25); E drejta në liri dhe siguri (K.SR. neni 27); Trajtimi i personave të privuar nga liria (K.SR. neni 28); Të drejtat shtesë në rast të privimit të lirisë pa vendim gjyqësor (K.SR. neni 29); E drejta në gjykim të drejtë (K.SR. neni 32); Të drejtat e veçanta të të akuzuarve (K.SR. neni 33); Siguria ligjore në të drejtën penale (K.SR. neni 34); E drejta mbrojtjes së barabartë dhe mjetit juridik (K.SR. neni 36); Liria lëvizjes (K.SR. neni 39); Fshehtësia e korrspodencës (K.SR. neni 41); mbrojtja e të dhënave personale (K.SR. neni 42); Kishat dhe bashkësitë fetare (K.SR. neni 44); Liria e mendimit dhe shprehjes (K.SR. neni 46); Liria e shprehjes së përkatësisë kombëtare (K.SR. neni 47); Ndalimi i nxitjes së urrejtjes racore, etnike dhe fetare (K.SR. neni 49); E drejta e votimit (K.SR. neni 52); E drejta e tubimit (K.SR. neni 54); E drejta e asociimit (K.SR. neni 55); E drejta e petitionit (K.SR. neni 56); E drejta në grevë (K.SR. neni 61); Ndalimi i diskriminimit të pakicave kombëtare (K.SR. neni 76); Ndalimi i asimilimit të dhunshëm (K.SR. neni 78); E drejta në ruajtjen e veçantive (K.SR. neni 79); Zhvillimi i frymës së tolerances (K.SR. neni 81); Hierarkia e akteve ligjore vendore dhe ndërkombëtar (K.SR. neni 194);

Figura 6.2.3.1 Kërcënimet e sigurisë njerëzore në Serbi dhe mbrojtja Kushtetuese

Në Republikën e Serbisë, mbrojtja e sigurisë njerëzore nga kërcënimet garantohej përmes kodifikimi të këtyre kërcënimeve. Në vazhdim do të prezantojmë të gjitha normat të cilat mbrojnë sigurinë njerëzore. *Siguria personale kërcënohet nga: dhuna fizike dhe krimi, terrorizmi, dhuna në familje dhe punësimi i fëmijëve.* Kodi Penal i Serbisë ka inkriminuar cenimin e sigurisë personale nga këto kërcënimet përmes normave penalo juridike në kuadër të nëntë (9) kapitujve të saj.

- *Dhuna fizike dhe krimi*, në vazhdimësi cenon sigurinë personale andaj edhe ligjvënësit

kanë inkriminuar në Kodin Penal format me të cilat cenohet siguria personale. Normat penalo juridike nga Kapitulli 13 *“Veprat kundër jetës dhe trupit”* që mbrojnë qytetarët nga dhuna fizike dhe krimi janë: *“Vrasja”* (neni 113); *“Vrasja e rëndë”* (neni 114); *“Vrasja nga pasioni”* (neni 115); *“Vrasja e fëmijës”* (neni 116); *“Vrasja nga neglizhenca”* (neni 118); *“Lëndimi i rëndë trupor”* (neni 121); dhe *“Lëndimi i lehtë trupor”* (neni 122). Cenimi i Integritetit seksual mbrohet përmes normave penalo juridike nga kapitulli 18 të emërtuar *“Veprat seksuale”* inkriminojnë cenimin e integritetit seksual”, që janë: *“Dhunimi”* (neni 178); *“Marrëdhëniet seksuale me fëmijë”* (neni 180) dhe *Marrëdhënia seksuale me shpërdorim të pozitës”* (neni 181). Cenimi i pronës së qytetarëve si pjesë e kërcënimit nga krimi, mbrohet përmes normave penalo juridike nga kapitulli 21 të emërtuar *“Veprat kundër pronës”* që përfshijnë: *“Vjedhja”* (neni 203); *“Vjedhja e rëndë dhe komplekse”* (neni 204); *“Vjedhja e rëndë”* (neni 205); *“Plaqkitja”* (neni 206); *“Përvetësimi”* (neni 207); *“Mashtrimi”* (neni 208); *“Zhvatja”* (neni 214); dhe *“Shantazhi”* (neni 215).

- *Terrorizmi*. Kërcënimi nga terrorizmi është inkriminuar me normën penalo juridike *“Terrorizmi”* (neni 391) nga kapitulli 34 i emërtuar *“Veprat penale kundër njerëzimit dhe të drejtave të garantuara me ligjin ndërkombëtar”*.

- *Dhuna në familje*. Kërcënimi nga dhuna në familje inkriminohet me dy (2) norma penalo juridike; *“Dhuna në familje”* (neni 194) dhe *“Shkelja e detyrës familjare”* (neni 196), nga kapitulli 19 i emërtuar *“Krimet në lidhje me martesën dhe familjen”*.

- *Punësimi i fëmijëve*. Kërcënimi i sigurisë personale që rrezikohet nga punësimi i fëmijëve, mbrohet me normën penalo juridike *“Trafikimi me qenie njerëzore”* (neni 388), nga kapitulli 34 i emërtuar *“Veprat penale kundër humanitetit dhe të drejtave të garantuara me ligjin ndërkombëtar”*.

Segmenti i sigurisë së bashkësisë kërcënohet nga tensionet ndër-etnike, fetare dhe tensioneve tjera në bazë të identitetit. Siguria në bashësi është e mbrojtur me norma penale juridike nga kapitulli 14 i emërtua “Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit”, respektivisht me normat si në vijim: “Shkelja e të drejtës për të përdorur një gjuhë ose alfabetin” (neni 129); “Shkelja e të drejtës për shprehjen e përkatësia nacionale ose etnike” (neni 130); dhe “Shkelja e Lirive fetare dhe e riteve fetare” (neni 131).

Segmenti i sigurisë mjedisore, rrezikohet nga degradimi dhe ndotja e mjedisit dhe burimeve, dhe fatkeqësitë natyrore. Mbrojtja e sigurisë mjedisore mbrohet me norma penale juridike nga kapitulli 24 të emëruar “Veprat penale kundër mjedisit”, të cilat inkriminojnë ndotjen e mjedisit dhe degradimin e burimeve, përfshirë kërcënimet nga fatkeqësitë natyre përmes veprave penale si në vazhdim: “Ndotja e mjedisit” (neni 260); “Dështimi për të ndërmarrë masat e nevojshme të mjedisit” (neni 261); “Dëmtimin e mjedisit” (neni 264); “Shkatërrimi i pyjeve” (neni 274); dhe “Vjedhja e pyjeve” (neni 275).

Siguria ekonomike, respektivisht çështja e të drejtës së punësimit për qytetarët e Serbisë mbrohet me normën penale juridike e cila inkriminon “Shkeljen e të drejtave në marrëdhëniet e punës dhe të drejtave të sigurimit social” (KPS, neni 163). Kjo normë penale juridike inkriminohet çdo person që me vetëdije nuk vepron në përputhje me ligjet dhe rregulloret, marrëveshjen kolektive dhe aktet tjera të përgjithshme në bazë të të drejtave të punës dhe për mbrojtjen e veçantë të të rinjve, grave dhe të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Kjo normë penale juridike nga neni 163 të KPS-së, korrespondon me nenin 221 “Cenimi i të drejtave në marrëdhëniet e punës” të Kodit Penal të Kosovës, dhe qëllimi kriminalo politik i kësaj norme penale juridike në të dyja kodet penale të shteteve respektive është që të sigurohen dhe të realizohen të drejtat e punëtorit.

E drejta e punëtorit është themelimi dhe pushimi i marrëdhënies së punës, e drejta për pagën apo të ardhurat tjera (shtesat), të cilat i takojnë në bazë të ligjit. Kështu, objekt i mbrojtjes së kësaj vepre penale janë të drejtat themelore të punëtorit të cilat rrjedhin nga puna apo marrëdhënia e punës sikurse janë cekur në dispozitën e kësaj norme penalo-juridike (Salihu, 2014:591).

Segmenti i sigurisë ushqimore, kërcënohet nga skamja, uria dhe keq ushqyerja, ndërsa mbrohet përmes nomrës penale juridike “Abuzimi me të drejtën e përfitimeve të sigurimit social” (neni 168) nga kapitulli 16 i emërtuar “Veprat penale kundër të drejtës së punës”.

Segmenti i sigurisë shëndetësore, kërcënohet nga: sëmundjet vdekjeprurëse infektive; mungesa e qasjes në kujdesin themelor shëndetësor dhe ushqimi i pasigurt.

- *Sëmundjet vdekjeprurëse infektive, si kërcënim i shëndetit të qytetarëve mbrohet me normat penale juridike: “Transmetimi i sëmundjes ngjitëse” (neni 249) dhe “Transmetimi i infeksionit HIV” (neni 250) nga kapitulli 23 i emërtuar “Veprat penale kundër shëndetit njerëzor”.*

- *Mungesa e qasje në kujdesin themelor shëndetësor, për qytetarët e Serbisë inkriminohet me dy norma penale juridike; “Dështimi për të vepruar në përputhje me rregullat shëndetësore gjatë epidemisë” (neni 248) dhe “Dështimi për të ofruar shërbimin mjekësor” (neni 253), nga kapitulli 23 i emërtuar “Veprat kundër shëndetit njerëzor”.*

- *Ushqimi i pasigurt, inkriminohet me norma penale juridike nga kapitulli 23 “Veprat kundër shëndetit njerëzor”, përmban normat penale që cenojnë ushqimin e sigurtë, duke përfshirë; “Prodhimin dhe lëshimin në qarkullim të produkteve të dëmshme” (neni 256);*

Inspektimi i pandërgjegjshëm ushqimor (neni 257); dhe “Ndotja e ujit të pijës dhe ushqimit” (neni 258).

Segmenti i sigurisë politike kërcënohet nga represioni politik dhe abuzimet e të drejtave të njeriut. Këto kërcënime që cenojnë të liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit mbrohen përmes normave penalo juridike nga kapitulli 14 i Kodit Penal të Serbisë të emërtuar “Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit”, që lidhen me kërcënimin nga represioni politik, që përfshinë: “Heqja e paligjshme e lirisë” (neni 132); “Shtytja e rrëfimit” (neni 136); “Bastisja e paligjshme” (neni 140); “Zbulimi i paligjshëm i sekretit” (neni 141); “Shkelja e privatësisë së letrës apo dokumentit tjetër” (neni 142); “Shkelja e të drejtës për mjet juridik” (neni 147); dhe “Parandalimi i tubimit publik” (neni 151). Ndërsa, kërcënimet nga abuzimet e të drejtave të njeriut mbrohen me normat penalo juridike, që përfshijnë: “Shkelja e barazisë” (neni 128); “Shkelja e lirisë së qarkullimit dhe banimit” (neni 133); “Shtrëngimi” (neni 135); “Këqtrajtimi dhe torturimi” (neni 137); “Shkelja e paprekshmërisë së shtëpisë” (neni 139); “Regjistrimi dhe përgjimi i paautorizuar” (neni 143); “Fotografimi i paautorizuar” (neni 144); “Publikimi i paautorizuar dhe prezantimi i tekstit të tjetrit, portretit dhe regjistrimit” (neni 145); “Grumbullimi i paautorizuar i të dhënave personale” (neni 146); 1 “Shkelja e lirisë së fjalës dhe të daljes publike” (neni 148); “Parandalimi i printimeve dhe shpërndarja e materialeve të shtypura dhe transmetimi (neni 149); “Parandalimi i publikimit të përgjigjes dhe korrigjimit” (neni 150); dhe “Parandalimi i bashkimit politik, sindikatës ose shoqatës dhe aktiviteteve të tjera” (neni 152). Kur të pandehurit në cilin e policëve në kryerje të detyrë zyrtare me qëllim që ta nxjerrin deklaratën nga i dëmtuari e kanë përdorë forcën, ashtu që pasi e kanë sjellë të dëmtuarin në lokalet e policisë e kanë rrahë duke

kërkuar që tu tregoj se ku gjendet personi i caktuar, e kanë kryer veprën penale, marrja e deklaratës me anë të shtrëngimit nga neni 65 par.2 lidhur me par 1 të Ligjit Penal të Serbisë (Salihu, 2014:539). *Arsyetimi*: Nga vërtetimi i gjendjes së fakteve gjykata ka gjet se në veprimet e të akuzuarve përmbushen elementet e veprës penale, marrja e deklaratës me anë të shtrëngimit nga neni 65 par 2 të Ligjit Penal të Serbisë. Të akuzuarit si persona zyrtar-polic në kryerjen e detyrës e kanë përdorë forcën ndaj të dëmtuarit me qëllim që të marrin informacionin se ku gjendet personi i caktuar, me që rast i kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore të rrezikshme për jetë... Ndërsa sa i përket lëndimit të rënd trupor të akuzuarit kanë vepruar me dashje eventuale sepse kanë qenë të vetëdijshëm se në mënyrën se si e kanë rrahë të dëmtuarin duke e goditur me këmbë, duar, shufër të gomës në pjesët vitale të trupit do të mund t'i shkaktojnë lëndime të rënda trupore të rrezikshme për jetë dhe janë pajtuar nëse shkaktohet kjo pasojë (*Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Serbisë Kz.nr.1524/o2 dt. 10.09.2003*).

Raporti i Amnesty International (AI, 2016: 315), që i referohet vlerësimit për shkeljes së të drejtave të njeriut në Serbi shpërfaq vazhdimësinë e shkeljes së këtyre të drejtave dhe pasigurisë njerëzore të rrezikuar në shumicën e rasteve nga vet aparati shtetëror. Kështu raporti rendit një numër problemesh sa i përket kufizimt të lirisë së shprehjes në veqanti ndaj mediave dhe shoqërisë civile, diskriminimin e popullsisë Rome e deri tek trajtimi i konstatuar si jokushtetues përmes Ligjit për tubime publike. Kriza e refugjatëve, duke pasur parasysh vërshimin që kishte Serbia si vend transit për në Hungari nuk ka lënë pa e ndikuar edhe këtë vend ku raporti identifikon instanca të keqtrajtimit të refugjatëve dhe migrantëve si dhe eksplotimit financiar të tyre. Në raport në vazhdimësi

theksohet edhe problematika që vazhdon tash e sa vite rreth ndjekjes së krimeve të luftës dhe moszgjidhjen e qështjes së fatit të personave të zhdukur nga vitet e 90-ta.

6.2.4 Gjermania

Kushtetuta e Gjermanisë e cila ka hyrë në uqi në vitin 1949 ka vënë një theks të veçantë në të drejtat e njeriut. Kjo Kushtetutë garanton të gjitha të drejtat e parapara me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe KEDNj, ku kjo e fundit iu jep bazë edhe qytetarëve të paraqesin kërkesë për shkelje të drejtave në GJEDNj. Arsyeja e përfshirjes së Gjermanisë në këtë analizë nuk është pretendim që ligjet tona apo aq më pak praktika jonë të jetë në nivel me atë të Gjermanisë, po thjeshtë për të treguar se si një vend demokratik, një vend themeltar i BE-së dhe shtet i fuqishëm, kujdeset për sigurinë njerëzore dhe si e trajton atë në nivel të Kodit të vet penal. Kushtetuta e Gjermanisë garanton sigurinë njerëzore në kuadër të të drejtave dhe lirive të njeriut (Kapitulli I, të drejtat fundamentale). Normat kushtetuese të cilat i mbrojnë segmentet e sigurisë njerëzore i paraqesim përmes tabelës në vazhdim.

SEGMENTET	KËRCËNIMET	MBROJTJA KUSHTETUESE (NENI)
Personale	Dhuna fizike dhe krimi	Dinjiteti njerëzor (K.GJ. neni 1); Liritë personale (K.GJ. neni 2); prona, trashëgimia, shpronësimi (K.GJ. neni 14)
	Terrorizmi	Dinjiteti njerëzor (K.GJ. neni 1); Liritë personale (K.GJ. neni 2);
	Dhuna në familje	Dinjiteti njerëzor (K.GJ. neni 1); Liritë personale (K.GJ. neni 2); Martesa, familja dhe fëmijët (K.GJ. neni 6);
	Punësimi i fëmijëve	Martesa, familja, fëmijët (K.GJ. neni 6);
Bashkësisë	Tensionet ndër-etnike, fetare të identitetit	Dinjiteti njerëzor (K.GJ. neni 1); liritë personale (K.GJ. neni 2); liria e besimit dhe ndërgjegjës (K.GJ. neni 4); Liria e shprehjes, artit dhe shkencës (K.GJ. neni 5); martesa, familja dhe fëmijët (K.GJ. neni 6); Liria asociimit (K.GJ. neni 8); Feja dhe shoqërite fetar (K.GJ. nenet 136, 137,138,139, 140)
Mjedisore	Degradimi dhe ndotja e mjedisit dhe burimeve, fatkeqësitë natyrore	Liritë personale (K.GJ. neni 2)
Ekonomike	Papunësia dhe varfëria e	Liria e punësimit (K.GJ. neni 12)

	vazhdueshme	
Ushqimore	Skamja, uria dhe kequshqyerja	Dinjiteti njerëzor (K.GJ. neni 1); Liritë personale (K.GJ. neni 2).
Shëndetësore	Sëmundjet vdekjeprurëse infektive	Dinjiteti personal (K.GJ. neni 1); Liritë personale (K.GJ. neni 2)
	Mungesa e qasjes në kujdesin shëndetësor	Dinjiteti personal (K.GJ. neni 1); Liritë personale (K.GJ. neni 2).
	Ushqim të pasigurt	
Politike	Represioni politik	Të drejtat personale (K.GJ. neni 2); Barazia para ligjit (K.GJ. neni 3); Paprekshmëria e banimit (K.GJ. neni 13); E drejta peticionit (K.GJ. neni 17).
	Abuzimet e të drejtave të njeriut	

Figura 6.2.4.1 Kërcënimet e sigurisë njerëzore në Gjermani dhe mbrojtja kushtetuese

Segmenti i sigurisë personale. Dhuna fizike, krimi, terrorizmi, dhe punësimi i fëmijëve kërcënojnë sigurinë personale të qytetarëve të Gjermanisë. Kodi penal i Republikës së Gjermanisë ka inkriminuar cenimin e sigurisë personale përmes normave penalo juridike në tetë (8) kapituj të saj.

- *Dhuna fizike dhe krimi*, kërcënojnë jetën dhe shëndetin e qytetare, andaj edhe ligjvënësit gjermanë kanë inkriminuar këto rreziqe përmes normave penalo juridike në disa kapituj të kodit penal. Kapitulli 16 i emërtuar “Veprat kundër jetës”, mbrojnë jetën e qytetarit përmes inkriminimit të këtyre veprave penale: “*Vrasja në rrethana të veçanta rënduese*” (neni 211); “*Vrasja*” (neni 212) dhe “*Vrasja në rrethana lehtësuese*” (neni 213). Kapitulli 17 i emërtuar “Veprat kundër personit” mbrojnë shëndetin e qytetarit përmes inkriminimit të këtyre veprave penale: “*Shkaktimi i dëmtimit trupor*” (neni 233); “*Shkaktimi i dëmtimit trupor me mjet të rrezikshëm*” (neni 224); “*Shkaktimi i dëmtimit të rëndë trupor*” (neni 226); “*Dëmtimi trupor që shkakton vdekje*” (neni 227); dhe “*Shkaktimi i dëmtimit trupor nga neglizhenca*” (neni 229). Normat penalo juridike nga kapitulli 13 “Veprat kundër vetpërcaktimit seksual” mbrojnë cenimin e integritetit seksual përmes veprave penale: “*Abuzimi me pozitën zyrtare*” (neni 174b); “*Abuzimi me fëmijë*” (neni 176); “*Abuzimi i rëndë me fëmijë*” (neni 176a); “*Abuzimi me fëmijë shkaktar i vdekjes*” (neni

176b); dhe “*Dhunimi*” (neni 177). Cenimi i sigurisë personale nga kërcënimet e pronës dhe pasurisë mbrohet me normat penale juridike nga kapitulli 19 i emërtuar “*Vjedhja dhe përvetësimi i paligjshëm*”, që përfshinë këto vepra penale: 242 “*Vjedhja*” (neni 242); “*Vjedhja e rëndë*” (neni 243); “*Plaçkitja e shtëpisë private*” (neni 244); “*Vjedhja e rëndë e bandës*” (neni 244a); “*Përvetësimi i paligjshëm*” (neni 246); “*Vjedhja nga i afërmi ose personi që jeton në të njëjtën shtëpi*” (neni 247); dhe “*Vjedhja dhe përvetësimi i paligjshëm i objektit ose vlerës së vogël*” (neni 248a). Normat penale juridike nga kapitulli 20 “*Plaçkitja*” mbrojnë pronën dhe jetën e qytetarit duke inkriminuar cënimin e këtyre të fundit përmes veprave penale të parashikuara në këtë kapitull: “*Plaçkitja*” (neni 249); “*Plaçkitja e rëndë*” (neni 250); “*Plaçkitja që shkakton vdekje*” (neni 251); “*Vjedhja dhe përdorimi i forcës për të kthyer sendet e vjedhura*” (neni 252); “*Shantazhimi*” (neni 253); dhe “*Shantazhimi dhe përdorimi i forcës ose kërcënimit me jetën dhe trupin*” (neni 255). Normat penale juridike nga kapitulli 28 “*Veprat penale që shkaktojnë rrezik të përgjithshëm*”, mbrojnë qytetarin nga kërcënimet e përgjithshme ndaj jetës dhe trupit përmes normave penale: “*Zjarrvënia nga neglizhenca*” (neni 306b); “*Shkaktimi i eksplodimit neuklear*” (neni 307); “*Shkaktimi i eksplodimit*” (neni 308); “*Keqpërdorimi i rrezatimit jonizues*” (neni 309); “*Lirimi i rrezatimit jonizues*” (neni 311); “*Shkaktimi i përmytjes*” (neni 313); dhe “*Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga helmimi*” (neni 314).

- *Terrorizmi*, si kërcënimet ndaj sigurisë personale mbrohet me dy (2) norma penale juridike: “*Formimi i organizatave terroriste*” (neni 129a) dhe “*Organizatave kriminale dhe terroriste jashtë vendit*” (neni 129b), nga kapitulli 17 i emërtuar “*Veprat kundër rendit publik*”.

- *Punësimi i fëmijëve*, mbrohet me normën penalo juridike “*Trafikimi me qenie njerëzore me qëllim të shfrytëzimit në punë*” nga kapitulli 18 “*Veprat kundër lirisë personale*”.

- *Dhuna në familje*, në kuadër të Kodit penal dhe kapitullit të veprave kundër martesës fokusin më të madh e ka çështjen e shkeljes së detyrimeve që dalin nga martesa siç janë: mospagesa e alimentacionit për fëmijë, shkelja e detyrimit të kujdesit apo arsimimit apo incesti

Segmenti i sigurisë së bashkësisë, kërcënohet nga tensionet ndër-etnike, fetare dhe tensioneve tjera në bazë të identitetit, të cilat mbrohen përmes normave penalo juridike nga dy kapituj të kodit penal të Gjermanisë. Kapitulli 7 i emërtuar “*Veprat kundër rendit publik*”, inkriminon “*Nxitja e urrejtjes*” (neni 130); ndërsa në kapitullin 11 “*Veprat lidhur me religjionin dhe ideologjinë*”, inkriminojnë këto vepra penale: “*Poshtërimi i feve, shoqatat fetare dhe ideologjike*” (neni 166); “*Pengimi i ushtrimit të religjionit*” (neni 167); “*Pengimi i funeralit*” (neni 167a); dhe “*Dhunimi i varreve*” (neni 168).

Segmenti i sigurisë mjedisore, rrezikohet nga *degradimi dhe ndotja e mjedisit dhe burimeve, si dhe fatkeqësitë natyrore*, të cilat mbrohen përmes normave penalo juridike nga kapitulli 29 “*Veprat kundër mjedisit*” që përfshijnë këto vepra penale: “*Ndotja e ujit*” (neni 324); “*Ndotja e tokës*” (neni 324a); “*Ndotja e ajrit*” (neni 325); “*Hudhja e paligjshme e mbeturinave*” (neni 326); dhe “*Rrezikimi i hapësirave të mbrojtura*” (neni 329). Vepra tjera që kanë të bëjnë me sigurinë mjedisore dhe që janë të lidhura ngushtë edhe me sigurinë shëndetësore janë: Keqpërdorimi i radiacionit jonizues (neni 309), “*Shkaktimi i rrezikut të rëndë nga helmimi*” (neni 330a) dhe vepra tjetër që ekskluzivisht lidhet me dëmtim të shëndetit që është *Shkaktimi i rrezikut të rëndë përmes liritimit të helmit* (neni 330a).

Segmenti i sigurisë shëndetësore, në formën dhe mënyrën se si është rregulluar me Kodin penal na jep një gërshetim të të njëjtave norma që mund të rrezikojnë sigurinë mjedisore që lidhen edhe me sigurinë shëndetësore pasi i referohen ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës. Kodi poashtu parasheh edhe veprën penale të *Braktisjes* sipas neni 221 të e cila vepër mund të rrezikojë seriozisht shëndetin e personit të braktisur e edhe të qoj në vdekjen e tij. Një tjetër segment i cili bie në sy në rregullimin penal është edhe kujdesi që i kushton Gjermania si shtet kujdesit shëndetësor. Normat e veqanta rreth kujdesit shëndetësor janë të rregulluara me legjislacion të veçantë i cili nuk është temë e kësaj analize megjithatë ajo që përfshin Kodi është pikërisht kujdesi shëndetësor që i kushtohet personave në nevojë për këtë kujdes dhe atë me inkriminimin e *Rrezikimit të trajtimit të personave me varshmëri* (neni 323b), *Mosofrimi i ndihmës mjeksore dhe shpëtimit* (neni 323c).

Segmenti i sigurisë ekonomike në kodin penal është i kufizuar që qështjet e sigurisë së punëtorëve në punë dhe atë përmes inkriminimit të rasteve të *Mospagesës dhe keqpërdorimit të pagave* (neni 266a) dhe *Shkaktimi i rrezikut gjatë punëve në ndërtimtari* (neni 319). Këto parashihen si norma që ligjdhënësi ka pare të arsyeshme të jenë pjesë e Kodit penal ndërkaq siguria më e gjerë ekonomike sanksionohet me ligje tjera të veqanta.

Segmenti i sigurisë politike kërcënohet nga *represioni politik* dhe *abuzimet e të drejtave të njeriut*. Normat penalo juridike që mbrojnë qytetarin nga represioni politik janë të përcaktuara në dy (2) kapituj, respektivisht kapitulli 18 “*Veprat kundër lirisë personale*” inkriminon veprën penale “*Burgimi i paligjshëm*” (neni 239), ndërsa kapitulli 30 “*Veprat e shkaktuara në zyre publike*”, mbron qytetarin nga represioni politik përmes veprave penale si në vazhdim: “*Heqja e një akti zyrtar*” (neni 336); “*Tarifa e arbitrazhit*” (neni 337); “*Shkaktimi i lëndimit trupor gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare*” (neni 340); “*Detyrimi i*

ndonjërit për të dhënë deklaratë” (neni 343); “*Ndjekja e qëllimshme ose me dashje e personave të pafajshëm*” (neni 344); dhe “*Zbatimi i sanksioneve penale kundër personave të pafajshëm*” (neni 345). Abuzimet me të drejta të njeriut me norma penalo juridike nga kapitulli 18 të emërtuar “*Veprat kundër lirisë personale*” që përfshijnë: “*Trafikimi me qenie njerëzore me qëllim të shfrytëzimit seksual*” (neni 232); “*Rrëmbimi i të miturit nga kujdesi i prindërve të tyre*” (neni 235); “*Trafikimi i fëmijëve*” (neni 236); “*Martesa e dhunshme*” (neni 237); “*Rrëmbimi me qëllim shantazhimi*” (neni 239a); dhe “*Pengmarrja*” (neni 239b). Segmenti i sigurisë politike në një shtet reflektohet nga zgjedhjet e drejta lokale dhe parlamentare ose nga keqpërdorimi i zgjedhjeve që për pasojë të zgjedhurit nuk kanë legjitimitet përfaqësues të popullit por autorizim të përfaqësimit të grupeve të interesit të cilët i kanë ndihmuar që të zgjedhen për deputet. Kodi penale i Republikës së Gjermanisë, lidhur me keqpërdorimet në zgjedhje ka përcaktuar tërë kapitullin katër (4), të titulluar “*Krimet kundër institucioneve Kushtetuese dhe në kontekstin e zgjedhjeve dhe fletëve të votimit*”, që përfshinë 12 vepra penale. Ajo që vërehet qartë në Kodin e Gjermanisë i cili ofron një siguri shtesë për barazinë politike dhe shmangien e represionit politik është pikërisht inkriminimi si vepër penale *Shkaktimin e rrezikut të përndjekjes politike përmes përdorimit të forcës, kërcënimeve apo mashtrimit* në nenin 234a. Ky nen paraqet një sinonim të një shteti demokratik ku vlerat demokratike të barazisë për të gjithë janë qartazi të dhëna njo vetëm në mënyrë deklarative kushtetuese por që janë thellë të mishëruara edhe në legjislacionin penal për një siguri më të madhe juridike.

Në aspekt të zbatimit praktik të mbrojtës së të drejtave të njeriut, raporti i Amnesty International (AI, 2016: 165), shpërfaq edhe problematikën e dekadës së fundit në botë, e rrjedhimisht edhe në Evropë, siq janë rritja e ekstremizmit islamik dhe kriza e refugjatëve.

Këto zhvillime kanë ndikuar në masë në tensionet dhe krimet e urrejtjes drejtuar në veqanti ndaj populates myslimane në Gjermani dhe për pasojë edhe diskriminim të një komuniteti të tillë duke minuar kështur sigurinë në bashkësi. Një gjë tjetër që ven në pah raporti është edhe shkelja e të drejtave dhe keqtrajtimi nga ana e autoriteve që automatikisht ngrit edhe kërcënimin e sigurisë politike përmes shkeljes së të drejtave të njeriut, në veqanti duke mos paraparë mekanizma efektiv për adresim të këtyre shkeljeve.

KAPITULLI VII: EKUILIBRI I PJESËMARRJES

7.1 Mekanizmat vendor të sigurisë

Institucionet vendore të sigurisë përcaktohen me kushtetutë (KK, 2008, kapitulli XI), duke theksuar parimet themelore në kontrollit civil të institucioneve të sigurisë. Kushtetuta themelon një numër të institucioneve të sigurisë, udhëheqja e të cilave vendoset mbi parimin e ekuilibrit në mes pushteteve: kontrolli civil dhe ekuilibri në ushtrimin e kompetencave në lëminë e sigurisë. Këto dy segmente përkufizojnë standardet më të avancuara në përdorimin e forcës fizike kolektive nga ana e shtetit në kohë paqeje dhe në kohë të luftës, kjo ngase forca pa kontroll shembet nga vetë pasha e saj (*lat. Vis consilli experts mole ruit sua*- thënë nga Horaci). Qeverisja e veprimtarisë së Institucioneve të Sigurisë në Republikën e Kosovës përcaktohen nga Kushtetuta, e cila ndërton modelin e ushtrimit të mandatit të institucioneve të sigurisë si dhe përcakton autoritetin e përgjithshëm kushtetues për kontrollimin e tyre. Parimi i parë i qeverisjes së institucioneve të sigurisë është parimi Maks Veber-it, me të cilin përjashtohet çdo autoritet tjetër jo-shtetëror për t'u marrë me çështje nga sektori i sigurisë. Pra, Republika e Kosovës ka

monopol në këtë çështje duke përjashtuar çdo aktor tjetër, për t'u marrë me çështje të sigurisë në mënyrë legjitime.

Në një botë që është duke u globalizuar vazhdimisht, Republika e Kosovës nuk mund të jetë immune ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve të ndërlidhura me këtë zhvillim dhe në këtë kontekst Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka krijuar kornizën ligjore për institucionet e sigurisë së Kosovës, të cilat përbëjnë sektorin e sigurisë, që janë: KSK; PK; AKI dhe ACA. Të gjitha institucionet e sigurisë janë politikisht neutrale dhe i nënshtrohen mbikëqyrjes civile dhe demokratike (Qeveria Kosovës, 2010:6).

Forca e Sigurisë së Kosovës, sipas neni 126 të Kushtetutës së Kosovës, është forcë kombëtare e sigurisë për mbrojtjen e qytetarëve dhe komunitetet e Republikës së Kosovës. Kuvendi, Presidenti, Kryeministri dhe Ministri i Forcës së Sigurisë përbëjnë zinxhirin e mbikëqyrjes civile të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në pajtim me nenin 14 të ligjt, Forca e Sigurisë së Kosovës përbëhet nga një komponentë aktive prej më së shumti 2500 pjesëtarë dhe nga një komponentë rezervë prej më së shumti 800 pjesëtarë. Në kuadër të mandatit të saj FSK-ja në pajtim me nenin 10-të të Ligjit për FSK-në, ka edhe pjesëmarrjen në operacionet për reagim ndaj krizave, përfshirë operacionet në mbështetje të paqes. Në funksion të përmbylljes së procesit të transformimit të FSK-së dhe krijimit të Forcës së Armatosur të Kosovës (FAK), me 25 prill 2014, Qeveria e Kosovës ka aprovuar Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve (38 ligje) që ndërlidhen me këtë proces. Pas miratimit të ligjit, pritet të fillojë përafrimi me NATO-n, me qëllim të inkuadrimit si anëtare e barabaratë përkrah Republikës së Shqipërisë, duke u rreshtuar në forcën më të madhe të sigurisë kolektive, e cila ka qëllim të trashëguar që nga paraardhësi i saj, Lidhja e Kombeve (Kelsen, 1948:783).

Këshilli i Sigurisë së Kosovës (KSK). Kushtetuta e Kosovës në nenin 127, në mënyrë të qartë autorizon Këshillin e Sigurisë së Kosovës (KSK) për të zhvilluar Strategjinë e Sigurisë të Republikës së Kosovës, duke vepruar për këtë qëllim në bashkëpunim me Presidentin e Kosovës dhe Qeverinë. KSK-ja ushtron funksione ekzekutive që kufizohen në funksionet që ndërlidhen në veçanti me gjendjen e jashtëzakonshme (në pajtim me nenin 131.8 të Kushtetutës së Kosovës). Si edhe shumica e institucioneve të sigurisë, edhe në kuadër të KSK-së, funksionon qendra e situatave, përgjatë 24 orëve të ditës, e cila ofron informata të shpejta rreth gjendjes dhe koordinon aktivitetet operacionale në tërë Kosovën. Qendra e situatave në pajtim me nenin 17 të KSK-së, shërben si qendër operacionale për mbledhjen e informatave, analizave themelore dhe mbështetjes për menaxhim të krizave. Këshilli i Sigurisë së Kosovës në pajtim me nenin 9 të Ligjit për KSK-në, nënshtrohet mbikqyrjes Parlamentare.

Policia e Kosovë (PK). Në pajtim me nenin 18 të Kushtetutës së Kosovës ka përgjegjësi për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Ligji (04/L-076) për Policinë e Kosovës rregullon autorizimet, detyrat dhe organizimin si dhe çështje tjera të ndërlidhura me aktivitetet dhe veprimet e Policisë së Kosovës, përfshirë organizimin e saj në nivel qendror dhe lokal, Numri i përgjithshëm i policëve është 7193 (FRIDOM, 2010:42). PK-ja në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve për menaxhimin e incidenteve të mëdha, duhet të pajiset me mjete të përshtatshme (*makina të blinduara*) (Qeveria Kosovës, 2014:38).

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI). është themeluar dhe funksionon në bazë të nenit 129 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ligjit (03/L-063) për AKI-në. Agjencioni në pajtim me nenin 2 të Ligjit, mbledhë informacion në lidhje me kërcënimet

ndaj sigurisë së integritetit territorial, integritetit të institucioneve, rendit kushtetues, stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik, si dhe kërcënimet ndaj sigurisë globale në dëm të Kosovës. Agjencioni në pajtim me nenin 129 të Kushtetutës së Kosovës është përgjegjëse për zbulim, vlerësim, hetim dhe mbikëqyrje të kërcënimeve ndaj sovranitetit të Kosovës, integritetit territorial, stabilitetit shoqëror-politik, krimit të organizuar, terrorizmit dhe kërcënimeve tjera të brendshme ose të jashtme.

Autoriteti Civil i Aviacionit (ACA). Është themeluar në pajtim me nenin 130 të Kushtetutës së Kosovës dhe rregullon veprimtarinë e aviacionit civil në Republikën e Kosovës si dhe në pajtim me ligjin (03/L-051) të ACA-së, është ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror. Aktualisht i tërë kontrolli i hapësirës ajrore të Kosovës mbetet nën autoritetin e NATO/KFOR-it., por sidoqoftë, kontrolluesit e kualifikuar dhe të licensuar të Trafikut Ajror kontrollojnë aterimin dhe nisjen e mjeteve fluturuese në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës (Qeveria Kosovës, 2014:10). Hapësira e sipërme ajrore e Kosovës do të menaxhohet nga autoriteteve hungareze (HungaroControl Ptc.Ltd), përgjatë pesë viteve të ardhshme, pastaj Institucinet vendore do të jenë përgjegjëse për menaxhimin e hapësirës së saj ajrore (Qeveria Kosovës, 2014:24).

Të gjitha këto institucione kushtetuese, janë të obliguara të garantojnë sigurinë njerëzore, mirëpo, meqenëse segmentet e sigurisë njerëzore në Republikën e Kosovës është e cenuar në vazhdimësi, atëherë egziston dilema, nëse këto institucione janë duke e kryer obligimin e tyre kushtetues, garantimin dhe mbrojtjen e sigurisë njerëzore.

7.2 Qytetaria pjesëmarrëse

Një nga parimet bazë të parandalimit dhe mbrojtjes së sigurisë njerëzore është qasja multisektoriale përmes pjesëmarrjes së qytetarëve. Në vitet e fundit në shtetet demokratike,

idea e bashkëprodhimit të sigurisë është rritur në masë të madhe, ngase është kuptuar se për të gëzuar sigurinë duhet kontribuar për të. Kjo nënkupton se edhe qytetari duhet të jetë pjesë e makanzimit gjithpërfshirës në ofrimin e sigurisë njerëzore. Ekzistenca e mekanizmave që do të shtjellojmë më poshtë tregon qartazi se falë ndikimit të madh të bashkësisë ndërkombëtare Kosova ka ecur shumë më përpara në krijimin e partneritetit me qytetarë.

Kontributi qytetarëve përmes “Ekipeve të Veprimit për Sigurinë në Bashkësi”

(EVSB): EVSB-të janë grupe të organizuara në nivel komunal përbërë nga përfaqësues nga komuniteti, qeveritë lokale dhe policia. EVSB-të janë themeluar nga programi i ICITAP/Departamenti i Drejtësisë-SHBA si dhe ndihmuar nga misioni i OSBE-së në Kosovë (MPB, 2011:17). Qëllimi i EVSB-ve është identifikimi dhe adresimin e kërcënimeve që rrezikojnë sigurinë njerëzore dhe kualitetin e jetës e tërë kjo për një qëllim të përbashkët- krijimin e një bashkësie më të sigurt. Aktivitetet e këtyre ekipeve janë të përqendruara në çështjet e llojllojshmërisë, sjelljes negative nëpër shkolla, prostitucionit, edukimit shëndetësor dhe çështjet e të pastrehëve, EVSB-të kanë identifikuar dhe adresuar shumë brenga të sigurisë dhe qetësisë në komunitetet ku ata punojnë. Pra, në këtë aspekt mund të konkludojmë se këto ekipe angazhohen në ruajtjen e sigurisë njerëzore në lokalitetet ku ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

EVSB-të, strategjia kombëtare e sigurisë në komunitet dhe strategjia e policisë në komunitet: Theksojmë se EVSB-të janë pjesë esenciale e arkitekturës në zhvillimin mbi sigurinë në komunitet. Si një forum i sigurisë në komunitet i nivelit lokal EVSB-të janë të institucionalizuar si kontribues kryesor të sigurisë në komunitet të Kosovës duke qenë të njohur në mënyrë të drejtpërdrejtë në Strategjinë Kombëtare të Sigurisë në Komunitet si

dhe në Strategjinë e Policisë së Kosovës mbi Policinë në Komunitet. Në vitin 2011 Qeveria e Kosovës ka aprovuar Strategjinë Kombëtare të Sigurisë në Bashkësi (SKSB) dhe Strategjia e Policisë në Bashkësi (SPB) e Policisë së Kosovës (MPB, 2011). Me këtë EVSB-të janë institucionalizuar si komponentë kritik të infrastrukturës Kosovare të sigurisë në bashkësi.

Kontributi qytetarëve përmes Këshillave Komunalë për Sigurinë në Bashkësi

“KKSB”: Pas themelimit të EVSB-ve, në shumicën e komunave të Kosovës, është konstatuar se mungon një hallkë lidhëse në mes EVSB-së, dhe institucionit të Komunës. KKSB-të janë themeluar në vitin 2009 në të gjithë Kosovën me vizion të përmirësimit të sigurisë dhe stabilitetit në bashkësi. Duke parë rendësinë dhe kontributin që KKSB-të mund të japin në sigurinë në komunitet, KKSB-të janë bërë pjesë e infrastrukturës ligjore, duke u trajtuar në Ligjin për Policinë e nr.: 03/L-035 dhe Udhëzimin Administrativ (MPB, UA 27/2012:RKS) i cili ka definuar pozicionin e KKSB-së, duke e lidhur më ngushtë KKSB-në me Kuvendin e Komunës (MAPL, 2013:21). KKSB-ja mbështet një qasje jo-tradicionale dhe gjithëpërfshirëse për sigurinë në bashkësi dhe parandalimin e krimit dhe dukurive të tjera negative, parimet udhëzuese të përcaktuara nga Zyra e Kombeve të Bashkuara duhet të mbeten në krye të aktiviteteve të KKSB-së (UNODC, 2013). Këto parime udhëzuese përfshijnë: Lidërsip konstruktiv qeveritar; Zhvillimi dhe përfshirja socio-ekonomike; Bashkëpunimi/partneriteti; Qëndrueshmëria/ përgjegjësia; Njohuria bazike; Të drejtat e njeriut/sundimi i ligjit/kultura e ligjshmërisë; Ndërvlerësia dhe Dallimet (UNODC, 2013). Qëllimi i KKSB-ve është ngritja e vetëdijes për lloje të ndryshme të krimit, prishjes së rendit dhe sjelljeve të dhunshme brenda komunitetit lokal, si dhe identifikimi i shqetësimeve lokale sa i përket sigurisë publike, me qëllim të krijimit të një komune apo

qyteti sa më të mirë dhe më ideal për të jetuar, ngase jashtë një qyteti ideal, nuk dote ketë asnjë njëri të mirë (Irwin, 1989:41).

Me qëllim të mbështetjes së parandalimit të krimit dhe sigurimit të prosperitetit në bashkësi, KKSB-ja kërkon nga zyrtarët përgjegjës të sigurisë, të punojnë me përfaqësuesit e shoqërisë civile si dhe zyrtarët nivel lokal, për të zbatuar politikat e qeverisjes së mirë. Ky koncept në shumë vende të botës njihet si "policimi në bashkësi", detyrat dhe përgjegjësitë e KKSB-të si organe komunale këshilluese për çështjet e sigurisë (MPB, 2011:16), të cilat në bashkëpunim me policinë, analizojnë dhe shqyrtojnë të gjitha çështjet e sigurisë së komunitetit për të mirën e gjithë qytetarëve që jetojnë në komunë.

Me KKSB-të forcohet edhe më shumë qasja e re bërjes së sigurisë njerëzore si përgjegjësi jo vetëm e Policisë së Kosovës, por edhe strukturave të nivelit lokal dhe shoqërisë civile. KKSB-ja siguron një forum të veçantë për t'i bashkuar në një vend këto grupe të interesit (MAPL, 2014).

7.3 Kapacitetet rajonale të sigurisë

Numri i përgjithshëm i personave të uniformuar (forcat policore dhe ushtarake) në shtetet e rajonit është rreth 200.000. Pra, në rast hipotetik të krijimit të një fuqie ballkanike për siguri dhe emergjenca, ajo fuqi do të kishte në dispozicion një numër të konsiderueshëm të fuqisë për t'i dalur në ndihmë mbi 23 milion banorëve të këtyre shteteve të rajonit. Në kuadër të forcave në Ballkan, duhet theksuar edhe prezencën dhe fuqinë e KFOR-it, në Kosovë.

Në vazhdim prezantojmë tabelën në të cilën pasqyrohen të dhënat specifike për numrin e forcave mbrojtëse dhe të sigurisë në këto shtete.

#	Shteti	Popullata	Ushtarë	Policë
1	Shqipëria	3,011,405	14,250	9915
2	Bosnja dhe Hercegovina	3,875,723	10,500	16.733
3	Kroacia	4,475,611	16,550	21.339
4	Kosova	1,859,203	2,500	8.445
5	Maqedonia	2,087,171	8,000	11.411
6	Mali i zi	653,474	2,080	4.210
7	Serbia	7,243,007	28,150	45.000
	Gjithsej	23,205,594	82.030	117.053

Figura 7.3.1. Fuqia e sigurisë në rajon

Përveç këtyre forcave të sigurisë, në rajon mund të angazhohen edhe forcat e sigurisë kolektive, të cilën e përbëjnë shtetet e interesuara, të cilat në raste të veçanta anashkalojnë disa rregulla dhe norma me qëllim që të largimin të një rreziku të madh që rrezikon qytetarët e tyre (Kupchan, 1995:52-61). Siguria kolektive është një ide e vjetër, të cilës po i vjen koha (Betts, 1992:5-43) që përmes aksionit kolektiv të largojnë kolektivisht një të keqe të identifikuar (Orakhelashvili, 2011:4-86).

Përveç shteteve, sigurinë kolektive mund të ofrojë edhe Këshilli Sigurimit i OKB-së (Sarooshi, 1999:14) edhe pse duket se askush nuk beson në shanset e sigurisë kolektive; për shkak të karakterit të saj kundërt, është në kundërshtim me imperativat e maturisë për luftën bërthamore (Koskeniemi, 1995:455).

KAPITULLI VIII: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

8.1 Konkluzione:

1. *Siguria njerëzore dhe përgjegjësia për mbrojtjen ndaj kërcënimeve komplekse të saj.* Koncepti “siguria njerëzore” në të gjitha variantet e përcakton individin objekt kryesor referimi. Pasiguria njerëzore në shumë raste paraqitet si pasojë e mjungesës së sundimit të ligjit, qeverisjes së dobët dhe zhvillimit të pamjaftueshëm shtetëror. Kauzaliteti i lidhjeve në mes të qeverisjes së dobët dhe ngecjes zhvillimore, mund të jetë shumëfaktorial dhe me ndërlidhje të shumta: kërcënimet nga papunësia apo tensionet ndëretnike mund të jenë lidhje kauzaliteti apo shkakësore, të ndërlidhura me dhunën politike. Për më tej, kauzaliteti mund të reflektojë me një raport të ndërlidhur ‘bumerang’: Papunësia dhe ngecjet zhvillimore jo vetëm që mund të kategorizohen si shkak-pasojë e dhunës politike, por mund të rezultojë me rritjen e papunësisë dhe ngecje të zhvillimit ekonomik. Parandalimi dhe reagimi ndaj dhunës politike të zbatuar nga aparati shtetëror mund të realizohet përmes diplomacisë ndërkombëtare dhe asaj rajonale. Reagimi diplomatik kërkon adresim adekuat ndaj vet represionit të pushtetit shtetëror, duke u bazuar në lirinë nga frika, pasiguria dhe nga nevoja, për qytetarët e Republikës së Kosovës. Duke e konsideruar vëmendjen e shkollës së konceptimit të ngushtë me dhunën politike si variabël e varur dhe fokusin e shkollës së konceptit të gjerë mbi zhvillimin njerëzor si variabël e pavarur, krijohet mundësia e një konteksti politik për të kuptuar kauzalitetin dhe politikat e parandalimit dhe reagimit ndaj pasigurisë njerëzore.

2. *Siguria njerëzore dhe korelacioni me të drejtat e njeriut.* Siguria njerëzore trajtohet kryesisht përmes të drejtave të njeriut. Në bazë të analizës së dokumenteve të

ndryshme ndërkombëtare kemi arritur në konkludimin se, në fakt, mbrojtja më e mirë që mund t'i ofrohet qytetarit është pikërisht trajtimi i segmenteve të sigurisë njerëzore përmes të drejtave të njeriut, duke vënë në fokus përgjegjësinë e shtetit për të mbrojtur këto të drejta. Në dekadat e fundit GjEDNj gjatë shqyrtimit të rasteve të prezantuara para kësaj gjykate ka trajtuar obligimin shtetëror nga dy aspekte:

- Obligimit negativ sipas Konventës (KEDNj), që nënkupton se shteti duhet të kufizohet nga shkelja e të drejtave të njeriut.
- Obligimit pozitiv sipas Konventës dhe standardi i 'Kujdesit të shtuar' i cili si standard i ri nënkupton se shteti duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar sigurinë e individëve nën juridiksionin e vet.

Kjo e fundit nënkupton se në momentin kur shteti vihet në dijeni të kërcënimeve të rrezikojnë jetën, mirëqenien dhe sigurinë e individëve duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të shmangur një rrezik të tillë, i cili njëkohësisht paraqet edhe rrezik për sigurinë njerëzore. GjEDNj ka trajtuar një numër rastesh kur është konstatuar pikërisht përgjegjësia e shtetit për mosmbrojtjen e individit nga kërcënimet e sigurisë. Duke qenë se puna e kësaj Gjykate është mjaft dinamike dhe që në vazhdimësi bëjnë interpretim të zgjeruar të dispozitave të KEDNj autoritetet në Kosovë duhet siguruar një mekanizëm i cili në mënyrë të vazhdueshme do t'i bënte të qasshme këto vendime, në gjuhët zyrtare të Kosovës, për profesionistët ligjor.

3. Siguria politike. Shikuar nga analizimi përmbledhës i dispozitave kushtetuese dhe penale konkludojmë se Kodi Penal i Kosovës, por edhe një numër i ligjeve tjera përmbajnë norma të cilat mjaftueshëm mbrojnë dhe inkriminojnë veprat të cilat mund të cenojnë sigurinë politike të qytetarëve. Me gjithë proceset integruuese të Republikës së

Kosovës, si shtet Kosova ka arritur të bëjë një reformë të jashtëzakonshme me qëllimin të avansimit të drejtat e njeriut, por edhe për forcimin e institucioneve shtetërore. Megjithatë, duke pasur parasysh vakuumin e madh të viteve të 90-ta, e më pas qeverisjen e shtetit nga organet mikse ndërkombëtare dhe vendore, duket sikur Kosova prapë se prapë ka dështuar në trasimin e një rruge ku siguria njerëzore të merr vendin e merituar në politikën shtetërore. Zbatimi praktik i normave mbrojtëse mbetet ende një dëshirë e parealizuar dhe Kosova ende mbetet një shtet me një rrugë të gjatë për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut.

4. *Siguria personale.* E drejta në siguri personale është e garantuar me DUDNj dhe KEDNj. Në të dyja këto dokumente e drejta në jetë dhe liri janë të drejtat kryesore që kërkojnë mbrojtje. Edhe GJEDNj në jurisprudencën e vet ka një numër shumë të madh të rasteve që ka trajtuar ku këto raste pikërisht iu janë referuar të drejtës së individit në siguri personale. Në veqanti, kohëve të fundit kjo gjykatë është fokusuar në konstatimin e dështimit të shtetit për të mbrojtur qytetarët e vet dhe dinjitetin dhe integritetin e tyre si obligim pozitiv që ka shteti sipas KEDNj. Duke pasur parasysh se kërcënimet ndaj këtij segmenti të sigurisë janë të shumta andaj edhe e njëjta është e mbuluar me një numër të madh normash në Kodin penal të Kosovës dhe ligjet tjera relevante. Mund të themi se është pikërisht kjo kategori e në veqanti veprat e terrorizmit që përveq që kërcënon sigurinë individuale ka implikime edhe të rrezikimit të sigurisë së përgjithshme dhe për këtë edhe fokusi i përqendrimit të mbrojtjes shtetërore është vënë pikërisht në këtë të fundit. Sa i përket mbrojtjes legislative që i ofrohet këtij segmenti të sigurisë në Kosovë mund të thuhet se është shumë e avansuar.

5. **Siguria e bashkësisë.** Përmes kushtetutës, Republika e Kosovës garanton drejtësinë sociale, mirëqenien ekonomike dhe përparimin e jetës personale dhe të përbashkët duke krijuar pajtueshmëri me konceptin e segmenteve të sigurisë individuale dhe të bashkësisë në kuadër të sigurinë njerëzore. Meqenëse Kushtetuta reflekton garantuesin, përveç tjerave, edhe sigurinë në bashkësi, mbrojtja e saj bëhet përmes përligjes së normave penale juridike në kodin penal. Qytetarët e Kosovës duhet të jenë të lirë dhe të barabartë me të tjerët, dhe pastaj përmes garantimit të gjuhës dhe shkrimit të komunikojnë të barabartë me komunitetin e tyre dhe me të tjerët. Pra vetëm qytetarët që kanë ndjenjën e barazisë para Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës kanë ndjenjën e sovranit. Kosova në vazhdimësi është duke u ballafaquar me qështje të sigurisë së komuniteteve të ndryshme si grupet e ndryshme etnike, komuniteti LGBT, popullsia Rome dhe tani edhe problematika e tensioneve ndër-fetare për shkak të ekstremizmit islamik. Duke pasur parasysh se është pikërisht populli ai që i pari ballafaqohet me kërcënimet andaj është edhe e kuptueshme që populli si sovran të konsultohet në çdo rast kur rrezikohet siguria e tyre personale dhe në komunitetet e tyre sepse pa një siguri të tillë është i pakuptimtë edhe ekzistimi i vet *shtetit të të gjithëve*. Në linjë me konceptet e mësipërme të sigurisë në bashkësi përmes partenritetit me qytetarë dhe duke pasur parasysh tashmë ekzistimin e mekanizmave të tillë si KKSB dhe EVSB.

6. **Siguria ekonomike.** Siguria ekonomike të qytetarit garantohej përmes mbrojtjes së pronës dhe të drejtës së punës dhe ushtrimit të profesionit pa kufizime. Kushtetuta e Republikës së Kosovës i garanton secilit të drejtën e zgjedhjes së profesionit dhe vendit të punës. Janë po të njëjtat të drejta të cilat janë të proklamuar edhe me Paktin ndërkombëtar për të drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe Kartën Sociale

evropiane, andaj edhe mund të thuhet se të drejtat ekonomike ngrisin obligime që janë më shumë se vetëm obligime kombëtare. Në Republikën e Kosovës të drejtat ekonomike janë të rregulluara edhe me dispozitat e Kodit Penal. Përgjithësisht mund të thuhet se mbulimi i këtyre veprave përmes legjislacionit vendor është i mjaftueshëm me mundësinë që në të ardhmen të mund të rregullohen edhe më detajisht për të ofruar mbrojtje gjithpërfshirëse. Meqenëse, të drejtat ekonomike dhe sociale janë të drejta kushtetuese.

7. **Siguria ushqimore.** E drejta ndërkombëtare dhe kushtetuta e Republikës së Kosovës ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme të këtij segmenti të sigurisë njerëzore duke njohur se qasja në furnizime adekuate me ushqime paraqet nevojën dhe të drejtën më bazike njerëzore. Uria paraqet shkelje të dinjitetit të njeriut dhe një pengesë e progresit social, politik dhe ekonomik. Legjisacioni Penal i Kosovës përmban norma penalo juridike të mjaftueshme që mbrojnë qytetarët nga kontaminimi i qëllimshëm apo i paqëllimshëm i ushqimit për konsum. Mirëpo, përkundër ekzistimit të këtyre normave penale të cilat sanksionojnë personat që çënojnë kualitetin e ushqimit të qytetarëve, kjo dukuri është shumë prezente në tërë territorin e Kosovës. Për shkak të rasteve të shumta të dokumentuara në Kosovë kur tregtuesit e ndryshëm kanë manipuluar me sigurinë e produkteve.

8. **Siguria shëndetësore.** Duke marrë parasysh se siguria shëndetësore synon ofrimin e mbrojtjes së mjaftueshme për qytetarët, nga sëmundjet e ndryshme dhe trajtimin e përgjegjshëm shëndetësor të qytetarëve mund të konkludojmë se një mbrojtje e tillë është mjaftueshëm e paraparë me norma penalo juridike dhe norma tjera në Kosovë. Ajo që përgjithësisht mungon në Kosovë, sikurse edhe në segmentet tjera të sigurisë njerëzore, është zbatimi praktik i këtyre normave dhe një llogaridhënie më e madhe e zyrtarëve që

janë të thirrur për ofrimin e një mbrojtje të tillë. Vlerësohet se në aspekt të mbrojtjes së qytetarëve është e domosdoshme që të punohet më shumë zbatimin e dispozitave të ligjit Nr. 04/L-249 për sigurimin shëndetësor, të miratuar me datë 25.04.2014, në mënyrë që të punësuarit në Institucionet e Republikës së Kosovës, do të mund të realizojnë sigurimin shëndetësor për vete dhe për familjarët e tyre.

9. Siguria mjedisore. Është e drejtë e njeriut të jetojë një jetë të dinjitetshme dhe të shëndoshë. Pasiguria mjedisore rrezikon çdo gjë që ka të bëjë me mirëqenien e individit andaj si e tillë ka ndikim edhe në segmentet tjera të sigurisë. Qytetarët e Kosovës, janë dëshmitarë të degradimit të vazhdueshëm të mjedisit e në veqanti që nga paslufta '99, për shkak se institucionet e Kosovës nuk arritën të krijojnë rregull në aspektin e ruajtjes së ambientit. Para syve të qytetarëve u degraduan shtretërit e lumenjve dhe kodrinave përmes eksplotimit të rërës dhe u dogjën pyje për qëllime të mbulimit dhe lehtësimit të prerjes ilegale të drunjëve. Ky dëmtim i shkaktuar nga qytetari nuk matet me dëmin të cilin e shkaktojnë subjektet industriale të cilat ndotin ajrin me lëshimin e tymit nga furnaltat e tyre në interes të nxjerrjes së produkteve për shitje në treg. Degradimi i mjedisit në Kosovë ka arrit nivelet alarmuese e megjithatë duket të mos jetë as në agjendat shtetërore e në veqanti nuk duket të jetë në agjendën e organeve të Sundimit të ligjit. Sundimi i ligjit ka përvetësuar një praktikë që mendoj se është shumë e gabuar ku personat nuk mbahen përgjegjës për secilën nga shkeljet e shkaktuara (qoftë ajo edhe për mjedis psh. e cila shpesh duket irelevante nga prokurorët) duke përcjellur në këtë formë mesazhin se çdo shkelje është e rëndësishme dhe se asnjë shkelje e asnjë norme sado e vogël të jetë ajo të mos kalojë pa u llogaritur në akuzat që do ti ngarkoheshin atyre kryesve. Kjo të paktën

është një praktikë e vendeve më të zhvilluara radhëve të të cilëve tentojmë ti bashkohemi në të ardhme.

10. *Politika ndëshkimore si mjet për forcimin e sigurisë njerëzore.* Nëse hedhim një vështrim mbi segmentet e ndryshme të sigurisë të shtjelluar përgjatë gjithë materialit të mësipërm do të vërejmë se ajo që Kosova qalon si shtet në masë të madhe është pikërisht zbatimi praktik i dispozitave të parapara me Kodin dhe ligjet tjera në Kosovë. E njëjta mund të thuhet në veçanti për politikën ndëshkimore e cila paraqitet si njëra nga fushat më problematike të Sundimit të ligjit në Kosovë. Kjo politikë e brishtë ndëshkimore ka një ndikim të jashtëzakonshëm në të gjitha sferat e jetës pasi në veçanti përmes politikës më mirë të themi të mosndëshkimit ka bërë amnestimin e shkelësve dhe rrezikuesve të të gjitha të drejtave të njeriut dhe të segmenteve të sigurisë njerëzore. Për pasojë kemi shumë e shumë raste recidivizmi dhe vepra të shumta penale të cilat në baza ditore rrezikojnë sigurinë njerëzore në të gjitha aspektet. Siq u përmend në disa raste, dështimi i Kosovës si shtet qëndron pikërisht në moskujdesin dhe mospërfilljen e disa prej kërcënimeve të sigurisë në Kosovë si: kërcënimet ndaj mjedisit, shëndetit, ushqimit etj., në raport me veprat tjera.

11. *Mekanizmat e sigurisë në Republikën e Kosovës.* Kosovës 16 vite pas luftës mund t'i numërohen mjaft përparime por edhe dështime sa i përket formimit të mekanizmave të cilët janë dhe mund të jenë përgjegjës për mbrojtjen nga kërcënimet e sigurisë njerëzore. Formimi i Policisë së Kosovës para 16 vitesh shënoi hapin e parë për ndërtimin e këtyre mekanizmave. Ajo që vlen të përmendet është se nën udhëheqjen ndërkombëtare PK arriti të avansohet dhe në veçanti të përqafojnë idetë e reja mbi mënyrën e organizimit strukturor. Një nga risitë e saj ishte edhe formimi i Policisë në Komunitet e

cila ishte e dizajnuar për të kuptuar më për së afërmi brengat dhe shqetësimet e popullatës me qëllim që të ofrohet më shumë siguri për qytetarët. Ekipeve e Veprimit për Sigurinë në Bashkësi (EVSb) dhe Këshillat Komunle për Sigurinë në Bashkësi (KKSB), janë dy mekanizma tjerë të themeluar në Kosovë, të cilët më së miri adresojnë nevojën e qasjes multisektorale për adresimin e kërcënimeve të sigurisë përmes partneritetit qytetar institucion. Përkundër ngritjes së bashkëpunimit në disa nga komunat e Kosovës, ato përgjithësisht kanë dështuar në koordinimin dhe realizimin e projekteve konkrete reale në zhvillimin e misionit të tyre për përfshirjen e vet qytetarit dhe bashkëpunimit me të në ofrimin e sigurisë për të gjithë qytetarët.

8.2 Rekomandime

1. Në respektim të obligimit kushtetues nga neni 53, i rekomandojmë Këshillit Gjyqësor i Kosovës të krijoj një mekanizëm, i cili në mënyrë koherente dhe sistematike do të sigurohej që të gjitha vendimet e GJEDNj-së, të përkthehen në gjuhët zyrtare të Kosovës, dhe të njëjtat t’iu vihen në dispozicion gjyqtarëve dhe profesionistëve ligjor, me qëllim që në kuadër të vendimeve të tyre të zbatojnë nenin 53 të kushtetutës, citojmë: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me kushtetutë, interpretohen në hamoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

2. Në mbrojtje të sigurisë personale dhe sigurisë politike të qytetarëve të Republikës së Kosovës, rekomandojmë që norma penale “Ndjekja me qëllim ose me vetëdije e personit të pafajshëm”, nga neni 344 i Kodit Penal të Gjermanisë, të inkorporohet në kapitullin XVII *“Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut”*, në Kodin Penal

të Kosovës. Kjo normë do të sanksiononte zyrtarin publik i cili qëllimshëm apo me vetëdije ndjek penalisht një person të pafajshëm apo këdo tjetër që ndyshe nuk mund të ndiqet penalisht apo bën përpjekje që një ndjekje e tillë të kryhet. Inkorporimi i kësaj norme penale në Kodin Penal, do të ishte në pajtim edhe me nenin 29 [E drejta e Lirisë dhe Sigurisë], të Kushtetutës së Kosovës. Përfshirja e këtij neni në kuadër të legjislacionit vendor, paraqet një garancion shtesë për qytetarët, dhe grupet e caktuara të interesit, se shteti, nuk do të cenoj arbitrarisht: sigurinë e tyre politike dhe personale për të “kënaqur” apetitet e tyre. Kjo mund të jetë veçanërisht evidente në rastet kur aparati shtetëtor përmes ndikimit në sundimin e ligjit, mund të bëjë pa bazë apo padrejtësisht persekutim të oponentëve të tyre politikë, duke u thirrur në pohimin për ndonjë shkelje të dispizitave ligjore nga ana e tyre. Spekulime (me apo pa bazë) për një qasje të tillë janë bërë në masë të madhe gjatë zhvillimeve politike në Kosovë, në periudhën 2015-2016, kur partitë opozitare kanë përdorur metoda të ndryshme, përfshirë edhe ato të dhunshme, në kundërshtimin e veprimeve të pushtetit, duke bllokuar punën e Institucioneve shtetërore.

3. Në frymën e njëjtë sikurse tek rasti i ndjekjes së qëllimshme të personit të pafajshëm, rekomandojmë që edhe norma penale “Zbatimi i sanksioneve penale kundër personave të pafajshëm”, nga neni 345 i Kodit Penal të Gjermanisë, të inkorporohet në kapitullin XVII “Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut”, të Kodit Penal të Kosovës. Kjo normë do t’i ofronte mbrojtje personave të pafajshëm, nga ekzekutimi i padrejtë i dënimit me burgim, masës së trajtimit të ndalimit me rehabilitit dhe ndalimit apo paraburgimit nga autoriteti publik, i cili ekzekuton një sanksion të tillë, në të gjitha rastet kur me ligj një sanksion i tillë nuk mund të ekzekutohet.

4. Në mbrojtje të sigurisë personale, ekonomike dhe politike të qytetarëve të Republikës së Kosovës, rekomandojmë që norma penale “Parandalimi i kthimit në punë”, nga neni 292 i Kodit Penal të Slovenisë, të inkorporohet në kapitullit XIX “Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhënit e punës” të Kodit Penal të Kosovës. Një normë e tillë do të rregullonte çështjen e kthimit të punëtorit në postin e vet, në rast të një vendimi të formës së presë, që i jep të drejtën atij për t’u kthyer në vendin e punës. Arsyeja e përfshijes së kësaj dispozite qëndron në atë se, përderisa legjislacioni ka paraparë mundësinë e parashtrimit të mjetit juridik në Gjykatë, duke u ankuar në largimin e padrejtë (sipas tij) nga vendpunimi, legjislacioni nuk parasheh taksativisht ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit të gjykatës, nga ana e punëdhënësit, në rastet kur e njëjta e gjen si të bazuar kërkesën e punëtorit.

5. Mirëqenia sociale është parakusht themelor i një shoqërie të zhvilluar. Duke shikuar në politikat aktuale në Kosovë, konstatojmë se shteti ka dështuar në mbrojtjen e mirëqenies së fëmijëve. Paketa sociale, respektivisht Ligji nr.2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, siguron mbështetje vetëm për familjet të cilat kanë fëmijë nën moshën 5 vjeçare, duke rrezikuar kështu mirëqenien dhe sigurinë ekonomike, shëndetësore dhe ushqimore të fëmijëve mbi këtë moshë, e aq më tepër mundësimin e arsimit të detyrueshëm fillor, për këta fëmijë. Norma egzistuese ndikon jo vetëm në të ardhmen e atij fëmije dhe familjes së tij apo saj pasi njëkohësisht mundëson uljen e nivelit arsimor të qytetarëve duke krijuar kështu edhe për të ardhmen gjenerata të cilat do të jenë në pamundësi të sigurimit të jetesës së tyre. Në mbrojtje të sigurisë dhe të drejtave të fëmijëve të kësaj moshe rekomandojmë ndryshimin e nenit 4 (kriteret jofinanciare për ndihmë sociale) të Ligjit Nr.2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, duke ndjekur

shembullin e frymës së dispozitave të neneve 2 dhe 10 të Ligjit të Republikës së Kroacisë Nr.94/01; 138/06; 107/07; 37/08; 61/11; 112/12; 82/15 (2015), mbi shtesat e fëmijëve, të cilat parashohin asistencë sociale për familjet me fëmijë deri në moshën 15 vjeçare, respektivisht, deri në moshën 19 vjeçare, nëse fëmiju vazhdon shkollimin e rregullt në shkollë të mesme. Të njëjtat dispozita sigurojnë që këtë asistencë ta gëzojnë fëmijët e familjeve, të ardhurat e të cilave janë deri në 50% nën pagën minimale në Republikën e Kroacisë. Përfshirja e një praktike të tillë në Kosovë siguron që asistencë për këta fëmijë, të mos kushtëzohet vetëm nga fakti, nëse familja nuk gëzon fare të ardhura, por edhe atëherë kur ato të hyra nuk janë të mjaftueshme për sigurimin e mëreqenies së tyre.

6. Për të ofruar një mbrojtje më të suksesshme të të gjitha segmenteve të sigurisë rekomandojmë që ashpërsimi i sanksioneve penale, të bëra në Kodin penal të vitit 2013, të përcillet edhe me ashpërsim të politikës ndëshkimore – përmes sistemit të matjes së dënimeve (sanksioneve). Matja e dënimeve do të duhej bërë përmes një Udhëzuesi që do të ndihmonte jo vetëm në matjen e dënimit por edhe në sanksionimin uniform në tërë Kosovën. Një praktikë e tillë realizohet në disa vende të botës por me theks të veçantë në SHBA dhe Britani të madhe. Të dyja këto shtete kanë një sistem mjaft efikas të organizimit të kësaj politike përmes manualëve udhëzues:

- Manuali për matjen e dënimeve në SHBA - *United States Sentencing Commission, Guidelines Manual, §3E1.1 (Nov. 2015)*;
- Manuali për matjen e dënimeve në Britaninë e madhe: *Sentencing Guidelines Council, Magistrates' Court Sentencing Guidelines (2008)*;

Një Udhëzues për matjen e dënimeve në Kosovë, do të ofronte mbrojtje të shumfishtë:

- Sigurimin e trajtimit të barabartë të kryesve të veprave të ngjajshme në veçanti duke siguruar që dënimet të mos shërbejnë si mjet i represionit shtetëror apo politik.
- Sigurimin që pesha e veprës të përcaktojë edhe lartësinë e dënimit duke numëruar secilin faktor i cili mund të ashpërsojë apo zbus dënimin. Kjo është me vlerë sidomos në veprat të cilat në Kosovë nuk u kushtohet fare rëndësi e të cilat paraqesin kërcënim të sigurisë mjedisore, ushqimore e shëndetësore. Përmes një udhëzuesi të tillë secila nga veprat do të ishin relevante dhe do të llogariteshin në lartësinë e dënimit.
- Përmes një politike të tillë ndëshkimore ku secili faktor ka peshën e vet sigurohet ashpërsimi i dënimit. Ky ashpërsim ndikon jo vetëm në kryesin e asaj vepre por ka edhe efekt në shoqëri duke zbrapsur elementet destruktive të shoqërisë dhe njëherësh duke i krijuar popullatës ndjenjën se siguria e tyre mbrohet nga shteti.

LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

Burime parësore:

1. Akt shpallje gjykimi e Gjykata Supreme e Kosovës: Nr. Ap. 8/2010 (14.04.2011).
2. Akt shpallje gjykimi e Gjykatës Komunale në Gjilan: Nr. P.1261/08, (29.12.2008).
3. Akt shpallje gjykimi e Gjykatës Komunale në Prishtinë: Nr. 322/08.
4. Akt shpallje gjykimi e Gjykatës Komunale në Prishtinë: Nr: 2971/08.
5. Akt shpallje gjykimi e Gjykatës Komunale në Prishtinë: Nr: P 164/09.
6. Akt shpallje gjykimi e Gjykatës Komunale të Prishtinës: Nr.1118/85.
7. Akt shpallje gjykimi e Gjykatës Qarkut, S. Pozhega–Kroaci: Nr. Kz.135/89, (25. 09. 1989).
8. Akt shpallje gjykimi e Gjykatës së lartë Lubjanë: KP-1266/93.
9. Akt shpallje gjykimi e Gjykatës së Qarkut në Beograd, Serbi: Nr. Kz. 3046/91 (17. 12.1991).
10. Akt shpallje gjykimi e Gjykatës së Qarkut në Bjelovar, Kroaci: Nr.Kz, 150/92, (9.04.2010).
11. Akt shpallje gjykimi e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë: Nr. Ap. 822/06.
12. Akt shpallje gjykimi e Gjykatës së Qarkut në Prizren: Nr.166/2004, datë 13.07.2005
13. Akt shpallje gjykimi e Gjykatës së Zhupanisë së Bjelovarit, Republika e Kroacisë: Ap, nr.180/98, (28.05.1998).
14. Akt shpallje gjykimi e Gjykatës së Zhupanisë, Bjellovar, Kroaci: Nr. Ap.nr.67/95, (06.04.1995).

15. Akt shpallje gjykimi e Gjykatës së Zhupanisë, në Bjelovar: KŽ-936/88, (19. 1. 1989), *Bilten Županijskog suda u Bjelovaru*, br. 14/90., t. 62, preuzeto iz Bačić, F.; Pavlović, Š., *Komentar Kaznenog zakona*, Zagreb, 2004., str 749, Hrvatska.
16. Akt shpallje gjykimi e Gjykatës Supreme e Kroacisë: Ap.nr.440/2006.
17. Akt shpallje gjykimi e Gjykatës Supreme Federative e Jugosllavisë: Nr. Ap. 115/56.
18. Akt shpallje gjykimi e Gjykatës Supreme të Kosovës: Nr. Ap.23/2005, (15.03.2005).
19. Akt shpallje gjykimi e Gjykatës Supreme të Kosovës: Nr.Ap. 381/2005, (20.12.2005).
20. Akt shpallje gjykimi e Gjykatës Supreme të Serbisë: Nr. Pkl. 1/75.
21. Akt shpallje gjykimi e Gjykatës Supreme të Serbisë: Nr.Kz. 1524/o2, (10.o9.2003).
22. Akt shpallje gjykimi e Gjykatës Komunale në Prishtinë: Nr. 1040/05, (22.12. 2006).
23. Akt shpallje gjykimi i GJ.E.D, rasti Kadi (Case C-402/05 P and C-415/05.P.Kadi and Al Barakaat International Foundation v.Council and Commission [2008], ECR I-6351).
24. Akt shpallje gjykimi i GJ.E.D.NJ, (Application no.5310/71), i datës 18.o1 1978, rasti Irlanda kundër Britanisë së Madhe.
25. Akt shpallje gjykimi i GJ.E.D.NJ, Guerra and others, vs. Italy, (Application no.14967/89), European Court of Human Rights, date of the Ruling 19 February 1998.
26. Akt shpallje gjykimi i GJ.E.D.NJ, López Ostra vs. Spain, (Application no. 16798/90), European Court of Human Rights, date of the Ruling 9 December 1994.

27. Deklarata e Rio-s, për mjedisin dhe zhvillimin, (1992), “*Raporti i konferencës së Kombeve të Bashkuara për mjedisin dhe zhvillimin*”, Asambleja e Përgjithshme, Dist.General, 12 gusht 1992, New York, SHBA.
28. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, (10 dhjetor të vitit 1948), Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, New York, SHBA.
29. Direktiva 2003/54 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës, e datës 26 qershor 2003, në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe shfuqizimin e Direktivës 96/92 / EC.
30. Direktiva e Këshillit të Evropës Nr.2004/80/EC lidhur me kompensimin e viktimave të krimit.
31. Kodi Penal i Kroacisë. Gazeta zyrtare nr.125/11 dhe 144/12, për Kodin Penal të Republikës së Kroacisë miratuar nga kuvendi me 26 tetor 2011.
32. Kodi Penal i Republikës së Gjermanisë. Kodi Penal në versionin e shpallur më 13 nëntor, 1998, Ligji Federal i Gazetës zyrtare [*Bundesgesetzblatt*] I f. 3322, i fundit ndryshuar me nenin 1 të Ligjit të datës 24 shtator 2013, p. 3671 dhe me tekstin e nenit 6 (18) të Ligjit të datës 10 tetor 2013.
33. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-082. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr.19/13 korrik 2012, Prishtinë. Kuvendi Republikës së Kosovës.
34. Kodi Penal i Republikës së Serbisë. Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë, nr.85/2005, 88/2005 - ndryshuar 107/2005, e ndryshuar: 72/2009, 111/2009, 121/2012, 104/2013 i 108/2014. Kuvendi Popullor i Republikës së Serbisë.
35. Kodi Penal i Republikës së Slovenisë. (*Penal Code of the Republic of Slovenia*, (Official Gazette RS, No 55/2208).

36. Konventa Evropiane për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal (Convention on the Protection of the Environment through Criminal Law), *European Treaty Series - No. 172*, Strasbourg, 4.XI.1998.
37. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, (1950), Këshilli Evropës, Romë.
38. Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.
39. Konventa e Hagës, (1980), “Konventa për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijë.
40. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj.
41. Konventa ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve (CRC) neni 24(2)(c).
42. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR) neni 12(2)(b).
43. Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas.
44. Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor.
45. Konventa për të Drejtat e Fëmijës; Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.
46. Kushtetuta e Gjermanisë. Basic Law for the Federal Republic of Germany in the revised version published in the Federal Law Gazette Part III, classification number 100-1, as last amended by the Act of 11 July 2012 (Federal Law Gazette I p. 1478).
47. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (me amendamentet I-XXIII). *Ky botim përfshinë tekstin e Kushtetutes të Republikës së Kosovës (të miratuar me 9 prill 2008) me Amendamentet I - XXII (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 25 dt.*

7 shtator 2012) dhe Amendamentin XXIII (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7 dt. 26 mars 2013).

48. Kushtetuta e Republikës së Kroacisë (*Teksti i pastruar, 15 janar 2014*).
49. Kushtetuta e Republikës së Serbisë. Kuvendi Popullor i Republikës së Serbisë me 8 nëntor 2006, ka marrë vendim për Kushtetutën e Republikës së Serbisë (Gazeta zyrtare RS, nr.98/2006).
50. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Ndryshuar me ligjin nr.9675, datë 13.1.2007; ligjin nr.9904, datë 21.4.2008; me ligjin nr.88/2012, datë 18.9.2012. Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare.
51. Kushtetuta e Republikës së Slovenisë.(Miratuar në: 23 Dec 1991, Ndryshuar më 14 korrik të vitit 1997, më 25 korrik 2000, 7 Mars 2003, 15 qershor 2004, 20 Qershor 2006, Dokumenti ICL Statusi: Maj 25, 2007).
52. Ligji Nr 2003/22, “Për Inspektoriatin Sanitar”, Kuvendi Kosovës.
53. Ligji Nr 94/01, mbi shtesat e fëmijëve në Republikën e Kroacisë, me ndryshim plotësimet 138/06; 107/07; 37/08; 61/11; 112/12; 82/15,
54. Ligji Nr. 03/L-035, “për Policinë e Kosovë”, Kuvendi Kosovës.
55. Ligji Nr. 03/L-045, “Për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës”, Kuvendi i Kosovës.
56. Ligji Nr. 03/L-046, “Për Forcën e Sigurisë së Kosovës”, Kuvendi Kosovës.
57. Ligji Nr. 03/L-050, “Për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës”, Kuvendi Kosovës.
58. Ligji Nr. 03/L-051 “për Aviacionin Civil”, Kuvendi Kosovës.
59. Ligji Nr. 03/L-063,”Për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë”, Kuvendi Kosovës.

60. Ligji Nr. 04/L-076, “për Policinë”, Kuvendi Kosovës.
61. Ligji Nr. 2012/04-L 125 “Për Shëndetësi”, Kuvendi Kosovës.
62. Ligji Nr.03/L-142, “Rendi dhe qetësia publike”, Kuvendi Kosovës.
63. Ligji Nr.03/L-178,”Për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë në Republikën e Kosovës”, Kuvendi Kosovës.
64. Ligji Nr.04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.2003/15 për shkemën e ndihmës sociale në Kosovë.
65. Ligji Nr.2003/15 për Skemën e ndihmës sociale në Kosovës
66. Ligji Nr.2004/38, “Për të Drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve të Kosovës në kujdesin shëndetësor”, Kuvendi Kosovës.
67. Ligji Nr.2006/02-L 38, “Për Inspektoriatin Shëndetësor”, Kuvendi Kosovës.
68. Ligji Nr.2006/02-L 76, “për Shëndetin Riprodhues”, Kuvendi Kosovës.
69. Memorandumi Athinës (08 dhjetor 2003), Memorandum i mirëkuptimit për tregun energjetik rajonal në Evropën Juglindore dhe integrimi i tyre në tregun e brendshëm energjetik të Bashkimit Evropian.
70. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, Miratuar dhe hapur për nënshkrim, ratifikim dhe aderim nga Asambleja e përgjithshme 2200A (XXI) të 16 dhjetorit 1966. Hyrë hyrja në fuqi më 3 janar 1976 në përputhje me nenin 27.
71. Qarkore e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, drejtuar të gjithë kryetarëve të Gjykatave për shqetësimet lidhur me matjen-zbutjen e dënimit.
72. Qarkore e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, drejtuar të gjithë kryetarëve të Gjykatave të qarkut, lidhur me harmonizimin e politikave ndëshkimore.

73. Rekomandimi nr. (92) 17, i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare, lidhur me konsistencën në matjen e dënimeve.
74. Rekomandimet e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për “Kriteret minimale për Inspektimet Mjedisore”, RMCEI 2001/331/EC.
75. Udhëzim Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL, “për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi”, Qeveria e Kosovës.
76. Vendimi OKB, “*Sanksionet e Komisionit për Terroristët*”, (EC Reg.881/2002).

Literturë - Burime dytësore:

1. Agjencia për Barazi Gjinore e Kosovë, (2008), “*Siguria fillon në shtëpi*”, Qeveria Kosovës, Prishtinë, Kosovë.
2. Amnesty International, (2016), “Gjendja e të drejtave të njeriut në botë”, raporti i vitin 2016, Londër, Angli
3. Antti Savela, (2006), *Evaluation of the quality of adjudication in courts of law*”, *Painotolo Suomenmaa*, Oulu, Finlandë.
4. Balbo, M., & Guadagnoli, G. (2009), “*United Nations Trust Fund for Human Security*”, Projects implemented by UN-Habitat in Afghanistan, p.6, Cambodia and Sri Lanka.
5. BIRN, (2011), “*Raporti i monitorimit të Gjykatave 2010-2011*”, BIRN, Prishtinë.
6. Brownlie, Ian, (2008), “*Principles of Public International Law*”, 7 ed, Oxford Press, New York, USA.
7. Climate Change and Human Rights, December 2015, UNEP, Kenia & Columbia Law School, UNEP.

8. Collins, Alan, (2007), *Studime bashkëkohore të sigurisë*, UET Press, Tiranë.
9. Cvijović, O., Popović, D, (1977), “*Priručnik obrazaca za praktičnu primenu zakona u krivičnom postupku*”, Privredna štampa, Beograd, Serbia.
10. Deutsche Stiftung für Internationale rechtliche Zusammenarbeit E.V. GIZ, (2006),
11. Dragoti, Edmond, (2007), “*Psikologjia ligjore e krimi*”, UT, Tiranë. Shqipëri.
12. Elezi, I; Hysi, V, (2006), “*Politika Kriminale*”, PEGI, Tiranë, Shqipëri.
13. Emanuel, Steven, (2002), “*Criminal Law*”, Aspen Publisher, Aspen Colorado, USA.
14. EUCRIM-The European criminal law associations’ forum, (2010), “*Data protection*”, Max Planck society for the advancement of science, Freiburg, Deutschland.
15. EULEX, (2011), “*EULEX Program report 2011- Bolstering the rule of law in Kosovo: A stock take*”, Eulex, Prishtinë, Kosovë.
16. EUROSTAT, (2016), “*Asylum in the EU Member States*”, Press office, Press release 44/2016 - 4 March 2016.
17. Fondi Humanitar për të Drejtat e Njërit (2012), “*Gjyqësori Kosovar ende nuk është i gatshëm për t’u ballafaquar me sfidat më të rënda*”, FHD, Prishtinë, Kosovë.
18. Fondi për të Drejtën Humanitare, (2011), “*Proceset Gjyqësore në Kosovë për krime të luftës dhe vepra penale të motivuara në baza etnike dhe politike*”, FHD, Prishtinë, Kosovë.
19. Food and nutrition security towards human security by Louise O. Fresco Assistant Director-General, Agriculture Department and Wilfried O. Baudoin, Senior Officer, Horticultural Crops Group, FAO, par,28.

20. Gjykata Supreme e Kosovës, (2014), “*Buletini i praktikës gjyqësore së Gjykatës Supreme të Kosovës*”, GJSK, Prishtinë, Kosovë.
21. Gruda, Zejnullah, (2001), “*Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut: Dokumente-II*”, UP, Prishtinë, Kosovë.
22. Gudmundur Alfredsson, Asbjørn Eide, (1999), “*Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut- standardi i arritjes së përbashkët*”, Martinus Nijhoff publishers, Lund, Oslo, Norway.
23. Halili, Ragip, (2005), “*Kriminologjia*”, Universiteti Prishtinës, Prishtinë, Kosovë.
24. Halili, Ragip, (2007), “*Viktimologjia*”, Xhad studio, Prishtinë, Kosovë.
25. Hanski, Raija; Suksi, Markku, (1999), “*Hyrje në mbrojtjen ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut*” bot.2, Instituti për të drejtat e njeriut, Universiteti i Abo Akademisë, Turku, Finland.
26. Harris, D., O'Boyle, M., Bates, E., & Buckley, C. (2014). *Law of the European convention on human rights*, p. 582, Oxford University Press, USA.
27. HRC, (2013), *Report of the Independent Expert on the issue of Human Rights Obligations Relating to the Enjoyment of a Safe, Clean, Healthy and Sustainable Environment*, John H. Knox, pp. 29, 79-81, A/HRC/25/53.
28. International Symposioum -The world society of Victimology, (2012), “*Justice for victims: Cross-cultural perspectives on conflict, truma and reconciliation*”, Tilburg University, Tilburg, Netherlands.
29. Joseph Weiler, (2008), ‘Editorial, Kadi — Europe’s Medellin?’, 19 *European Journal of International Law*, p 895.

30. Juan Carlos Ochoa, S, (2013), “*The rights of Victims in Criminal Justice Proceedings for Serious Human Rights Violations*”, Martinus Nijhoff Publishers, Boston, USA.
31. Këshilli Evropës, QSHDNJ, (2001), “*Për një rend publik Evropian- vendime të zgjedhura të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut*”, QSHDNJ, Tiranë, Shqipëri.
32. Kissinger, Henry, (1999), “*Diplomacia*”, CEU, Leart, Tiranë, Shqipëri.
33. Kombe, Jean-François Akandji, (2003), POSITIVE Obligations under the European Convention on Human Rights, A guide to the implementation of the European Convention on Human Rights, *Human rights handbooks*, (7).
34. Krasniqi, Kolë, (2005), “*Terrorizmi Ndërkombëtar*”, Eugen, Prishtinë, Kosovë.
35. Latifi, Vesel, (2004), “*Kriminalistika*”, UP, Prishtinë, Kosovë.
36. Latifi, Vesel, (2008), “*Politika kriminale*”, Koha, Prishtinë, Kosovë.
Legjislacioni për rendin dhe sigurinë, Qendra Juridike e Kosovës, Prishtinë, Kosovë.
37. Lubet, Steven, (2004), “*Modern trial advocacy*”, NITA, Chikago, USA.
38. Marthews, Bod dhe Ross, Liz, (2010) “*Metodat e hulumtimit- Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane*”, Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë, Shqipëri.
39. Mauet. A, Thomas, (1988), “*Fundaments of trial techniques*”, Little brown, Toronto, Canada.
40. Ministria e Drejtësisë së Kosovës, (2009), “*Doracak për përgatitjen e provimit të Jurisprudencës*”, bot. 3, UNDP, Prishtinë, Kosovë.
41. Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës, (2008-2011) “*Strategjia nacionale dhe*

42. Ministry of justice of Finland, (2006), “*Bill drafting instructions*”, MJ, Helsinki, Finland.
43. NCSC/IFES, (2005), “*Vlerësimi dhe përmirësimi i njohurisë së qytetarëve mbi sistemin juridik*”, NCSC/IFES, Prishtinë, Kosovë.
ndërkombëtare”, Finnish-OHCHR, Human Rights, Support Programme - Kosovo, Prishtinë, Kosovë.
44. Ogata, Sadako, & Sen, Amantya. (2003). Human security now, commission of human security. *Commission on human security*, New York, USA.
45. OHCHR, (2005), “*Të drejtat e Njeriut: Përmbledhje instrumentesh ndërkombëtare*”, vëllimi II, *Biblioteka Kombëtare dhe universitare e Kosovës*, Prishtinë, Kosovë.
46. OSBE, (2010), “*Sistemi i drejtësisë penale në Kosovë*”, OSBE, Prishtinë, Kosovë.
47. OSBE-ODIHR, (2007), “*Završni komentar na Nacrt Ustava Republike Crne*”, Opinion-Nr: GEN – MNG/087/2007, (MASz/IU/DP), Varshavë, Poloni
plani i veprimet kundër trafikimit me qenie njerëzore”, MPB, Prishtinë, Kosovë.
48. Pompelio, Richard D., (2009), “*Crime victims Rights*”, *Equal justice publishing*, New Jersey, USA.
49. Prandel, Jean; Corstens, Geert; Vermeulen, Gert, (2009), “*E drejta Penale Evropiane*”, *Papirus*, Tiranë, Shqipëri.
50. Qendra Juridike e Kosovës, (2011), “*Lex Legis: Ligjet e aplikueshme në Kosovë*-
51. Qendra për të Drejtat e Njeriut Gjenevë, (1994), “*Përmbledhje e Instrumenteve*
52. Qeveria e Shqipërisë, (2015), “*Plani kombëtar për integrimin evropian*” Tiranë, Shqipëri.

53. Richards, Julian, (2012), *“A guide to National Security threats, responses and strategies”*, Oxford university press, Oxford, England.
54. Rizvanolli-Kusari, Benina, (2013), *“Të drejtat e viktimave të krimit- obligim shtetëror: Udhëzues me përmbledhje të dokumenteve ndërkombëtare nga fusha e të drejtave të viktimave të krimit”*, Ambasada SHBA-së në Kosovë, Prishtinë, Kosovë.
55. Salihu, Ismet, (2005), *“E drejta Penale- Pjesa përgjithshme”*, UP, Prishtinë, Kosovë.
56. Salihu, Ismet, (2006), *“E drejta Penale- Pjesa veçantë”*, UP, Prishtinë, Kosovë.
57. Salihu, Ismet, (2011), *“E drejta Penale Ndërkombëtare”*, Universiteti FAMA, Prishtinë, Kosovë.
58. Saliu, Kurtesh, (2004), *“E drejta Kushtetuese”*, bot.4, UP, Prishtinë, Kosovë.
59. Smibert, Jon, (2013), *“Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës”*, Departamenti i Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ambasada e SHBA-së në Prishtinë, Kosovë.
60. Smibert, Jon, (2014), *“Parimet e provave”*, Departamenti i Drejtësisë, Ambasada e SHBA-së në Kosovë, Prishtinë, Kosovë.
61. Sven Marius, Urke, Lynn, Sheehan, (2008), *“Reforma Gjyqësore në Kosovë”*, Ministria e punëve të jashtme e Norvegjisë, Prishtinë, Kosovë.
62. Tadjbakhsh, Shahrbanou, (2005), *“Human security: concept and implications, with an application to post-interventions challenges in Afghanistan, p6, Études du CERI.*
63. The European Security and Defence Union, (2011), *“The European Institutions must now pull together on the same rope for Europe’s security”*, ProPress Publishing group Brussels/Berlin, Berlin. EU.

64. U.S. Department of Justice, (2007), “*Asset Forfeiture policy manual*”, DoJ, Washington, USA.
65. UDIHR-OSBE, (2011), “Manual për mbrotjen Penale ndërkombëtare”, UNICRI, Turin, Italy.
66. Ujkani, Emrush, (2012), “*E drejta e Bashkimit Evropian*”, Qendra Juridike e Kosovës, Prishtinë, Kosovë.
67. UNEP, (2014), “Compendium on Human Rights and the Environment: Selected international legal materials and cases”, p.82, Nairobi, Kenya.
68. UNITAR, (2002), “*Global Terrorism- A course produced by the United Nations Institute for Training and research, Programme of correspondence Instruction In Peacekeeping operations*”, UN, New York, USA.
69. UNODC, (2010), “*Guidance on the preparation and use of serious and organized crime threat assessments*”, Socta, Vienna, Austria.
70. UNODC, (2013), “*Biznesi, korrupsioni dhe krimi në Kosovë: Ndikimi i ryshfetit dhe i krimit tjetër në ndërmarrjet private*”, UNODC, Vienna, Austria.
71. Vodineliq, Vladimir, (1970), “*Kriminalistika*”, Enti teksteve mësimore, Prishtinë, Kosovë.
72. West, Simon, P, and Schultz, L, (2015), Learning for resilience in the European Court of Human Rights: adjudication as an adaptive governance practice.*Ecology and Society*, 20(1), 31.
73. Willcoxon, George, (2005), “*Përmbledhje e ligjeve kundër terririzmit dhe krimit të organizuar*”, Qendra Judirike e Kosovës, Prishtinë, Kosovë.

Burime nga interneti:

1. Analiza mjedisore e shtetit. Marrë nga Banka Botërore:
http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/Resources/KosovoCEA_Alb.pdf (parë me 2.11. 2014).
2. Deklarata e samitit botëror të ushqimit, 1996, në [www.http://www.mae.ro/sites/default/files/file/pdf/2014.06.25_summit_declaration.pdf](http://www.mae.ro/sites/default/files/file/pdf/2014.06.25_summit_declaration.pdf) (12 gusht 2014).
3. Të dhëna nga Agjencia Evropiane e statistikave EUROSTAT. Marrë nga http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Asylum_statistics#Asylum_applicants. (parë me 12 shtator 2015).
4. Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Kosovës, për muajin dhjetor 2015.
<https://ask.rks-gov.net> (parë me 12.02.2016)
5. Siguria mjedisore. Marrë nga: <http://www.envirosecurity.org/> (parë me 12.05.2014)
6. Koorporata Energjetike të Kosovës. Marrë nga: <http://www.kek-energy.com/> (parë me 11.09.2013)
7. KFOR. Marrë nga faqja: http://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/pdf_2015_02/20150127_150201-kfor-placemat.pdf (parë me 12.05.2014)
8. Ndryshimet krimaterike të qeverisë së Kanadasë. Marrë nga: <http://www.nrcan.gc.ca/forests/climate-change/13083> (parë me 30.11.2013)
9. Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara. Marrë nga: <http://www.un.org/millenniumgoals/> (parë 10.7. 2013)
10. EULE – Marrë nga: <http://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,2> (parë 3.7.2014)
11. Raporti i Departamentit të Shtetit, të SHBA, 2014. Marrë nga: <http://www.state.gov/j/ct/rls/crt/2014/239406.htm> (parë me 05.01.2015)

12. Në mbrojtje të mjedisit, UNEP. Marrë nga [www.
http://postconflict.unep.ch/publications/uranium.pdf](http://postconflict.unep.ch/publications/uranium.pdf) (parë, 2.6.2014)
13. Azilkërkuesit Kosovar në Evropë: Marrë nga [www.
http://www.indeksonline.net/lajme/1453/eurostat-kosova-renditet-e-4-ta-66-885-shtetas-kerkuan-azil-ne-vitin-2015/](http://www.indeksonline.net/lajme/1453/eurostat-kosova-renditet-e-4-ta-66-885-shtetas-kerkuan-azil-ne-vitin-2015/) (parë me 05 mars 2016).
14. Manuali për matjen e dënimeve në SHBA - *United States Sentencing Commission, Guidelines Manual, §3E1.1 (Nov. 2015)*. Marrë nga [www.
http://www.ussc.gov/sites/default/files/pdf/guidelines-manual/2015/GLMFull.pdf](http://www.ussc.gov/sites/default/files/pdf/guidelines-manual/2015/GLMFull.pdf).
25. Manuali për matjen e dënimeve në Britaninë e madhe: *Sentencing Guidelines Council, Magistrates' Court Sentencing Guidelines (2008)*. Marrë nga [www.
https://www.sentencingcouncil.org.uk/wp-content/uploads/MCSG_web_-_October_2014.pdf](https://www.sentencingcouncil.org.uk/wp-content/uploads/MCSG_web_-_October_2014.pdf)

CITIME DHE REFERENCA:

1. Aaron X. Fellmeth & Maurice Horwitz, (2009), *Guide to Latin in International Law*, “*Right to punish - The state’s right to punish criminal offenses pursuant to its laws within the limits of the international*”, Oxford University Press, Oxford, New York, USA.
2. Abazovic, Mirsad, (2006), “*Siguria nazionale*”, 35, Universiteti AAB”, Prishtinë, Kosovë.
3. Adle, Emanuel & Barnett, Michael, (1998) “*Security Communities*”, Cambridge University Press, 484, Cambridge, New York, USA.
4. Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, (2010), “*Raport mbi gjendjen e natyrës*” UNDP, Prishtinë, Kosovë.
5. Alp, Ali Hikmet, (2000), “*The South-East Europe Co-operation Process: an Unspectacular, Indigenous Regional Co-operation Scheme: Perceptions, international Journal of European Affairs*”, 5(3), Ambassador (retd.) Ali Hikmet Alp often leads the Turkish delegation to the Committee of Political Directors, A brief history: From random meetings towards as institution, Brussels, Belgium.
6. AMMK, (2008), “*Biodiversiteti Kosovës*”, 13, përgatitur nga Qenan Maxhuni, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Prishtinë, Kosovë.
7. Amouyel, Alexandra, (2006), “*What is human security*”, *Human Security Journal*, 1(06), 13, New York, USA.
8. Anger, Joakim, (2012), “*Reform cooperation in the Western Balkans—regional cooperation: experiences, constraints and opportunities*”, 1-78, final report, Sida, Stockholm, Sweden.

9. Arnold Wolfers, (1952), “*National Security as an Ambiguous Symbol*”, *Political Science Quarterly*, Vol 67, No. 4, 482, JSTOR, Yale University, New Haven, Connecticut, USA.
10. Assembly, O. G. (2001),”*Road map towards the implementation of the United Nations Millennium Declaration: Report of the Secretary-General*”,*In Road map towards the implementation of the United Nations Millennium Declaration: report of the Secretary-General*. United Nations, New York, USA.
11. Assembly, U. G. (1948). Universal declaration of human rights. *UN General Assembly*, New York, USA.
12. Baier, Kurt, (1981). When does the right to life begin Human Rights, *Nomos* 23, ed. J. R. Pennock & J. W. Chapman, 201-229, New York, USA.
13. Barber, Benjamin R, (2003), “*Strong democracy: Participatory politics for a new age*, 20 anniversary edition, 1-232, University of California Press, London England.
14. Basigalup, Daniel Horacion. and others, (2006). ProINTA Carmina. first Argentine Alfalfa cultivar tolerant to bloat. Resumen. In *North American Alfalfa Improvement Conference. 40, Trifolium Conference. 19. 2006 07 16-19, July 16-19, 2006. Bloomington, Minnesota. USA*.
15. Bauman, Zygmund, (2013), “*Community: Seeking safety in an insecure world*”, 168, 8 ed, John Wiley & Sons, E-book, Maiden, Massachusetts, USA.
16. Bechev, D. (2006), “Carrots, sticks and norms: the EU and regional cooperation in Southeast Europe”, *Journal of Southern Europe and the Balkans*, 8(1), 27-43. Oxford, United Kingdom.

17. Bernard Bouloc, (2007), "*Droit Pénal général*", Dalloz, 20⁶ⁿ ed , n^o 30. Adde, P.Bouzat, *Traite de droit pénal et de criminologie*, Tome 1,2⁶ⁿ ed, Dalloz, 1970, n^o 1, Paris, France.
18. Betts, Richard K, (1992), "Systems for peace or causes of war? Collective security, arms control, and the new Europe", *International Security*, 5-43, vol 17, at: Brown, Mitchael, "Theories on war and peace", Harvard college, Massachusetts, USA.
19. Brand, Judith and Idrizi, Valdete, (2012) "Grass-root Approaches to Inter-Ethnic Reconciliation in the Northern Part of Kosovo," Kosovar Institute for Policy Research and Development, p.,4, Prishtina, Kosovo.
20. Burke, Anthony, (2002), "*Beyond Security, Ethics and Violence*", *War against the other, Aporias of security. Alternatives*, 1-27, Routledge, New York, USA.
21. Canetti, Ran; Dodis, Yevgeniy; Pass, Rafael, & Walfish, Shabsi, (2007), "*Universally composable security with global setup*", *In Theory of Cryptography*, 61-85, Springer Berlin Heidelberg, Berlin Germany.
22. Cassese, A., Gaeta, P., & Jones, J. R. (Eds.). (2002). *The Rome statute of the International Criminal Court: a commentary* (Vol. 1). Oxford University Press, Oxford, England.
23. CDU, (2008), "Parimet e Lirisë dhe Sigurisë për Gjermaninë - Manifesti i partisë së unionit kristian demokrat të Gjermanisë- Materiale për edukim qytetar dhe bashkëpunim ndërkombëtar të Fondacionit Konrad Adenauer", Fondacioni Konrad Adenauer, 7, Berlin, Gjermani.

24. Christopher M. Dent, (2007), ""Economic Security“, në Allan Collins (ed.), "Contemporary Security Studies", Oxford University Press, 2007, 256, Oxford, United Kingdom.
25. Cimamonti, Sylvie, (1996), "*L'ordre public et le droit pénal, in L'ordre public a la fin du XX' siècle*", 89, Dalloz, Paris, France.
26. Colin Powell, (2002), US Secretary of State "The United Nations Environment Program" (UNEP), special edition magazine, "Our Planet", World Summit for Sustainable Development", New York, USA.
27. Collins, Alan, (2007), "Studime bashkëkohore të sigurisë", 262, UET Press, Tiranë, Shqipëri.
28. Collins, Alan, (2013), "*Contemporary security studies*", Third ed, Oxford press university, 129-131, Oxford, United Kingdom.
29. Collins, Alan, 2007, "*Contemporary security studies*", 129-131, Oxford press university, New York, USA.
30. Commission of the European Communities, (2008), 05.11.2008 SEC (2008) 2692 final, Brussels, Belgium;
31. Cornish, Derek B, & Clarke, Ronald V, (Eds.), (2014), "*The reasoning criminal: Rational choice perspectives on offending*", 1-228, Transaction Publishers, New Jersey, USA.
32. Council of Europe, (2005), "*Trajnig for terrorism, of Convention on the prevention of Terrorism: article 7*", Council of Europe, Strasbourg, France.

33. Davies, Paul, (2008). *The Goldilocks enigma: why is the universe just right for life?* H. Mifflin Harcourt, 228-233, Boston-New York, USA.
34. De Burca, Gráinne, (2009), “*The EU, the European Court of Justice and the international legal order after Kadi*”, *Harvard international law journal*, 1(51), Cambridge, Massachusetts, USA.
35. DeMartino, Manfred F, (1963), “*Sexual behavior and personality characteristics: Dominance - feeling, security-insecurity, and sexuality in women*”, 113-143, *The Citadel Press New York*, New York, USA.
36. Demolli, Haki, (2008), “*Terrorism in Kosovo and Measures against it*”, at, *Iztok Prezelj, 2008, Nato security through science series e human and societal dynamics*, 32, 114, Amsterdam, Netherlands.
37. Dodde, Felix(Ed), (2005), “*Human and Environmental Security: An Agenda for Change*”, Earthscan Publications, Limited, London, United Kingdom.
38. Domat, Jean, (1723),”*Le droit public, suite des lois civiles dans leur ordre naturel*”, et s. *livre III, des crimes et des délits*, p.190, Paris, France.
39. Ecological Society of America, (1999), “*Issues on Ecology*”, Number 4, 3, *Biodiversity and Ecosystem Functioning: Maintaining Natural Life Support Processes*, Arizona, USA.
40. Edmund F. McGarrell and Paul B. Stretesky, (2011), *Environmental and natural-resources crime*, *International journal of comparative and applied criminal justice*, volume 34, Routledge, Taylor & Francis group, Michigan, USA.

41. Eide, Asbojrn, (1989) Raporti i Raportuesit Special mbi të drejtat në ushqim adekuat, dokument i KBE/CN.4/ sub. 2/1987/23. 35, New York, SHBA.
42. Elden, Stuart, (2006), "Contingent sovereignty, territorial integrity and the sanctity of borders", *SAIS review*, 26(1),11-24, Volume 26, Number 1, Winter-Spring 2006, Project MUSE The Johns Hopkins University Press, Baltimore, Maryland, USA.
43. Elezi, Ismet; Hysi, Vasilika, (2006), "*Politika Kriminale*", 40-41, PEGI, Tiranë, Shqipëri.
44. Enri Hide, (2012). "*Siguria njerëzore në Shqipëri: mes teorisë dhe praktikës. Analizë e sondazhit mbi sigurinë njerëzore*", Ky shkrim është në kuadër të punimeve shkencore të konference rajonale "Siguria njerëzore në kontekst rajonal", UET press, 20, Tiranë, Shqipëri.
45. Erhard Busek, (2006), "*10 Years Southeast European Cooperative Initiative From Dayton to Brussels*", Pg.1-10, Springer-Verlag. Wien, Austria.
46. European Union, (2012), "Treaty on European Union and the Treaty on the Functioning of the European Union," 2012/C 326/01, Bruxel, Belgium.
47. Evans, Carolyn, (2001), "*Freedom of religion under the European Convention on Human Rights*", Vol. 1, Oxford University Press, Oxford, United Kingdom.
48. Frashër Demaj, (2001), "Britania e Madhe dhe çështja Shqiptare 1875-1913", 71, UP, Prishtinë, Kosovë.
49. FRIDOM, (2009), "*Rishikimi funksional i sistemeve të anti korrupsionit*", 42, Freedom House, Iniciativa Kosovare për Stabilitet, SIGMA, Transparency International dhe UNDP, Prishtinë, Kosovë.

50. Ganor, Boaz, (2002), "Defining terrorism: Is one man's terrorist another man's freedom fighter?", *Police Practice and Research*", 3(4), 287-304, The International Policy Institute for Counter-Terrorism Journal, volume 3, issue 4, Herzlia, Israel.
51. Garcia-Mora, Manuel R, (1962), "*The Nature of Political Offenses: A Knotty Problem of Extradition Law*", *Virginia Law Review*, 1226-1257, JSTORE, Virginia, USA.
52. Garner, B. A., & Black, H. C. (2004), "*Black's law dictionary*" St. Paul, MN: Thomson/West, Chicago, USA.
53. Godfray, Hugh Charles Jonathan and others, (2015), "*Food security: the challenge of feeding 9 billion people*", *science*, 327(5967), 812-818, West Sussex, Great Britain.
54. Griffin, Stephen M, (1998), "*American constitutionalism: from theory to politics*", *Princeton University Press*, 32, New Jersey, USA.
55. Gruda, Zejnullah, (2003), "*E drejta ndërkombëtare publike*", Libri II, Universiteti i Prishtinës, 142-204, Prishtinë, Kosovë.
56. Gudmundur Alfredson, Asbjorn Eide, (1999), "*Deklarata universal mbi të drejtat e Njeriut-Standardi i arritjes së përbashkët*" "Martinus Nijhoff Publishers, Hagë/Boston/Londër.
57. Habermas, Jürgen, (1991), "*The structural transformation of the public sphere: An inquiry into a category of bourgeois society*", 102-107, MIT press, University of Oregon, USA.

58. Habermas, Jürgen, (1992), *“Faktizität und Geltung, Beitrage zur Diskrstheorie des Rechts und des demokratischen Rechtsstaats”*, Suhrkamp Verlag, Frankfurt am Main, Germany.
59. Habermas, Jürgen, (1996), *“Between facts and norms”*, trans. William Rehg, Polity, Oxford, 274-328, Oxford, New York, USA
60. Habermas, Jürgen, (1996), *“Contributions to a discourse theory of law and democracy”*, 293, Cambridge Polity Press, Cambridge, United Kingdom.
61. Hanski, R & Suksi, M, (1999), *“Instituti për të drejtat e njeriut, Universiteti i Abo Akademisë”*, *“Hyrje në Mbrojtjen Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut”*, botimi 2, Institute for human rights, 6, Prishtinë, Kosovë.
62. Hart, Herbert Lionel Adolphus & Honoré, Tony (1991), *“Causation and Responsibility, në Philosophy of Law”*, 4 ed, p 510, Wadsworth Publisching Company, Belmont California, USA.
63. Hart, Herbert Lionel Adolphus, (2002), *“Eine Vereinigungstheorie von Prävention und Vergeltung, në Recht und Moral, Texte zur Rechtsphilosophie, Hrsg von N. Hoerster”*, 277, Reclam Verlag, Stuttgart, Germany.
64. Hasani, Enver; Čukalović, Ivan, (2013), *“Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës”*, bot.1, GIZ, Prishtinë, Kosovë.
65. Hay, Anthony W. (2002) *“Konferenca mbi Mësimet rreth gjeografisë dhe Gjeopolitikës dhe vërejtjet mbi këtë subject”*, marrë nga Shehu, K. M., & Moisiu, S. (2011), *“roli i drejtimit dhe Siguria”*, Revista ushtarake, 148, Tiranë, Shqipëri.
66. Henk, Dan, (2005), *“Human Security: Relevance and Implications”*, Parameters, Air war coll Maxwell, afb, al, p 91-106, Alabama, USA.

67. Hope, Tim, (1995), "*Community crime prevention: Crime and Justice*", 21-89, the university of Chikago, USA.
68. Huey, Laura, (2012), "*Invisible Victims: Homeless and the Growing Security Gap*", 174pp, Toronto, Ontario: University of Toronto Press, Toronto, Canada.
69. Hughes, Christopher, (2004), "*Japan's security agenda: Military, economic, and environmental dimensions*", 22-29, Lynne Rienner Publishers, Boulder, Colorado, USA.
70. Hyde, Charles Cheney, (1922), "*International law chiefly as interpreted and applied by the United States*", Vol. 1, No: 2, Little, Brown, 1019, Boston, USA.
71. International Journal of Comparative and applied criminal justice,(2011), "Official journal of the American Society of Criminology", 267-268, Routledge, Michigan,
72. Jacques, Robert, (1986), "*Terrorisme, ideologjie securitaire et libertes publique*", *chronique juridiciare et constitutionnelle*, RDP, p 1651, Montchrestien, 1988, Paris, France.
73. Jashari, Muhamed, (2015), "*Koncepti i të drejtave të njeriut, sovranitetit shtetëror dhe përgjegjësia për të mbrojtur*", 445, Shkup, Maqedoni.
74. Jeanclos, Yves, (2009), "*Droit Pénal Européen*", *Edition Economica*, 15, Paris, France.
75. Jeffery, C. Ray, (1977). *Crime prevention through environmental design* (p. 351), Beverly Hills: Sage Publications, Florida, USA.
76. Jock Martin, Thomas Henrichs, (2010), Mjedisi i Evropës, Gjendja dhe Perspektiva 2010, *Sintezë*, Shtypur nga Rosendahls-Schultz Grafisk, Kopenhagë, Danimarkë.

77. Kahler, Miles, (2004), "*Economic Security in an Era of Globalisation: Definition and Provision*", *Pacific Review*, Vol. 17(4), 485-502. At, Collins, Alan, (2007), "*Contemporary Security Studies*", Oxford, New York, USA.
78. Kambovski, Vlado, (2011), "*Kazneno pravo*", opsht del, Skopje: 2-ri Avgust S-Stip (466), Skopje, Makedonija.
79. Kant, Immanuel, & Ellington, James (1993), "*Grounding for the Metaphysics of Morals: with on a supposed right to lie because of philanthropic concerns*"p 69, 3 ed, Hackett Publishing, Indianapolis, Indiana, USA.
80. Kelsen, Hans, (1945), "*General theory of law and state*" 3-14, (Vol. 1), translated by Anders Wedbert, The Lawbook Exchange, Ltd, New Jersey, USA.
81. Kelsen, Hans, (1948), "Collective security and collective self-defense under the charter of the United Nations", *Am. J. Int'l L.*, 42, 783, New Jersey, USA.
82. Kelsen, Hans, (2003), "*Principles of international law*", 73, *The Lawbook Exchange, Ltd*, Klark, New Jersey, USA.
83. Këshilli Europës, (2001), "*Për një rend publik European- vendime të zgjedhura të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut*", 3-8, *Qendra shqiptare e të drejtave të njeriut*, Tiranë, Shqipëri.
84. Këshilli i Evropës, (1992), "*Rekomandim Nr. (92)17, i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare lidhur me konsistencën në matjen e dënimeve*", *Miraturar nga Komiteti i Ministrave, me 19 tetor 1992 në takimin e 482*, Strasburg, Francë.
85. Këshilli i Evropës, (2002), "*Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut neni 5: E drejta për jetën dhe sigurinë e personit*", Romë, Itali - Strasburg, Francë.

86. King, Gary & Murray, Christopher, (2001-2002), “*Rethinking Human Security*”, *Political Science, Quarterly*, Vol. 116, No. 4, p 585-610, Euroakadeemia, University in Kristiine, Tallinn, Estonia.
87. Knoblock, John, (1994), *Xunzi: A translation and study of the complete works* (Vol. 3). *Stanford University Press*, 127-138, Stanford, California, USA.
88. Kohler, Anne Marie and others, (1989),”Montesquieu. Spirit of Laws”, *Cambridge tests in the History of Political Thought*, Cambridge University Press, Cambridge, United Kingdom.
89. Komisioni Evropian, (2004), “*Liri, siguri dhe drejtësi për të gjithë*”, 4, Bruksel, Belgjikë.
90. Koskeniemi, Marti, (1995), “*Place of Law in Collective Security*, *The Mich. J. Int'l L.*, 17”, 455, Turku, Finland.
91. Kupchan, Charles A, (1995), “The promise of collective security”, 52-61, Published by: Wiley on behalf of The International Studies Association, *International Security*, vol. 40, no; 2, New Jersey, USA.
92. Latifi, Vesel, (2008), “*Politika Kriminale*”, 27-78, UP, Prishtinë, Kosovë.
93. Latifi, Vesel; Elezi, Ismet dhe Hysi, Vasilika, (2012), “*Politika e Luftimit të Kriminalitetit*”, 65-75, *Juridica*, Prishtinë, Kosovë.
94. Lee, Jonah, (2009), “A War for Water”, *In World Environmental and Water Resources Congress Great Rivers*, 3897-3905, American Society of Civil Engineers, ASCE, New York, USA.

95. Liszt, Franc Von, (1911), *“Traite de droit pénal allemande”*, traduit de la 17^e édition allemande (1908) par R., Lobstein, Paris, V.Giard & E.Briere, Tom 1, p 1, Paris, France.
96. Lopandić, Duško, (2001), *“Regional Initiatives in South Eastern Europe: an Assessment”*. In *SEED International Conference on Restructuring Stability and Development in Southeastern Europe*, Institute for International Politics and Economics, Belgrade, Serbia.
97. Macpherson R, Burkle (2013), *“FM Jr. Neglect and failures of human security in humanitarian settings: challenges and recommendations”*, Prehosp Disaster Med.; 28 (2):1-5, Charlotte, North Carolina USA.
98. Makovei, Monika (2002), *“E drejta për lirinë dhe sigurinë e personit - Një udhëzues për zbatimin e Nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*, 17, *Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut Këshilli i Evropës F-67075*, Strasbourg, Belgjikë.
99. MALP, (2014), *“Doracak për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi”*, 26, Qeveria Kosovës, Prishtinë, Kosovë.
100. MAPL (2013), *“Raport për funksionimin e Komunave të Republikës së Kosovës”*, 21-22, Qeveria Kosovës, Prishtinë, Kosovë.
101. Marthews, Bob dhe Ross, Liz, (2010) *“Metodat e hulumtimit- Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane”*, Qendra për Arsim Demokratik, fq.1-481,Tiranë.
102. McDougal, M. S and Lasswell, H. D, (1959), *“The Identification and Appraisal of Diverse Systems of Public Order”*, 29, American Journal of International Law, Massachusetts, USA.

103. McDougal, Myres Smith (1960), *"Studies in the World Public Order"*, 3-12, Yale University press, Printed in Amsterdam, Netherland.
104. McKean, Warwick, (1983), *"Equality and discrimination under international law"*, Michigan Law Review, Vol. 82, No. 4, 1984, Survey of Books Relating to the Law (Feb., 1984), 908-913, Michigan, USA.
105. McRae, Robert Grant and Hubert, Don, (2001), *"Human security and the new diplomacy: Protecting people, promoting peace"*, McGill-Queen's Press-MQUP, 15-74. Québec, Canada.
106. Mejdani, Rexhep (2007), citim nga seminari *"Zhvillimi i Strategjisë Kombëtare të Sigurisë"* të organizuar në Hotel Tirana Internacional me datë: 21.09.2007,(shikuar me: 12.12.2012), Tiranë, Shqipëri.
107. MFSK, (2014), Revista *"Forca jonë"*, Viti III, Nr. 29, 1, Qeveria Kosovës, Prishtinë, Kosovë.
108. Mill, John Stuart, (2000), *"Një sistem Logjike, në Utilitarizmi dhe shkrime të tjera"*, ISP&Dita, 77, Tiranë, Shqipëri.
109. Mill, John Stuart. (2015), *"On liberty"*, Oxford university press, 85, Oxford, United Kingdom.
110. Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës, (2011),*"Strategjia Nacionale dhe Plan i Veprimit për Sigurinë në Bashkësi 2011-2016"*, Qeveria Kosovës, Prishtinë, Kosovë.
111. Newman, Edward, (2001), *"Human security and constructivism"*, International Studies Association, 2(3), 239-251, Wiley-Blackwell, Connecticut, USA

112. Nippel, Wilfried, (1995), *“Public order in ancient Rome”*, p 9, Cambridge University Press, Cambridge, New York, USA.
113. Nicholl, Desmond, (2008), *“An Introduction to Genetic Engineering”*, 3rd edition, Cambridge university press, Cambridge, New York, USA.
114. Oberleitner, Gerd, (2002), *“Human Security and Human Rights”*, Occasional Paper Series, 8, 1-29, Graz, Austria.
115. OKB, (1948), *“Deklarata universale e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut”* UN, New York, SHBA.
116. Orakhelashvili, Alexander, (2011), *“Collective security”*, 4-86, Oxford University Press, Oxford, United Kingdom.
117. OSBE, (2010), *“Sistemi i drejtësisë penale në Kosovë: 2007-2010”*, 16, OSBE, Prishtinë, Kosovë.
118. OSBE, (2010), *“Vlerësimi i ndikimit: Ekipet e Kosovës për Sigurinë në Bashkësi”*, 42, OSBE, Prishtinë, Kosovë.
119. Owen, Taylor, (2004), *“What is ‘Human Security- Security Dialogue’*, Vol. 35, 347-87, International Peace Research Institute, Oslo, Norway.
120. Paris, Roland, (2001). *“Human security: Paradigm shift or hot air”*, 87-102, Journal article, Vol. 26, No. 2, International security, Harvard college, Masachussets, USA.
121. Pateman, Carole, (1976), *“Participation and democratic theory”*, 1-101, Published by the Syndics of the Cambridge University Press, New York, USA.
122. Pauline Kerr, (2010), *“Human Security”*, 121-135, In Allan Collins (ed), 3 ed, 2015, *“Contemporary Security Studies”*, Oxford University Press, Oxford, U.Kingdom.

123. Per, Pinstруп-Andersen, (2009), "*Food security: definition and measurement*, *Food security*, 1(1), 57, *The Earth Institute at Columbia University*, New York, USA.
124. Percy, Stephen L, (1978), "*Conceptualizing and Measuring Citizen Co-Production of Community Safety*", *Policy Studies Journal*, 7(s1), 486-493, *Indiana University*, Pennsylvania, USA.
125. Percy, Stephen L, (1987), "*Citizen Involvement in coproducing safety and security in the community*", 83-93, M.E. Sharpe, Inc, New York, USA.
126. Petersen, Poul Erik (2003), "*The World Oral Health Report 2003: continuous improvement of oral health in the 21st century—the approach of the WHO Global Oral Health Programme*, *Community Dentistry and oral epidemiology*", 31(s1), 3-24, *John Wiley & Sons*, Geneva, Switzerland.
127. Philippe Conte, (2005), "*Remarque sur la conception contemporaine de l'ordre public pénal en France*", 233, *Revista studimore Juridike* nr, 1, Tiranë, Shqipëri.
128. Pinstруп-Andersen P & Pandya-Lorch, R. (1998), "*Food security and sustainable use of natural resources: a 2020 vision*", 1-10, *Ecological economics*, *The Transdisciplinary Journal of the The International Society for Ecological Economics*, 26(1), Washington DC, USA.
129. Pogge, Thomas, (2007), "*Severe poverty as a human rights violation: Freedom from poverty as a human right: who owes what to the very poor*", 11-53, *UNESCO Publishing*, Oxford university press, Oxford, New York. USA.
130. Posch, Albert (2009), "*The Kadi Case: Rethinking the relationship between the EU law and International Law*", p15, *Columbia Journal of European Law*, New York.

131. Puig, Santiago Mir, (2004), “*Valoraciones, Normas y Antijuridicidad Penal*”, p 5, *Revista Electronica de Cienca Penal y Criminologia, Catedrático de Derecho Penal, Universidad de Barcelona, Barcelona, Espana.*
132. Qeveria e Kosovës, (2012), “*Përgjigjet e pyetësorit për përgatitjen e Studimit të Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit*”, Qeveria Kosovës, Prishtinë, Kosovë.
133. Reka, Blerim; Holl, Otmar; Sela, Ylber, (2010), “*Institucionet dhe politikat e Unionit Evropian*” 32-33, Tetovë, Maqedoni.
134. Rousseau, Jean Jacques, & Gourevitch, Victor, (1997). *Rousseau: 'The Social Contract' and Other Later Political Writings*. Cambridge University Press, 64, Cambridge, United Kingdom.
135. Rousseau, Jean Jacques, (1762), “*Du contract social, Ou Principes du Droit Politiques*”, 116, Marc Michel, Amsterdam, Netherland.
136. Rousseau, Jean Jacques, (1920). “*The Social Contract*”: & *Discourses, translated with an Introduction by G.D.H. Cole: J.M.Dent and Sons, 1923, 8/7/2015, 638, London and Toronto, printed in Great Britain.*
137. Rousseau, Jean Jacques, (1984), “*A discourse on inequality*”, Dover Publications, INC, 1-192, Mineola, New York, USA.
138. Rousseau, Jean Jacques, (1998), “*Kontrata Sociale*”, *Shtëpia Botuese Luarasi*, 21, Tiranë, Shqipëri.
139. Rousseau, Jean Jacques, (2000), “*Discourse on the Origin of Inequality*”, *Oxford University Press, Oxford, New York, USA.*

140. Rousseau, Jean Jacques, and Gourevitch, Victor, (1997). *Rousseau: 'The Social Contract' and Other Later Political Writings*", 156, Cambridge University Press, Cambridge, United Kingdom.
141. Sadiković, Lada (2006), "Të drejtat e njeriut", 11, Universiteti i Sarajevës, Sarajevë, Bosnja dhe Hercegovina.
142. Salihu, Ismet, (2005), "E drejta penale - pjesa e përgjithshme", 633, UP, Prishtinë, Kosovë.
143. Salihu, Ismet, (2011), "E drejta penale ndërkombëtare", 91-342, U.FAMA, Prishtinë, Kosovë.
144. Salihu, Ismet, Zhitija, Hilmi dhe Hasani, Fejzullah, (2014), *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës*, botimi 1, *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*, 1-1176, Prishtinë, Kosovë.
145. Salihu, Ismet; Zhitija, Hilmi dhe Hasani, Fejzullah, (2012), "Komentar i Kodit Penal të Kosovës", 560, Prishtinë, Kosovë.
146. Sandifer, Durward, (1939), "Evidence before international tribunals" p. 211, *Chicago Foundation Press*, Chicago, USA.
147. Sarooshi, Danesh, (1999), "The United Nations and the development of collective security: The delegation by the UN Security Council of its Chapter VII Powers", Oxford University Press, Oxford, New York, USA.
148. Schneiner, Bruce, (2003), *Beyond fear: Thinking sensibly about security in an uncertain world*", 275-281, *Springer Science & Business Media*, New York, USA.

149. Skoler, Daniel L, (1975), "World implementation of the United Nations Standard Minimum Rules for treatment of prisoners", *J. Int'l L. & Econ.*, 10, 453, William S. Hein & Co., Inc., New York, USA.
150. Tatalovic, Siniša and Bilandžić, Mirko, (2006), "*Osnove nacionalne sigurnosti*", MUP Republike Hrvatske, Zagreb, Hrvatska.
151. Thakur, Ramesh & Newman, Edward, (2004), "*Broadening Asia's Security and Discourse Agenda*", 347pp, United Nations University Press, Tokyo, Japan.
152. Thakur, Ramesh, (2004), "A political worldview", *security Dialogue*, 35/3:347, United Nations University press, New York, USA.
153. Travis, Phyllida and others, (2004), "*Overcoming health-systems constraints to achieve the Millennium Development Goals*", 364(9437), 900-906, at *The Health Journal: The Lancet*, Elsevier RELX Group plc, Atlanta, USA.
154. Ul Haq, Misbah, (1994), "*Reflections on human development*" (No. HDOCPA-1994-11). Human Development Report Office (HDRO), United Nations Development Programme (UNDP).
155. UN, (1994), "*Declaration on Measures to Eliminate International Terrorism* annex to UN General Assembly resolution 49/60,"*Measures to Eliminate International Terrorism*," of December 9, 1994, *UN Doc. A/Res/60/49*. At: Sarker, M. F. H., & Salam, M. A. *Uprising Terrorism in Bangladesh: A Threat to Internal Security*, UN, New York, USA.
156. UN, General Assembly, (1994), 49/60, par.II-5/a. "*Measures to eliminate international terrorism*", UN, New York, USA.

157. UN, General Assembly, O. G. (2001). *“Road map towards the implementation of the United Nations Millennium Declaration: Report of the Secretary-General. In Road map towards the implementation of the United Nations Millennium Declaration: report of the Secretary-General”*, New York, USA.
158. UNDP, (1994), *“Human Development Report– New Dimensions of Human Security*, Oxford University Press, New York, USA.
159. UNDP, (1994), *“Human Development Report: New Dimensions of Human Security”*, Oxford University Press, New York, USA
160. United Nations, (2001), *“Environment Programme, Depleted Uranium in Kosovo Post-Conflict Environmental Assessment”*, 27-52, First published by UNEP, Bern, Switzerland.
161. United States Department of Justice, International Criminal Investigative Training Assistance Program (ICITAP), pp 10, Program Management Plan for Kosovo, DoJ, Washington, USA.
162. UNODC, (2013), *“United Nations Standards and Norms in Crime Prevention At your finger tips”*, New York, USA.
163. Varwick, Johannes (2003). *The Kosovo Crisis and the European Union: The Stability Pact and its Consequences for EU Enlargement. International politik*, 4. Cite: Bildt, Carl: *“Rebuilding the Balkans”*, *Financial Times*, 21 June 1999, New York, USA.
164. Vasak, K, (1977), Human rights: A thirty-year struggle: The sustained efforts to give force of law to the Universal Declaration of Human Rights, UNESCO Courier, 30, 11, Paris: United Nations Educational, Scientific, and Cultural Organization.

165. Velleman, David, (1999), "A Right of Self Termination? *Ethics*", 109(3), 606-628, Oxford: Oxford University Press, Oxford, United Kingdom.
166. Waddington, P. A. (1994), "*Liberty and order: Public order policing in a capital city*", 2-25, *University college London*, London, Great Britain.
167. Wilson, Carol, (2015), "*Freedom at Risk: The Kidnapping of Free Blacks in America, 1780-1865*", University Press of Kentucky, USA.
168. Wraight, Christopher D, (2008), "*Rousseau's' The Social Contract': A Reader's Guide*", Bloomsbury publishing, 223, London, New Delhi, New York, Sydney.
169. Yack, Bernard, (1985), "*Community and conflict in Aristotle's political philosophy*, 92, *The Review of Politics*", volume 47 issues 01, *Cambridge Journals*, Cambridge Univeristy press, Cambridge, United Kingdom.
170. Yang, Chao; Chandler, Harkreader and Gu, Guofei, (2011), "Die free or live hard? Empirical evaluation and new design for fighting evolving twitter spammers", In *Recent Advances in Intrusion Detection* (pp. 318-337), Success Lab, Texas A&M University, Texas, USA.